

SFIDAT E POLICISË SË KOSOVËS PËR LUFTIMIN DHE PARANDALIMIN E VEPRAVE PENALE TË KORRUPSIONIT NË RADHËT E SAJ

Kadri Arifi

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në

Shkenca Juridike, me profil E Drejtë Publike, për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Ass. Dr. Lulzim Tafa

Numri i fjalëve: 77539

Tiranë, Maj 2017

DEKLARATA E AUTORESISË

Nën përgjegjësinë time, deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Autori

Prishtinë, maj 2017

ABSTRAKT

Qëllimi i punimit është analizimi i veprave penale në fushën e korrupsionit zyrtar të kryera nga zyrtarët e Policisë së Kosovës në periudhën 2010-2015, i arritjeve në krijimin e infrastrukturës ligjore, i ngritjes dhe funksionimit të institucioneve të mbikëqyrjes dhe të kontrollit, i administrimit të disiplinës, i ndërtimit të kapaciteteve profesionale, si dhe i efikasitetit të tyre në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Policinë e Kosovës.

E themeluar më 6 shtator 1999, nën mandatin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Policia e Kosovës, përveç problematikës për ngritjen e kapaciteteve administrative dhe operacionale, u përball që në fillim me sfida të shumta, si pasojë e situatës së pasluftës, e procesit të tranzicionit, e ndryshimeve ekonomike, sociale e politike, e mungesës së legjislacionit dhe të mekanizmave adekuate të kontrollit dhe të parandalimit të krimit dhe korrupsionit.

Në këto kushte, mjaft sfidues ka qenë numri i madh i raportuar i veprave penale të korrupsionit, të kryera nga zyrtarët e Policisë së Kosovës. Kjo situatë diktonte nevojën e luftës kundër kësaj dukurie, të aplikimit të procedurave dhe të metodave për hetimin dhe parandalimin efikas të veprave penale të korrupsionit në Policinë e Kosovës.

Për këtë qëllim duheshin analizuar shkaqet, llojet dhe trendi i veprave penale dhe i keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga zyrtarët e policisë. Krahas punës së përditshme praktike të policisë në këtë drejtim, koha shtronte nevojën edhe të studimeve të mirëfillta shkencore të këtyre dukurive. Në këtë kuadër u ndërmor edhe ky studim, objekt i të cilit është adresimi i sfidave konkrete dhe të perspektivës për luftën kundër korrupsionit në radhët e Policisë së Kosovës, edhe përmes menaxhimit më të mirë të

personelit, forcimit të integritetit profesional të zyrtarëve policorë dhe rritjes së efikasitetit të mekanizmave të kontrollit dhe të mbikëqyrjes institucionale të Policisë së Kosovës.

Fjalët kyçe: Policia e Kosovës, veprat penale, korrupsioni, zbatimi i ligjit

ABSTRACT

The purpose of this research is the analyses of criminal acts in the field of the official corruption committed by the Kosovo Police officers in the period 2010-2015, of the achievements in establishing legal framework, establishing and functioning of institutions of control and oversight, administration of discipline, building professional capacities as well as their efficacy in preventing and combating corruption in Kosovo Police.

Established on 6th of September 1999, under the Resolution 1244 of the Security Council of the United Nations, Kosovo Police except the challenges in building the administrative and operational capacities, it faced many other challenges since the beginning, as a result of post war situation, transitional process, economic, social and political changes, lack of legislation as well as the lack of proper mechanisms of control and prevention of crime and corruption.

In these circumstances, the high number of reports of criminal acts of corruption committed by the officers of Kosovo Police was quite challenging issue. This situation urged the need for the fight against this phenomenon, for the application of procedures and methods for effective investigation and prevention of criminal acts of corruption in Kosovo Police.

Thus, the causes, types and trends of criminal acts and abuse of the office by the police officers had to be analyzed. In addition to the daily practical work of the police in this direction, it was a necessity of time for proper scientific study of this phenomenon. The research was conducted in this context, with the subject of addressing concrete challenges and in the perspective of fight against corruption in the Kosovo Police lines, also through better personnel management, strengthening professions integrity of police

officers and increasing the efficacy of the mechanism of control and institutional oversight of Kosovo Police.

Key words: Kosovo Police, criminal offences, corruption, law enforcement

DEDIKIMI

Dedikuar familjes sime....

FALËNDERIME

Dëshiroj të falënderoj udhëheqësin shkencor, prof. ass. dr. Lulzim Tafa, për motivimin, përkrahjen, këshillat dhe ndihmën e pakursyer që më ka dhënë gjatë gjithë kohës së studimeve.

Gjithashtu, shpreh mirënjohje dhe falënderim për drejtuesit, për stafin akademik dhe administrativ të Shkollës Doktorale të Universitetit European të Tiranës për përkushtimin e treguar në mbarëvajtjen e studimit.

Falënderoj personelin e Policisë së Kosovës, në veçanti, kolegët Bahri Ajvazi dhe Yll Azemi për bashkëpunimin dhe ndihmën e dhënë në përpunimin dhe sistemimin e të dhënave statistikore për qëllime të punimit.

Falënderoj familjen dhe të afërmit për mirëkuptimin dhe përkrahjen morale të treguar gjatë gjithë kohës së studimeve.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

DEKLARATA E AUTORËSISË.....	ii
ABSTRAKTI.....	iii
ABSTRACT.....	v
PËRMBAJTJA E LËNDËS	ix
LISTAT E FIGURAVE, TABELAVE DHE GRAFIKËVE	xiii
LISTA E SHKURTIMEVE.....	xiv
KREU I: HYRJE.....	1
1.1 Shtrimi i problemit	1
1.2 Arsytet e ndërmarrjes së studimit.....	2
1.3 Qëllimi dhe rëndësia e studimit.....	3
1.4 Hipotezat dhe pyetjet kërkimore të studimit	4
1.5 Metodologjia dhe metodat e kërkimit	6
1.6 Mundësitë dhe kufizimet e studimit.....	8
1.7 Struktura e punimit.....	9
KREU II: KORRUPSIONI NË POLICI SI FORMË E KORRUPSIONIT ZYRTAR..	12
2.1 Vështrim hyrës mbi korrupsionin zyrtar	12
2.2 Dukuria e korrupsionit në polici.....	17
2.3 Faktorët që ndikojnë në korrupsionin policor	29
2.4 Faktorët që ndikojnë në kryerjen e veprave të korrupsionit nga punonjësit e PK 34	
KREU III: ASPEKTI PENALO-JURIDIK I VEPRAVE PENALE TË	
KORRUPSIONIT	41
3.1 Rregullimi penalo-juridik i veprave penale të korrupsionit në legjislacionin e Kosovës	41
3.1.1 Objekti i mbrojtur tek ky grup veprash penale.....	43
3.2 Veprat penale në fushën e korrupsionit në Kodin Penal të Kosovës	44
3.2.1 Figura e veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” - Neni 422...47	
3.2.2 Figura e veprës penale “Keqpërdorimi i informatës zyrtare” – Neni 423.....	50
3.2.3 Figura e veprës “Konflikti i interesit” – Neni 424	51
3.2.4 Figura e veprës penale “Përvetësimi në detyrë” - Neni 425	54
3.2.5 Figura e veprës penale “Mashtrimi në detyrë” – Neni 426	56

3.2.6 Figura e veprës penale “Përdorimi i paautorizuar i pasurisë” – Neni 427	59
3.2.7 Figura e veprës penale “Marrja e ryshfetit” – Neni 428	59
3.2.8 Figura e veprës penale “Dhënia e ryshfetit” - Neni 429	63
3.2.9 Figura e veprës penale “Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj” - Neni 430	66
3.2.10 Figura e veprës penale “Ushtrimi i ndikimit” – Neni 431.....	67
3.2.11 Figura e veprës penale “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore” Neni 432.....	69
3.2.12 Figura e veprës penale “Zbulimi i fshehtësisë zyrtare” – Neni 433.....	71
3.2.13 Figura e veprës penale “Falsifikimi i dokumentit zyrtar” - Neni 434.....	73
3.2.14 Figura e veprës penale “Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme” - Neni 435	75
3.2.15 Figura e veprës penale “Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor” – Neni 436	76
3.2.16 Figura e veprës penale “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”–Neni 437....	77
3.2.17 Figura e veprës penale “Pranimi i paarsyeshëm i dhuratave” - Neni 315.....	78
3.2.18 Figura e veprës penale “Dhënia e paarsyeshme e dhuratave” - Neni 316.....	79
3.2.19 Figura e veprës penale “Moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale”-Neni 385 ..	80
3.3 Disa mangësi në dispozitat e KPK kundër korrupsionit, në raport me standardet ndërkombëtare	81
3.4 Legjislacioni në funksion të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.....	85
3.4.1 Ligji nr. 03/L- 159 Për Agjencinë Kundër Korrupsionit.....	87
3.4.2 Ligji nr. 03/l-178 për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë.....	90
3.4.3 Ligji nr. 04/l-051 për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik	91
3.4.4 Ligji nr. 04/l-050 Për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.....	92
3.4.5 Ligji nr.2004/3 Kundër diskriminimit.....	94
3.4.6 Ligji nr. 04/l-043 për Mbrojtjen e informatorëve.....	95
KREU IV: LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT	98
4.1 Trajtimi i dukurisë së korrupsionit në konventat ndërkombëtare	98
4.1.1 Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit.....	98
4.1.2 Konventa Civile për Korrupsionin	102
4.1.3 Konventa Penale Kundër Korrupsionit	102
4.1.4 Konventa e OECD-së Kundër Korrupsionit	103

4.2 Vështrim krahasimor i legjislacionit të Kosovës me legjislacione të huaja	104
4.2.1 Legjislacioni i Sllovenisë kundër korrupsionit, në aspektin krahasimor me Kosovën	105
4.2.2 Legjislacioni i Austrisë kundër korrupsionit, në aspektin krahasimor me Kosovën	112
4.2.3 Legjislacioni i Serbisë kundër korrupsionit, në aspektin krahasimor me Kosovën .	118
KREU V: ANALIZË E TË DHËNAVE RRETH VEPRAVE PENALE TË	
KORRUPSIONIT TË KRYERA NGA PUNONJËSIT E POLICISË SË KOSOVËS	124
5.1 Realizimi i kërkimit empirik dhe burimet e informacionit.....	124
5.2 Analiza e rasteve të hetuara nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK)	126
5.2.1 Trendi i ankesave të pranuar nga IPK	126
5.2.2 Trendi i rasteve penale të evidencuara nga IPK-ja.....	127
5.2.3 Numri i punonjësve të PK-së subjekte të hetimeve penale	128
5.2.4 Llojet më të shpeshta të veprave penale të hetuara ndaj punonjësve të PK	130
5.3 Hetimet penale të iniciuara ndaj zyrtarëve të PK për korrupsion zyrtar	132
5.3.1 Dinamika e veprave penale të korrupsionit zyrtar, në vitet 2010-2015	132
5.3.2 Llojet më të shpeshta të veprave të korrupsionit zyrtar	133
5.3.3 Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”	134
5.3.4 Dinamika e veprës penale “Marrja e ryshfetit”	135
5.3.5 Vepra penale “Falsifikimi i dokumentit zyrtar”	136
5.4 Analizë e të dhënave sasiore të fituara nga pyetësi lidhur me korrupsionin në PK.....	138
KREU VI: HETIMI I VEPRAVE PENALE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT E	
POLICISË SË KOSOVËS DHE PROBLEMET QË DALIN	154
6.1 Personeli policor subjekt i hetimeve penale	154
6.2 Ndarja e kompetencave për zhvillimin e hetimeve penale ndaj zyrtarëve të PK-së	156
6.2.1 Roli i PK-së në hetimet penale të zyrtarëve të saj.....	157
6.3 Roli i Inspektoratit Policor në hetimet penale ndaj punonjësve të PK-së	158
6.4 Iniciimi i hetimeve penale ndaj zyrtarëve të PK-së.....	161
6.4.1 Prezumi i pafajësisë së subjektit që hetohet.....	163
6.5 Ndjekja penale dhe gjykimi për rastet e korrupsionit.....	167
6.6 Politika penale për personat që janë dënuar për vepra penale të korrupsionit ...	173
6.7 Sfidat në administrimin e hetimeve penale ndaj zyrtarëve policorë	179

KREU VII: PERSONELI POLICOR, MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI

INSTITUCIONAL I POLICISË SË KOSOVËS	185
7.1 Vështrim hyrës	185
7.2 Personeli policor dhe çështjet etike	189
7.2.1 Procesi i rekrutimit në Policinë e Kosovës	194
7.2.2 Hetimi i së kaluarës së kandidatit.....	196
7.3 Administrimi i masave disiplinore në Policinë e Kosovës.....	199
7.3.1 Shkeljet e rënda disiplinore.....	202
7.3.2 Shkeljet e lehta disiplinore	204
7.4 Roli i institucioneve të mbikëqyrjes dhe të kontrollit	206
7.5 Mekanizmat e kontrollit të brendshëm të Policisë së Kosovës	208
7.5.1 Drejtoria e Standardeve Profesionale.....	209
7.5.2 Komisioni i Brendshëm Disiplinor	212
7.5.3 Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime.....	213
7.5.4 Komisioni për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës	214
7.6 Mekanizmat e kontrollit të jashtëm të Policisë së Kosovës dhe roli i tyre në luftën kundër korrupsionit	216
7.6.1 Roli i Inspektoratit Policor të Kosovës në kontrollin e jashtëm të PK-së	219
7.6.2 Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI)	220
7.6.3 Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsion (KKKK).....	221
7.6.4 Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK).....	222
7.6.5 Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit.....	223
7.6.6 Zyra e Kordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike	224
7.6.7 Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë	224
7.6.8 Avokati i Popullit.....	225
7.6.9 Auditori i Përgjithshëm	228
7.6.10 Misioni i Bashkimit European për Sundimin e Ligjit - EULEX	229
KREU VIII: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	231
8.1 Përfundime të përgjithshme rreth studimit.....	231
8.2 Shqyrtime mbi vërtetimin e hipotezave të studimit	240
8.3 Rekomandime.....	260
LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA	266

LISTAT E FIGURAVE, TABELAVE DHE GRAFIKËVE

Figurat

Figura 1: Struktura organizative e IPK-së.....	160
--	-----

Tabelat

Tabela 1: Llojet më të shpeshta të veprave penale të evidencuara në polici.....	131
Tabela 2: Veprat penale nga fusha e korrupsionit zyrtar, në vitet 2010-2015	134
Tabela 3: Personeli i Policisë së Kosovës.....	190
Tabela 4: Struktura e Personelit të Policisë së Kosovës	190

Grafikët

Grafiku 1: Trendi i ankesave në vitet 2010-2015.....	127
Grafiku 2: Rastet e veprave penale të evidencuara në IPK në periudhën 2011-2015	128
Grafiku 3: Numri i punonjësve policorë subjekt i hetimit penal në periudhën 2011-2015.....	128
Grafiku 4: Numri i punonjësve policorë subjekte të hetimit penal, shprehur në përqindje	129
Grafiku 5: Dinamika e veprave penale të korrupsionit zyrtar, në vitet 2010-2015.....	133
Grafiku 6: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në vitet 2010-2015.....	134
Grafiku 7: Dinamika e veprës penale <i>Marrja e ryshfetit</i> , në vitet 2010-2015	136
Grafiku 8: Dinamika e veprës penale “ <i>Falsifikimi i dokumentit zyrtar</i> ”, 2010-2015	137

LISTA E SHKURTIMEVE

AKK - Agjencia Kundër Korrupsionit

EULEX - European Rule of Law Mission in Kosovo

DCAF - Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura

DRP - Drejtoria Rajonale e Policisë

DSP - Drejtoria e Standardeve Profesionale

IPK - Inspektorati Policor i Kosovës

KPPK - Kodi i Procedurës Penale i Kosovës

KPPPK - Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës

KPK - Kodi Penal i Kosovës

KPS - Kodi Penal i Sllovenisë

KPSrb - Kodi Penal i Serbisë

KPA - Kodi Penal i Austrisë

KBD - Komisioni i Brendshëm Disiplinor

KASH - Komisioni për Shpërblime dhe Ankesa

KELDP - Komisioni për Emërime të Larta dhe Disiplinë në Polici

KSHPF - Komisioni për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

OECD - Organisation for Economic Co-operation and Development

OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

PK – Policia e Kosovës

PSSP - Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

UNMIK - United Nations Mission in Kosovo

KREU I: HYRJE

1.1 Shtrimi i problemit

Krahas sfidave me ndikim në paqen, sigurinë dhe stabilitetin e shtetit dhe të shoqërisë, siç janë terrorizmi, krimi i organizuar, krimet kibernetike etj., edhe korrupsioni, keqpërdorimi i pushtetit dhe tejkalimi i kompetencave nga zyrtarët shtetërorë është bërë preokupim jo vetëm i qeverive nacionale, por edhe i bashkësisë ndërkombëtare. Ky shqetësim rritet edhe më shumë sidomos kur në krim dhe në korrupsion përfshihen struktura të shtetit dhe zyrtarë të zbatimit të ligjit, që vënë, kështu, në dyshim funksionimin e organeve të zbatimit të ligjit dhe efikasitetin e tyre në shërbim të qytetarëve.

Edhe vendet e rajonit tonë janë prekur dhe infektuar rëndë nga dukuria e korrupsionit, aq sa rajoni sot konsiderohet një njollë e zezë për Europën. Veprat penale, korrupsioni dhe sjelljet e pahijshme të personave të veshur me pushtet shtetëror krijojnë shqetësim në publik. Por edhe më e rëndë është kur në të tilla vepra penale përfshihen zyrtarë dhe oficerë policorë, të cilët kanë për mision të ruajnë rendin dhe sigurinë në vend. “Edhe pse korrupsioni dhe brutaliteti policor nuk tolerohen haptazi, një numër ngjarjesh përgjatë historisë tregon se problemi ende ekziston dhe kërkon vëmendjen e autoriteteve policore.” (Peak, Gaines, Glensor, 2004:262).

Edhe në Kosovë korrupsioni dhe abuzimi me detyrën dhe me kompetencat paraqesin një plagë të hapur për shoqërinë në përgjithësi, për shkak se shtrirja e kësaj dukurie në organet e administratës shtetërore konsiderohet të jetë mjaft e lartë.

Veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe ato të korrupsionit dallojnë nga veprat e tjera penale sidomos në pasojat dhe dëmet që shkaktojnë abuzimi me detyrën zyrtare,

moskryerja me qëllim e saj apo korrupsioni i zyrtarëve. Nga këto veprime nuk e pëson vetëm institucioni, siguria dhe buxheti i shtetit, por edhe mirëqenia e qytetarëve.

Rreziku prej veprave penale të korrupsionit bëhet edhe më i madh kur ato prekin institucionet që merren me luftën kundër këtyre dukurive, pra, edhe policinë. Qytetarët besojnë në policinë e shtetit, e cila përgjigjet për ruajtjen e rendit dhe sigurisë, për mbrojtjen e pronës, zbatimin e ligjit, krijimin e një ambienti për jetë të sigurt. Ata presin që policia t'u vijë në ndihmë atyre kur ata kanë nevojë për shërbime të sigurisë publike dhe në rast situatash kritike apo fatkeqësish natyrore. Lidhur me këtë, Curtis thekson se “shoqëria e sotme me një ritëm kaq të shpejtë dhe gjithnjë në ndryshim vazhdon të përjetojë një ndryshim të paprecedent social, kulturor, ligjor, politik, ekonomik dhe teknologjik – pritjet nga policia e saj janë rritur në mënyrë eksponenciale.” (Curtis, 2011:20).

Ndërsa përfshirja e zyrtarëve policorë në vepra penale i zhgënjën qytetarët dhe rrit mosbesimin e tyre te policia, si organ i zbatimit të ligjit, dhe tek institucionet shtetërore, në përgjithësi.

Përpjekjet e qeverive dhe të organizatave të ndryshme për të luftuar keqpërdorimin e detyrës zyrtare dhe korrupsionin po shtohen vazhdimisht. Kështu ndodh edhe në Kosovë, ku shihet se dukuria e korrupsionit ka marrë shtrirje në të gjitha institucionet publike, përfshirë edhe policinë.

1.2 Arsyet e ndërmarrjes së studimit

Një nga arsyet e ndërmarrjes së hulumtimit të kësaj teme është mungesa e studimeve në këtë fushë në Kosovë, ku ka një boshllëk të madh. Duke qenë se PK-ja, si një organizatë e re, megjithë arritjet në punën e saj, është përballur dhe përballët çdo ditë me sfidën e korrupsionit dhe me një numër të madh veprash penale, ku janë

përfshirë punonjës të saj, ka lindur nevoja e njohjes dhe e studimit të thelluar të kësaj problematike, për të evidencuar çështjet që dalin. Në këto kushte, mendova të ndërmeroja këtë kërkim të mirëfilltë shkencor, për të identifikuar përmasat e fenomenit të korrupsionit dhe të veprave penale të kryera nga zyrtarët policorë, dhe sidomos shkaqet dhe faktorët që i favorizojnë ato. Studimin dhe analizën në mënyrë të gjithanshme të fenomenit në rastin e Kosovës, si nga ana teorike, ashtu edhe praktike, e konsiderova një motiv për të dhënë një kontribut në punën që Policia e Kosovës bën për përmirësimin gjendjes dhe për forcimin e luftës kundër veprave penale dhe korruptive në radhët e saj.

Një arsye tjetër e ndërmarrjes së këtij punimi doktoral është se ai i shërben edhe kualifikimit tim të mëtijshëm profesional dhe shkencor dhe do të shërbejë si nxitje për t'u marrë edhe më tej me punë kërkimore-shkencore.

1.3 Qëllimi dhe rëndësia e studimit

Qëllimi i punimit të doktoraturës është, në radhë të parë, identifikimi dhe analiza e problematikave të keqpërdorimit të detyrës dhe e veprave penale të korrupsionit nga zyrtarët e Policisë së Kosovës, analizimi i legjislacionit penal, nxjerrja e problemeve dhe i vështirësive të agjencive ligjzbatuese në përpjekjet e tyre për të parandaluar dhe luftuar këtë dukuri kriminale. Përmes kësaj analize synohet të jepet një kontribut për përmirësimin e politikave penale dhe të luftës kundër korrupsionit dhe, njëkohësisht, për pasurimin e mendimit juridik e kriminologjik lidhur me këto vepra penale. Gjithashtu, punimi synon hulumtimin e shkaqeve të këtyre veprave penale, identifikimin dhe adresimin i sfidave në hetimin dhe posaçërisht në parandalimin e tyre, si edhe të bëjë një analizë dhe vlerësim kritik për funksionimin dhe efikasitetin e mekanizmave institucionalë ekzistues, të jashtëm dhe të brendshëm, në parandalimin dhe hetimin e

veprave penale të kryera nga zyrtarët policorë. Veçanërisht për praktikantët e sektorit, ky studim synon të ndihmojë në identifikimin e mangësive ligjore, administrative apo menaxheriale që vështirësojnë përpjekjet në parandalimin dhe luftimin e sjelljeve devijante brenda personelit në Policinë e Kosovës.

Rëndësi e veçantë e studimit është se ai adreson sfidat konkrete dhe të perspektivës për të ardhmen e Policisë së Kosovës në menaxhimin e personelit, në forcimin e integritetit profesional dhe në rritjen e efikasitetit të mekanizmave të kontrollit dhe të mbikëqyrjes së zyrtarëve policorë. Studimi përpiqet të ofrojë ide dhe mundësi të reja, që do të shërbejnë në aspektin praktik për menaxhimin sa më efektiv të personelit, për ta ndihmuar Policinë e Kosovës në përmbushjen e misionit të vet.

Një kontribut i veçantë i studimit do të jetë influencimi në vendimmarrjet strategjike, në planifikimin e veprimeve për forcimin e integritetit policor, në përmirësimin e procedurave të rekrutimit, seleksionimit, si dhe në edukimin dhe trajnimin e personelit. Krahas këtyre, studimi do të jetë një ndihmë edhe për ekspertët dhe profesionistët e kësaj fushe, si edhe për studiuesit e tjerë akademikë.

1.4 Hipotezat dhe pyetjet kërkimore të studimit

Hipotezat e këtij disertacioni janë ngritur dhe formuluar për të arritur në konstatime dhe në konkluzione lidhur me tematikën e kërkimit shkencor.

Për një studim sa më përmbajtësor dhe për analizimin e veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe të korrupsionit nga zyrtarë policorë të PK-së, në mënyrë të tillë që të arrihet në disa konkluzione të drejta dhe të dobishme, kam parashtruar Hipotezën kryesore dhe këto nënhipoteza:

Hipoteza kryesore: Megjithë plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, korrupsioni në Policinë e Kosovës po merr formë fenomeni, ngaqë mungojnë

masat efikase për parandalimin dhe luftimin e tij, ndaj del domosdoshmëria e forcimit të vazhdueshëm të luftës kundër këtij fenomeni.

***Nënhipoteza 1:** Politika penale për veprat penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës në fushën e korrupsionit zyrtar nuk është efektive.*

***Nënhipoteza 2:** Legjislacioni i Kosovës kundër korrupsionit, i harmonizuar me legjislacionin ndërkombëtar ndikon në parandalimin dhe luftimin me sukses të dukurisë së korrupsionit dhe të veprave penale në radhët e Policisë së Kosovës.*

Pyetjet kërkimore

Pyetjet kërkimore të aplikuara në këtë punim doktore janë formuluar në mënyrë të tillë që t'i japin hulumtimit kahjen e shqyrtimeve dhe analizave dhe për të mundësuar arritjen e disa konkluzioneve që na çojnë në vërtetimin e hipotezave. Ato janë:

1. Cilat janë sfidat në hetimin e veprave penale të kryera nga zyrtarët e PK-së?
2. Cilët janë faktorët që ndikojnë në veprat korruptive dhe në kryerjen e veprave penale nga ana e punonjësve të PK-së?
3. A janë efektive masat parandaluese dhe mekanizmat e pavarur institucionalë të mbikëqyrjes dhe kontrollit institucional të PK-së?
4. A është efikase politika penale për personat që janë dënuar për kryerjen e veprave penale të korrupsionit?
5. A është i plotë legjislacioni i Kosovës për korrupsionin dhe në përputhje me aktet dhe standardet ndërkombëtare?
6. Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet mes legjislacionit të Kosovës, Sllovenisë, Serbisë dhe Austrisë?

1.5 Metodologjia dhe metodat e kërkimit

Metodologjia e ndjekur në këtë punim u zgjodh në funksion të analizimit të të dhënave sasiore dhe cilësore.

Së pari, u morëm me grumbullimin e materialit teoriko-praktik që do të shërbente për temën, duke shfletuar burime parësore dhe dytësore, si literaturë, legjislacioni vendas dhe i huaj, dokumente dhe raporte të institucioneve të ndryshme të Kosovës apo të organizmave ndërkombëtare. Së dyti, u morëm me planifikimin dhe strukturimin e temës, me formulimin e pyetjeve kërkimore dhe të hipotezave të studimit, shoqëruar kjo me zhvillimin e kërkimit empirik në terren përmes anketimit me pyetësor. Së fundi, pas analizës së të dhënave u bë trajtimi dhe përpilimi i temës, si dhe u nxorën përfundimet dhe rekomandimet, me të cilat mbyllet studimi.

Të dhënat sasiore për studimin e veprave penale të kryera nga punonjës të policisë janë siguruar nga raportet statistikore të PK-së dhe IPK-së, përmes të cilave u studiuan trendi i veprave penale në vite, llojet e veprave të raportuara, numri i zyrtarëve të PK-së të përfshirë në to etj. Shqyrtimi i një numri vendimesh gjyqësore të marra ndaj zyrtarëve të PK-së të gjykuar ka shërbyer për të parë llojin e veprave, si dhe politikën ndëshkimore të ndjekur nga gjykatat. Për të njohur perceptimin e vetë zyrtarëve të PK-së për çështjet etike, integritetin, korrupsionin dhe për veprat penale të kryera nga zyrtarët policorë kemi kryer një hulumtim përmes metodës së anketimit me pyetësor. Po ashtu, janë intervistuar zyrtarë të lartë të PK-së, kompetentë për implementimin e standardeve profesionale dhe për parandalimin dhe hetimin e veprave penale brenda PK-së. Për ilustrim të fakteve dhe opinioneve kemi përdorur edhe raportime nga mediat, si edhe ide nga debate publike, uorkshope dhe konferenca të ndryshme për punën e PK-së, që i kemi ndjekur dhe vrojtuar vetë.

Metodologjia e ndjekur dhe rezultatet e saj na krijuan mundësinë për të kaluar në fazën më të rëndësishme, atë të hartimit të punimit. Për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të punimit, zgjedhëm dhe përdorëm këto metoda:

Metoda juridike është zgjedhur dhe zbatuar në këtë punim doktoral për të pasqyruar infrastrukturën ligjore në fushën e veprave penale të korrupsionit zyrtar. Aplikimi i saj ka qenë mjaft i përshtatshëm për temën, sepse mundësoi pasqyrimin e karakteristikat juridiko-penale të veprave penale në fushën e korrupsionit zyrtar, të politikave ndëshkimore, si dhe vështrimin e legjislacionit të disa vendeve me synime të caktuara.

Metoda e analizës është aplikuar për të njohur sa më mirë materien e veprave penale kundër detyrës zyrtare dhe të veprave të korrupsionit. Me këtë metodë kemi mundur të analizojmë të dhënat sasiore dhe cilësore për secilën nga këto vepra penale për periudhën 2010-2015 dhe trendin e tyre në vite, si dhe të bëjmë interpretimin e tyre, në funksion të nxjerrjes së përfundimeve të studimit.

Metoda statistikore na ka shërbyer për të evidencuar vëllimin, strukturën dhe dinamikën e veprave penale të korrupsionit. Duke marrë për bazë të gjitha statistikatat e mbledhura nga institucione të ndryshme, përmes kësaj metode kemi realizuar zbërthimin dhe krahasimin e tyre për të bërë matjen e variablave dhe për të parë shkallën dhe përmasat e fenomenit.

Metoda krahasuese është përdorur për të vënë përballë rregullimin e bërë nga legjislacioni i Kosovës në fushën e veprave penale të korrupsionit zyrtar, e parë kjo në raport me rregullimin e bërë nga legjislacioni i dy vendeve të BE-së, si Sllovenia dhe Austria, dhe të Serbisë, si dhe me konventat e ndryshme ndërkombëtare.

Metoda e anketimit u aplikua me synimin për të marrë një informacion real lidhur me perceptimin që kanë vetë punonjësit e policisë për korrupsionin dhe për

kryerjen e veprave penale në radhët e tyre. Për pyetjet e parashtruara në pyetësin e shpërndarë u kërkuan përgjigje, duke ruajtur anonimin dhe pavarësinë e të intervistuarve. Kjo ka ndikuar në besueshmërinë e përgjigjeve të dhëna.

1.6 Mundësitë dhe kufizimet e studimit

Për hulumtimin e temës së doktoraturës na është mundësuar të sigurojmë, përveç literaturës së bollshme, edhe një sërë dokumentesh, kodesh, raportesh kombëtare dhe të organizatave ndërkombëtare. Po ashtu, kemi arritur të grumbullojmë të dhëna empirike nga hulumtimi në terren përmes anketimit. Por kemi pasur edhe disa vështirësi dhe kufizime. Gjatë një studimi të tillë kufizimet janë të pritshme, pasi lënda për këtë studim përbën një risi dhe, për nga përmbajtja, është mjaft e gjerë. Mënyra dhe kronologjia e trajtimit institucional të këtyre veprave penale, ndryshimet legjislative, ndryshimet në mandatin dhe në kompetencën e njësive përgjegjëse për hetimin dhe administrimin e çështjeve hetimore prodhojnë disa kufizime gjatë studimit. Në fillim, veprat penale të kryera nga zyrtarët e PK-së janë trajtuar nga zyrtarë policorë ndërkombëtarë, për t'u bartur më vonë në kompetencë të Policës së Kosovës dhe të Inspektoratit Policor të Kosovës. Prandaj, kufizimet e mundshme ishin të pritshme, sidomos në qasjen në të dhënat e çështjeve të hetuara nga zyrtarë të policisë ndërkombëtare. Dosjet e hetimeve penale ishin të shpërndara në njësi hetimore dhe gjykata të ndryshme dhe, në mungesë të një sistemi të integruar të të dhënave, kemi hasur vështirësi në sigurimin e të dhënave statistikore nga rastet e hetimeve ndaj zyrtarëve të PK-së.

Kufizime kanë ardhur edhe për mungesë të literaturës së kësaj fushe në gjuhën shqipe. Prandaj jemi përqendruar në shfrytëzimin e literaturës së huaj, si dhe të një numri raportesh publike, siç janë raportet vjetore, dokumentet strategjike për policinë, si dhe në të dhënat statistikore të mundësuar nga administrata e Policisë së Kosovës.

Kufizim tjetër ka qenë edhe fakti që në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK) dhe në IPK nuk u gjetën të dhëna statistikore për karakteristikat personale të autorëve të këtyre veprave.

1.7 Struktura e punimit

Ky punim doktore është strukturuar në tetë kapituj.

Kreu i parë - përmban shkrimin e problemit, arsyen e studimit, qëllimin dhe rëndësinë e tij, hipotezat dhe pyetjet kërkimore të studimit, metodologjinë dhe metodat e punimit, si dhe mundësitë dhe kufizimet që patëm gjatë kryerjes së punimit.

Kreu i dytë - sjell vështrime teorike mbi korrupsionin policor si formë e korrupsionit zyrtar, duke analizuar dukurinë e korrupsionit dhe faktorët që e ndikojnë. Mbështetur në literaturë, në punimet dhe raportet hulumtuese nga autorë dhe hulumtues të ndryshëm në fushën e keqpërdorimit të detyrës, shkeljeve të ligjit dhe korrupsionit nga ana e zyrtarëve policorë, këtu i bëhet një vështrim i veçantë situatës aktuale për nivelin e korrupsionit në Kosovë dhe ndikimit të tij në nivelin e korrupsionit dhe të shkeljeve të ligjit nga zyrtarët e PK-së. Për këtë, janë analizuar, gjithashtu, raporte të komisioneve dhe të instituteve, për zhvillimet në vende të ndryshme, për trendin dhe llojet më të shpeshta të shkeljeve të ligjit nga zyrtarë policorë.

Kreu i tretë, trajton rregullimin juridiko-penal të veprave penale të korrupsionit zyrtar, duke analizuar objektin mbrojtës të këtyre veprave penale, si dhe figurën e veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe të veprave të korrupsionit, përfshi edhe raste nga praktika gjyqësore. Kapitulli përmban edhe analizë të legjislacionit vendor në funksion të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, si dhe

diskutimin mbi mangësitë e dispozitave penale të Kodit Penal të Kosovës në raport me standardet ndërkombëtare.

Kreu i katërt, trajton aspektin ndërkombëtar të legjislacionit kundër korrupsionit. Këtu analizohen konventat e rëndësishme ndërkombëtare kundër korrupsionit, si dhe jepet një vështrim krahasimor i legjislacioneve të huaja kundër kësaj dukurie. Për krahasim janë përzgjedhur Sllovenia, Austria dhe Serbia.

Në *kreun e pestë* janë paraqitur dhe janë analizuar të dhënat statistikore, faktorët që ndikojnë në kryerjen veprave penale nga zyrtarë të PK-së, si dhe të dhënat sasiore që janë përfutur përmes pyetësorit, lidhur me perceptimin e zyrtarëve të PK-së për korrupsionin policor dhe për integritetin e tyre. Një vend të rëndësishëm zë këtu interpretimi i çdo rezultati dhe nxjerrja e konkluzioneve të veçanta për secilin prej tyre.

Kreu i gjashtë sjell bazën ligjore për zhvillimin e procedurës penale ndaj zyrtarëve të PK-së, duke përcaktuar edhe ndarjen e kompetencave për zhvillimin e hetimeve penale ndaj tyre. Në këtë kapitull analizohen roli i IPK-së në hetimet penale kundër zyrtarëve të PK-së, politika penale e veprave të korrupsionit zyrtar dhe politika penale në aktgjykimet e gjykatave, në rastet ku janë të përfshirë edhe zyrtarë të PK-së. Kapitulli përmban edhe raste nga praktika gjyqësore. Një vështrim i veçantë u bëhet këtu konceptit të prezumimit të pafajësisë dhe sfidave në administrimin e hetimeve penale ndaj zyrtarëve policorë.

Kreu i shtatë – flet për procedurën administrative të hetimeve disiplinore, për përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore, për mekanizmat e administrimit të disiplinës në PK, si dhe për arritjet e PK-së në krijimin e kapaciteteve të brendshme për mbikëqyrje dhe kontroll, në identifikimin dhe adresimin e sfidave të PK-së në ruajtjen dhe forcimin e integritetit të personelit. Po ashtu trajtohet funksionimi i mekanizmave

të jashtme të mbikëqyrjes dhe kontrollit demokratik të PK-së, roli i tyre dhe i infrastrukturës ligjore, kompetencat dhe funksionet e tyre në kontrollin e policisë.

Studimi mbyllet me *kreun e tetë*, i cili përmban konkluzionet e studimit për vërtetimin e hipotezave dhe rekomandimet, që kemi mundur të hartojmë, si rezultat i shqyrtimit të temës dhe i analizave që bëhen në këtë punim.

Në fund të studimit jepet literatura e shfrytëzuar për hartimin e këtij punimi.

KREU II: KORRUPSIONI NË POLICI SI FORMË E KORRUPSIONIT ZYRTAR

2.1 Vështrim hyrës mbi korrupsionin zyrtar

Studimet dhe hulumtimet e shkeljeve penale të zyrtarëve publikë në fushën e korrupsionit për një kohë të gjatë kanë munguar. Mirëpo, demokratizimi i shoqërisë, kërkesat për transparencë, forcimi i rolit të mediave dhe të shoqërisë civile kanë ndikuar në trajtimin shkencor dhe institucional të dukurisë së korrupsionit. Kjo, sepse, pasi, veprimet korruptive të personave zyrtarë publikë, që në të shumtën e rasteve paraqiten si keqpërdorim i detyrës zyrtare për përfitime private, janë shtuar dhe, tashmë, përbëjnë një problem të madh për shoqërinë në vende të ndryshme të botës. Sipas autorëve Denhardt, Grubbs (2007:125), megjithëse ka dallime në qasjen dhe në mënyrat e trajtimit, gjatë dekadave të fundit, është rritur ndjeshëm interesi për çështjet etike në organizatat publike.

“Gazetat, revistat, televizioni dhe interneti kanë ekspozuar rastet e skandaleve, mashtrimeve, humbjeve, keqpërdorimeve dhe korrupsionit. Në reagim ndaj këtij problemi, organizatat e sektorit publik kanë bërë përpjekje për të forcuar integritetin dhe të rrisin përkushtimin për sjellje etike.” (Hays, Kearney, 2003:301)

Në aspektin teorik kjo çështje është trajtuar dhe është studiuar në shumë vende, duke u ndalur, kryesisht, në sfidat bashkëkohore, me të cilat përballen institucionet shtetërore, pritjet e publikut për shërbime efikase dhe transparente. Kjo ndodh, sepse korrupsioni prek dhe cenon edhe ekonominë dhe politikën, faktorët socialë, shkallën e zhvillimit të demokracisë në vend, të drejtat dhe liritë e njeriut etj.

Është diskutuar shpesh se çfarë nënkupton në vetvete termi “korrupsion”. Zyra e Kombeve të Bashkuara e thotë qartë se “Nuk ekziston një definicion gjithëpërfshirës dhe i pranuar në mënyrë universale i korrupsionit” (UNODC, 2004:23). Kjo krijon në praktikë disa vështirësi, kur vjen puna për përcaktimin se cilat veprime të kësaj dukurie

për bëjnë vepër penale apo thjesht shkelje disiplinore. Mungesa e një përkufizimi gjithëpërfshirës për korrupsionin mund të bëhet pengesë, në shumë aspekte, për luftimin e kësaj dukurie, si në aspektin nacional, ashtu edhe në aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në aspektin ligjor, kjo nxjerr problemin e përcaktimit të saktë të kufirit ndarës mes shkeljeve administrative që paraqesin shkelje disiplinore apo shkelje të kodit të etikës dhe shkeljeve që përbëjnë vepër penale. Në të dyja rastet mund të flitet për sjellje devijante, për keqpërdorim apo për korrupsion, por, në aspektin e sanksioneve, ndryshojnë procedura, autoriteti hetues dhe lloji sanksionit. Për shkeljet administrative dhe të kodit të etikës që nuk kanë elemente të veprës penale hetimi bëhet nga niveli mbikëqyrës, nga mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe sanksionet janë masa administrative. Kurse shkeljet që kanë elemente të shkeljes së dispozitave penale hetohen dhe ndëshkohen sipas ligjit dhe procedurës penale.

Duke qenë se vende të ndryshme kanë specifikat e tyre të fushës politike, juridike, sociale etj., bashkësia ndërkombëtare e ka të vështirë të arritur në një emërues të përbashkët lidhur me termin korrupsion. Siç thotë edhe Zyra Kundër Drogës dhe Krimit, e OKB-së, “përpyekjet për të gjetur një përkufizim më të saktë janë kundërshtuar pa dallim nga shumë vende, për shkak të problemeve ligjore, kriminologjike dhe problemeve politike”. (UNODC, 2004:23)

Një problem që ka ngjallur debat është edhe përcaktimi i qartë i kuptimit që kanë termi “keqpërdorim” i pushtetit apo i pozitës zyrtare dhe termi “korrupsion”.

Përkufizimi i termit korrupsion ka të bëjë edhe me aspektin e ndërtimit të kapaciteteve për luftimin e këtij fenomeni, pasi për këtë kërkohet përcaktimi i qartë i kompetencave të mekanizmave të jashtëm dhe të brendshëm të kontrollit. Po ashtu, edhe për faktin se ky fenomen ndikohet edhe nga faktorë politikë dhe kulturorë. Kjo e bën edhe më të vështirë formulimin e një përkufizimi të vetëm për termin në fjalë.

“Korrupsioni është krim i ndërlikuar dhe me kufij të paqartë, që shpesh e bëjnë të vështirë dallimin e keqbërësit dhe të viktimës. Ai nuk është domosdoshmërisht ndërveprim njëdimensional, ku keqbërësi aktiv detyron palën pasive; të dyja palët mund të përfitojnë dhe viktima mund të jetë palë e tretë apo komuniteti në tërësi. Për më tepër, janë faktorët kulturorë dhe shoqërorë që mund ta bëjnë edhe më të paqartë këtë çështje. Dhënia e dhuratave, për shembull, qoftë si “shenjë falënderimi” apo si lubrifikues burokratik, mund të konsiderohet e pranueshme në një kulturë, ndërsa konsiderohet joetike në një tjetër” (UNODC, 2011:9).

Megjithë mungesën e një përkufizimi universal të korrupsionit zyrtar, disa organizata ndërkombëtare kanë dhënë përkufizime, por, kuptohet, ato nuk përmbledhen në një paragraf të vetëm, pasi kjo është e pamundur për vetë kompleksitetin dhe gjerësinë e përmbajtjes së dukurisë së korrupsionit.

Në kreun e tretë të Konventës Kundër Korrupsionit, të Kombeve të Bashkuara, në nenin 15, *Ryshfeti i zyrtarëve publikë vendorë*, përcaktohen si vepra penale të korrupsionit veprimet që kryhen me qëllim, si:

- a. Premtimi, ofrimi apo dhënia zyrtarit publik, drejtpërsëdrejti apo jo drejtpërsëdrejti, për ndonjë avantazh të padrejtë, për vetë zyrtarin apo për ndonjë person apo entitet tjetër, në mënyrë që zyrtari të veprojë apo të përmbahet nga veprimi në ushtrimin e detyrave të tij apo të saj zyrtare.
- b. Kërkimi apo pranimi nga zyrtari publik, drejtpërsëdrejti dhe apo jo drejtpërsëdrejti, i ndonjë avantazhi të padrejtë, për vetë zyrtarin apo për ndonjë person apo entitet tjetër, në mënyrë që zyrtari të veprojë apo të përmbahet nga veprimi në ushtrimin e detyrave të tij apo të saj zyrtare (UN, 2004:17).

Konventa Civile e Këshillit të Europës, neni 2, e përkufizon kështu korrupsionin: kërkimi, ofrimi, dhënia apo pranimi, drejtpërsëdrejti dhe apo jodrejtpërsëdrejti, i ryshfetit apo i ndonjë avantazhi jo të drejtë apo gjasave për të, që çrregullon performancën e duhur të ndonjë detyre apo sjelljeje.

Sipas Bankës Botërore, korrupsioni është: abuzimi me detyrën publike, për përfitime private. Kurse Organizata Transparency International e përkufizon korrupsionin: abuzim me pushtetin e besuar, për përfitim privat.

Konventa Ndëramerikane Kundër Korrupsionit, neni 6, përkufizon si korrupsion disa vepra:

- a. Kërkimi apo pranimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, nga një zyrtar qeveritar apo person që kryen funksione publike, i ndonjë artikulli me vlerë monetare apo i ndonjë përfitimi tjetër, si dhurata, favori, premtimi apo avantazhi për vete apo për ndonjë person apo subjekt tjetër, në shkëmbim të ndonjë veprimi apo mosveprimi në kryerjen e funksioneve të tij publike;
- b. Ofrimi apo dhurimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, zyrtarit qeveritar apo personit që kryen funksione publike, i ndonjë artikulli me vlerë monetare apo i ndonjë përfitimi tjetër, siç janë dhurata, favori, premtimi apo avantazhi për vete apo për ndonjë person apo subjekt tjetër, në shkëmbim të ndonjë veprimi apo mosveprimi në kryerjen e funksioneve të tij publike;
- c. Çdo veprim ose mosveprim gjatë kryerjes së detyrave të tij nga një zyrtar qeveritar apo një person që kryen funksione publike, me qëllim përfitimi të paligjshëm për veten e tij apo për palën e tretë;
- d. Përdorimi mashtrues apo fshehja e pasurisë, që rrjedh nga ndonjë veprim referuar në këtë nen;
- e. Pjesëmarrja si aktor kryesor, bashkaktor kryesor, nxitës, bashkëpunëtor apo bashkëpjesëmarrës, pas kryerjes së veprimit, apo në ndonjë mënyrë tjetër, kryerjen apo në tentim kryerjen e, apo në ndonjë bashkëpunim apo komplot për të kryer ndonjë prej veprave referuar në këtë nen.

Dukuria e korrupsionit zyrtar përbën një problem të mprehtë për secilin vend.

Përmasat e ndikimit të kësaj dukurie në vetë shtetin dhe në shoqëri janë të mëdha. Për këto flitet në shumë raporte dhe analiza nga autorë dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare. Në një raport të organizatës Transparency International vihet në dukje:

“Korrupsioni mund të rrezikojë, si kapacitetin, edhe legjitimitetin e shtetit. Duke e privuar shtetin nga resurset dhe duke i keqpërdorur ato, korrupsioni e dobëson aftësinë e shtetit për të ofruar shërbimet publike kyçe, përfshi sigurinë. Kjo mund të dobësojë drejtpërdrejt kapacitetin e shërbimeve të sigurisë; për shembull, nëse ushtarët mbesin pa paguar apo pajisjet e tyre janë me defekte apo të vjetruara, sepse buxhetet e prokurimit janë përvetësuar, aftësia dhe motivimi i tyre për të mbrojtur shtetin ka gjasë të bien. Korrupsioni, gjithashtu, mund të zvogëlojë legjitimitetin e shtetit, pasi qeveria dështon të përmbushë pritshmëritë e qytetarëve, duke rritur kështu tek ata dëshirën që të sfidojnë me anë të dhunës regjimin ekzistues. (Transparency International, 2014:13)

Kjo është situatë tipike për vendet me të kaluar diktatoriale, ku ky fenomen trajtohet më tepër në aspektin deklarativ, sesa në aspektin ligjor, llogaridhënës dhe me transparencë. Pas përmbysjes së komunizmit në vendet e Lindjes, proceset e kalimit në ekonominë e tregut, të integritimeve rajonale dhe globale janë përcjellë me ndryshime në fushën legislative, ekonomike, kulturore dhe politike. Për arritjen e standardeve dhe të kritereve të përmbushjes së kërkesave për demokraci, në këto vende u realizuan ndryshime rrënjësore sidomos në infrastrukturën ligjore. Këto ndryshime krijuan bazë

dhe mundësi për avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të pakicave, të drejtës dhe lirisë së shprehjes, vendosjes së ekonomisë së tregut e të konkurrencës, fuqizimin e shoqërisë civile, transparencën, llogaridhënien, zgjedhjet e lira etj. Por, eksperiencia tregoi se proceset integruese dhe kalimi nga një regjim diktatorial në pushtet demokratik patën edhe pasoja negative, të cilat janë shfaqur gjatë fazës së tranzicionit. Një nga këto pasoja është dukuria e përhapjes së korrupsionit në institucionet politike dhe ekonomike të vendeve në tranzicion. “Tranzicioni nga regjimi komunist në ekonomi të tregut krijoi mundësi të veçanta për përfitime ilegale dhe nivel të lartë të korrupsionit.” (Zeneli,2012:17).

Në korrupsionin e një vendi ndikojnë edhe faktorë të jashtëm politikë, që mund të përcaktojnë nivelin e përhapjes së korrupsionit në sektorin publik, por rol të madh kanë faktorët brenda vendit, sidomos sjellja dhe përdorimi i pozitës së zyrtarëve të lartë publikë.

“Korrupsion i Madh” është shprehje e përdorur për të përshkruar korrupsionin që pushton nivelet më të larta të qeverisë, që shkaktojnë keqpërdorime të mëdha të pushtetit. Një erozion i gjerë i sundimit të ligjit, i stabilitetit ekonomik dhe i besimit në qeverisje të mirë, ndodh shumë shpejt. Nganjëherë kjo konsiderohet si “kapje e shtetit”, që do të thotë se interesat e jashtëm ilegalisht shtrembërojnë nivelet më të larta të sistemit politik për qëllime private.(UNODC, 2004:23).

Zyrtarët, që, në sajë të funksionit, disponojnë resurse dhe kanë autorizimin dhe kompetencat për shpërndarjen e tyre, duke përfituar nga mungesa kapaciteteve të mbikëqyrjes dhe të kontrollit, nga mangësitë në legjislacion, nga mungesa e autonomisë institucionale në vendimmarrje etj., mund t’i keqpërdorin apo t’i keqmenaxhojnë. Po ashtu, ata vendosin për përcaktimin e privilegjeve, beneficioneve, gradimeve, caktimin e posteve, shërbimeve, kontratave, shpërblimeve dhe të tjera çështje me vlerë, për të cilat njerëzit kanë interes dhe i synojnë. Në dhënien e këtyre dhe gjatë procesit të menaxhimit dhe shpërndarjes së resurseve financiare dhe në formë asetesh, mundësitë për korrupsion janë më të mëdha. “Arsyeja kryesore për praninë e korrupsionit në

administratën publike në mbarë botën është se administratorët shpërndajnë atë që njerëzit e tjerë e dëshirojnë” (Rosenbloom, Kravchuk, 2005:521).

2.2 Dukuria e korrupsionit në polici

Edhe në organizatat policore, korrupsioni është një nga format më të shpeshta të sjelljeve devijante dhe të shkeljeve penale nga zyrtarët. Edhe këtu, përkufizimi i termit ‘korrupsion policor’ mbetet një nga sfidat në trajtimin e dukurisë. Sipas Newburn, termi “korrupsioni policor” përdoret për veprime të tilla, si: ryshfeti; dhuna dhe brutaliteti; falsifikimi dhe shkatërrimi i dëshmive; racizmi; dhe favorizimi apo nepotizmi (Newburn, 1999:4).

Përkufizimi më gjithëpërfshirës i korrupsionit në polici, është dhënë nga Organizata Policore Ndërkombëtare (Interpol). Në konferencën e Asamblesë së Përgjithshme të Interpol-it, mbajtur më 23 tetor 2002, në Yaounde të Kamerunit, u aprovua rezoluta AG-2002-RES-0, e propozuar nga grupi i ekspertëve kundër korrupsionit, e cila përmban standardet globale për luftimin e korrupsionit në organizatat e policisë. Sipas nenit 2 të kësaj rezolute, korrupsioni në polici përkufizohet:

- a. Kërkesa ose pranimi (i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë) nga personeli i policisë i parave, sendeve me vlerë, dhuratave, favoreve, premtimeve, shpërblimeve ose përfitimeve, për veten e tij/saj apo për këdo person, grup ose entitet, në këmbim të çdo veprimi apo mosveprimi (dështimi për të vepruar) të kryer ose të premtuar për mosveprim ose mosveprim në të ardhmen gjatë kryerjes, ose që lidhet me kryerjen e çdo funksioni të kontrollit policor ose që lidhet me të.
- b. Dhënia ose ofrimi (i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë) nga personeli i policisë i parave, sendeve me vlerë, dhuratave, favoreve, premtimeve, shpërblimeve ose përfitimeve, për personelin e policisë apo për cilindo person, grup ose entitet, në këmbim të çdo veprimi apo mosveprimi (dështimi për të vepruar) të kryer ose të premtuar për mosveprim ose mosveprim në të ardhmen gjatë kryerjes, ose që lidhet me kryerjen e çdo funksioni të kontrollit policor ose që lidhet me të.
- c. Çdo veprim ose mosveprim (dështim për të vepruar) gjatë kryerjes së detyrës nga një polic, i cili në mënyrë të padrejtë mund të paraqesë ngarkimin me faj ose dënimin për një kundërvajtje penale të një personi ose në mënyrë të padrejtë mund të kontribuojë që një person të mos ngarkohet me faj ose të shkarkohet nga një kundërvajtje penale.
- d. Shpërndarja e paautorizuar e informacionit policor të besueshëm ose të klasifikuar, për shpërblim apo për arsye të tjera.
- e. Çdo veprim ose mosveprim (dështim për të vepruar) gjatë kryerjes së detyrës nga një polic me qëllim marrjen e parave, të sendit me vlerë, dhuratës, favorit,

- premtimit, shpërblimit ose përfitimit për veten e tij/saj ose çdo personi tjetër, grupi ose entiteti.
- f. Çdo veprim ose mosveprim (dështim për të vepruar) që përbën akt korrupsioni sipas legjislacionit të vendit anëtar.
 - g. Pjesëmarrja si autor kryesor, bashkautor, inicues, nxitës, bashkëpunëtor, ndihmës përpara kryerjes së një veprë, ndihmës pas kryerjes së një veprë dhe komplotues në vepra të cituara në dispozitat pararendëse të këtij neni (Interpol, 2002)

Shkalla e korrupsionit, e shpërdorimeve dhe e sjelljeve devijante të zyrtarëve policorë varet dhe ndikohet nga niveli i korrupsionit dhe krimit në nivel të përgjithshëm në vend. Në një vend, ku niveli i krimit dhe i korrupsionit është i lartë, edhe mjaft punonjës të policisë e ka të vështirë të ruajnë vlerat etike dhe profesionale dhe integritetin.

Një nga format më të përfolura të korrupsionit në polici është pranimi i mitës. Një raport hulumtues i UNODC në lidhje me korrupsionin në Kosovë, konkludon se zyrtarët e Policisë së Kosovës radhiten shumë lart për marrje të mitës:

Sipas përvojës së atyre që kanë paguar, së paku, një ryshfet në 12 muajt para anketës, zyrtarët publikë që marrin më së shumti ryshfet në Kosovë janë mjekët (42% e njerëzve me përvoja të freskëta të korrupsionit u japin ryshfet mjekëve), zyrtarët policorë (30%), infermieret (26%) dhe zyrtarët komunalë (20%). Zyrtarë të tjerë publikë marrin përqindje më të vogël të ryshfetit, që radhiten nga zyrtarët për punë sociale (4%) deri te gjyqtarët dhe prokurorët (16%) (UNODC, 2011:17).

Zyrtarët policorë janë në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët, qoftë në zbatim të ligjit, qoftë në kryerjen e shërbimeve të ndryshme ndaj publikut dhe jo rrallëherë qytetarët u ofrojnë zyrtarëve policorë ndonjë dhuratë, që mund të shihet si dhënie mite, por mund të konsiderohet edhe thjesht dhuratë e rastit. Kjo duhet të shihet jo vetëm në kontekstin kulturor, por, në radhë të parë, në kontekstin ligjor, domethënë, si janë sanksionuar në dispozitat ligjore pranimi dhe dhënia e dhuratave, a janë të dënueshme apo jo. Gjithashtu, duhen parë mënyrat ligjore të kontrollit, të mbikëqyrjes dhe të raportimit të pranimit të dhuratave. Por shumë e rëndësishme është sidomos, mbështetja në ligj se kur mund të flitet thjesht për një dhuratë dhe kur kjo përbën vepër penale të marrjes së mitës.

Lidhur me këtë, mes autorëve të ndryshëm ka nxitur debat problemi nëse pranimi nga zyrtarë publikë i mitës në formë dhuratash mund të tolerohet deri në një masë apo duhet të konsiderohet shkelje administrative apo penale. Ata i trajtojnë sjelljet devijante me elemente të veprës penale, kryesisht, nga këndvështrimi i korrupsionit.

Kjo përfshin keqpërdorimin e kompetencave dhe të autoritetit policor, shfrytëzimin e pozitës dhe një masë të madhe të resurseve të organizatës për të shmangur parandalimin e krimit, inkurajimin e krimit nga të tjerët, përfshirjen në krim, luftimin e krimit përmes mjeteve joligjore apo thjesht ushtrimin e kompetencave për qëllime të paligjshme (Maurice, 2009:30-31).

Për përcaktimin e rolit dhe të përgjegjësisë së organizatave policore dhe për krijimin e standardeve të përbashkëta të pranura të sjelljes dhe të vlerave etike të zyrtarëve policorë janë hartuar dhe miratuar disa dokumente nga institucionet ndërkombëtare. Ndër to janë edhe: Kodi Europian i Etikës Policore, Konventa Kundër Korrupsionit, e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, etj.

Në pranimin e dukurisë së korrupsionit në polici ndikojnë edhe kompetencat e saj, në kuptimin që ato nuk duhen keqpërdorur dhe tejkaluar. Përmes këtyre kompetencave, policia duhet të luajë përcaktimi kushtetues rolin që i përcakton kushtetuta dhe ligjet e vendit, të harmonizuara këto me konventat dhe dokumentet e tjera ndërkombëtare.

Roli dhe qëllimi kryesor i policisë në një shoqëri demokratike të udhëhequr nga forca e ligjit është: të ruajë qetësinë publike dhe rendin në shoqëri; të mbrojë dhe të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të sanksionuara, veçanërisht, në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut; të parandalojë dhe të luftojë krimin; të zbulojë krimin; të kryejë funksione të ndihmës dhe shërbimeve për publikun. (Këshilli i Europës, Kodi Europian i Etikës Policore, 2001:7).

Me qëllim që kompetencat në kryerjen e detyrës zyrtare të respektohen sa më mirë, janë dhënë edhe kufizime, standarde dhe procedura që parandalojnë, por edhe ndëshkojnë sjelljet devijante dhe të papëlqyeshme, krimin dhe korrupsionin, si dhe çdo lloj tejkalimi të kompetencave ligjore nga zyrtarë të policisë.

Por këtu ndikojnë edhe shumë elemente të tjera, si mënyra e organizimit dhe struktura e organizatave policore, tradita, kultura organizative, misioni, vlerat dhe

kompetencat ligjore të tyre. Gjithashtu rol të madh kanë edhe formimi profesional, integriteti, zbatimi i kodit të etikës nga personeli policor. Në vende të ndryshme, sidomos në vendet e zhvilluara demokratike, janë bërë shumë përpjekje për ndërtimin e organizatave policore demokratike, duke u fokusuar në arritjen e standardeve më të larta të respektimit të të drejtave të njeriut, të parandalimit të sjelljeve të papëlqyeshme, korrupsionit dhe sjelljeve kriminale të zyrtarëve të zbatimit të ligjit. Por nuk ndodh kështu në shumë vende të tjera. Sipas studiuesit Peak, megjithë përpjekjet e bëra për të ruajtur standardet e pritura të sjelljes “gjatë gjithë historisë së saj, policia ka përjetuar probleme që përfshijnë sjellje të pahijshme dhe korrupsion.”(Peak, 2004:360)

Hulumtimet dhe analizimi që autorë të ndryshëm u bëjnë dukurisë së korrupsionit dhe shkeljeve penale nga zyrtarë policorë, nxjerrin në pah edhe pasojat që kjo dukuri sjell për shoqërinë dhe për shtetin. Autorët David Bayley dhe Robert Perito, në raportin special, të publikuar nga Instituti për Paqe, i Shteteve të Bashkuara, lidhur me korrupsionin policor, duke analizuar të dhënat nga raportet e komisioneve policore në shtetet anglishtfolëse, vijnë në përfundimin se e përbashkët në raportimet për korrupsionin policor është ideja se:

Korrupsioni policor shkakton humbje të resurseve, e bën drejtësinë të dështuar, ngadalëson zhvillimin ekonomik dhe e vë popullatën kundër qeverisë. Për arsyen se policia është institucioni primar për zbatimin e ligjit në çdo shoqëri, korrupsioni policor ndalon sundimin e ligjit në vend. Kur policët shesin shërbimet e veta për përfitime private, sundimi i ligjit pushon së ekzistuari (Bayley, Perito, 2011:2)

Korrupsioni, gjithashtu, shërben si praktikë maskuese për aktivitetet e krimit të organizuar. Grupet e krimit të organizuar e përdorin korrupsionin për të depërtuar në shtet, në ekonominë e ligjshme, në organet e zbatimit të ligjit dhe në politikën dhe konsiderohet si një praktikë maskuese shumë më e fuqishme dhe me një nivel të caktuar garancie. (Këshilli i Europës, 2006:65)

Autorët Peak, Gaines dhe Glensor, duke kundërshtuar idenë e pranimi të dhuratave nga zyrtarët e zbatimit të ligjit, në *Police Supervision and Management; In an Era of Community Policing*, vijnë në përfundimin se:

Ekzistojnë dy argumente themelore kundër pranimi të dhuratave nga policia. I pari është argumenti i tatëpjetës së rrëshqitshme, i diskutuar më herët, i cili propozon që dhuratat janë

hapi i parë në korrupsionin policor. Me t'u pranuar dhuratat, etika e zyrtarët policorë përmbysset dhe ata hapen ndaj rënieve të tjera të integritetit të tyre. Gjithashtu, zyrtarët që pranojnë dhurata të vogla apo shpërblime më pas janë të obliguar t'u ofrojnë dhuruesve shërbim apo akomodim më të veçantë Argumenti i dytë: disa propozojnë se pranimi i dhuratave është gabim, ngaqë zyrtarët marrin shpërblimin për shërbimin, që, si rezultat i funksionit të tyre, ata janë të obliguar ta ofrojnë. Kjo do të thotë që zyrtarët nuk kanë të drejtë legjitime të pranojnë kompensim në formë bakshishi (Peak,Gaines,Glensor, 2004:237).

Korrupsioni në polici, përfshirë edhe veprat penale dhe sjellje të tjera të zyrtarëve policorë në kundërshtim me etikën policore, janë dukuri që kanë marrë përmasa, të cilat nuk mund të injorohen, por duhet të studiohen dhe të analizohen, me qëllim që të ndërmerren masat e nevojshme për parandalimin e tyre.

Emërues i përbashkët i raporteve, i teksteve apo i punimeve në këtë fushë është së shkeljet ligjore dhe korrupsioni në polici kanë efekte negative në cilësinë e jetës së qytetarëve, pengojnë promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, pengojnë luftimin e kriminalitetit, dëmtojnë kapacitetet, aftësitë vepruese dhe imazhin e organizatave policore dhe të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, në përgjithësi.

Dukuria e korrupsionit dhe e përfshirjes së zyrtarëve të shërbimeve policore në vepra kriminale është e pranishme thuajse në të gjitha shtetet, pavarësisht nga rregullimi shtetëror, nga shkalla e zhvillimit të demokracisë, nga zhvillimi ekonomik, kultura dhe traditat. Ekziston një varësi e korrupsionit policor nga korrupsioni në përgjithësi në vend. Si njëri, dhe tjetri shkaktajnë pasoja të rënda.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se në këto vende nuk ekziston dukuria e korrupsionit në tërësi dhe e korrupsionit policor në veçanti, madje, ajo shfaqet edhe në nivel të lartë. Edhe në vendet me nivel të ulët të sundimit të ligjit dhe me mungesë të transparencës, ku institucioni i llogaridhënies nuk funksionon dhe ku dukuria e korrupsionit është prezente në të gjitha institucionet, është e pritshme që edhe korrupsioni policor të jetë në nivel të lartë. Studiues të ndryshëm kanë evidencuar edhe

dallimet e kësaj dukurie në vende të ndryshme. Lidhur me këtë, autorët Bayley dhe Perito theksojnë:

Ka një dallim mes korrupsionit policor në vendet në zhvillim dhe atij në vendet e zhvilluara. Në vendet në zhvillim sjellja korruptive e zyrtarëve policorë është më e dukshme, sepse ajo manifestohet kur qytetarë paguajnë mitë për t'iu shmangur dënimeve, si, për shembull, në pikat e kontrollit të automjeteve. Në vendet e zhvilluara korrupsioni policor në vlera mund të jetë më i lartë, sesa në vendet në zhvillim, por është më pak i vërejtur nga publiku (Bayley, Perito, 2011:5-6).

Veprat penale të korrupsionit mund të trajtohen për nga *intensiteti* dhe për nga *lloji* i veprës. Në disa shtete, më të shpeshta janë rastet e raportuara të dhunës së tepruar policore, të brutalitetit, diskriminimit racor apo etnik dhe forma të tjera të shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në vende të tjera, më të shumta janë veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare për qëllime përfitimi material.

Për sa i përket *intensitetit* të kryerjes së veprave, ky dallon nga shteti në shtet, varësisht nga niveli i përgjithshëm i korrupsionit në vend, nga sundimi i ligjit, nga legjislacioni dhe nga efikasiteti i organeve përgjegjëse të kontrollit dhe të mbikëqyrjes. Në vendet ku policia tradicionalisht i ka shërbyer elitës apo partisë politike në pushtet, policia është parë si autoritet për përdorimin e forcës dhe jo si shërbim ndaj publikut. Në të tilla vende nuk është krijuar një traditë e mbikëqyrjes dhe e kontrollit institucional të organizatave policore. Për pasojë, tejkalimi i kompetencave zyrtare, korrupsioni, brutaliteti dhe diskriminimi i qytetarëve nga ana e oficerëve policorë nuk janë trajtuar.

Në shtetet ku niveli i korrupsionit është i ulët, të renditura sipas Transparency International, si Danimarka, Finlanda, Zelanda e Re, Suedia, Singapori, Zvicra, Australia, Norvegjia, Kanadaja, Holanda etj., konsiderohet që organizatat policore kanë shkallën më të ulët të rasteve të shkeljeve të ligjit dhe të korrupsionit. Kjo paraqet një shpjegim logjik të ndikimit pozitiv apo negativ të ambientit të jashtëm në polici. Kemi parasysh këtu legjislacionin, sundimin e rendit dhe të ligjit, traditën për mbikëqyrje institucionale të forcave të rendit dhe të faktorëve të tjerë që mund të ndikojnë në

parandalimin dhe luftimin apo në nxitjen dhe tolerimin e korrupsionit dhe të shkeljeve ligjore nga zyrtarë policorë. Megjithatë, me vlerë do të ishte studimi i ndikimit i ambientit të jashtëm në nivelin e korrupsionit policor, në aspektin krahasues mes vendeve me demokraci të zhvilluar dhe me nivel të ulët të korrupsionit dhe vendeve me nivel të lartë të krimit dhe të korrupsionit.

Në një studim të kryer nga Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) theksohet:

Në rastin e vendeve postkomuniste në tranzicion, ka tre faktorë shtesë që ndikojnë në korrupsionin policor. Së pari, ndryshe nga vendet në tranzicion të Amerikës Latine, Europës Jugore dhe Afrikës së Jugut, vendeve postkomuniste iu desh të zëvendësojnë sistemin politik, por edhe atë ekonomik; brenda një kohe të shkurtër, këto vende u përpoqën të kalojnë nga një ekonomi e centralizuar dhe në mënyrë dërmuese në pronësi të shtetit, në një ekonomi kryesisht në pronësi private dhe të udhëhequr nga parimet e tregut. Në shumë vende ky tranzicion ekonomik u shoqërua nga një grumbullim i dyshimtë pasurie dhe kryesisht nga një pabarazi në rritje (DCAF,2012:47)

Vendet e Europës Juglindore, që sundoheshin nga regjime diktatoriale, karakterizoheshin nga mungesa e traditës së sundimit të ligjit, e llogaridhënies dhe e demokracisë. Një nga këto vende ka qenë edhe Shqipëria, e cila gjatë tranzicionit të gjatë është përballur me pasojat nga e kaluara e regjimit diktatorial, si në fushën ekonomike, politike, edhe në atë të sigurisë, pra, edhe në fushën e zbatimit të ligjit dhe të funksionimit të strukturave të policisë. “Duhet thënë se fillimi i procesit të demokratizimit e gjeti Policinë të papërgatitur në çdo drejtim, ligjor, edukativ, organizativ, teknik etj.” (Yzeiri, 2002:10). Ndaj, si në çdo sektor të jetës, edhe në Policinë e Shtetit zuri vend dukuria e korrupsionit. Siç vë në dukje një raport Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM):

“Rënia e regjimit komunist dhe ndryshimet radikale politike, sociale dhe ekonomike që kanë pasuar, e ekspozuan policinë ndaj një sërë dobësish, ndaj korrupsionit. Mundësitë e shumta për përfitime personale dhe përfitime të organizatës kanë bërë që organizata e policisë të jetë një nga institucionet më të ndikuara nga korrupsioni (IDM, 2014:39).

Përmasat e mëdha dhe niveli i lartë i korrupsionit në Shqipëri u bënë mjaft shqetësuese dhe objekt i analizave të strukturave dhe organizmave të ndryshme ndërkombëtare. Mund të përmendim këtu projektin CARPO (Zhvillimi i Sistemeve

Policore të Besueshme dhe Funksionale) apo Raportin mbi Gjendjen e Krimit të Organizuar dhe Krimit Ekonomik në Europën Juglindore, që kanë analizuar faktorët e korrupsionit në fazën e tranzicionit. Duke u ndalur në pjesën për Shqipërinë të këtij raporti, mësojmë se:

Procesi i tranzicionit në Shqipëri, që prej vitit 1991 është ndikuar rëndë nga disa faktorë, si: Ndryshimet dramatike në sistemin politik, të shoqëruara me ndryshime në sistemin ekonomik dhe instalimin e pronës private, me ndikime nga preferencat partiake, me presione politike dhe me korrupsion;
Kriza e skemave piramidale në vitin 1997, në të cilën burime financiare të konsiderueshme u përqendruan në duart e pak vetave, duke shkaktuar revolta publike dhe ndryshimin e qeverisë;
Fluksi i madh i refugjatëve kosovarë në Shqipëri;
Migracioni në shkallë të gjerë i shqiptarëve, kryesisht, në vendet fqinje, Itali dhe Greqi (Këshilli i Europës, 2006:69).

Në një raport të IDM thuhet “...gjatë viteve ‘90, policia është ndodhur në trekëndëshin e krimit të organizuar, politizimit dhe dobësive organizative për t’iu përgjigjur korrupsionit dhe, kështu, ishte përfshirë në korrupsion të shkallës së gjerë.”(IDM, 2014:39).

Një tjetër raport i Këshillit të Europës, në pjesën për Shqipërinë, thotë:

Korrupsioni dhe krimi i organizuar/ekonomik mendohet se janë dy anët e të njëjtës medalje. Ai përfshin ryshfetin dhe praktika të tjera korruptive, që drejtohen, si kundër nëpunësve civilë të nivelit të ulët për përmbushjen e nevojave operative (policët, zyrtarët e strukturave doganore dhe të taksave, oficerët e sigurisë, nëpunësit e zyrave të regjistrimit etj.), ashtu edhe kundër zyrtarëve të nivelit të lartë, për përmbushjen e objektivave afatgjata (prokurorët dhe gjykatësit, politikanët, anëtarët e parlamentit, të shërbimit informativ etj.)(Këshilli i Europës, 2006:65)

Edhe Raporti hulumtues lidhur me korrupsionin në Shqipëri, i publikuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara Zyra e OKB, në Vjenë, Kundër Drogës dhe Krimit (UNODC), duke analizuar përvojat e qytetarëve që kanë paguar mitë, vjen në përfundim se policia është ndër organizatat më të korruptuara, kur është fjala për marrje të mitës. Në këtë raport, midis të tjerash, thuhet:

Sipas përvojës së qytetarëve që kanë paguar, së paku, një ryshfet në 12 muajt para hulumtimit, zyrtarët publikë që marrin më së shumti bakshish në Shqipëri janë mjekët (71% e qytetarëve me përvoja të freskëta të korrupsionit u japin ryshfet mjekëve); infermieret (47%); zyrtarët policorë (14%) dhe zyrtarët e regjistrimit të veturave (8%). Zyrtarë të tjerë publikë marrin një përqindje më të vogël të ryshfetit, që radhiten: nga

përfaqësuesit e zgjedhur komunalë (1%) deri të zyrtarët e regjistrimit të tokës (7%) (UNODC,2011:21).

Edhe në Bullgari policia u përball me nivel të lartë të korrupsionit policor gjatë periudhës së tranzicionit. Autorët Dzhekova, Gouner dhe Bezlov, duke analizuar shkaqet e korrupsionit policor në këtë vend, vijnë në përfundimin se, me fillimin e procesit të tranzicionit, është rritur shkalla e kriminalitetit në vend. Kjo situatë e përkeqësuar e krimit, në kombinim me krizën politike dhe ekonomike, me rënien e të ardhurave personale të stafit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ishte shkaku i rritjes së korrupsionit në polici. Si pasojë e ndryshimeve organizative dhe e reformimit të policisë në pajtueshmëri me proceset e demokratizimit dhe të integriteteve europiane, vetëm “Në periudhën 1990-1993 numri i oficerëve policorë të larguar ishte 12.000 deri 19.000 veta” (Dzhekova, Gouner, Bezlov, 2013:100).

Shqetësuese ishte dukuria e korrupsionit edhe në Rusi, “Ekzistenca e korrupsionit policor në Federatën Ruse ka qenë subjekt i shumë diskutimeve politike dhe sociale. (Williams, 2002:93-94).

Po ashtu, shfaqje të korrupsionit në organizatën e policisë janë vërejtur edhe në ish-Republikën Jugosllave të Malit të Zi. Siç vëmë re në raportin vjetor 2011 të policisë së këtij vendi, gjatë vitit 2010, janë ngritur akuza ndaj 45 oficerëve policorë të dyshuar për krime, për vepra që ndiqen sipas detyrës zyrtare.” (Police Report, 2011:63-64).

Republika e Sllovenisë, një vend i dalë nga ish-blloku i vendeve komuniste, kaloi fazën e tranzicionit dhe, tashmë, është e integruar në Bashkimin European dhe ka nivel të lartë të zhvillimit të demokracisë dhe nivel të ulët të korrupsionit. Megjithatë, atje i kushtohet kujdes mbikëqyrjes së përfshirjes së zyrtarëve policorë në vepra penale dhe në afëra korruptive. Autorja Tadeja Kolenc, në librin e saj “Policia sllovene“, duke trajtuar kryerjen e veprave penale apo të kundërvajtjeve nga zyrtarë të policisë, thekson

idenë se përgjegjësi para ligjit janë të gjithë njësoj dhe të barabartë dhe se parimet dhe procedurat hetimore duhet të kryhen bazuar në procedurat ligjore dhe në metodologjinë e punës së policisë hetimore.

“Polici i dyshuar për kryerje të ndonjë krimi apo kundërvajtje, - vë në dukje ajo, - si çdo person tjetër i dyshuar të ketë kryer krim apo kundërvajtje, do të procedohet në pajtim me Ligjin e Policisë, me Ligjin e Procedurës Penale apo me Ligjin për Kundërvajtje” (Kolenc, 2003:41).

Më tej, autorja, duke folur për rëndësinë e administrimit të çështjeve të brendshme në sistemin e policisë, me qëllim identifikimin e parregullsive dhe gjetjen e metodave për parandalimin e tyre dhe mbrojtjen e organizatës policore nga ndikimi i korrupsionit, thekson se: “Meqë korrupsioni është një nga parregullsitë më të mëdha të funksionimit të çdo sistemi, veçanërisht të sistemit policor, i duhet kushtuar vëmendje të veçantë” (Kolenc, 2003:41).

Megjithatë, jo vetëm vendet e dala nga diktatura, por edhe ato me nivel të lartë të zhvillimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit përballen seriozisht me fenomenin e korrupsionit policor. “Është risi në Japoni, ku në mediat, së fundmi, ka vërshuar një valë lajmesh për nivelin e lartë të korrupsionit policor. (Williams, 2002:93-94).

Pra, edhe në ato vende me nivel të lartë të zhvillimit demokratik dhe të sundimit të ligjit dukuria e korrupsionit policor, abuzimet me detyrën, rastet e shpërdorimit, brutaliteti dhe skandale të tjera janë prezentë.

Një çështje tjetër që kërkon vëmendje është edhe varësia e numrit të rasteve të shkeljeve të ligjit, pra edhe të korrupsionit, në një vend të caktuar, edhe nga aspekti demografik dhe gjeografik. Kjo ka të bëjë me faktin se sa shpesh janë në kontakt qytetarët me zyrtarë policorë. Ky tregues ndryshon nga një vend në tjetrin, varësisht nga numri i banorëve, nga shkalla e kriminalitetit dhe nga metodat e policimit që aplikohen në vende të ndryshme.

Në studime të ndryshme dhe në literaturën e botuar, shohim që analizimi i korrupsionit policor bëhet më së shumti përmes identifikimit dhe shqyrtimit të *formave* dhe *llojeve* të ndryshme të veprave korruptive. Këto janë të shumëllojshme, të natyrave të ndryshme, në varësi të veprimeve jo të ligjshme që kryejnë zyrtarë të caktuar policorë gjatë kryerjes së detyrave të veçanta dhe operacioneve konkrete gjatë punës. Ndaj ato duhen njohur mirë nga drejtuesit e policisë dhe nga organet mbikëqyrëse të saj, me qëllim që të parandalohen dhe të zbulohen sa më parë. Për disa lloje veprash korruptive të zyrtarëve të policisë flasin në botimin e tyre edhe autorë, si Bayley dhe Perito:

“Si forma më të zakonshme të korrupsionit ishin evidencuar përpilimi i raporteve të falsifikuara dhe kryerja e paragjykimeve, mbrojtja e lojërave ilegale, vjedhja e drogës në rrugë, vjedhja e pasurisë së konfiskuar, pranimi i zbritjeve gjatë blerjes dhe shitja e informacioneve lidhur me operacionet policore.” (Bayley, Perito, 2011:4).

Një ndarje më e detajuar dhe më specifike e llojeve të korrupsionit policor jepet në një studim për korrupsionin në polici, drejtësi dhe doganë të kryer nga Instituti për Kriminalistikë në Bundeskriminalamt (BKA) të Gjermanisë. Në hulumtimin gjithëpërfshirës “Einschätzungen zur Korruption in Polizei, Justiz und Zoll”, për korrupsionin, autorët Mischkowitz, Bruhn, Desch, Hübner dhe Beese argumentojnë se ekzistojnë lloje të ndryshme të korrupsionit policor. Ata theksojnë se, fillimisht, shfaqet *korupsioni spontan*, që përkufizohet si një sjellje e individit, që nuk ndikohet nga jashtë. Më pas, përmendin një lloj tjetër të korrupsionit, që ata e quajnë *korupsioni i planifikuar*, i cili nënkupton ekzistencën e kontaktit mes atij që jep mitë dhe atij që e pranon atë, si dhe ndërmarrjen e hapave të caktuara për vepra korruptive. Një lloj tjetër i korrupsionit policor është *korupsioni situativ*. Ky përkufizohet nga këta autorë si i ngjashëm me korrupsionin spontan, por që dallon prej tij, ngaqë nuk përsëritet, kryhet vetëm një herë dhe ndodh më tepër si rastësi, në rrethana dhe situata të caktuara. Një lloj tjetër është *korupsioni sistematik*, i cili paraqitet si një veprim korruptiv gjithmonë i planifikuar dhe nënkupton një bashkëpunim sistematik dhe marrëdhënie të

vazhdueshme mes atyre që japin mitë dhe atyre që e marrin atë. Karakteristikë e këtij lloji të korrupsionit është se nicipativa për veprimet korruptive është e dyanshme, edhe e dhënësit, edhe e marrësit të mitës. Një variant i *korruptionit sistematik* është *korruptioni i strukturuar*, i cili quhet kështu, sepse është fjala për afera korruptive që kanë depërtuar në struktura, në organizma të ndryshme dhe se bashkëpunimi mes elementeve apo pjesëve të sistemit është i qëndrueshëm dhe i pavërejtur. (BKA, 2000:172-175)

Edhe Komisioni i Pavarur Policor për Ankesa (IPPC) në një raport të publikuar për korrupsionin policor në Angli dhe Uells paraqet karakteristikat e dukurisë së korrupsionit, llojet më të shfaqura, administrimin e rasteve, politikën ndëshkimore dhe ndryshimet legjislative me qëllim luftimin e kësaj dukurie. Pasi jepen shifrat e rasteve të korrupsionit policor për një periudhë dyvjeçare, ky raport detajon edhe llojet e veprave korruptive të kryera:

“Në vitet 2008/09 dhe 2010/11 mesatarja e rasteve të referuara të korrupsionit ishte 3.2 raste në 1000 personel policor”.

Nga rastet e referuara në Komisionin e Pavarur Policor për Ankesa (IPPC), më të shpeshta ishin:

13% e rasteve: zbulim i paautorizuar, përfshirë zbulimin e detajeve personale të shkelësve, të të dyshuarve apo civilëve; informata të raporteve të krimit; informata që mund të rrezikojnë rastin për gjykatë;

15% e rasteve: abuzim i autoritetit, përfshi edhe abuzimin e besimit apo të drejtave të kolegut apo zyrtarit civil dhe keqpërdorim i kompetencave dhe të autoritetit policor për përfitime të organizatës, për vete apo për të tjerët;

30% e rasteve: vjedhje dhe mashtrim, përfshi vjedhjen, në detyrë, të pasurisë, përfshi atë të marrë në arrest, përfshi para dhe/apo sende të sekuestruara, ku pasuria nuk është kthyer, përfshi droga të jashtëligjshme; shpenzime mashtruese apo pretendime për punë jashtë orarit; përdorim i paautorizuar i kartës policore të kreditit;

9% e rasteve: keqpërdorim i sistemeve, përfshi qasje të paautorizuar në sistemet policore për përfitime personale;

33% e rasteve: pengim i rrjedhës së drejtësisë, përfshi falsifikimin e të dhënave, dëshmi të rreme në gjyq, falsifikimin e deklaratave të dëshmitarëve dhe manipulimin e provave (IPPC, 2012:32-33)

Në përputhje me këtë situatë, u ndërmorën edhe masat e nevojshme për forcimin e luftës kundër shfaqjeve të ndryshme të korrupsionit. Sipas raportit të mësipërm, këto masa ishin:

Reagimet ndaj korrupsionit policor kanë pasur tendencë të përqendrohen në rregullimin e sjelljeve të policisë, rregullimin në legjislacion, sikurse Ligji mbi Policinë dhe Provat Penale 1984, dhe themelimin e Departamenteve të Standardeve Policore, përfshirë Njësitë Kundërkorrupsion. Më gjerësisht, është e qartë që çështja e korrupsionit nuk është e izoluar vetëm në policinë e Britanisë (IPPC, 2012:12)

Lidhur me sjelljen e zyrtarëve të zbatimit të ligjit, në raport me etikën profesionale, me keqpërdorimin e detyrës apo me shkeljet penale po zhvillohen gjithnjë e më shumë debate, diskutime dhe hulumtime, po shkruhet shumë në media, si dhe po bëhen në strukturat përkatëse analiza, raporte gjithnjë e më kritike dhe transparente. Diskutimi i hapur dhe i argumentuar për problemet në këtë fushë, sigurisht, ka nxitur institucionet qeveritare përgjegjëse të ndërmarrin masa për forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm dhe sidomos për forcimin e integritetit të punonjësve policorë. Megjithatë, “pavarësisht gjetjeve pozitive, hulumtimet sugjerojnë se keqpërdorimet policore mbeten problem që duhet të adresohen nga politikëbërësit dhe profesionistët policorë. (Wiesburd, Greenspan, Hamilton, Williams, Bryant, 2000:11).

Ky është një konstatim që e sugjeron vetë situata në terren në vende të ndryshme të botës. Ndaj dhe shtrohet me të madhe nevoja e ndërtimit dhe e fuqizimit të pandërprerë të kapaciteteve për mbikëqyrje demokratike dhe të pavarur të organizatave policore, si dhe domosdoshmëria e veprimit të ligjit mbi këdo që përfshihet në vepra korruptive, qoftë punonjës i thjeshtë, qoftë zyrtar i lartë i policisë. Parandalimi dhe lufta kundër veprave penale të korrupsionit edhe në organizatat policore mbetet një prioritet i përhershëm i qeverive nacionale.

2.3 Faktorët që ndikojnë në korrupsionin policor

Identifikimi i faktorëve dhe i shkaqeve të korrupsionit policor është hapi i parë në trajtimin e kësaj dukurie, me qëllim parandalimin dhe luftimin efikas të saj. Autorë të ndryshëm kanë argumentuar se kompleksiteti i korrupsionit vjen si pasojë e faktorëve të

shumtë që shpjen në shfaqjen e tij. Këta faktorë mund të kërkohen te niveli i korrupsionit në vend, te mangësitë në legjislacion, tek kultura organizative, te funksionet e mbikëqyrjes, te trajnimi dhe rekrutimi i punonjësve, te sjellja individuale, personaliteti i punonjësve dhe te faktorë të tjerë. Këta faktorë janë shumë kompleksë, ndaj kërkojnë njohje dhe studim të vëmendshëm nga drejtuesit dhe strukturat përkatëse, për të depërtuar në karakterin dhe personalitetin e secilit punonjës e sidomos në sjelljen e tyre në punë. Kjo është e domosdoshme, pasi:

Sjellja e një punonjësi është shpesh e paparashikueshme, për shkak se ajo, zakonisht, përfshin një ndërveprim jashtëzakonisht kompleks mes një zyrtari dhe një situatë të caktuar. Personaliteti është një element i rëndësishëm i sjelljes dhe nuk mund të nënvlerësohet. Në të njëjtën kohë, secili person ndikohet nga të tjerët dhe nga rrethana të caktuara që kanë të bëjnë me një ngjarje. Nuk ekzistojnë dy persona të njëjtë, çdo person ka karakteristika të veçanta në ambientin e punës (More, Wegener, 1992:69)

Qendra DCAF, në publikimin “Pakoja e Instrumenteve mbi Integritetin e Policisë”, si burim të korrupsionit policor paraqet individin, por edhe dështimet e menaxhimit të personelit nga strukturat përkatëse të institucionit a të organizatës. Në të thuhet:

“Individët që punojnë në një organizatë kanë objektivat e tyre, të cilat mund të ndryshojnë nga ato të organizatës. Ambicia, lakmia dhe shmangia e problemeve janë një pjesë e vogël e motiveve që mund të çojë anëtarët e një organizate të zhvillojnë strategji personale dhe të ndjekin interesat vetjake, të cilat mund të dëmtojnë ato të organizatës. Dobësitë organizative dhe të menaxhimit mund të ndihmojnë interesat individuale të mbizotërojnë mbi ato kolektive dhe mund të inkurajojnë zhvillimin e korrupsionit. Kjo është tërësisht e vërtetë edhe për organizatat e shërbimit policor. (DCAF, 2012:76)

Duke analizuar sjelljen e individit në raport me korrupsionin, autorët Mischkowitz, Bruhn, Desch, Hübner dhe Beese (2000:206) identifikojnë një numër çështjesh apo qëndrimesh, që duhen marrë në konsideratë kur është fjala për sjelljen e individëve si faktor kontribues në sjelljet devijante dhe në veprimet kriminale dhe korruptive. Sipas tyre, ato janë:

- problemet personale (shembull: borxhet, varësia, partneri);
- frustrimi nga profesioni, pakënaqësia ndaj drejtuesit;
- identifikim i tepërt me autoritetin;

- perceptimi për pagë të ulët;
- mbingarkesa në shërbim;
- dëshira e ekzagjeruar për njohje dhe prestigj;
- ambicie e tepruar;
- aktivitete shtesë të çfarëdolloji;
- kontaktet private me mjedisin;
- kontakte private në tregti, industri dhe me qarqe lobiste;
- luajaliteti i “keqkuptuar”;
- monotonia në profesion;

Përveç faktorëve të natyrës individuale, në kryerjen e veprave penale dhe të korrupsionit në përgjithësi, për korrupsionin në polici ekzistojnë edhe faktorë të tjerë, kulturorë dhe institucionalë. Faktorë të tillë janë identifikuar dhe diskutuar nga hulumtues të ndryshëm. Hubert Williams, duke analizuar faktorët kryesorë institucionalë dhe kulturorë që ndikojnë në krijimin e një sjelljeje korruptive në polici në vende të ndryshme, vjen në përfundimin se faktorët primarë burojnë nga dështimet në këto katër fusha kryesore: rekrutimi, trajnimi dhe promovimi i personelit; resurset (pagat dhe pajisjet e punonjësve; sistemet e llogaridhënies brenda departamenteve, në gjykata, si dhe legjislacioni; traditat kulturore, që pengojnë zhvillimin profesional të standardeve të policisë. (Williams, 2002:86). Duke folur për shkaqet që ndikojnë në shfaqjen e veprave korruptive, po ky autor ngarkon me përgjegjësi strukturat përkatëse që nuk e bëjnë mirë punën e tyre për menaxhimin si duhet të personelit. Ai shprehet: “Korrupsioni ekziston, sepse shumë departamente nuk bëjnë punë të mirë gjatë punësimit, trajnimit, pagesës dhe disiplinimit të oficerëve të tyre”. (Williams, 2002:97).

Procesi i rekrutimit dhe i seleksionimit të personelit, si faktor kontribues në korrupsion, kërkon një kujdes të veçantë, pasi përzgjedhja cilësore e personelit është vendimtare për parandalimin e kryerjes së veprave korruptive. Rekrutimi i kandidatëve të paverifikuar mirë dhe me mangësi në integritetin personal ka mundësi të mëdha të

shpjerë në sjellje devijante dhe në shpërdorim të detyrës në fazat e mëvonshme të karrierës nga këta elementë. Fitch thotë:

“Është e vërtetë që, së paku, disa nga zyrtarët që përfshihen në aktivitete të paligjshme kanë arritur të shpëtojnë disi, për shkak të metave në procesin e punësimit dhe thjesht kanë vazhduar rrugën joetike të tyre. Gjithsesi, ky shpjegim nuk mund të sqarojë përse edhe zyrtarë të mirë policorë përfshihen në keqpërdorim të detyrës.” (Fitch, 2011:24).

Nga kjo del se, edhe kur procesi i rekrutimit të personelit të policisë kryhet në parametra cilësorë, është tepër e nevojshme të punohet vazhdimisht për trajnimin, edukimin dhe këshillimin e tyre, me synim parandalimin e sjelljeve korruptive.

Ndikimi *i kulturës* në sjelljet dhe në qëndrimet e zyrtarëve policorë është po ashtu ndër faktorët që duhet marrë parasysh. Në dizertacionin e tij me titull “Kultura dhe subkultura në Forcat Policore të Turqisë”, Yildiz shprehet:

Përkufizimet dhe konceptet e tipologjisë së devijimeve policore japin bazë për ekzaminimin e sjelljes së papërshtatshme policore dhe veçanërisht për prapavijën e saj kulturore. Fillimisht, na lejon të kuptojmë sesi një gamë e gjerë sjelljesh devijante mund të ndërlidhen me subkulturën e punonjësve të policisë. Për më tepër, ato na shërbejnë si pikë e përbashkët fillestare për ekzaminimin e praktikave të papërshtatshme policore. Të kuptuarit e devijimeve policore dhe e rrënjëve të tyre kulturore është mjaft i rëndësishëm. Përmes të kuptuarit konceptual të formave të ndryshme të sjelljeve devijante, mund të udhëzojmë autoritetet policore në Turqi që të përqendrojnë qasje alternative të problematikës, në vend të teorive të thjeshta dhe të pabaza, si ajo e “mollës së kalbur” (Yildiz, 2001:17)

Një tjetër faktor i rëndësishëm për parandalimin dhe shmangien e veprimeve korruptive të personelit policor janë edhe *kontrolli dhe mbikëqyrja* sistematike e personelit. Pa një mbikëqyrje adekuate nuk do të arrihen efektet e pritshme pozitive nga personeli policor. Mungesa e mbikëqyrjes prodhon pasoja negative në luftën kundër korrupsionit. Roli i mbikëqyrësve është vendimtar në menaxhimin e personelit, për ruajtjen e vlerave etike të punonjësve të policisë, për krijimin e një kulture të llogaridhënies dhe të transparencës, për forcimin e integritetit profesional dhe për parandalimin e korrupsionit dhe të sjelljeve tjera të kundërligjshme. Është me vend të theksohet se mbikëqyrësit duhet të jenë shembull për punonjësit që kanë në varësi, duke manifestuar cilësi, sjellje dhe qëndrime të standardeve të larta, që të kenë të drejtën

morale dhe legjitime t'ua kërkojnë ato vartësve të tyre. “Udhëheqja është gur themeli i bazës morale të organizatës. Kjo është një e vërtetë historike. Udhëheqësit japin tonin, dhe përmes aktiviteteve dhe veprimeve të tyre ata e bëjnë model këtë sjellje për të gjithë të tjerët.” (Riccucci, 2006:192).

Lidhur me këtë, autorët Iannone theksojnë:

Mbikëqyrësi duhet të jetë në gjendje të kontrollojë veten para se të kontrollojë të tjerët. Nëse ai ndjek një sërë rregullash të veta, ndëkohë që kërkon nga vartësit të ndjekin model më rigoroz të sjelljes, ai nuk mund të presë nga ata që ta respektojnë. Nëse nuk ka vetëdisiplinë, ai nuk do të mund të disiplinojë vartësit e vet siç duhet. Po kështu, nëse ai nuk ndjek urdhrat nga mbikëqyrësit e vet, vështirë se mund të presë që urdhrat e tij të zbatohen (Iannone, Iannone, 2001:212).

Edhe *pagat dhe benificionet e personelit, investimet në pajisjet, në teknologji, në kushtet e punës*, nëse mungojnë mbikëqyrja dhe kontrolli, nuk do të kenë efektet e pritura pozitive në luftën kundër veprimeve korruptive.

Një faktor tjetër me rëndësi të veçantë në parandalimin e rasteve të korrupsionit në polici është edhe *organizimi i punës* për zbatimin e detyrave nga personeli mbi bazën e disa standardeve të policisë. Por në praktikë, ndodh që gjatë ushtrimit të detyrës, zyrtarët policorë në shumë raste nuk kanë norma të shkruara se si duhet të veprojnë, si të sillen për çdo situatë dhe çfarë vendimi të marrin. Kjo bën që shpeshherë ata të veprojnë sipas mendimit të tyre, pra, në bazë të parimit të diskrecionit. Mirëpo, në këto kushte ekziston mundësia që ky parim të keqpërdoret dhe punonjës të caktuar të policisë të shkasin në veprime devijante, korruptive, arbitrare, të paligjshme etj. Në mungesë të disa rregullave të shkruara sesi duhet të veprojnë në situata të ndryshme, punonjësit e policisë i atribuojnë vetes liri të pakufizuar veprimi, gjë që sjell kryerjen e veprimeve që i tejkalojnë kompetencat e tyre, por edhe të veprimeve të kundërligjshme. Duke e trajtuar këtë çështje, Newburn vë në dukje:

Zyrtarët policorë kanë liri të konsiderueshme veprimi kur vendosin nëse do të zbatojnë ligje të caktuara në situata të caktuara, duke bërë të mundshme që këto vendime të ndikohen nga përfitimet materiale apo leverdi të tjera se sa nga të gjykuarit profesional. Një nga burimet kryç të veprimeve devijante janë resurset e disponueshme brenda organizatës policore. Në

këtë situatë nuk është thelbësore vetëm ndryshueshmëria në përdorimin e lirisë së veprimit. Është, gjithashtu, fokusi i punës së policisë. Janë disa forma të punës së policisë që shoqërohen me mundësi më të mëdha dhe me gjasa më të mëdha për korrupsion. (Newburn, 1999:16)

Duke tërhequr vërejtjen se diskrecion nuk do të thotë arbitraritet, dr.Migena

Leskoviku, nënvizon rastet e shpërdorimit të tij:

- Organi administrativ kryen një paligjshmëri nëpërmjet mosrespektimit të gabuar ose të qëllimshëm të kufizimeve ligjore të dhëna për ushtrimin e diskrecionit.
- Shpërdorimi i diskrecionit mund të jetë objektiv ose subjektiv.
- Një shpërdorim objektiv vjen nga mosrespektimi ose shkelja e parimeve kushtetuese, si barazia, proporcionaliteti, paanësia etj.
- Një shpërdorim subjektiv është rezultat i ushtrimit të diskrecionit për një qëllim të gabuar, ose kur ushtrimi i tij nuk justifikohet nga argumentet në të cilat është mbështetur. (Leskoviku, M.2012)

Faktorët dhe shkaqet e sjelljeve devijante dhe të korrupsionit në organizatat e policisë duhet të kërkohen në ato që u përmendën më lart, te kombinimi i tyre dhe te faktorë të tjerë politikë, socialë, kulturorë, ekonomikë dhe ligjorë, duke marrë parasysh edhe rrethana të tjera kulturore të shteteve të ndryshme. Identifikimi i hershëm i kësaj dukurie krijon mundësi për institucionet përgjegjëse, me qëllim marrjen e masave legislative, administrative; krijimin e mekanizmave të pavarura për hetimin e të gjitha pretendimeve për shkelje, qoftë penale, qoftë administrative; minimizimin e dëmeve dhe të pasojave negative të shkaktuara; ruajtjen e besimit të publikut dhe, jo më pak e rëndësishme, mbrojtjen dhe përkrahjen e personelit policor, forcimin e integritetit të punonjësit të policisë dhe sigurimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët.

2.4 Faktorët që ndikojnë në kryerjen e veprave të korrupsionit nga punonjësit e PK

Lufta kundër shfaqjeve të korrupsionit policor kërkon shkallë të lartë angazhimi të drejtuesve dhe të strukturave të kontrollit e të mbikëqyrjes mbi policinë. Një rol vendimtar për zhvillimin me sukses të kësaj lufte luan identifikimi i hershëm i faktorëve që ushqejnë korrupsionin në zyrtarët e policisë së Kosovës.

Në kryerjen e veprave penale nga zyrtarët e PK-së ndikojnë faktorë të përgjithshëm dhe faktorë të veçantë. Faktorët e përgjithshëm janë të njëjtë me ata që ndikojnë veprat kriminale dhe korrupsionin policor edhe në vende të tjera. Ata mund të grupohen si: faktorë individualë, kulturorë, institucionalë, të legjislacionit etj.

Me faktorë të veçantë kemi parasysh ata që lidhen me disa rrethana specifike të Kosovës. Të tilla kanë qenë e kaluara e Kosovës, tranzicioni, kushtet e ndërtimit të policisë së saj etj.

Kosova, si një shtet i ri, u ballafaqua me shumë probleme të trashëguara nga koha e diktaturës komuniste, e dhunës dhe e diskriminimit në ish-Federatën Jugosllave, si dhe me pasojat e luftës. Ndërsa procesi i tranzicionit, sikurse në vendet tjera, në Kosovë u karakterizua nga një dinamikë e ndryshimeve ekonomike e politike. Nga vendosja e administratës së UNMIK-ut në vitin 1999 e deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 2008 kemi një dualizëm në pushtet, edhe administratën ndërkombëtare, edhe institucionet vendore. Ky dualizëm pushtetesh krijoi mjaft vështirësi në krijimin dhe funksionimin e organeve dhe institucioneve të Kosovës. UNMIK-u kishte të drejtën e vendimmarrjes dhe të udhëheqjes në ndërmarrje publike, të drejtën e emërimit dhe zgjedhjes së personelit vendor në pozita mbikëqyrëse dhe, më e rëndësishmja, kishte kompetencat për zbatimin e ligjit, ruajtjen e rendit publik, luftimin e krimit dhe korrupsionit. Edhe kompetencat dhe pushteti i pakufizuar i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, mungesa e infrastrukturës ligjore, procesi i ngadalshëm i vendimmarrjes dhe i harmonizimit të qëndrimeve politike, gjendja e rëndë ekonomike dhe sociale, si dhe mungesa e një vizioni të qartë për të ardhmen politike të Kosovës jo vetëm eliminonin pavarësinë e institucioneve vendore, por mund të themi se disa prej ishin faktor që niveli i krimit dhe, sidomos, i korrupsionit qeveritar të mbetej në nivel të lartë.

“Korrupsioni qeveritar krijon një ambient që mundëson disa lloje të krimeve të trafikimit. Disa zyrtarë policorë, zyrtarë të Ministrisë së Punës dhe zyrtarë të tjerë qeveritarë janë akuzuar apo dënuar për krime të trafikimit.” (U.S.Country Report, 2015:210).

Edhe rrethanat e krijimit të PK patën ndikimin e tyre në shfaqjen e korrupsionit në polici. Si një nga institucionet e para dhe më të rëndësishme të pasluftës, Policia e Kosovës, u krijua nën mandatin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, në kohën kur institucionet vendore qenë të brishta dhe vepronin nën organizmat ndërkombëtare që u vendosën në Kosovë. Policia e UNMIK-ut, që kishte mandatin për krijimin e PK-së përbëhej nga zyrtarë dhe ekspertë policorë që vinin nga disa vende të ndryshme dhe jo të gjithë kishin aftësitë dhe kualifikimin e duhur që kërkohen për krijimin e një organizate policore me vlera etike dhe profesionale. Ata që vinin nga vende në zhvillim nuk sollën sjellje, praktika dhe modele të mira për policinë vendore dhe ndihmuan shumë pak në implementimin e standardeve europiane të policimit. Për më tepër, disa prej tyre vinin nga rajonet me konflikte afatgjata dhe nuk kishin përvoja demokratike, ndaj edhe nuk mund të kontribuonin sa duhet në krijimin e një ambienti të sigurt, ku sundojnë ligji dhe rendi. Kontributi i tyre në përgatitjen dhe në formimin profesional të zyrtarëve të PK-së ishte i nivelit të ulët, për shkak të ndryshimeve dhe dallimeve të mëdha legislative, metodave të punës, traditës, kulturës dhe barrierave gjuhësore.

Për rrjedhojë, edhe procesi i rekrutimit të personelit ka ndeshur me vështirësi në përzgjedhjen e kandidatëve, në verifikimin dhe në hetimin e së kaluarës së tyre. Edhe trajnimi teorik i oficerëve vendorë të përzgjedhur, që kryhej nga OSBE-ja, me instruktorë, kryesisht, të Europës Perëndimore dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka pasur shprehje nga trajnimi praktik, të cilin e bënin instruktorë nga vende në zhvillim.

Më 2013, Transparency International Government Defence Anti-Corruption Index ka gjetur se vetëm tri vende, Australia, Suedia dhe Spanja, kanë ofruar trajnime në

kundërkorrupsion për udhëheqësit në të gjitha nivelet për t'u siguruar se ata i kanë të qarta çështjet e korrupsionit me të cilat ata mund të përballen gjatë angazhimit në terren. Dy vende të tjera, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Greqia, kishin doktrinë ushtarake që e trajtonte korrupsionin si çështje strategjike në operacione. (Transparency International, 2014:7)

Kështu, ka ndodhur që, ndërsa instruktorët europianë dhe ata amerikanë promovonin vlerat e larta të etikës dhe të respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, ata që duhej t'i implementonin këto standarde përmes trajnimit fushor praktik, jo gjithmonë i kanë përcjellë si duhet ato, pasi vepronin sipas praktikave të vendeve të tyre. Kjo ka shkaktuar paqartësi dhe konfuzion tek oficerët e rinj policorë të Kosovës. Të metat e kësaj praktike i kemi njohur, si përmes vrojtimeve personale, por edhe në analiza e studime të ndryshme.

Problem ishte sa të aftë dhe kompetentë ishin zyrtarët policorë të UNMIK-ut, që u vendosën në Kosovë. Fakt është se më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të zyrtarëve policorë ndërkombëtarë vinin nga shoqëri autokratike dhe shumë të korruptuara. Duke sjellë zyrtarë policorë që nuk e kanë përvojën e zbatimit të ligjit në shoqëritë demokratike dhe të papërgatitur për të operuar në mënyrë korrekte dhe të dobishme, UNMIK-u i ka përkeqësuar gjërat edhe më shumë. Me një profil të tillë të zyrtarëve "policorë ndërkombëtarë", ishte e qartë se ata nuk do të mund t'i kontribuonin në mënyrë domethënëse zhvillimit të policisë së Kosovës dhe kanë armiqësuar marrëdhëniet me popullatën vendase (CASIN, 2003:23).

Këto rrethana në të cilat u krijua Policia e Kosovës, administrimi nga Misioni i Kombeve të Bashkuara (UNMIK) deri në shpalljen e pavarësisë, mungesa e infrastrukturës ligjore, mungesa e përvojës të stafit vendor etj., sigurisht që prodhuan mjaft probleme pasoja, që mbeten sfidë për PK. Këto mangësi mund të shihen si faktor kyç në shfaqjen e dukurive të korrupsionit të zyrtarëve tanë policorë. Po ashtu, presioni për ta krijuar sa më shpejt dhe në një kohë të shkurtër Policinë e Kosovës, vështirësitë ekonomike, varfëria dhe papunësia e madhe, por edhe situata politike e pastabilizuar mirë kanë ndikuar negativisht në arritjen e standardeve të policimit demokratik.

Përfundimisht, mund të thuhet se, në shumë raste, burimi i sjelljeve devijante të punonjësve të Policisë së Kosovës lidhet pikërisht me fazën e themelimit të saj. "Në terma praktikë, është vështirë të priten rezultate të mira kur kontingjentet policore nga më

shumë se 45 shtete operojnë në terren në të njëjtën kohë dhe, natyrshëm, komunikimet dhe standardet kanë qenë tepër kuturu në një ambient të tillë.” (ICG, 2005:23).

Një ndikim të madh në rritjen e pranisë së korrupsionit në Policinë e Kosovës ka pasur edhe struktura dhe përbërja e administratës ndërkombëtare në Kosovë. Ajo ka qenë e tillë që nuk ka mundur sa duhet zhvillimin dhe fuqizimin e mekanizmave të kontrollit shtetëror dhe ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme për parandalimin dhe luftimin efikas të krimit dhe të korrupsionit, në përgjithësi, dhe në polici, në veçanti. Duhet theksuar këtu sidomos mungesa e vullnetit politik e administratës ndërkombëtare dhe e qeverisë së Kosovës për të luftuar korrupsionin në administratën shtetërore.

“Ndërsa organe të ndryshme të UNMIK-ut, si ITF (Investigative Task Force-Task Forca Hetuese) ka hetuar një sërë pretendimesh për korrupsion, vullneti politik, si brenda UNMIK-ut, ashtu edhe i institucioneve të qeverisë së Kosovës që të reagojnë mbi to dhe të ndërmarrin veprime, në veçanti kundër figurave të larta, mbeti shumë e kufizuar gjatë periudhës së administrimit të UN” (Transparency International, 2014:23)

Prania e korrupsionit në institucione të tjera të shtetit, madje, edhe në qarqet e larta zyrtare, pa dyshim, ushtron ndikim edhe në policinë e Kosovës, e cila nuk është e shkëputur prej tyre. Për këtë ndikim flet edhe Këshilli i Europës kur shqyrton gjendjen e korrupsionit në Kosovë. Në një raport të tij të vitit 2015, thuhet:

Kosova është demokraci e brishtë, e cila vuan prej llogaridhënies dhe transparencës së dobët qeveritare. Sipas shumë studimeve, korrupsioni është një prej problemeve më të mëdha dhe mbetet fenomen shumë i përhapur në Kosovë në palë të ndryshme joqeveritare të interesit në nivel vendor, si dhe në palë të ndryshme ndërkombëtare të interesit. Studimet ndërkombëtare rreth perceptimit të korrupsionit, po ashtu, tregojnë se perceptimi ka mbetur në të njëjtin nivel të ulët apo është përkeqësuar. (Këshilli i Europës, 2015:22)

Por korrupsioni në polici ndikohet edhe nga niveli i korrupsionit në lidërshtipin politik. Sipas disa autorëve që kanë studiuar korrupsionin policor: “Korrupsioni nuk mund të ekzistojë pa pasur një bashkëpunim aktiv të oficerëve të lartë policorë dhe figurave kryesore në hierarkinë politike.”(Thibault, Lynch,McBride, 2007:35).

Gjithashtu, në nivelin e korrupsionit në PK ndikojnë edhe një sërë faktorësh të tjerë, si sistemet jo të shëndosha të llogaridhënies në prokurori dhe në gjykata; legjislacioni jo i plotë; aspekti demografik dhe gjeografik, që ka të bëjë me faktin se sa

shpesh janë në kontakt qytetarët me zyrtarë policorë etj. Rol të rëndësishëm luan edhe bashkëpunimi i PK me organizata policore të vendeve të tjera, si dhe me agjenci dhe organizata ndërkombëtare, që mund të ofrojnë përvoja bashkëkohore në trajnimin dhe edukimin policor, si dhe në luftën me sukses të korrupsionit në radhët e policisë.

Sidoqoftë, faktorët kryesorë të përhapjes së korrupsionit policor duhet të kërkojnë brenda vetë policisë.

Një ndër faktorët e brendshëm që lidhet me nivelin e korrupsionit policor është gjendja dhe performanca e kapaciteteve profesionale të policisë. Kjo ka të bëjë me politikat që ndiqen për rekrutimin dhe përzgjedhjen e personelit, për trajnimin dhe zhvillimin profesional të tij, në emërimet në postet e larta të policisë, në gradimet, si dhe në aspektin buxhetor në krijimin e kushteve të punës, të investimeve në pajisje dhe teknologji. Nga këto varet shumë prezenca e rasteve të keqpërdorimit të pozitës dhe e shkeljeve të ligjit nga zyrtarët e policisë.

Fakti që ka dalë nga hulumtimi i kryer se në PK nuk janë organizuar trajnime të mjaftueshme të fokusuara në forcimin e integritetit policor, ka ndikuar negativisht në luftën kundër korrupsionit policor. Nëse 64% e pjesëmarrësve në anketim deklarojnë se nuk kanë bërë trajnim lidhur me integritetin policor, se 60% prej tyre kanë nevojë për trajnim në këtë fushë, kjo tregon se sa pak punohet në PK për forcimin dhe ruajtjen e vlerave në radhët e policisë. Kjo, në fakt, favorizon përfshirjen e zyrtarëve të PK-së në vepra penale dhe korruptive.

Po ashtu, defektet e kontrollit dhe të mbikëqyrjes mbi vartësit lënë shteg që punonjësit policorë gjatë kryerjes së detyrës, ndërsa joshen dhe tundohen nga aferat korruptive, në mungesë të mbikëqyrjes, bien pre e tyre, shkelin ligjin, cenojnë detyrën, duke rrezikuar ndëshkimin, por edhe duke prishur imazhin e policisë.

Nga ana tjetër, edhe masat ndëshkimore që japin gjykatat apo strukturat e tjera kanë një rol për parandalimin e veprave korruptive në polici. Ndërsa mungesa e efikasitetit të tyre, dhënia në shumë raste e dënimeve më të buta sesa parashikojnë dispozitat ligjore, për shkak të ndërhyrjeve apo favorizimeve të qëllimshme, nuk japin mesazhe të shëndosha për luftimin e korrupsionit të zyrtarëve policorë.

Këta faktorë dhe shumë të tjerë që veprojnë në praktikë, duhen parë me prioritet nga strukturat drejtuese të Policisë së Kosovës, me qëllim që, mbi analizën e tyre, të bëhen korrigjime dhe përmirësime në dokumentet dhe planet strategjike të luftimit të formave të ndryshme të korrupsionit policor, në strategjinë zhvillimore dhe planin e veprimit të PK etj.

Për ruajtjen dhe forcimin e integritetit policor dhe kontrollin e korrupsionit brenda organizatës, strukturat drejtuese, eprorët duhet të ndjekin nga afër, si i kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë zyrtarët policorë në terren, në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, në sigurinë e jetës dhe pronës, në luftimin e krimit, në arrestimin e personave të dyshuar dhe detyra të tjera. Mangësitë në këtë drejtim prodhojnë efekte negative në sjelljen e personelit. Prandaj drejtuesit duhet të veprojnë rigorozisht mbi bazën e një strategjie dhe plani veprimi të hartuar lidhur me integritetin policor, në bazë të praktikave dhe të standardeve të organizatave policore të vendeve europiane. Mungesa e një plani strategjik për ruajtjen dhe forcimin e integritetit profesional të oficerëve të policisë nuk ndihmon, por e pengon luftën e korrupsionit në PK.

KREU III: ASPEKTI PENALO-JURIDIK I VEPRAVE PENALE TË KORRUPSIONIT

3.1 Rregullimi penalo-juridik i veprave penale të korrupsionit në legjislacionin e Kosovës

Dukuria e korrupsionit, e keqpërdorimit të pozitës dhe të kompetencave zyrtare dhe, në përgjithësi, veprimet e kundërligjshme të personave zyrtarë, janë njohur me kohë në të drejtën penale si vepra kriminale.

Në kuptimin juridik, korrupsioni paraqet shkelje të rendit kushtetues, për shkak se godet garancitë kushtetuese, liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit dhe, për pasojë, ushtrimi i shërbimeve publike merr karakter të kryerjes së tyre vetëm për ata qytetarë që janë në gjendje ose mund t'i paguajnë ato shërbime, dhe po ashtu në kuptimin juridik, korrupsioni definohet në mënyra të ndryshme si dhe në vepra të ndryshme penale. (Latifi, 2006:202).

Veprat penale kundër detyrës zyrtare përbëjnë sjellje të kundërligjshme të drejtuar kundër funksionimit të rregullt të shërbimeve publike, që kryejnë personat e autorizuar a personat zyrtarë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre ose lidhur me kryerjen e kësaj detyre. Kjo formë e veprës penale sot hyn në kategorinë e kriminalitetit me shkallë të lartë rreziku për shoqërinë. Kjo manifestohet jo vetëm në pasojat materiale që rezultojnë nga kryerja e këtyre veprave penale, por sidomos në rrënimin dhe çrregullimin e rrjedhave themelore të jetës shoqërore, duke atakuar vlerat morale të shoqërisë. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1204).

Element esencial i këtyre veprave penale është cenimi i detyrës zyrtare nga personat zyrtarë, përmes shfrytëzimit të kundërligjshëm të pozitës dhe kompetencave zyrtare që rrjedhin prej saj. Bëhet fjalë për keqpërdorimin e pushtetit përmes shfrytëzimit të palejueshëm të pozitës dhe të kompetencave zyrtare. Rrezikshmëria e këtyre veprave penale vjen veçanërisht nga fakti se ato i kryejnë persona që janë titullarë zyrtarë, që kanë mundësinë e fshehjes së kësaj forme të kriminalitetit. Kryerja e

pandershme, e parregullt dhe e paligjshme e detyrës zyrtare, keqpërdorimi i kompetencave publike përbën sulm edhe mbi integritetin e detyrës nga vetë ata dhe, njëkohësisht, favorizon edhe korrupsionin në administratë. Nëse administrata, për shkak të korrupsionit është e lidhur edhe me autorët e veprave penale ose me qëllim kryerjen e këtyre veprave penale, veprimet e saj janë të lidhura dhe të organizuara reciprokisht, atëherë krijohen mundësitë për përhapje të pakufizuar të paligjshmërisë (anarkisë), që është vështirë të kontrollohet dhe të zbulohet. Të tilla sjellje cenojnë autoritetin e pushtetit dhe dobësojnë besimin e qytetarëve ndaj nëpunësve të aparatit të shtetit të tyre, por sjellin pasoja edhe në tërë shoqërinë. Kjo ndodh, sepse “korrupsioni, përveç dimensionit politik dhe ekonomik, ka edhe dimensionin psikologjik, filozofik, historik dhe kulturor” (Tänzler, 2008:103).

Për rrezikshmërinë që paraqesin për shoqërinë qëndrimet dhe sjelljeve korruptive të zyrtarëve publikë, në mjaft dokumente dhe konventa ndërkombëtare tërhiqet vëmendja për domosdoshmërinë e penalizimit të tyre, duke i përcaktuar në legjislacion si vepra të penale të ndëshkueshme. Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit shprehet shumë qartë për këtë:

“Secili shtet palë shqyrton marrjen e masave legislative dhe të tjera, që mund të jenë të nevojshme për parashikimin si vepër penale, kur kryhet me qëllim abuzimi me funksionet ose me pozicionin, që është kryerja ose moskryerja e një akti, duke thyer ligjin nga një nëpunës publik në ushtrim të funksioneve të tij ose të saj, me qëllim marrjen e një avantazhi të parregullt për vete ose një person tjetër apo subjekt. (Neni 19).

Edhe në Komentarin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, lidhur me këtë problem të rëndësishëm, theksohet: të gjitha shtetet marrin masat e duhura për pengimin dhe eliminimin e të gjitha formave të keqpërdorimit të kompetencave nga administrata publike. Krahas masave të karakterit parandalues, parashikohen dhe aplikohen edhe forma të ndryshme të vënies para përgjegjësisë së personave zyrtarë, ku bën pjesë edhe përgjegjësia penale. Me më shumë ose më pak

dallime, veprat penale kundër detyrës zyrtare sanksionohen në të gjitha legjislacionet penale bashkëkohore.

Në legjislacionin e Kosovës, këto vepra penale parashikohen në Kodin Penal të Kosovës, ku jepen edhe përcaktimet e sanksioneve që duhet të jepen ndaj tyre. Kjo, sigurisht, është një praktikë legislative e domosdoshme dhe e mirë, pasi kështu rregullohen në aspektin penalo-juridik të gjitha veprat penale të kësaj fushe, që përbëjnë problem jo vetëm për Policinë, por për tërë shoqërinë e Kosovës. Karakteristikat juridiko-penale të këtyre veprave penale janë të larmishme dhe ato do të analizohen në këtë punim lidhur ngushtë me politikën penale dhe hetimore të tyre që shprehet në legjislacionin vendas. Më poshtë do të bëjmë fjalë për elementet konstituive të tyre, për elementet objektive dhe subjektive që ato kanë, për përcaktimin e përgjegjësisë penale të personave që i kryejnë këto vepra, duke e vënë theksin te domosdoshmëria që, për luftimin efikas të korrupsionit, veprat që konsiderohen të kundërligjshme duhet të jenë të përcaktuara mirë në legjislacionin vendas, por edhe në dokumente dhe konventa ndërkombëtare.

3.1.1 Objekti i mbrojtur tek ky grup veprash penale

Detyra zyrtare mund të cenohet vetëm nga bartësit e detyrës zyrtare, respektivisht, nga personat zyrtarë. “Pasojë e përgjithshme e të gjitha veprave penale të përfshira në këtë kapitull, është rrezikimi a cenimi i veprimit të rregullt, të ligjshëm të pushtetit publik, pushtetit administrativ dhe organeve të tij”.(Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1203)

Objekti i mbrojtur në këto vepra penale janë shërbimet publike, respektimi i ligjit, por edhe sjelljet e ndershme ndaj qytetarëve, me qëllim që të ruhet dhe të forcohet besimi i tyre te organet publike dhe rendi juridik.

Në kuptimin formal, objekti i mbrojtur është ushtrimi i ligjshëm i kompetencave zyrtare, publike të personave zyrtarë dhe personave përgjegjës, ndërsa në kuptimin material, është interesi i shoqërisë, në përgjithësi, dhe i çdo individ për veprim të pastër, të ndershëm, të ligjshëm të organeve shtetërore dhe shërbimeve të tjera me interes publik. Vetëm kështu ata përmbushin interesin e tyre shoqëror; interesin e qytetarëve që këto shërbime të të drejta jenë dhe në përputhje me ligjin.

3.2 Veprat penale në fushën e korrupsionit në Kodin Penal të Kosovës

Veprat penale korruptive dhe ato kundër detyrës zyrtare, në kuptimin më të përgjithshëm paraqesin shpërdorimin e pushtetit që ka një zyrtar në një vend pune ose në një pozicion të hierarkisë sociale dhe ekonomike, për përvetësimin e paligjshëm të pasurisë për vete apo për një person tjetër. “Shumica e veprave penale kundër detyrës zyrtare kanë për qëllim luftimin e korrupsionit si fenomen negativ, që, krahas shumë pasojave negative, dobëson edhe besimin e qytetarëve ndaj punës së administratës dhe besimin e qytetarëve në ligjet e shtetit” (Salihu, 2006:334).

Vepra të tilla penale, që cenojnë vlera nga më të ndryshme, janë: ushtrimi i pandërgjegjshëm i detyrave, keqpërdorimi i detyrave dhe kompetencave zyrtare, veprat korruptive, nxjerrja e sekretit zyrtar, përvetësimi i pasurisë, marrja dhe dhënia e ryshfetit etj.

Një nga elementet themelore të përbashkëta të veprave penale të këtij kapitulli është edhe fakti që autor, në numrin më të madh të rasteve, mund të jetë vetëm personi zyrtar. Kjo ka detyruar ligjvënësin që në Kodin Penal të Kosovës, të jepet qartë se me *person zyrtar* nënkuptohet:

a) personi i zgjedhur ose i emëruar në një organ shtetëror; b) personi i autorizuar në një organ shtetëror, organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik, i cili, sipas

ligjit apo ndonjë dispozite tjetër, të nxjerrë në pajtim me ligj, ushtron detyra të posaçme;

c) personi i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj.

Mirëpo personi zyrtar, si subjekt kryesor i këtyre veprave, nuk përcakton vetvetiu karakterin e veprave, për t'u radhitur në grupin e veprave penale kundër detyrës zyrtare. Esenca e veprave penale kundër detyrës zyrtare është cenimi i detyrave dhe i funksioneve të shërbimeve. Pra, koncepti i veprave të tilla është shumë më i gjerë. Në to, përpos veprave që ndërmerren në ushtrimin e detyrës zyrtare, hyjnë edhe vepra penale specifike, që nuk janë ekskluzivisht vepra penale zyrtare, por që mund t'i kryejnë, përveç personave zyrtarë, edhe persona të tjerë në detyrë, që punojnë në organet shtetërore a në ndonjë shërbim publik. Autor i tyre mund të jetë edhe çdo person që ushtron ndikim, që jep ryshfet etj.

Kryesit e veprave penale të korrupsionit rëndom nuk janë nga radhët e kriminalitetit klasik, por janë përfaqësues të shtresave më të larta shtetërore, ata janë persona në pozita dhe me autoritet, titullarë funksionesh të larta shtetërore dhe ekonomike, me autorizime të caktuara, persona në vende përgjegjëse në afarizmin komercial, ekonomik dhe doganor; në qarkullimin e mallrave, agjentë tregtarë etj. (Salihu, 2005:277).

Zakonisht, autorët më të shpeshtë të këtyre veprave penale janë persona zyrtarë që ushtrojnë një funksion të caktuar në organet shtetërore, në shërbimet publike, në institucionet dhe entet e tjera publike, të cilat vendosin për të drejtat dhe detyrat e qytetarëve dhe të personave juridikë, si: dhënia e lejeve a pëlqimeve të caktuara, dhënia e certifikatave, aktvendimeve, diplomave, caktimi i detyrimeve tatimore, doganore dhe detyrimeve të tjera financiare ndaj shtetit etj. Këta persona i mveshin vetes shumë pushtet dhe, duke shfrytëzuar pozitën, kalojnë në vepra korruptive, që u sjellin përfitime të mëdha të paligjshme, që dëmtojnë financat e shtetit.

Në Kodin Penal të Kosovës është përkufizuar edhe shprehja *persona të huaj zyrtarë*. Kjo nënkupton: anëtarët e pushtetit legjislativ, ekzekutiv, administrativ ose të

organeve gjyqësore të një shteti të huaj; funksionarët publikë të organizatave ndërkombëtare dhe të organeve të tyre; gjyqtarët dhe personat e tjerë zyrtarë të Gjykatës Ndërkombëtare, që ndodhen me shërbim në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, Kodi Penal ka një dispozitë të veçantë (neni 430) për ndjekje penale me karakter korrupsioni me elementë të huaj. Mund të themi se lidhur me këtë çështje është harmonizuar e drejta penale e Kosovës me të drejtën penale që funksionon në Bashkimin Europian.

Në shumicën e dispozitave të Kodit Penal për veprat penale të korrupsionit konstatojmë se si element kyç parashikohet që vepra penale është e tillë kur kryhet *me dashje*. Kjo është shumë e drejtë, pasi në jetë ndodh që shumë veprime të kryhen edhe nga pakujdesia profesionale.

“Pakujdesia profesionale është pakujdesi e personit, i cili gjatë ushtrimit të profesionit apo zejes së tij, është i detyruar të jetë më i kujdesshëm, sesa njerëzit e tjerë. Me fjalë të tjera, konsiderohet se vepra është kryer nga pakujdesia profesionale, nëse personi gjatë ushtrimit të profesionit, detyrës apo zejes, nuk ka treguar atë masë të kujdesit që kërkohet gjatë ushtrimit të profesionit të tij dhe nëse për shkak të mungesës së kujdesit të duhur është shkaktuar pasoja e ndaluar.” (Salihu, 2005:317).

Megjithëse KPK nuk parashikon norma të posaçme që rregullojnë çështjen e përgjegjësisë penale për veprat që kryhen nga pakujdesia profesionale, nuk duhet përjashtuar fakti që, në praktikë, edhe pakujdesia profesionale ushtron ndikim në trajtimin penalo-juridik të autorëve të veprave penale. Përjashtim bën vepra penale e zbulimit të sekreteve zyrtare, për të cilën është parashikuar përgjegjësia penale edhe për pakujdesi. Këtu është fjala për “pakujdesi të personit, i cili në profesionin e tij, është i detyruar të jetë më i kujdesshëm, sesa personat e tjerë, kur ndërmerr veprime në lëmin e profesionit”(Petrovic, 2006:85).

Këto përcaktime të legjislacionit lidhen me vetë natyrën e këtyre veprave penale, te të cilat më së shpeshti bëhet fjalë për veprim të vullnetshëm dhe të paligjshëm gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, shpesh me qëllim përfitimi të material.

3.2.1 Figura e veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” - Neni 422

Nocioni penalo-juridik i shpërdorimit të pozitës zyrtare ose i kompetencave nënkupton ato sjellje të kundërligjshme të personave zyrtarë, gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, që kryhen me qëllim përfitimi për vete apo për një person tjetër.

Dispozita e nenit 422 konsideron vepër penale veprimet e personit zyrtar, që shfrytëzon detyrën apo autoritetin zyrtar, tejkalon kompetencat, që nuk përmbush detyrat zyrtare, me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që shkel rëndë të drejtat e personit tjetër. “Kryesi i veprës penale shfrytëzon shërbimin, autorizimet e tij publike në mënyrë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me interesat dhe qëllimet e shërbimit. Ai shfrytëzon në mënyrë të kundërligjshme mundësitë lidhur me pozitën e tij zyrtare apo me autorizimet”. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1209)

Sipas KPK, neni 422 par.2, shpërdorimi i detyrës zyrtare nga personi zyrtar përfshin, por nuk kufizohet në:

- shkeljen me dashje apo me dijeni të ligjit, lidhur me detyrat apo me punësimin e zyrtarit;
- moskryerjen me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj;
- pranimin e dhuratës, tarifës apo përparësisë të çfarëdo lloji, si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare, përveç nëse pranimi i dhuratës, i tarifës apo i përparësisë lejohet me ligj;
- keqpërdorimin e pasurisë, të shërbimeve apo të personelit qeveritar apo të ndonjë sendi tjetër me vlerë që i përket qeverisë e që ka rënë në kujdesin apo posedimin e zyrtarit si rezultat i detyrës apo punës së tij;
- nënshkrimin me dashje të personit tjetër në keqtrajtim ose arrest, ndalim, kontroll, marrje, heqje, vlerësim ose barrë për të cilën e di se është e kundërligjshme;
- ndalimin ose pengimin me dashje të tjetrit në ushtrimin apo gëzimin e ndonjë të drejte, privilegji, pushteti apo imuniteti ligjor.

Me këtë nen, ligjvënësi ka parashikuar si të dënueshme ato veprime të zyrtarit, që kanë për qëllim jo vetëm përfitime të kundërligjshme për vete, për tjetrin, por edhe që u shkaktojnë dëme personave të tjerë, duke shpërdoruar pozitën zyrtare, duke tejkaluar kompetencat ose duke mos përmbushur detyrat e tij.

Kjo vepër ekziston edhe kur veprimi i ndërmarrë nuk ka karakterin e veprimeve zyrtare, por është ndërmarrë duke e keqpërdorur detyrën zyrtare në mënyrë të kundërligjshme, duke kryer veprime që nuk janë në kuadër të detyrës zyrtare, por janë veprime kriminale të formave të ndryshme.

Në KPK veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është përcaktuar në mënyrë alternative, në tri forma: shfrytëzimi (shpërdorim) i pozitës zyrtare apo kompetencave; tejkalimi i autorizimeve zyrtare; dhe mospërmbushja e detyrave zyrtare (moskryerja e detyrimeve zyrtare). Shembull tipik janë keqpërdorimet e detyrës zyrtare, lidhur me të ashtuquajturat kompetenca diskrecionale, kur personi zyrtar, me rastin e nxjerrjes së ndonjë akti ose të zgjidhjes së ndonjë rasti, është i autorizuar që, në mesin e shumë zgjidhjeve, të zgjedhë atë që është më e arsyeshmja. Nëse personi zyrtar në këtë rast nuk udhëhiqet nga interesi i shërbimit, por e bazon vendimin në ndonjë interes të vetin ose të huaj, ai keqpërdor detyrën zyrtare, edhe pse vepron në kuadër të detyrës zyrtare. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1211)

Vepra penale ekziston edhe në rastin kur personi zyrtar, kryen veprimin sipas kompetencave që ka, por nuk ka marrë leje apo pëlqim paraprak nga eprorët. P.sh., punonjësi i policisë falsifikon autorizimin për kontrollimin e banesës dhe, në bazë të këtij autorizimi, ka kryer kontrollin dhe bastisjen e banesës.

Vepra penale e moskryerjes së detyrës zyrtare kryhet edhe me mosveprim. Kjo ndodh, kur zyrtari nuk ndërmerr veprimin që është i detyruar ta ndërmarrë, ose kur këtë veprim e bën të tillë që të mos mund të arrihet qëllimi që do të arrihej, po ta ndërmernte

atë veprim. Po ashtu, kemi vepër penale kur personi zyrtar nuk e bën atë që ka në kompetencë të tij dhe që e ka për detyrë ta bëjë; kur ai refuzon ta kryejë veprimin që është i detyruar ta kryejë, ose kur vonon ndërmarrjen a kryerjen e ndonjë detyrimi të tij zyrtar. Do të kishim të bënim me vepër edhe kur personi zyrtar nuk e nxjerr fare aktin, që është i detyruar ta nxjerrë; kur refuzon të vendosë për ndonjë çështje që i përket kompetencës së tij; kur qytetarit nuk i jep certifikatën që ai kërkon etj. Në raste të tilla, personi zyrtar nuk e kryen detyrën e tij as në kuptimin formal, as në kuptimin material.

Gjithashtu, vepra penale ekziston kur personi zyrtar e kryen formalisht veprimin zyrtar, por duke e zvarritur në kohë apo në mënyrë të tillë, saqë ajo bëhet e pavlerë dhe nuk shërben për qëllimin e duhur.

Vepra penale konsiderohet e tillë, kur kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë. Kjo nënkupton dijeninë e autorit se po shfrytëzon pozitën e tij zyrtare, po tejkalon kompetencat ose nuk po e kryen detyrën e tij, si dhe faktin që me këtë ai përfiton dobi pasurore për vete apo për tjetrin, ose i shkakton tjetrit çfarëdo dëmi. Punonjësi i Policisë së Kosovës, me uniformë zyrtare dhe gjatë orarit të punës, me automjetin e tij shoqëron një kamion që transporton naftë deri në destinacionin e tij përfundimtar, në Prishtinë. Ai u gjet fajtor për vepër penale të kontrabandimit të mallrave, sipas nenit 283, par.1, në lidhje me nenin 23 të KPPK, si dhe për veprën penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare, sipas nenit 339, par.2, lidhur me par.1, të KPPK (Gjykata Komunale Skënderaj, P.nr.113/07)

Që të kemi vepër penale, është e nevojshme që autori të jetë i vetëdijshëm se me të ai do të arrijë për vete ose për një person tjetër çdo lloj përfitimi (material ose jomaterial) dhe se, kështu, i shkakton dëm një personi tjetër. Përmes kësaj vepre autori shkel rëndë të drejtat e dikujt, duke keqpërdorur detyrën zyrtare. Nëse nuk vërtetohet që

veprimi është kryer me dashje, nuk kemi konsumim të kësaj vepre penale, por thjesht shkelje disiplinore.

Lidhur me këto raste, Schmallegger thekson: “Zyrtari publik, që, nën petkun e ligjit apo të kompetencës zyrtare, vepron në atë mënyrë që tejkalon kufijtë e kompetencave ligjore, mund të jetë fajtor për keqpërdorimin e tyre”. (Schmallegger, 2006:474).

Po ta shohim me vëmendje këtë, autori përdor fjalët “mund të jetë” (*may be*) fajtor. Ai ka parasysh edhe faktin që zyrtari publik duke keqpërdorur detyrën, mund të kryejë thjesht shkelje administrative, jo domosdo vepër penale.

Nga ana *objektive*, kjo vepër kryhet vetëm me dashje, me anë të veprimeve ose të mosveprimeve të kundërligjshme, që çojnë në keqpërdorimin e pozitës zyrtare apo kompetencat që rrjedhin prej saj. “Kuptimi normal i termit “dashje” është: qëllim ose synim” (Herring, 2013:137)

Nga ana *subjektive*, ky krim kryhet me dashje të drejtëpërdrejtë vetëm nga persona zyrtarë. Subjekt i këtij krimi është personi zyrtar.

3.2.2 Figura e veprës penale “Keqpërdorimi i informatës zyrtare” – Neni 423

Sipas Kodit Penal, shprehja “informatë zyrtare” nënkupton informatën në të cilën personi ka qasje si rezultat i detyrës apo punës së tij dhe e cila nuk është bërë publike.

Dispozita e nenit 423 konsideron vepër penale veprimet që ndërmerr personi zyrtar duke keqpërdorur me dashje informatën zyrtare, me qëllim që të përfitojë për vete apo për një person tjetër ndonjë përparësi që nuk i takon.

Në paragrafin 2 të këtij neni parashikohet një formë cilësuese themelore e kësaj vepre penale: vepra konsumohet, nëse informata zyrtare ka të bëjë me prokurimin apo

ankandin publik. Kjo nënkupton keqpërdorimin e informatave në tenderime të ndryshme nga personi zyrtar, që i ka siguruar ato në bazë të punës a detyrës së tij, dhe ua përcjell personave që marrin pjesë në ankand publik apo në tender, me qëllim që t'u sigurojë përparësi, favore atyre personave, për ta fituar tenderin etj. Ky veprim bie në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik, sipas të cilit nuk lejohet që personave pjesëmarrës në tender t'u jepen të dhëna, që nuk duhen bërë publike, rreth tenderit, ofertave, çmimeve që janë ofruar etj.

Me këtë nen ligjvënësi ka sanksionuar nxjerrjen e paautorizuar të informatave zyrtare të cilat nuk hyjnë në kategorinë e fshehtësisë zyrtare dhe, në këtë mënyrë, u ofron mbrojtje informacioneve të ndryshme, që ende nuk janë bërë publike dhe që duhen mbrojtur për të siguruar mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme, sidomos në proceset e prokurimit, ku dhënia e një informacioni mund krijojë përparësi për njërin palë dhe të ndryshojë rezultatin e procedurës.

Rrethanë rënduese paraqet nëse vepra penale rezulton në dobi pasurore apo humbje në vlerën që tejkalon pesëdhjetë mijë (50.000) euro.

Nga ana *objektive*, ky krim kryhet vetëm me dashje, me anë të veprimeve ose të mosveprimeve të kundërligjshme, që çojnë në keqpërdorimin e informatës zyrtare.

Nga ana *subjektive*, ky krim kryhet me dashje vetëm nga persona zyrtarë. Autori e kryen veprën duke e ditur se ai po zbulon një informatë zyrtare, e cila nuk i është bërë e njohur publikut dhe duke ditur se, me dhënien e saj, po i bën favor apo dëm dikujt.

Subjekt i këtij krimi është personi zyrtar.

3.2.3 Figura e veprës “Konflikti i interesit” – Neni 424

Personat zyrtarë apo përgjegjës duhet të jenë të paanshëm, kur kanë të bëjnë me personat e afërt të tyre, si dhe me subjektet me të cilat kanë apo do të kenë raporte

financiare vetë ata apo edhe të afërmit e tyre. Dispozitat e këtij neni janë risi në KPK dhe parashohin sanksionimin e veprimeve që, sipas ligjit, nënkuptojnë konflikt interesi.

Neni i KPK konsideron vepër penale veprimet e personit zyrtar që merr pjesë personalisht në ndonjë *çështje zyrtare* në të cilën ai apo ndonjë anëtar i familjes ose ndonjë person juridik, që ka të bëjë me të, ka interes financiar. Rrethanë rënduese paraqet, nëse çështja zyrtare është veprim i prokurimit apo ankand publik.

Sipas këtij neni, kjo vepër penale ka dy forma. Forma e parë e saj konsumohet kur personi zyrtar *merr pjesë* në vendimmarrje, si anëtar komisioni, paneli etj., për të vendosur për çështje ku ai apo dikush nga anëtarët e familjes së tij kanë interes financiar. Kurse forma e dytë konsumohet nëse konflikti i interesit ka të bëjë me procedurat e prokurimit publik, ankandin publik, tenderat e ndryshëm etj. Rastet më tipike janë kur zyrtari përgjegjës i prokurimit shpërblen me kontratë pune apo për shërbime kompaninë e familjarëve të tij.

Sipas par.4 të këtij neni, shprehja “merr pjesë” nënkupton ushtrimin e autoritetit zyrtar përmes vendimit, miratimit, mosmiratimit, rekomandimit, këshillimit, hetimit ose në ndonjë mënyrë tjetër të ushtrimit të ndikimit për një çështje zyrtare (neni 424.3).

Ndërsa me “çështje zyrtare”, sipas par.4 të këtij neni, nënkuptohet procedura gjyqësore ose procedurë tjetër zyrtare; aplikimi, kërkesa për vendim ose përcaktim tjetër zyrtar; kontrata apo kërkesa; ankandi publik ose veprim tjetër i prokurimit; ose ndonjë çështje tjetër që prek interesat financiare apo personale të zyrtarit apo të personit tjetër.

Krahas KPK ekziston edhe *Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit*, Neni 7, i të cilit përcakton se konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, kur gjatë ushtrimit të funksionit të tij zyrtari ose personi i afërt ka interes privat pasuror ose personal jopasuror, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikon ose mund të ndikojë në kryerjen në mënyrë të drejtë të funksionit

publik, kur gjendet në situata të shkeljes së mundshme të parimeve, të kufizimeve dhe ndalesave apo detyrimeve, sipas dispozitave të këtij ligji. Sipas nenit 7 të po këtij ligji, “person i afërt” është çdo person fizik ose juridik, i cili ka pasur ose ka lidhje interesi me personin zyrtar.

Ky ligj përmban dispozita të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo zyrtar, kur merr pjesë drejtpërdrejt a në mënyrë të tërthortë në një vendimmarrje gjatë ushtrimit të funksionit publik. Objekt i ligjit është përcaktimi i rregullave, i subjekteve, i përgjegjësive dhe i kompetencave për identifikimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesit publik dhe interesit privat të zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Sipas këtij ligji, “interesi publik” nënkupton besimin dhe pritjen e publikut për vendimmarrje të paanshme dhe të drejtë të zyrtarëve në ushtrimin e funksionit publik. Ndërsa me “interes privat” nënkuptojmë interesin privat pasuror ose personal jopasuror të zyrtarit, që mund të ndikojë në vullnetin e tij në vendimmarrje gjatë ushtrimit të funksionit publik. Me “konflikt interesi” nënkuptojmë konfliktin e interesit publik dhe interesit privat të zyrtarit.

Nga ana *objektive*, ky krim kryhet vetëm me dashje, me anë të veprimeve ose të mosveprimeve të kundërligjshme, që çojnë në konflikt interesi.

Nga ana *subjektive*, ky krim kryhet vetëm nga persona zyrtarë.

Vepra penale konsiderohet e kryer kur bëhet vetëm me dashje, pra, me dijeninë e autorit se në një çështje ai apo anëtar i familjes së tij ka interes financiar dhe, megjithëkëtë, nuk tërhiqet nga vendimmarrja.

3.2.4 Figura e veprës penale “Përvetësimi në detyrë” - Neni 425

Sipas përkufizimit ligjor, përvetësimi në detyrë (shpërdorimi) është përvetësimi i parave, i letrave me vlerë apo i sendeve të tjera të luajtshme nga personi të cilit i janë besuar ato në bazë të detyrës ose brenda një organi publik, me qëllim përfitimi të dobisë pasurore të kundërligjshme për vete apo për tjetrin.

Kemi rrethanë cilësuese, kur vepra penale rezulton me dobi pasurore apo humbje në vlerë që tejkalon pesë dhjetë mijë (50.000) euro.

Kjo vepër penale është e ngjashme me atë të shpërdorimit të detyrës dhe, për këtë arsye, shpesh quhet *shpërdorim detyre* dhe trajtohet si vepër penale kundër pasurisë (në legjislacionin e vendeve të tjera, p.sh., në atë të Sllovenisë, ajo klasifikohet në grupin e veprave penale kundër pasurisë). Kjo, për faktin se objekt i kësaj vepre penale, përveç detyrës zyrtare, është edhe pasuria. Megjithatë, shpërdorimi në detyrë, për nga natyra e vet, është vepër penale kundër detyrës zyrtare, sepse thelbi i saj qëndron në shfrytëzimin e pozitës, që një person i caktuar ka, për përvetësimin e sendeve të theksuara.

Autor i kësaj vepre penale është personi, i cili, duke qenë në detyrë në një organ publik, është i autorizuar të disponojë një send të caktuar, të punojë me të, ta japë për shfrytëzim etj. “Kurse te shpërdorimi i pasurisë së huaj (neni 330 i KPK) sendet e theksuara të luajtshme mund t’i përvetësojë çdo person (pra, jo vetëm personi zyrtar), të cilit i janë besuar sendet e tilla, dhe ky është dallimi mes këtyre dy veprave penale”. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1226)

Objekt i veprës penale *Përvetësimi në detyrë*, mund të jenë pasuria e luajtshme: paratë, letrat me vlerë dhe sendet e tjera të luajtshme, të cilat autorit të veprës penale i janë besuar në punë tek organi publik. Kjo përbën, njëkohësisht, elementin themelor të kësaj vepre penale, i cili e veçon atë nga vepra penale e vjedhjes. Punonjësi policor, i

caktuar në detyrë në ruajtjen e objektit qeveritar në Prishtinë, kishte vjedhur një sasi derivatesh të naftës, të cilat kanë qenë të dedikuara për gjeneratorin e objektit. Në vendin e ngjarjes, autori u kap në flagrancë, duke i vendosur bidonat me derivate të naftës në automjetin e tij. Me urdhëresë të prokurorit, i dyshuari është arrestuar dhe është dërguar në qendrën për mbajtje. Pas sigurimit të provave materiale është ushtruar kallëzim penal ndaj policit, me dyshimin për veprën penale “Vjedhje e rëndë” dhe “Shpërdorim i detyrës zyrtare apo autorizimit” (IPK, 2012:16).

Siç shihet, autori nuk u akuzua për përvetësim prone, pasi në këtë rast prona, nafta, nuk i ishte dhënë në besim, por ishte pronë që zyrtari policor e kishte për detyrë ta mbronte.

Me ‘besim të sendeve’ konsiderohet besimi i atyre sendeve që janë në funksion të kryerjes së një detyre të caktuar dhe që funksionalisht lidhen me kryerjen e obligimeve zyrtare.

Autor i veprës penale mund të jetë vetëm personi zyrtar, i cili është i autorizuar që, në raste të caktuara me ligj, të kryejë veprime të caktuara zyrtare.

Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje drejtpërsëdrejti. Personi zyrtar duhet të jetë i vetëdijshëm se marrjen e sendit të huaj po e bën me rastin e ndërmarrjes së ndonjërit nga veprimet e caktuara zyrtare. Për t’u konsideruar e dënueshme një vepër e përvetësimit të të mirave që ia ofron pozita, ajo duhet të kryhet me qëllim përfitimi të kundërligjshëm për veten ose për tjetrin, në të kundërt, veprimet pa qëllim përfitimi konsiderohen vetëm shkelje administrative. Një e akuzuar kishte konsumuar të gjitha elementet e veprës penale të parashikuara nga neni 340, par. 3, i KPK, kur, si shefe e thesarit në bankë, në fund të orarit të punës, të hollat i kishte vënë te tavolina ku ndodhej makina e numërimit të tyre, duke i seleksionuar sipas bankënotave dhe nga këto të holla kishte marrë në vazhdimësi sasi të caktuar parash, të cilën ia ka dhënë NN,

ndërsa pjesën tjetër e ka kthyer në thesarin e bankës (Gjykata e Qarkut Prishtinë, P.nr.729/2008).

E kontestueshme paraqitet situata te vepra e vazhduar e përvetësimit në detyrë (shpërdorimit). A mund të konstituohet forma e rëndë e kësaj vepre penale, duke i mbledhur shumat e përfitimit pasuror të realizuar në shumë vepra penale të përvetësimit (shpërdorimit)? A mund të cilësohen shumë vepra të rënda penale të parashikuara nga paragrafi 2, sipas paragrafit 3. Mund të thuhet se një qëndrim i tillë është në kundërshtim me parimin themelor të konstruktit të veprës së vazhduar penale, si një vepër penale, tek e cila cilësimi bëhet në bazë të veprës më të rëndë e jo në bazë të mbledhjes së tyre. Gjithashtu, mund t'i bëhet vërejtje, ngase është në kundërshtim me idenë themelore të veprës së vazhduar penale, që kryesi të mos trajtohet rëndë, po më lehtë. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1228)

Nga ana *objektive*, ky krim kryhet vetëm me dashje, me anë të veprimeve ose mosveprimeve të kundërligjshme, që çojnë në përvetësim në detyrë.

Nga ana *subjektive*, ky krim kryhet vetëm nga persona zyrtarë.

Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje, që përfshin dijeninë e autorit se është duke kryer përvetësim në detyrë.

3.2.5 Figura e veprës penale “Mashtrimi në detyrë” – Neni 426

Ky nen përcakton se veprën penale *mashtrimi në detyrë* e kryen personi zyrtar, i cili, me qëllim përfitimi të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për një person tjetër, bën prezantim të rremë të raportit të llogarive apo në ndonjë mënyrë tjetër e mashtron personin e autorizuar në kryerjen e pagesës së kundërligjshme.

Rrethanë cilësuese paraqet, nëse vepra penale rezulton me dobi pasurore në vlerë që tejkalon 50.000 euro.

Me këtë nen, ligjvënësi sanksionon veprimin e qëllimshëm për përfitim të kundërligjshëm, për vete apo për tjetrin, të pasurisë, duke bërë prezantime të rreme të llogarive apo duke mashtruar personin e autorizuar në kryerjen e pagesës së kundërligjshme.

Kjo vepër është e ngjashme me veprën e mashtrimit, tek e cila përfitimi i kundërligjshëm i dobisë pasurore kryhet duke mashtruar personin që kryen një pagesë të kundërligjshme. Dallimi qëndron në faktin që veprën penale të *mashtimit në detyrë* e kryen personi zyrtar. Me këtë rast, përveç pasurisë, cenohet edhe kryerja e ligjshme e detyrës zyrtare, e cila është objekt primar i mbrojtur. Prandaj, kjo vepër përbën një formë të posaçme të veprës penale të mashtrimit.

Veprimi i kryerjes së veprës përcaktohet si sjellje mashtruese e personit zyrtar, për të kryer një pagesë të kundërligjshme. Përveç prezantimit të llogarisë së rreme (që, në praktikë, është mënyra më e shpeshtë e kryerjes së kësaj vepre penale), sjellja mashtruese e personit zyrtar mund të kryhet edhe në mënyra të tjera, me të cilat te personi tjetër mund të krijohet një pasqyrë e gabuar për faktet që janë me rëndësi për pagesë. Për shembull, shënimi i të dhënave të rreme për kohën e kaluar në udhëtim, me qëllimin për të marrë shuma më të mëdha parash; pasqyrimi i rremë nga ana e agjentit të ndërmarrjes botuese për parapagesat e përfunduara për të përfituar një provizion më të madh; futja në librin e punëve të kryera të emrave edhe të personave që nuk kanë punuar fare etj.

Element thelbësor i kësaj vepre është që mashtrimi të jetë bërë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, kur personi zyrtar prezanton llogari të rreme, i cili, bazuar në detyrën zyrtare që kryen, është i detyruar ta paraqesë atë, por vetëm si të vërtetë.

Mashtrimi në detyrë duhet të kryhet me qëllim përvetësimi, për përfitim pasuror të kundërligjshëm, për vete a për tjetrin. Një përfitim i tillë më së shpeshti realizohet në

arkëtimin e paligjshëm të parave, por edhe të ndonjë vlere tjetër materiale. Prezantimi i llogarive të rreme si pasojë e gabimeve apo e paaftësisë profesionale të zyrtarit që i ka paraqitur ato pa qëllim përfitimi për veten, por, në fakt, ka përfituar një person i tretë apo i është shkaktuar dëm material organizatës, nuk konsiderohet veprë penale e mashtrimit në detyrë. Po ashtu, nuk konsiderohet veprë penale, kur personi zyrtar e kryen mashtrimin jo me qëllim të një pagese të kundërligjshme.

Vepra penale është kryer kur personi zyrtar, duke qenë i mashtruar, të ketë kryer pagesë të kundërligjshme. Pagesa është e kundërligjshme kur autorit të veprës penale i është paguar ajo që s'i takonte fare apo nuk i përkiste në shumën e paguar. Nëse personi zyrtar ka ndërmarrë veprime mashtruese, por nuk ka arritur ta mashtrojë personin e autorizuar, ose ia ka arritur ta mashtrojë, po ai nuk e ka kryer pagesën, atëherë do të ekzistonte tentativa e kësaj veprë penale e cila është e ndëshkueshme. “Pasoja e veprës penale qëndron në pagesën e kundërligjshme. Vepra është kryer kur personi zyrtar i mashtruar ka kryer pagesën e kundërligjshme. Nëse pagesa nuk është kryer përkundër veprimeve të ndërmarra, vepra penale e tentimit për këtë veprë është kryer.” (Tomic, 2007:388).

Nga ana objektive, ky krim kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, por është i domosdoshëm edhe qëllimi i përfitimit pasuror të kundërligjshëm, i kryer me anë të veprimeve ose të mosveprimeve të kundërligjshme, që çojnë në mashtrimin në detyrë.

Nga ana *subjektive*, ky krim kryhet vetëm nga persona zyrtarë.

Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje, që përfshin dijeninë e autorit se është duke kryer mashtrim në detyrë.

3.2.6 Figura e veprës penale “Përdorimi i paaautorizuar i pasurisë” – Neni 427

Sipas këtij neni të KPK, kjo vepër penale konsiderohet e kryer kur personi, pa autorizim, përdor paratë, letrat me vlerë apo pasurinë tjetër të luajtshme, e cila i është besuar atij në detyrë ose në përgjithësi në vendin e punës apo në të cilat ka qasje për shkak të shërbimit apo punës së tij, ose i jep pasurinë e këtyre personit tjetër, për shfrytëzim të paaautorizuar.

Kjo vepër dallon nga vepra penale e përvetësimit, pasi autori i merr sendet me qëllim që t’i përdorë dhe më pas t’i kthejë. Prandaj gjykata vlerëson rrethanat, qëllimet e autorit sipas rastit. Nëse, me prova të sigurt, vërtetohet qartë se autori nuk kishte për qëllim t’i kthente sendet e përvetësuar, atëherë ekziston vepra penale e përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës dhe jo vepra penale e përdorimit të paaautorizuar. Shërbimi duhet të jetë kryer në mënyrë të paaautorizuar, d.m.th., nuk ekziston asnjë bazë juridike e autorizuar për përdorim. Përkundraiz, personi në detyrë apo në punë, vetëm me lejen a urdhrin e organit kompetent mund t’ia japë për shërbim personit tjetër fizik apo juridik sendet që i janë besuar. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1238)

Vepra penale quhet e kryer me ndërmarrjen e veprimit të përdorimit të paaautorizuar të pasurisë. Motivi dhe as qëllimi i autorit për përdorim të paaautorizuar nuk janë me rëndësi për ekzistimin e veprës.

Autor i veprës penale mund të jetë vetëm personi në detyrë apo në punë. Vepra mund të kryhet vetëm me dashje, që përfshin edhe vetëdijen e autorit se po i përdor pa autorizim mjete e caktuara që i janë dhënë në besim.

3.2.7 Figura e veprës penale “Marrja e ryshfetit” – Neni 428

Vepra penale e marrjes së ryshfetit a përfitimeve të tjera është ndër më të shpeshtat në kategorinë e veprave penale të korrupsionit dhe përbën kërcënimin më të

madh për shoqërinë dhe për funksionimin e saj normal. “Marrja e ryshfetit e cila ndryshe emërtohet si korrupsion, kryhet në rastet kur personi zyrtar kërkon apo pranon para apo ndonjë përfitim tjetër lidhur me ushtrimin apo mosushtrimin e detyrës zyrtare”(Salihu, 2006:333).

Sanksionimi në KPK i kësaj vepre penale dhe i atyre të parashikuara nenin 429 të KP, sipas Hasanit (2014:1241), është pjesë e masave antikorruption në fushën e së drejtës penale. Kjo është parë e domosdoshme për mbrojtjen e pastërtisë, ligjshmërisë, objektivitetit, paanshmërisë dhe moskorrupsionit të organeve shtetërore dhe organeve të tjera. Nëse personi zyrtar është i korruptuar, nëse mund të “blihet” veprimi zyrtar, do të viheshin në dyshim objektet e mbrojtura të kësaj vepre penale; kështu komprometohet autoriteti i aparatit shtetëror; të gjitha veprimet dhe procedurat e atij organi vihen në dyshim. Qoftë edhe të izoluara, rastet e tilla shkaktojnë pakënaqësi tek opinioni i gjerë, bëjnë që të lindin dyshime ndaj paanshmërisë së aparatit shtetëror. Nëse kjo merr përmasa të një dukurie të gjerë, mund të paralizojë tërësisht aparatit shtetëror dhe shërbimet e tjera, gjë që prodhon pasoja të mëdha negative dhe hap rrugën e mosndëshkimit të veprave penale të ndryshme, e edhe të veprave më të rënda penale. Në një situatë të tillë, më nuk mund të bëhet fjalë për një shoqëri të shëndoshë.

Sipas Jovasevic (2011:359), qytetarët nuk janë të detyruar të paguajnë ryshfet apo të japin dhurata për shërbimet që janë pa pagesë, të cilat janë objekti i mbrojtur i kësaj vepre penale.

Neni 428, përcakton se veprën penale *marrje e ryshfetit* e kryen:

- Personi zyrtar i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që ai të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare.

- Personi zyrtar, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyrë që të veprojë ose të mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare.

Duke qenë se dispozitat e përgjithshme të ndjekjes penale vlejnë edhe për zyrtarë të autorizuar publikë, sikurse për dispozita të tjera, momenti i njoftimit të veprës duhet që të jetë sa më afër kohës së ndodhjes së veprës penale, respektivisht, kohës kur është mësuar për ndodhjen e saj, sepse në këtë mënyrë janë më të mëdha gjasat për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale (Korajliç, 2002:393)

Rrethana cilësuese tek kjo vepër ekziston, kur vepra penale rezulton me përfitim në vlerë që tejkalon pesëmbëdhjetë mijë (15.000) euro.

Struktura e veprimit të kryerjes tek kjo formë e marrjes së ryshfetit qëndron në: kërkimin apo marrjen e dhuratave apo të çfarëdo përfitimi tjetër dhe marrjen e premtimit për dhuratë ose marrjen e premtimit për çfarëdo përfitimi tjetër. Madje, kjo shpeshherë bëhet edhe me detyrim. Në dispozitat e këtij neni është përcaktuar vepra themelore nga sfera e delikteve korruptive, e cila tani emërtohet si marrje e ryshfetit, që është sinonim i marrjes së mitës, një emërtim ky adekuat, ngase në këto hapësira ky shpreh më së miri tërë negativitetin social të kësaj të keqeje të shoqërisë...Bëhet fjalë për delikte të imponimit të ndonjë përfitimi (crimen concussionis - delikt i detyrimit, të marrjes së mitës) (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1244).

Për ekzistimin e veprës është e parëndësishme nga kush ka ardhur nisëtiua për ryshfet – nga dhënësi apo nga marrësi i ryshfetit. Kërkimi i ryshfetit mund të qëndrojë në çfarëdo veprimi, nga i cili mund të përfundohet se personi zyrtar kërkon shpërblim për kryerjen a moskryerjen e një veprimi zyrtar. I pandehuri N.M., duke vepruar në cilësinë e prokurorit në hetimet penale kundër P.M., me dashje, për të përfituar shumë prej 50.000 eurosh për vete dhe për të bashkëpandehurit R.Z. dhe X.Z, ka ofruar pushimin e hetimeve, ka siguruar ndërprerjen e arrestit shtëpiak dhe këtyre të

bashkëpandehurve u ka zbuluar informacione të besueshme që u kanë mundësuar atyre të zhvatin nga P.M. shumën prej 30.250 euro. Njëkohësisht, ai e ka lejuar P.M. të dilte nga banesa e tij, në kundërshtim me kufizimet e shqiptuara me masën e arrestit shtëpiak (Gjykata e Apelit Prishtinë, PAKR 413/2013).

Marrja e ryshfetit, si dhe marrja e premtimit për ryshfet, mund të shprehen nëpërmjet veprimeve të ndryshme të personit zyrtar si, p.sh., marrja e ryshfetit, vënia në xhep, bartja tek dikush tjetër, shprehja e gatishmërisë për të marrë ryshfet, që mund të bëhet edhe me heshtje etj. Punonjësit policorë B.R., B.A., D.C., S.SH., gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare në pikë kontrolli të automjeteve, kishin ndaluar automjete që transportonin pije alkoolike dhe u kishin mundësuar atyre kalimin e mallrave pa dokumente përkatëse, duke marrë ryshfet para të gatshme, në vlerë 50 euro, 30 euro etj. Kështu ata konsumuan veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 343, par.1, të KPK. Ndërsa zyrtarët policorë, R.B., N.D.,B.N., u shpallën fajtorë për veprën penale shpërdorimi i detyrës zyrtare apo autorizimit, nga neni 339, par. 1, të KPK, sepse gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, në pikë kontrolli të automjeteve, ata kanë vëzhguar për së afërmi veprimet e kolegëve të tyre, lejin e kalimit të automjeteve pa dokumentacion, marrjen e ryshfetit dhe nuk e kanë penguar dhe as nuk e kanë njoftuar rastin organeve kompetente me çka kanë kryer veprën penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare apo autorizimit, nga neni 339, par. 1, të KPK (Gjykata Komunale Gjilan, P.nr.1222/09).

Kërkimi apo marrja e ryshfetit duhet të jenë të lidhura me veprimin zyrtar të personit zyrtar apo të personit përgjegjës. Pra, është e nevojshme që një person i tillë zyrtar të detyrohet që, në kuadër të kompetencave të veta, të kryejë a të mos kryejë një veprim që nuk duhej ta kryente, ose një veprim që do të duhej ta kryente.

Kjo vepër penale, nuk do të ekzistonte nëse ryshfeti i është dhënë personit zyrtar mbi ndonjë bazë tjetër dhe jo mbi atë që ka të bëjë me kryerjen e detyrës së tij zyrtare.

Ndërmjet personit zyrtar apo personit përgjegjës dhe dhënësit të ryshfetit është e nevojshme të ekzistojë marrëveshja, së paku, e heshtur, për shkëmbim shërbimesh; bëhet shërbimi për kundërshërbim, pranohet të merret ryshfeti apo premtimi për ryshfet, që të kryhet a të mos kryhet ndonjë veprim (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1242). I pandehuri, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në Pejë, në çështjen penale kundër të pandehurve D.N., P.N. dhe L.K., në cilësinë e personit zyrtar kishte pranuar nga V.Z. dobinë pasurore në vlerë prej 10.000 (dhjetë mijë) eurosh, në mënyrë që ai ta kryente brenda kompetencës së tij një akt zyrtar, të cilin nuk duhej ta kryente, me premtimin e garantimit të ndërprerjes së paraburgimit ndaj të pandehurve të sipërpërmendur. (Gjykata e Apelit Prishtinë, PAKR 412/15). Këto janë veprime të paligjshme, të dënueshme.

Autor i veprës penale të të gjitha formave mund të jetë vetëm personi zyrtar a personi përgjegjës.

Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë.

3.2.8 Figura e veprës penale “Dhënia e ryshfetit” - Neni 429

Me veprën penale të dhënies së ryshfetit rrezikohet ligjshmëria e ushtrimit të detyrave zyrtare nga jashtë, nga personat të cilët nuk janë persona zyrtarë. Arsyeja që kjo vepër penale është radhitur në këtë kapitull, para së gjithash, mbështetet në faktin se organikisht është ndërlidhur me marrjen e ryshfetit, ngase dhënia e ryshfetit më së shpeshti bëhet me kërkesën apo pranimin e ryshfetit nga ana e personit zyrtar (Salihu, 2006:337).

Neni 429 i Kodit Penal përcakton se veprën penale *dhënie e ryshfetit* e kryen:

- kushdo që, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premtan, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ai person të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare;
- kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premtan, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ai person të veprojë ose të mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare.

Me këtë vepër penale personi zyrtar shtyhet në shkeljen e kryerjes ligjore të detyrës. Për dallim nga veprat e tjera penale të këtij grupi, të cila mund t'i kryejë vetëm personi zyrtar, veprën penale të dhënies së dhuratës a të një përfitimi tjetër e kryen personi që nuk e ka cilësinë e personit zyrtar. Prandaj, me këtë vepër zyrtare, detyra rrezikohet nga jashtë e jo nga brenda, sikundër ngjan me veprat e tjera të këtij grupi. Edhe pse bëhet fjalë për vepër penale jozyrtare, ajo është radhitur me të drejtë në këtë grup të veprave penale, ngase është e lidhur me kryerjen apo moskryerjen e detyrës zyrtare, përkatësisht, me marrjen e dhuratave a formave të tjera të përfitimeve (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014;1253).

Vepra penale e dhënies së dhuratës apo e formave të tjera të përfitimit, e njohur si *dhënie e ryshfetit* (i ashtuquajtur *ryshfet aktiv*), ekziston kur dikush i jep ose i premtan personit zyrtar a personit përgjegjës dhuratë a ndonjë përfitim tjetër, në mënyrë që ai, në kufijtë e kompetencave të tij, të kryejë një veprim zyrtar, i cili nuk lejohet të kryhet, apo të mos kryejë veprimin që do të duhej ta kryente. Punonjësi i PK-së M. S. po i shqiptonte gjobën për kundërvajtje, i pandehuri B. i është afruar policit dhe i ka ofruar ryshfet, nga kuleta ka nxjerrë 10 (dhjetë) euro dhe ia ka futur në xhep policit, në mënyrë që polici të mos veprojë në pajtim me detyrat e tij zyrtare, përkatësisht që të pandehurit B. të mos ia shqiptojë gjobën, me këtë ka kryer veprën penale *dhënie e ryshfetit* nga neni 429, par.1, të KPK, (Gjykata Themelore në Prishtinë, PKR.nr.506/15).

Vepra penale konsiderohet e kryer kur vërtetohet fakti i premtimit ose i dhënies së dhuratës ose përfitimit tjetër lidhur me kryerjen e veprimit të kundërligjshëm apo moskryerjes së veprimit të ligjshëm zyrtar. Nuk është e domosdoshme që personi zyrtar, për shkak të marrjes së dhuratës ose premtimit se do t'i jepet dhuratë, të ketë kryer apo mos të ketë kryer veprimin zyrtar (Salihu, 2006:338).

Në paragrafin e katërt të nenit 429, ligjvënësi ka paraparë edhe masat stimuluese për denoncimin e rasteve të marrjes së ryshfetit. Në të thuhet: “Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni e ka dhënë ryshfetin me kërkesë të personit zyrtar apo personit përgjegjës dhe e lajmëron veprën para se ajo të jetë zbuluar ose para se të ketë kuptuar se vepra është zbuluar, gjykata mund ta lirojë nga dënimi”. Me këtë, ligjvënësi u jep mundësinë personave të ndërgjegjshëm, që, edhe pse kanë kryer një vepër penale për të realizuar një qëllim të tyre, të njoftojnë rastin dhe, kështu, të mos ndëshkohen.

Autor i veprës penale mund të jetë çdo person. Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Theksojmë këtu se përveç këtyre dispozitave të përgjithshme mbi ryshfetin, janë edhe disa dispozita specifike për ryshfetin aktiv dhe pasiv, lidhur me votimin (neni 215 i KP), me lidhjen e kontratës së dëmshme (neni 291 i KP) dhe me arratisjen e personit të privuar nga liria (neni 405 i KP). Neni 215.1 i KP ndëshkon me burgim prej 1 deri 5 vjet këdo që premtun, ofron ose jep ndonjë përfitim ose dhuratë të pamërituar ndonjë personi, me qëllim që të ndikojë atë person për të votuar, për të mos votuar, për të votuar në favor apo kundër një personi apo propozimi të caktuar ose për të hedhur një votë të pavlefshme në zgjedhje apo në referendum.

Neni 215.2 i KP ndëshkon me burgim prej 1 deri në 5 vjet këdo që kërkon ose pranon ndonjë përfitim ose dhuratë të pamërituar për vete ose për ndonjë person tjetër,

ose pranon ofertën apo premtimin për përfitim apo dhuratë të tillë, për të votuar ose për të mos votuar, për të votuar në favor apo kundër një personi apo propozimi të caktuar ose për të hedhur një votë të pavlefshme në zgjedhje apo në referendum. Personat të cilët shërbejnë si ndërmjetësues në rastet e shkeljes së paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni dënohen me burgim prej 1 deri në 5 vjet.

Kur veprat e mëparshme penale janë kryer nga anëtarë të Komisionit Zgjedhor apo nga ndonjë person gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare të tij/saj në lidhje me votimin, atëherë sanksioni është burgim prej 3 deri në 5 vjet.

3.2.9 Figura e veprës penale “Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj” - Neni 430

Sipas, nenit 120 të KPK, me termat *zyrtar i huaj publik* apo *person i huaj zyrtar*

- nënkuptohet:

- cilido person që mban detyrë legislative, ekzekutive, administrative apo gjyqësore në shtetin e huaj, qoftë i emëruar apo i zgjedhur;
- cilido arbitër që ushtron funksione sipas ligjit kombëtar mbi arbitrimin e shtetit të huaj;
- cilido person që ushtron funksion publik për shtetin e huaj, përfshirë për agjencinë publike ose ndërmarrjen publike;
- cilido zyrtar, punonjës apo përfaqësues i organizatës ndërkombëtare publike dhe organeve të tyre;
- cilido anëtar i asamblesë parlamentare ndërkombëtare; dhe
- cilido gjyqtar, prokuror apo zyrtar i gjykatës apo tribunalit ndërkombëtar që ushtron juridiksion mbi Republikën e Kosovës.

Dispozita e nenit 430 konsideron vepër penale këto veprime:

- premtimin, ofrimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë ose dhënien e ndonjë dhurate apo përfitim tjetër zyrtarit publik të huaj, në mënyrë që ai zyrtar i huaj publik ose personi tjetër të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare;
- premtimin, ofrimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë ose dhënien e ndonjë dhurate apo përfitim tjetër zyrtarit publik të huaj, në mënyrë që ai zyrtar i huaj publik ose personi tjetër të veprojë ose të mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare.

Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me përfitim në vlerë që tejkalon pesëmbëdhjetë mijë (15.000) euro, kjo paraqet rrethanë cilësuese.

Figura e veprës penale të dhënies së ryshfetit zyrtarit publik të huaj ka të bëjë me veprimin ose mosveprimin, i cili ka të bëjë me premtimin, ofrimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë ose dhënien e ndonjë dhurate apo përfitim tjetër zyrtarit publik të huaj, në mënyrë që ai zyrtar i huaj publik ose personi tjetër të veprojë ose të mos veprojë në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare.

3.2.10 Figura e veprës penale “Ushtrimi i ndikimit” – Neni 431

Kjo vepër penale është përfshirë në kreun e veprave penale *Kundër detyrës zyrtare*. Me këtë vepër do të duhej të keqpërdorej a të shfrytëzohej pozita zyrtare a statusi i personit në institucionet e Republikës së Kosovës, i cili, në mënyrë të paligjshme, ndikon te personi tjetër zyrtar që të kryhet a të mos kryhet ndonjë veprim i ligjshëm (i paligjshëm), me anë të marrjes së njëkohshme të dhuratës a të një përfitimi tjetër. Mirëpo, nga mënyra e ndërtimit të kësaj norme ligjore, rezulton se subjekt i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, edhe ai që ka statusin e personit zyrtar apo të personit përgjegjës, edhe ai që nuk e ka këtë status (kushdo). (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014;1258).

Me këtë vepër penale inkriminohet ndërhyrja te personi zyrtar kompetent për interes të personit të tretë. Këtu bëhet fjalë për ndërmjetësim - për ndikim te personi zyrtar apo te personi përgjegjës lidhur me punën nga fushëveprimi i tij zyrtar e për llogari të personit të tretë, i cili është i interesuar që një veprim i tillë të kryhet a të mos kryhet, ose është i interesuar të kryhet një punë e paligjshme apo të mos kryhet një veprim që është dashur të kryhet. Vetë ndikimi mbi personin zyrtar qëndron në shfrytëzimin e kryesit të pozitës zyrtare a shoqërore apo ndikimin mbi një autoritet të tillë, të bazuar në pozitën e kryesit në detyrë ose në shoqëri, në parti politike etj. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014;1257)

Neni 431 i KPK sanksionon cilindo që kërkon, merr ose pranon një ofertë ose premtim të një përparësie të padrejtë për vete ose për personin tjetër në lidhje me ushtrimin e një ndikimi të paduhur nga ana e kryesit mbi vendimmarrjen e një personi zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ushtrimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar. Gjithashtu, sipas këtij neni, sanksionohet kushdo që premtton, ofron ose i jep në mënyrë direkte apo indirekte çfarëdo përparësie të padrejtë personit tjetër, që ushtron ose konfirmon se ai është në gjendje të ushtrojë një ndikim të paduhur mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ushtrimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar.

Subjekt i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, edhe pse ai është kryesisht personi, në dobi dhe në emër të të cilit ndërmjetësohet. Autor i kësaj vepre penale nuk janë vetëm personat zyrtarë (neni 120, par.1 dhe 2 të KPK), por edhe çdokush që shfrytëzon pozitën e tij shoqërore dhe ndikimin. Kur është fjala për personat zyrtarë, atëherë është e mundur që kryes i veprës të jetë zyrtari vartës, i cili ndërmjetëson tek udhëheqësi a mbikëqyrësi i tij në shërbim, ku është i punësuar (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014;1259).

Mendoj se, me këtë nen, ligjvënësi mundëson një mbrojtje më efikase të personave zyrtarë ndaj ekspozimeve të mundshme nga ushtrimi i ndikimit për të marrë apo për të mos marrë një vendim që ka të bëjë me detyrat dhe përgjegjësit e tij. Duke parashikuar si veprim të dënueshëm edhe premtimin, qoftë direkt apo indirekt, dhe pa marrë parasysh nëse ndikimi është ushtruar dhe pavarësisht nëse është arritur rezultat i dëshiruar, ligjvënësi i ka mundësuar zyrtarit të jetë i paanshëm dhe i mbrojtur nga ndikimi i eprorëve apo i personave të tjerë jashtë institucionit.

Vepra penale kryhet me dashje, duke shfrytëzuar pozitën zyrtare ose pozitën shoqërore.

3.2.11 Figura e veprës penale “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore” – Neni 432

Për shkak të rëndësisë së veçantë që ka funksioni i gjyqtarit dhe të rolit që kanë gjyqtarët në mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut dhe në mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë, me këtë vepër penale, që përbën një formë të veçantë të keqpërdorimit të detyrës dhe autorizimeve zyrtare, penalo-juridikisht është sanksionuar shkelja e qëllimshme e ligjit nga ana e bartësve të funksioneve gjyqësore. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014;1261).

Neni 432 i Kodit Penal përcakton se këtë vepër penale e kryen gjyqtari, i cili, me qëllim përfitimi të kundërligjshëm të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër ose për t’i shkaktuar dëm personit tjetër, nxjerr vendim të kundërligjshëm.

Veprimi i kryerjes qëndron në marrjen e vendimit të kundërligjshëm apo në shkeljen e ligjit në ndonjë mënyrë tjetër. Me shkelje të ligjit, ku bën pjesë edhe marrja e vendimit të kundërligjshëm, nga personat zyrtarë të ngarkuar për të gjykuar dukuritë negative, të cilët, me qëllim për të fituar për vete apo për tjetrin apo për të dëmtuar ndokënd, gjykojnë çështjen duke mos qenë objektivë dhe duke nxjerrë aktgjykim të

kundërligjshëm. Kështu, autori, duke marrë vendim në favor të personit të caktuar, në realitet, sjell një vendim në kundërshtim me ligjin, qoftë duke mos e aplikuar ligjin, qoftë duke aplikuar ligjin në kundërshtim me dispozitat dhe kuptimin e tij. Sa i përket dashjes së të pandehurës O.J. për të nxjerrë vendime të kundërligjshme, kolegji konstaton se: duke parë që e pandehura në fjalë është informuar me kohë lidhur me ligjet e zbatueshme dhe ka ndjekur seminare rreth temës në fjalë, pastaj duke parë se kolegët e saj gjyqtarë dhe anëtarë të stafit të Gjykatës Komunale të Prishtinës e zbatonin drejt ligjin, se edhe e pandehura e zbatonte drejt ligjin në lëndët e tjera dhe duke e parë vetë numrin e parregullsive dhe lëshimeve lidhur me caktimin e lëndëve në rastet në fjalë, si dhe duke pasur parasysh ligjin e zbatuar procedural dhe material, e pandehura O.J. qëllimisht kishte nxjerrë vendime të kundërligjshme gjyqësore. (Gjykata e Apelit Prishtinë, PAKR 158/15)

Vepra penale mund të kryhet me veprim dhe mosveprim. Vepra penale kryhet me veprim, duke u marrë një vendim, aktvendim, urdhëresë dhe akt tjetër i kundërligjshëm, apo duke u ndërmarrë veprime të tjera, me të cilat shkelet ligji. Ndërkaq, vepra penale kryhet me mosveprim në rastet kur ka ekzistuar obligimi i gjyqtarit për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara (p.sh., gjyqtari nuk i ka futur në procesverbal me qëllim faktet e rëndësishme, nga të cilat varet ekzistimi apo mosekzistimi i përgjegjësisë penale të të akuzuarit). Mirëpo, për t'u konsumuar kjo vepër penale, kur veprimet janë ndërmarrë për të ndihmuar një palë në procedurë, gjyqtari do të duhej që atë ta ketë ndihmuar për t'i sjellë vetes apo një tjetri përfitim pasuror, por jo edhe atëherë kur vendimi i kundërligjshëm është marrë për përfitime të tjera nga ana e gjyqtarit; kjo është pasoja që ka krijuar ligji, i cili është kufizuar vetëm te përfitimi material, ngase, siç u tha më lart, vendimi i kundërligjshëm mund të merret

edhe atëherë kur gjyqtari nuk ka marrë përfitime materiale, po përfitime të tjera, ndonjë favor, çfarëdo qoftë ai. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1262)

Subjekte të veprës penale mund të jenë vetëm gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët për kundërvajtje dhe gjyqtarët laikë.

Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Që të konsiderohet vepër penale, marrja e vendimit të kundërligjshëm duhet të kryhet gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit. Përpos kësaj, është e domosdoshme që autori i veprës penale të ketë qëllimin që vetes apo tjetrit t'i silltet përfitim pasuror i kundërligjshëm, apo tjetrit t'i shkaktohet dëm. Sipas ndërtimit të kësaj norme ligjore, përfitimi duhet të jetë vetëm pasuror, mirëpo, kur kemi të bëjmë me dëmin, ai mund të jetë dëm material a jomaterial. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1264)

3.2.12 Figura e veprës penale “Zbulimi i fshehtësisë zyrtare” – Neni 433

Këtë vepër e kryen personi zyrtar, i cili pa autorizim kumton, dërgon ose në ndonjë mënyrë tjetër i vë në dispozicion personit tjetër informatën që përbën fshehtësi zyrtare ose siguron informatën e tillë me qëllim që t'ia përcjellë ndonjë personi të paautorizuar. (Neni 433, KPK). Punonjësi i policisë R. Xh., në lokalet e stacionit policor në Gjilan zbulon informacionin, që përmban fshehtësi zyrtare, në atë mënyrë që personin B.A, nga Gjilani, e njofton se në stacionin policor gjendet një laptop i vjedhur edhe përkundër faktit se i përmenduri më parë nuk e kishte paraqitur në polici se i është vjedhur laptopi. Pas njoftimit, i pandehuri, pa bërë fare rast për këtë, i merr një deklaratë personit B.A. dhe pasi gjoja i përmenduri e identifikon laptopin si pronë të veten, ia kthen të njëjtin, pa e verifikuar se është pronë e tij e që, në fakt, kishte qenë pronë e personit tjetër. (Gjykata Komunale Gjilan, P.nr.1115/07)

Nisur nga fakti se tek kjo vepër penale bëhet fjalë për mbrojtjen e fshehtësisë së të dhënave të caktuara, mund të thuhet se këtu, së pari mbrohen interesat që qëndrojnë pas këtyre fshehtësive, interesa që do të rrezikoheshin me cenimin e detyrës së ruajtjes së fshehtësisë. Së dyti, kur këto interesa nuk janë të rëndësishme, atëherë, me mbrojtjen e kësaj fshehtësie, ruhet besimi i publikut për paanshmërinë e shërbimit, që është parakusht për funksionimin normal të shërbimit dhe të institucionit. Interesi i shërbimit, përkatësisht, trajtimi i fshehtë i ndonjë të dhëne a fakti, imponon nevojën që të sigurohet dhe të ruhet fshehtësia e të dhënave të caktuara, të mësuara nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës. Në të kundërt, zbulimi apo kumtimi (vënia në dispozicion të tjetrit) do të mund ta rrezikonte kryerjen e rregullt dhe efikase të shërbimit dhe, në përgjithësi, besimin e opinionit ndaj profesionalizmit dhe funksionimit të paanshëm të shërbimeve dhe institucioneve publike. Kjo është arsyeja për të cilën këtyre të dhënave, përpos formave të tjera mbrojtëse, u është siguruar edhe mbrojtja penalo-juridike, gjë që paraqet edhe *ratio legis* të këtij inkriminimi. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1264)

Sipas paragrafit 1, të këtij neni, vepra penale kryhet për përfitim personal ose me qëllim publikimi apo shfrytëzimi të informacionit jashtë Republikës së Kosovës.

Subjekt i veprës është personi zyrtar, por mund të jetë edhe një person, të cilit ndërkohë i ka pushuar statusi i personit zyrtar, i cili i kumton ndonjë personi tjetër të dhënat që paraqesin fshehtësi, për të cilat ka marrë dijeni në kohën kur e kishte statusin e personit zyrtar.

Veprimi i kryerjes së veprës penale është përcaktuar në mënyrë alternative: si kumtim, bartje apo bërje e të dhënave të tilla, që paraqesin të dhëna të fshehta, të qasshme në ndonjë mënyrë tjetër, si dhe sigurimi i të dhënave të tilla, me qëllim që ato t'ia dorëzojë personit të paautorizuar. Këto të dhëna duhet t'i kumtohen tjetrit. Shprehja

“tjetrit” duhet kuptuar çdo person fizik a juridik, i cili nuk është kompetent, as i autorizuar të dijë për të dhëna të tilla. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1266).

Po ashtu, si specifike më e veçantë, në raport me veprat tjera në këtë kapitull, është edhe dënueshmëria për pakujdesi në kryerjen e veprave të tilla.

Objekt i veprimit janë të dhënat e besueshme, që paraqesin fshehtësi zyrtare.

Forma e cilësuar e kësaj vepre penale ekziston kur kumtimi, bartja e fshehtësive zyrtare bëhet për përfitim material dhe kur autori ka për qëllim që, të dhënat e tilla, t’i publikojë apo t’i shfrytëzojë jashtë territorit të Kosovës, në shtete të huaja.

3.2.13 Figura e veprës penale “Falsifikimi i dokumentit zyrtar” - Neni 434

Kjo vepër penale është një lloj i falsifikimit intelektual. Fjala është për falsifikimin e dokumenteve zyrtare ose afariste, të regjistrave (librave regjistruar) a shkresave, ose vërtetimi i dokumenteve të tilla me përmbajtje të pavërtetë. Dokumenti, në aspektin material, është i saktë, nënshkrimi i personit zyrtar a personit përgjegjës është i saktë, vula zyrtare është në dokument dhe dokumenti është përpiluar gjatë kohës së kryerjes së detyrës zyrtare. E kontestueshme është përmbajtja e pasaktë e dokumentit.

Ekzistojnë tri modalitete të falsifikimit të dokumentit:

1. Futja e të dhënave të pavërteta ose mosfutja e ndonjë të dhëne të rëndësishme;
2. Vërtetimi i dokumentit, regjistrat a shkresës së rreme;
3. Mundësimi i përpilimit të dokumentit, librit a shkresës së pavërtetë, me përmbajtje të rreme.

Neni 434 i Kodit Penal përcakton se veprën penale *falsifikim i dokumentit* e kryen personi zyrtar, i cili në dokumentin zyrtar, në regjistër ose në shkresën zyrtare shënon të dhëna të rreme ose nuk shënon të dhënat e duhura apo me nënshkrimin e tij ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar, regjistrin apo shkresën zyrtare, që

përmban të dhëna të rreme, ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrin ose shkresës së tillë me përmbajtje të rreme.

Këtë vepër e kryen edhe personi zyrtar i cili shfrytëzon dokumentin zyrtar, regjistrin ose shkresën zyrtare të rreme si të vërtetë në veprimtarinë e tij afariste ose që asgjëson, fsheh, dëmton apo në ndonjë mënyrë tjetër e bën të papërdorshëm dokumentin zyrtar, regjistrin ose shkresën zyrtare. (Neni 434, KPK)

Figura e veprës penale *falsifikim i dokumentit* ekziston kur personi zyrtar, në dokumentin zyrtar apo afarist, në regjistër apo shkresë shënon të dhëna të rreme ose nuk i shënon të dhënat e rëndësishme, ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar afarist, regjistrin zyrtar ose shkresën që përmban të dhëna të rreme, ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrin apo shkresës së tillë me përmbajtje të rreme. Në cilësinë e personit zyrtar, i pandehuri N.L. ekzaminues pranë qendrës për patentë shoferi, të Ministrisë së Transportit, në Gjakovë, dhe i pandehuri tjetër Sh.F., në cilësinë e personit zyrtar, oficer i policisë në njësinë e trafikut në Gjakovë, kanë shpërdoruar postin zyrtar, me qëllim përfitimi të dobisë pasurore për veten apo për tjetrin, duke falsifikuar vendin e aksidentit dhe pjesëmarrësit në aksident dhe si shkaktar të aksidentit kanë paraqitur shoferin e kamionetës, me initiale P.Rr., kinse i njëjti nuk i ka dhënë përparësi kalimi të pandehurit N.L., i cili drejtonte automjetin Opel Corsa, pronë e Ministrisë së Transportit dhe, me atë rast, këtij automjeti i është shkaktuar dëm material në vlerë prej 1.743 euro. Në fakt, aksidenti ishte shkaktuar në të njëjtën ditë nga një kamion me ngjyrë të verdhë me targa të Shqipërisë dhe automjeti i dëmtuar Opel Corsa drejtohej nga kandidatja A.L., nga Gjakova. Me çka si bashkëkryes kanë kryer veprën penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare nga neni 339 dhe veprën penale të falsifikimit nga neni 348 i KPK-së. (Gjykata Komunale Gjakovë, P.nr.540/08).

Forma *e parë* e veprës penale qëndron në përpilimin e dokumentit, regjistrit apo shkresës zyrtare me përmbajtje të rreme. Vepra është e kryer me shënimin në dokumentin e përmendur të të dhënave të rreme ose me mosshënimin e të dhënave të rëndësishme. Për shkak të natyrës së veprimit kryes, tentativa e veprës penale tek kjo formë nuk është e mundur (derisa të mos jetë ndërmarrë veprimi, nuk ka vepër penale).

Forma *e dytë* e veprës qëndron në vërtetimin e dokumentit, regjistrit apo shënimit zyrtar me përmbajtje të rreme, duke vënë në të nënshkrimin apo vulën. Vërtetimi duhet të bëhet nga personi zyrtar a personi përgjegjës, ndërsa për ekzistimin e veprës nuk është me rëndësi se cili person e ka përpiluar përmbajtjen e rreme.

Forma *e tretë* e veprës qëndron në mundësimin e përpilimit të dokumentit, regjistrit ose shkresës me përmbajtje të rreme. Kjo formë e veprës penale konsumohet kur personi zyrtar, me nënshkrimin e vet, përkatësisht, me vulën zyrtare i jep mundësi tjetrit të vërë në dorë dokumentin apo regjistrin me përmbajtje të rreme, por, me këtë rast, kërkohet që personi zyrtar të dijë se personi tjetër në një dokument a regjistër të tillë do të shënojë të dhëna të pavërteta. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1268)

Objekt i veprimit të kësaj vepre janë dokumentet zyrtare apo afariste, librat (regjistrat) ose shkresat zyrtare.

Subjekt i të gjitha formave të veprës mund të jetë vetëm personi zyrtar ose personi përgjegjës.

Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje.

3.2.14 Figura e veprës penale “Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme” - Neni 435

Sipas këtij neni, këtë vepër e kryen personi zyrtar, i cili arkëton nga tjetri diçka që personi i tillë nuk është i detyruar të paguajë ose arkëton më shumë sesa personi i

tillë është i detyruar të paguajë apo që gjatë pagesës ose dërgesës, paguan ose dërgon më pak se është dashur.

Autor i veprës penale mund të jetë vetëm personi zyrtar a personi përgjegjës, në fushëveprimin e punës së të cilit bëjnë pjesë punët e arkëtimit dhe pagesës.

Vepra penale kryhet me dashje. Për ekzistimin e veprës penale nuk është i nevojshëm një qëllim i veçantë, për të cilin kryhet arkëtimi a pagesa. Nga vetë natyra e veprës rezulton që ajo ekziston vetëm në kushtet që arkëtimi i tërësishëm i padetyruar apo mospagesa të jenë regjistruar në mënyrë të rregullt për institucionin. Edhe tentativa për të kryer veprën penale është e dënueshme (neni 435, par. 3).

Vepra paraqitet, edhe pse nuk ekziston qëllim i përfitimi të kundërligjshëm, si një formë e mashtrimit dhe e keqpërdorimit financiar. Megjithëkëtë, meqenëse me këtë vepër penale dëmtohet pasuria e tjetrit, qëllimi i këtij inkriminimi është mbrojtja e këtyre të drejtave të njerëzve, si dhe nevoja që personi zyrtar, me rastin e kryerjes së veprimeve dhe detyrave të këtilla zyrtare, t'u përmbahet me rreptësi rregullave financiare dhe rregullave të shërbimit dhe sjelljes, në kufijtë e asaj që i lejohet të arkëtojë, përkatësisht, të paguajë apo të dorëzojë. Sipas përshkrimit ligjor, veprën e konsumon personi zyrtar a personi përgjegjës, i cili arkëton nga dikush diçka që ai nuk është i detyruar të paguajë, ose arkëton më tepër, sesa është i detyruar të paguajë, ose ai që me rastin e arkëtimit a dorëzimit të ndonjë sendi, arkëton më pak, përkatësisht dorëzon më pak. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1271)

3.2.15 Figura e veprës penale “Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor” – Neni 436

Neni 436, i Kodit Penal përcakton se këtë vepër penale e kryen personi zyrtar, i cili gjatë bastisjes së lokaleve, personit apo gjatë ekzekutimit të vendimit gjyqësor, merr pasurinë e luajtshme, me qëllim përfitimi të dobisë pasurore për vete ose për personin

tjetër. Sipas karakteristikave, kjo vepër penale paraqet formë të posaçme të veprës penale të vjedhjes dhe veprës penale të shpërdorimit (keqpërdorimit) të detyrës zyrtare apo të autorizimit. Keqpërdorimi i pozitës zyrtare ndodh këtu, sepse sendet e vjedhura nuk i ishin besuar personit zyrtar. Prona e luajtshme e përvetësuar me kryerje të kësaj vepre penale nuk është e domosdoshme të jetë pronë e personit i cili është subjekt hetimi. “Marrja e pasurisë së huaj të luajtshme duhet të jetë kryer gjatë bastisjes së banesës, shtëpisë ose personit, ose gjatë procedurës së përmbarimit. Kjo është esenca e kësaj vepre penale dhe ky veprim e bën vepër penale kundër detyrës zyrtare.” (Tomiç, 2007:396).

Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, që përfshin edhe qëllimin e përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore. Kryes i veprës penale mund të jetë vetëm personi zyrtar.

3.2.16 Figura e veprës penale “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare” – Neni 437

Deklarimi, prejardhja dhe kontrolli i pasurisë dhe i dhuratave nga zyrtarët e lartë publikë është parashikuar me ligj si detyrim.

Neni 437, i Kodit Penal përcakton si vepër penale mosraportimin ose raportimin e rremë të pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër materiale ose të detyrimeve financiare.

Subjekt i kësaj vepre është:

- çdo person, i cili, sipas ligjit, është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe që nuk bën një gjë të tillë,

- çdo person, i cili, sipas ligjit, është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, i cili falsifikon ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë.

Figura e veprës penale, pra, janë mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare.

Kjo vepër penale ka dy forma alternative: alternativa e parë konsumohet kur kryesi falsifikon të dhënat (deklaron më pak sesa posedon pasuri realisht) dhe alternativa e dytë, kur kryesi nuk i jep të gjitha të dhënat e kërkuara nga ai, me qëllim të fshehjes së pasurisë, të cilën personi zyrtar e ka realizuar në periudhën për të cilën ka detyrim ta deklarojë atë. (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1276)

Autorë të kësaj vepre penale janë vetëm ata persona që, sipas ligjit të cituar më lart, kanë detyrim ligjor që çdo vit të paraqesin me kohë dhe me saktësi pasurinë që kanë realizuar si bartës të funksioneve të ndryshme sipas ligjit për deklarimin e pasurisë.

Për sa i përket anës subjektive, vepra penale kryhet vetëm me dashje drejtpërsëdrejti, që përfshin dijen e kryesit se ai ka detyrim ta deklarojë pasurinë në agjencionin antikorrupsion, por nuk dëshiron ta bëjë atë, pastaj dijen e tij se ai nuk po i jep të gjitha të dhënat e nevojshme. D.m.th. kjo vepër penale konsumohet vetëm atëherë kur vërtetohet se kryesi nuk i ka përmbushur me dashje detyrimet ligjore për deklarimin e pasurisë, i ka falsifikuar me qëllim të dhënat e paraqitura, përkatësisht nuk i ka paraqitur të dhënat e nevojshme (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:1276)

3.2.17 Figura e veprës penale “Pranimi i paarsyeshëm i dhuratave” - Neni 315

Sipas nenit 315 të KPK, këtë vepër penale e kryen kushdo që gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike kërkon apo pranon shpërblim, dhuratë apo ndonjë përfitim

tjetër joproporcional me qëllim të lënies anash të interesave të organizatës së tij të biznesit apo të personit juridik ose për t'i shkaktuar dëm organizatës së tillë të biznesit apo personit juridik me rastin e lidhjes së kontratës ose pajtimit për kryerjen e ndonjë shërbimi.

Kushdo që duke kryer vepër penale nga paragrafi 1. i këtij neni kërkon apo pranon shpërblim, dhuratë apo ndonjë fitim tjetër joproporcional për vete ose për personin tjetër në shkëmbim të lidhjes së ndonjë kontrate ose marrëveshjes për të kryer ndonjë shërbim.

Vepra penale konsumohet edhe nga kushdo që kërkon apo pranon shpërblim, dhuratë apo ndonjë fitim tjetër pas lidhjes së kontratës ose pas kryerjes së shërbimit.

Sipas paragrafit 1 të këtij neni, autor mund të jetë secili person gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike.

Veprimi me të cilin kryhet kjo vepër penale konsiston në kërkimin apo pranimin e dhuratës, shpërblimit apo ndonjë përfitimi tjetër joproporcional. Kërkimi apo pranimi duhet të jetë lidhur me ndonjë marrëveshje ose me kryerjen e ndonjë shërbimi, i cili është në favor për tjetrin, është për interes të tjetrit, me kusht që kryerësi me sjellje të tilla t'i shkaktojë dëm organizatës së biznesit a personit juridik të cilin e përfaqëson (Salihu, Zhitia, Hasani, 2014:871)

Dhurata apo shpërblimi i pranuar konfiskohet.

3.2.18 Figura e veprës penale “Dhënia e paarsyeshme e dhuratave” - Neni 316

Ky nen përcakton sanksionet për korrupsionin privat aktiv.

Këtë vepër e kryen kushdo që jep, tenton të japë apo premtan shpërblim, dhuratë apo ndonjë përfitim tjetër joproporcional personit që ushtron veprimtari ekonomike, me qëllim arritjen e ndonjë përparësie të paarsyetueshme për lidhjen e kontratës apo për

kryerjen e ndonjë shërbimi, ose për t'i shkaktuar dëm organizatës së biznesit apo personit juridik, duke lënë anash interesat e këtyre.

Nëse autori i veprës penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni jep shpërblim apo dhuratë sipas kërkesës dhe nëse veprën e lajmëron para së të jetë zbuluar apo para se ai ta ketë kuptuar se është zbuluar, gjykata mund ta lirojë nga dënimi.

Dhurata apo shpërblimi i dhënë konfiskohen, përveç në rastin nga paragrafi 3 i këtij neni, sipas të cilit, dhurata apo shpërblimi mund t'i kthehen personit që e kishte dhënë.

Figura e veprës *dhënia e paarsyeshme e dhuratave* përmban elementet “dhënia” dhe “premtimi”, por mungon elementi “ofrimi”, ashtu siç parashikohet në Konventën Penale kundër Korrupsionit, neni 7, *Korrupsioni aktiv në sektorin privat*.

Te disa vepra penale kundër ekonomisë si kryerës mund të jetë secili person, ndërsa te disa të tjera kryerës mund të jetë vetëm personi me cilësi të caktuara. Këta janë persona të caktuar në funksione përgjegjëse në organizata, kompani dhe biznese, persona të cilëve u janë besuar detyra të caktuara, apo personat të cilët kanë autorizime të veçanta dhe detyra të caktuara te personat juridikë. Kështu, me rastin e caktimit se cili person konsiderohet përgjegjës te veprat penale ekonomike duhet pasur parasysh organizimin e brendshëm të personit juridik. (Salihu,Zhitia,Hasani,2014:740).

3.2.19 Figura e veprës penale “Moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale” - Neni 385

Sipas dispozitave të KPK, këtë veprë penale e kryen kushdo që, duke qenë në dijeni për përgatitjen e kryerjes së ndonjë veprë penale, nuk e lajmëron këtë fakt në kohën kur kryerja e veprës penale ende ka mundësi të evitohet, ndërsa vepra penale është kryer ose është tentuar.

Rrethanë cilësuese konsiderohet, përveç veprave nga neni 385 par. 2, vrasje; vrasja e rëndë; sulmi me lëndim të rëndë trupor; veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës; veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare; veprat penale kundër integritetit seksual; veprat penale të narkotikëve dhe veprat penale të armëve, nuk lajmëron përgatitjen për kryerjen e një apo më shumë veprave penale nga Kapitulli XXXIV – *Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare*.

3.3 Disa mangësi në dispozitat e KPK kundër korrupsionit, në raport me standardet ndërkombëtare

Legjislacioni i Kosovës kundër korrupsionit është hartuar me përkrahjen dhe bashkëpunimin e Këshillit të Europës, Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), Misionit të Sundimit të Ligjit të Bashkimit European në Kosovë (EULEX) dhe Zyrës së Bashkimit European në Kosovë. Kjo, pa dyshim, e ka përafruar legjislacionin e Kosovës kundër korrupsionit me standardet ndërkombëtare. “Legjislacioni i Kosovës në masë të madhe i plotëson kërkesat e standardeve ndërkombëtare në fushën kundër korrupsionit” (Këshilli i Evropës, 2015:118).

Megjithatë, janë identifikuar mangësi në dispozitat kundër korrupsionit të Kodit Penal të Kosovës, në raport me Konventën Penale Kundër Korrupsionit.

Korrupsioni i zyrtarëve publikë kombëtarë, paraparë me konventë, në KPK ndëshkohet me dy dispozita qendrore, nenin 428 (*ryshfet pasiv*) dhe nenin 429 (*ryshfet aktiv*), të cilat përmbajnë të gjitha llojet e ryshfetit pasiv (të kërkuarit, të marrjes ose të pranuarit të një oferte apo propozimi) dhe ryshfetit aktiv (të premtuarit, të ofruarit dhe të dhënit), siç parashihet me Konventën e Këshillit të Europës. Por, duke marrë parasysh

se KPK, në nenin 120, par.2, përkufizon *personin zyrtar*, kurse par.3 i këtij neni përkufizon *zyrtarin e huaj publik* apo *personi i huaj zyrtar*, konsideroj se në nenin 428 të KPK duhet të shtohet një dispozitë e veçantë që të sanksionojë marrjen e ryshfetit nga zyrtari i huaj publik apo personi i huaj zyrtar. Kurse në nenin 429 të KPK duhet të shtohet një dispozitë e veçantë që të sanksionojë dhënien e ryshfetit nga zyrtari i huaj publik apo personi i huaj zyrtar.

Nga ana tjetër, nenet e KP që kanë të bëjnë me ryshfetin pasiv (nenet 429 dhe 430) nuk mbulojnë drejtpërdrejt situatat kur janë të përfshirë përfituesit *palë të treta* – për shembull, kur ryshfeti nuk i jepet vetë personit zyrtar, por gruas së tij ose personit tjetër. Kjo bie në kundërshtim me Konventën, ku thuhet: “për veten e tij/saj apo për këdo tjetër”; dhe me nenin 428 të KP, që thotë: “për veten e tij, saj apo personin tjetër”. Ndaj rekomandohet që të ndërmerren masa juridike për t’i përfshirë drejtpërdrejt përfituesit e tretë në nenet 429 dhe 430 të KP në lidhje me ryshfetin aktiv. (Këshilli i Europës, 2015:118)

Elementi i veprës “zyrtari publik vendor” është përcaktuar me nenin 120.2 të KPK. Te vepra penale e ryshfetit aktiv “Premtimi, ofrimi apo dhënia” dhe te vepra penale e ryshfetit pasiv “Kërkesa ose marrja, pranimi i një oferte apo premtimi” janë të përfshira qartë në dispozitat penale. Elementi i veprës “ndonjë përparësi të pamërituar” është përfshirë në dispozitat e ryshfetit. Në lidhje me dhuratat e zyrtarëve, ligji mbi deklarinimin e pasurisë dhe ligji mbi parandalimin e konfliktit të interesit përmbajnë rregulla specifike.

Shprehja “për vete apo për çdokënd tjetër” përfshihet vetëm në rastet e veprave penale të ryshfetit pasiv. Përfituesit *palë të treta*, siç është cekur më lart, nuk janë të përfshirë në mënyrë eksplicite në rastet e veprave penale të ryshfetit aktiv.

Për sa i përket veprimit apo mosveprimit, neni 3 i Konventës Penale, lloji i veprimeve që duhet të kryhen duhet të jetë “në ushtrim të funksioneve të tij ose të saj zyrtare”. Në dispozitat e KPK për veprat e ryshfetit lloji i veprimeve që duhet të kryhen apo të mos kryhen nga ana e zyrtarit publik në kontekstin e veprës penale të ryshfetit, duhet të jenë në “kuadër të detyrës së tij ose të saj zyrtare” KP 428, 429 dhe 430: “në pajtim me detyrën e tij ose të saj zyrtare” nenet 428, 429: “të veprojnë në kryerjen e detyrës së tij ose të saj zyrtare”, neni 430. Rekomandohet që autoritetet të sigurojnë që të mos ketë zbrazëti në sistem dhe, nëse është e nevojshme, të ndërmarrin masa legjislativë që veprat e ryshfetit aktiv dhe pasiv në sektorin publik t’i mbulojnë të gjitha veprimet/mosveprimet në ushtrimin e funksioneve të zyrtarit publik, qofshin apo jo në kuadër të fushëveprimit të detyrave të zyrtarit. (Këshilli i Europës, 2015:116).

Korrupsioni pasiv dhe aktiv në sektorin privat mbulohen me veprën penale *dhënia e paarsyeshme e dhuratave* nga neni 316 (korrupsioni aktiv) dhe *pranimi i paarsyeshëm i dhuratave* nga neni 315 (korrupsioni pasiv). Qëllimi i dhënësit dhe i marrësit të ryshfetit është lënia anash e interesit apo e dëmtimit të interesit të subjektit tek i cili ushtron veprimtari ekonomike. Nuk jam dakord me formulimin që i është dhënë nenit 316 - *dhënia e paarsyeshme e dhuratave* dhe me formulimin e nenit 315 - *pranimi i paarsyeshëm i dhuratave*, sepse përmbajtja e këtyre dy neneve sanksionon veprimet e korrupsionit aktiv dhe pasiv në sektorin privat, kurse dhënia apo pranimi i dhuratës paraqet veprimin si element të veprës. Lidhur me këtë rekomandoj që të ndryshohet ky formulim dhe të përshtatet me formulimin e dhënë në Konventën Penale, Korrupsioni aktiv në sektorin privat, respektivisht, Korrupsioni pasiv në sektorin privat.

Vetëm “dhënia” dhe “premtimi” për anën aktive, si dhe “kërkimi” dhe “pranimi” janë të përfshira në të dyja dispozitat. Elementet “ofrimi” dhe “pranimi i një oferte apo premtimi” mungojnë në përkufizimin e tyre. Duke konsideruar nenin 8 *Korrupsioni*

pasiv në sektorin privat të Konventës Penale kundër Korrupsionit, në të cilën kërkohet që secila palë të miratojë masa legislative, që janë të nevojshme për përcaktimin si vepra penale, sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim gjatë veprimtarisë ekonomike (biznesit): kërkimin ose marrjen, direkt ose indirekt, nga cilido person që drejton ose punon, në çfarëdolloj cilësie, në entitete të sektorit privat, të çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon ose premtimi për vete apo për të tjerë, ose pranimi i një oferte apo premtimi i një avantazhi të tillë, për të vepruar ose mos vepruar në kundërshtim me detyrat e tyre, vërejmë se elementet “pranimi i ofertës apo premtimi” mungojnë. Koncepti “ndonjë avantazh të pamerituar” jepet ndryshe, me fjalët “shpërblim, dhuratë apo ndonjë përfitimi tjetër joproporcional” (neni 316.1 i KP) apo “shpërblim, dhuratë apo ndonjë fitim tjetër” (neni 315.3 i KP).

Në nenet 315 dhe 316 të KP, mungon elementi “për veten e tij/saj apo këdo tjetër” por ai paraqitet në paragrafin 2 të nenit 315 KP (“për vete ose për personin tjetër”). Po ashtu, në të dyja dispozitat mungon shprehja “drejtpërdrejt apo tërthorazi”. Ndërsa fjalët “të veprojë apo të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij ose saj” janë shprehur kështu: “me qëllim të lënies anash të interesave të organizatës së tij të biznesit apo të personit juridik ose për t’i shkaktuar dëm organizatës së tillë të biznesit apo personit juridik me rastin e lidhjes së kontratës apo kryerjen e një shërbimi [ose pajtimit për kryerjen e ndonjë shërbimi – 315.1 i KP]” dhe paraqiten vetëm në nenet 315.1 dhe 316.1 të KP. Elementi qëllimor i të dyja veprave penale nxirret përmes fjalëve “me qëllim për... t’i shkaktuar dëm...” ose “me qëllim të arritjes së ndonjë përparësie të paarsyetueshme” (Këshilli i Europës, 2015:120).

Në nenet 315 dhe 316 ndonëse përcaktohet se kush e kryen veprën, nuk është përcaktuar saktë nëse personi që kryen veprimtari ekonomike është personi me cilësi të

caktuara. Ndërsa Konventa Penale, në nenet 7 dhe 8 të saj, e përcakton se personi që kryen veprën është në çfarëdo cilësie.

Mendoj që mangësi të tilla apo dallimet e identifikuara në dispozitat penale kundër korrupsionit, duhet të konsiderohen në ndryshimet e ardhshme të KPK.

3.4 Legjislacioni në funksion të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit

Siç e kemi vënë në dukje, menjëherë pas krijimit të shtetit të pavarur të Kosovës u bë një punë e mirë për hartimin e legjislacionit dhe të strukturave të ndryshme të zbatimit të ligjit. E gjithë kjo punë u krye nga ekspertët tanë, me ndihmën e ndërkombëtarëve, me qëllim që ligjet dhe e tërë infrastruktura ligjore të ishin me standardet ndërkombëtare. Këtu, do të ndalemi në përshkrimin e atyre institucioneve dhe strukturave ligjore që lidhen me këtë problematikë të studimit.

Një hap i rëndësishëm ka qenë krijimi i *Agjencisë Kundër Korrupsionit*, me synim fuqizimin e luftës kundër korrupsionit dhe plotësimin e infrastrukturës ligjore në fushën e luftimit dhe parandalimit të kësaj dukurie, të pranishme edhe në shoqërinë tonë. Kontributi i saj spikat veçanërisht në fushën e raportimit, të zbulimit dhe të hetimit të korrupsionit, si dhe aspektin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit.

Nisur nga roli dhe rëndësia që ka siguria e informacionit për organizatat policore, por edhe për institucionet e tjera të shtetit që posedojnë informata, është miratuar ligji për *Klasifikimin dhe verifikimin e sigurisë*, me të cilin përcaktohen kriteret dhe mënyrat e klasifikimit të informatave, si dhe normat për sigurinë e tyre dhe verifikimin e saj.

Me shumë rëndësi është edhe rregullimi ligjor i konfliktit të interesit, që ka të bëjë drejtpërdrejt me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në institucionet publike.

Ligji i miratuar për *Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik*, do të ndihmonte organizatat dhe institucionet publike që t'i harmonizojnë aktet e brendshme rregullative me dispozitat e këtij ligji, për të siguruar kështu transparencë dhe respektimin e kriterëve për shmangien e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.

Për plotësimin e bazës ligjore për luftimin e krimit dhe korrupsionit, ka pasur një rol të rëndësishëm edhe miratimi i ligjit për *Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë*. Sipas këtij ligji, deklarimi i pasurisë është obligim i të gjithë zyrtarëve publikë që nga momenti kur ata marrin detyrën publike.

Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë personave, si një nga parimet bazë mbi të cilat vepron Policia e Kosovës, është një tregues i rëndësishëm i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në një shtet demokratik. Kjo presupozon edhe zbatimin e parimit për mosdiskriminim. Ndaj dhe është miratuar ligji kundër diskriminimit të personit, i cili është në përputhje me nenin 14 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ku thuhet se gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla, si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.

Duke përmbushur një nga standartet e konventave ndërkombëtare, Kosova ka miratuar edhe ligjin për *Mbrojtjen e informatorëve*. Nxjerrja e këtij ligji është bërë në frymën e Konventës së OKB-së Kundër Korrupsionit, respektivisht, nenit 33 të saj, ku përcaktohet se secili shtet palë shqyrton përfshirjen në sistemin e tij të brendshëm ligjor të masave të përshtatshme për të garantuar mbrojtjen kundër çdo trajtimi të pajustificuar për çdo person që raporton në mirëbesim dhe për shkaqe të arsyeshme në organet

kompetente çdo fakt lidhur me veprat penale që parashikohen në pajtim me këtë Konventë.

Më poshtë po i trajtojmë në mënyrë të detajuar këto ligje.

3.4.1 Ligji nr. 03/L- 159 Për Agjencinë Kundër Korrupsionit

Sipas këtij ligji, AKK zhvillon procedurën e hetimit paraprak në rast dyshimi për korrupsion sipas detyrës zyrtare apo sipas informacioneve të pranura nga personat fizikë apo juridikë. Për këtë, Agjencia kërkon, mbledh, hulumton dhe analizon dokumentacionin dhe informacione të tjera për rastin, kërkon informacione nga personat e përfshirë në të dhe ekzaminon rrethanat që kanë lidhje me çështjen. Nëse pas përfundimit të procedurave hetimore paraprake konstatohet se ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale, Agjencia ia përcjell çështjen prokurorisë kompetente për procedim të mëtejshëm. Në rast se nuk dyshohet për vepër penale, por për shkelje administrative, Agjencia e përcjell rastin tek organi administrativ kompetent.

Sipas nenit 16 të ligjit, AKK është përgjegjëse për hartimin e strategjisë kombëtare kundër korrupsionit. Në të theksohet: “Agjencia përmes Qeverisë paraqet për miratim Strategjinë kundër Korrupsionit në Kuvendin e Kosovës, dokument i cili përmban politikat kundër korrupsionit që duhet të zbatohen nga institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, si në nivel qendror, ashtu edhe në atë lokal.”

Kompetencat e Agjencisë përcaktohen në nenin 5 të ligjit. Ato janë:

- inicon dhe zhvillon procedurën e zbulimit dhe hetimit paraprak të korrupsionit dhe përcjell kallëzime penale për rastet e dyshimit për korrupsion në prokurorinë publike kompetente, nëse për të njëjtin rast nuk zhvillohet procedurë penale;

- bashkëpunon me institucionet vendore, të huaja dhe ndërkombëtare që kanë për mision parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;
- në bashkëpunim me Komisionin, Qeverinë, institucionet e tjera dhe me organizatat joqeveritare, harton strategjinë kundër korrupsionit dhe planin e veprimit;
- monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e Strategjisë kundër Korrupsionit dhe planit të veprimit;
- mbikëqyr dhe parandalon rastet e konfliktit të interesit dhe ndërmer masat e parapara me ligj të veçantë;
- mbikëqyr pasuritë e zyrtarëve të lartë publikë dhe personave të tjerë, siç parashihet me ligj të veçantë;
- mbikëqyr pranimin e dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmer masat e parashikuara me ligj;
- bashkëpunon me autoritetet publike kompetente për hartimin, harmonizimin dhe zbatimin e legjislacionit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;
- përfaqësohet në takime ndërkombëtare që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, si dhe merr pjesë në procesin e negociatave për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale apo miratimin e instrumenteve ligjore ndërkombëtare kundër korrupsionit;
- bashkëpunon me institucionet kompetente të Republikës së Kosovës për realizimin e detyrimeve që dalin nga aktet ndërkombëtare kundër korrupsionit dhe ofron rekomandime për përmbushjen e detyrimeve të tyre;
- merr pjesë dhe ofron këshilla për hartimin e kodit të etikës në sektorin publik dhe privat;
- ofron opinione në lidhje me konfliktin e interesit dhe mbikëqyrjen e dhuratave që kanë të bëjnë me kryerjen e detyrës zyrtare;

- ofron sqarime në lidhje me mënyrën e deklarimit të pasurisë dhe çështje tjera nga fushëveprimi i Agjencisë;
- mbledh, analizon dhe publikon të dhënat statistikore ose të dhëna të tjera në lidhje me gjendjen e korrupsionit në Kosovë;
- bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile për ngritjen e vetëdijes së publikut lidhur me korrupsionin;
- i raporton Kuvendit një herë në vit dhe Komisionit çdo gjashtë (6) muaj për punën e Agjencisë. Komisioni mund të kërkojë raporte edhe më të shpeshta nga Agjencia.

Në pajtim me kërkesat që dalin nga konventat ndërkombëtare, ligji i siguron AKK-së pavarësi në ushtrimin e kompetencave të parashikuara me ligj. “Zyrtarët e Agjencisë gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare gëzojnë pavarësi të plotë dhe nuk mund t’u imponohet asnjë presion nga jashtë për shkak të detyrës së tyre apo kur ndërmarrin veprime të caktuara konkrete në pajtim me këtë ligj apo me ligjet e tjera në fuqi”. (Neni 21).

Agjencia vendos në mënyrë të pavarur për përdorimin e buxhetit, të cilin e miraton, me propozim të Agjencisë, Kuvendi i Kosovës.

AKK udhëhiqet nga Drejtori, të cilin e zgjedh Kuvendi i Kosovës me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të votave, nga njëri prej kandidatëve të propozuar. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit përcaktohen në nenin 11 të ligjit. Sipas tij, ai:

- udhëheq dhe organizon punën e Agjencisë;
- mbikëqyr punën e nëpunësve të Agjencisë;
- përfaqëson Agjencinë brenda dhe jashtë vendit;
- menaxhon buxhetin e Agjencisë dhe është përgjegjës për mënyrën e shpenzimit të tij;

- lidh marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare, në pajtim me ligjin në fuqi;
- vendos për angazhimin e ekspertëve jashtë Agjencisë;
- ushtron edhe detyra të tjera të përcaktuara me ligj.

AKK-ja, sipas këtij ligji, nuk ka kompetenca ekzekutive.

3.4.2 Ligji nr. 03/l-178 për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë

Sipas këtij ligji, të gjitha institucionet publike garantojnë sigurinë fizike dhe sigurinë e informacioneve të klasifikuara, në pajtim me standardet dhe procedurat e përcaktuara përmes akteve nënligjore. Ligji është në përputhje me standardet e përcaktuara nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe me rregulloret për sigurinë të Bashkimit Europian (neni 19).

Në nenin 24 të këtij ligji thuhet se Autoriteti Verifikues që ka përgjegjësi për të zhvilluar procedura të verifikimit të sigurisë, siç është përcaktuar me këtë ligj, për të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës dhe kontraktuesve të tyre, është Agjencia e Kosovës për Inteligjencë. Meqë zyrtarët e PK posedojnë dhe përdorin informacioneve të ndjeshme dhe ligjërish janë të detyruar që t'i trajtojnë ato në mënyrë konfidenciale dhe t'i mbrojnë nga keqpërdorimi, është me interes që ata të njohin sanksionet penale që parashikon Neni 50 i këtij ligji. Kjo ka rëndësi të madhe pasi kështu punonjësit e policisë që janë apo vihen në dijeni të informacioneve të klasifikuara, ndërgjegjësohen se shpërdorimi eventual i tyre ka pasoja për individë apo institucione, por edhe për vetë Policinë. Sipas këtij ligji, shkalla e sanksioneve përcaktohet nga niveli i klasifikimi të informacionit:

Personi, i cili, pa autorizim, publikon informacionin e klasifikuar, sipas këtij ligji, si “KONFIDENCIALE” dhe cilido bartës i autorizuar i informacionit të klasifikuar

që nuk e mbron atë siç kërkohet me këtë ligj, kryen vepër penale dhe dënohet me burgim prej një (1) deri pesë (5) vite (neni 50 par.1)

Personi i cili publikon pa autorizim informacionin e klasifikuar, sipas këtij ligji, si “SEKRET”, dhe cilido bartës i autorizuar i informacionit të klasifikuar që nuk e mbron informacionin e klasifikuar siç kërkohet me këtë ligj, kryen vepër penale dhe dënohet me burgim prej tri (3) deri dhjetë (10) vite (neni 50, par.2)

Personi i cili publikon pa autorizim informacionin e klasifikuar, sipas këtij ligji, si “TEPËR SEKRET”, dhe cilido bartës i autorizuar i informacionit të klasifikuar, që nuk e mbron atë siç kërkohet me këtë ligj, kryen vepër penale dhe dënohet me burgim prej pesë (5) deri dymbëdhjetë (12) vite. (neni 50, par.3).

Mendoj se sanksionet që parashikon ky ligj duhen harmonizuar me Kodin Penal, sipas të cilit, për veprën penale *zbulimi i fshehtësië zyrtare* parashikohet dënimi maksimum deri në dhjetë (10) vite burgim (neni 433 par.2, KPK). Ndërsa me Ligjin për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë, për këtë vepër penale parashikohet dënim me burg deri në dymbëdhjetë (12) vite.

3.4.3 Ligji nr. 04/l-051 për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Fushëveprimi i këtij ligji përkufizohet në nenin 5, sipas të cilit, dispozitat e ligjit përcaktojnë rregulla të detyrueshme për zyrtarët e lartë publikë që, gjatë ushtrimit të funksionit, të parandalojnë konfliktin mes interesave publike dhe private, si dhe përcaktojnë kufizimet bazë për zyrtarët e lartë publikë për ushtrimin e funksionit publik dhe funksioneve tjera që nuk janë të natyrës publike.

Në nenin 6 theksohet se konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të

ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Gjithashtu, ligji detyron çdo zyrtar të lartë, që gjatë ushtrimit të funksionit publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

Vëmendje të veçantë kërkon këtu edhe menaxhimi i duhur i konfliktit të interesit, mbështetur edhe në deklaratimet e pasurisë, që bëjnë zyrtarët, për të parë se mos ka fshehje të pasurisë së deklaruar, të origjinës saj dhe nëse ajo është legjitime apo jo.

3.4.4 Ligji nr. 04/l-050 Për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë

Ky ligj përcakton detyrimet e zyrtarëve të lartë publikë për ta deklaruar pasurinë, të ardhurat dhe prejardhjen, si edhe detyrën e Agjencisë për ta kontrolluar deklarin dhe kontrollin e pasurisë dhe detyrimet e të gjithë personave zyrtarë për të deklaruar dhuratat dhe prejardhjen e tyre (neni 1). Ai rregullon procedurën e deklarimit dhe kontrollin e pasurisë, të ardhurat dhe detyrimet e zyrtarëve të lartë publikë, të anëtarëve të familjes, si dhe sanksionet përkatëse, si edhe procedurën e deklarimit, kontrollit për dhuratat dhe prejardhjen e tyre të pranuar nga të gjithë personat zyrtarë (neni 2).

Efekti i këtij ligji është mundësia për të parë ndryshimet e pasurisë prej momentit kur zyrtari ka marrë detyrën publike deri në përfundim të detyrës.

Neni 3 i tij përcakton së për cilat pozita publike janë të obliguar personat zyrtarë të deklarojnë pasurinë, duke filluar nga organet më të larta, si:

Presidenti i Kosovës dhe të gjithë ushtruesit e funksioneve publike të emëruar, nga Kryetari i Kuvendit, deputetët, Kryeministri, zëvendëskryeministri, ministrat dhe

zëvendësministrat, si dhe gjithë të emëruarit nga ata, udhëheqësit e sekretarive dhe zyrave të tjera, të Presidentit, të Kuvendit, të Qeverisë së Kosovës, sekretari i përhershëm i Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, sekretari i përhershëm i Kuvendit, sekretari i përhershëm i kryeministrit, sekretarët e përhershëm të ministrave, drejtorët e departamenteve dhe pozitat e barasvlershme;

gjykatësit dhe prokurorët, drejtorët dhe anëtarët e bordit të kompanisë publike, personat e akredituar jashtë vendit si përfaqësues të Kosovës, udhëheqësit e agjencive, drejtorive dhe institucioneve tjera të nivelit qendror, të themeluar me ligj ose ndonjë akt tjetër,

kryetari dhe nënkryetarët e komunave, kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit e kuvendeve komunale, drejtori i administratës dhe i personelit të kuvendeve komunale, audituesit e përgjithshëm dhe inspektorët e nivelit qendror;

guvernatori dhe zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore, udhëheqësit e bankave dhe institucioneve financiare me kapital publik;

rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët e Universitetit Publik dhe sekretari i tij, si dhe sekretarët e njësive akademike dhe organizative të Universitetit Publik, të gjithë drejtorët dhe anëtarët e bordeve të shoqërive aksionere me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror dhe publik më shumë se 50%;

zyrtarët e lartë që kryejnë funksione publike në strukturat e rendit, sigurisë dhe shërbimit doganor, si: komandanti, zëvendëskomandanti i FSK-së, drejtori dhe zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës, drejtori dhe zëvendësdrejtori i Doganës, drejtori dhe zëvendësdrejtori i Agjencisë së Inteligjencës.

Për sa u përket punonjësve të Policisë, përveç AKK-së, në pajtim me ligjin në fuqi dhe, nëse ka dyshim të bazuar se punonjësi i Policisë është i përfshirë në vepër penale, IPK mund të kërkojë prej punonjësve të Policisë deklarata të hollësishme lidhur

me veprimtaritë e jashtme, siç janë: dypunësimi, investimet, pasuritë dhe dhuratat ose privilegjet (neni 19, IPK).

Sipas nenit 437 të Kodit Penal, mosraportimi ose raportimi i remë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare sanksionohet si vepër penale. Ndërsa për kundërvajtjet administrative dënimet jepen nga Agjencia Kundër Korrupsionit.

3.4.5 Ligji nr.2004/3 Kundër diskriminimit

Dispozitat dhe përkufizimet e këtij ligji janë në pajtim me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ato janë shumë të rëndësishme dhe krijojnë obligime për punën e policisë dhe të organeve të tjera pa dallim.

Neni 2 rregullon çështjet që kanë të bëjnë me mosdiskriminimin, mbështetur në:

parimin e trajtimit të barabartë, që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statuseve të tjera;

parimin e përfaqësimit të drejtë të të gjithë personave dhe të të gjithë anëtarëve të komuniteteve, lidhur me punësim në organet publike në të gjitha nivelet;

parimin e mirëkuptimit dhe tolerancës ndëretnike të qytetarëve të Kosovës.

Më tej, në procedurën e ankimit të palës në rast diskriminimi të çfarëdo lloji, ligji përcakton dhe rregullon edhe palën përgjegjëse për barrën e provës:

“Kur personat që e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë,

barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë” (Ligji Kundër Diskriminimit, 2004:4)

3.4.6 Ligji nr. 04/l-043 për Mbrojtjen e informatorëve

Ky ligji ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për nxitjen e zyrtarëve për paraqitjen e veprimeve kundërligjore. Neni 2 i tij e përkufizon informatorin si çdo person, i cili, si qytetar apo i punësuar, informon në mirëbesim autoritetin përkatës brenda institucioneve publike në nivelin qendror apo lokal, institucione, ndërmarrje publike apo private, për çdo dyshim të arsyeshëm për ekzistimin e veprimit kundërligjor.

Ky ligj, gjithashtu, është në përputhje edhe me Konventën Penale Kundër Korrupsionit, në nenin 22 të së cilës thuhet: secila palë duhet të miratojë masa të tilla, që janë të nevojshme, për të siguruar mbrojtje efektive dhe të përshtatshme për: a) ata që raportojnë veprat penale të vendosura, në përputhje me nenet 2 deri 14, ose që bashkëpunojnë me autoritetet hetimore ose proceduese; b) për dëshmitarë që dëshmojnë lidhur me këto vepra.

Në neni 3 të ligjit, ku parashikohet mbrojtja e të drejtave të informatorit, theksohet: Ndaj informatorit, që informon me qëllim të mirë për veprime kundërligjore, nuk mund të ndërmerren masa dënimi apo disiplinore, pushim nga puna, largim të përkohshëm (pezullim) nga puna apo diskriminim, si dhe i garantohet e drejta në mbrojtjen e anonimitetit.

Ndërsa neni 4 obligon institucionet publike në nivelin qendror dhe lokal, ndërmarrjet publike apo private që:

- a. të krijojnë kushte për punë të pavarur dhe të papengueshme të personit që i ka informuar veprimet potenciale të kundërligjshme;

- b. të krijojnë kushte për mbrojtjen e integritetit, të drejtave dhe interesave të informatorëve që informojnë për veprimet e kundërligjshme;
- c. të pranojnë informatën për veprimet e kundërligjshme dhe të zbatojnë procedurën në pajtim me këtë ligj;
- d. të ruajnë provat materiale dhe personale me të cilat vërtetohet veprimi i kundërligjshëm.

Ky ligj hyri në fuqi në vitin 2011, me idenë e forcimit të parandalimit dhe luftimit të formave të ndryshme të krimit dhe korrupsionit, por, për shkak se fjala informator (denoncues) ka një konotacion negativ nga e kaluara, nuk ka pasur praktika të mira në zbatimin e këtij ligji. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për organet e zbatimit të ligjit. “Rrallë herë punonjësit policorë kanë gatishmëri për të folur hapur për korrupsionin në polici” (Kesic, 2013:214).

Mendoj se është e nevojshme ngritja e vetëdijes së zyrtarëve për paraqitjen e veprave të kundërligjshme.

Me aprovimin e këtij ligji, Kosova ka përmblusur një nga standartet e parapara me konventa ndërkombëtare. Mirëpo, fillimisht kemi një paqartësi në aspektin terminologjik, sepse fjala “*informator*” nuk e ka kuptimin “*whistleblower*”, siç përcaktohet në konventa ndërkombëtare. Po ashtu, ka edhe ndonjë kontradiktë, si në nenin 3, par.5, ku informatorit i garantohet e drejta në mbrojtjen e anonimitetit, kurse në nenin 7, ku përcaktohet evidencimi i informatës së pranuar për veprime kundërligjore. Aty thuhet: evidencimi përmban edhe emrin dhe mbiemrin, adresën, institucionin e paraqitësit të informatës. Kjo eliminon anonimitetin, prandaj, mendojmë se kërkohet një rregullim.

Nga një shikim i kujdesshëm i Ligjit për mbrojtjen e informatorëve në Kosovë, konstatohet se ai është në përputhje me standardet ndërkombëtare, por vetën nga forma,

kurse në përmbajtje, mendojmë se nuk përputhet si duhet. Prandaj mendojmë se ai duhet të rivlerësohet dhe të ndryshohet.

KREU IV: LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

4.1 Trajtimi i dukurisë së korrupsionit në konventat ndërkombëtare

Në këtë kapitull po bëjmë përshkrimin e disa prej konventave ndërkombëtare, të cilat trajtojnë probleme të ndryshme të luftës kundër korrupsionit. Hartimi dhe miratimi i këtyre konventave ka qenë një nevojë, për arsye se në kohën e integritimeve globale, të zhvillimit të shpejtë të teknologjisë, të transportit dhe komunikimit, lëvizjes së lirë të mallrave, njerëzve dhe shërbimeve, korrupsioni, duke qenë i ndërlidhur me forma tjera të krimit të organizuar dhe të pastrimit të parave, është bërë një dukuri e përmasave shqetësuese, si për shtetet, ashtu edhe për aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë. ”Gjithnjë e më tepër, duket se kompanitë që operojnë në gjithë botën, në garë konkurruese për kontrata, përdorin veprime të kundërligjshme dhe korrupsion për të influencuar vendimmarrjen (Hetzer, 2008:75).

Më poshtë sjellim konventat kryesore, që kanë në qendër të tyre nevojën për luftën e vazhdueshme që duhet të zhvillojnë shtetet, por edhe bashkësia ndërkombëtare kundër korrupsionit. Në to jepen politikat dhe praktikat parandaluese kundër korrupsionit, funksionet kryesore antikorrupsion, parashikohen penalizimet për veprat penale të korrupsioni etj. Gjithashtu, në to gjenden udhëzime, rekomandime, kritere, standarde apo dispozita që rregullojnë bashkërendimin e forcave në këtë luftë dhe që duhen zbatuar me rigorozitet nga të gjitha shtetet që kanë aderuar dhe i kanë ratifikuar këto konventa.

4.1.1 Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit

Konventa e OKB-së Kundër Korrupsionit, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2005, është më e përgjithshmja në qasjen e saj; ajo mbulon një gamë shumë të gjerë çështjesh,

përfshirë parandalimin e korrupsionit, penalizmin e tij, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe konfiskimin e aseteve të rigjeneruara nga korrupsioni. Ajo, gjithashtu, kërkon nga palët të funksionalizojnë organe përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit përmes zbatimit të ligjit (OECD, 2008:3).

“Me aprovimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, zhvillimi i të drejtës ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit ka arritur majën më të lartë. Tani Konventa duhet të jetësohet. Kjo është detyrë ligjvënësve kombëtarë, e institucioneve të zbatimit të ligjit dhe e gjykatave.” (Kubiciel, 2009:154)

Dispozitat e Përgjithshme të Konventës përcaktojnë qëllimet e saj:

- a) nxitja dhe forcimi i masave për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit më me efikasitet dhe efektivitet;
- b) nxitja, lehtësimi dhe mbështetja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe asistencës teknike në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë rimarrjen e pasurisë;
- c) nxitja e integritetit, përgjegjësisë dhe administrimi i rregullt i çështjeve publike dhe pasurisë publike.

Me termin *person zyrtar*, konventa, nënkupton:

- i. çdo person që ka pozitë shtetërore legjislativë, ekzekutive apo juridike, qoftë i caktuar apo i zgjedhur, qoftë i përhershëm apo i përkohshëm, qoftë me pagesë apo pa pagesë, pa marrë parasysh moshën;
 - ii. çdo person tjetër që kryen funksion publik, përfshirë për agjenci publike apo për ndërmarrje publike, apo ofron shërbime publike, siç përcaktohet me ligjet vendore të shtetit dhe siç aplikohet në fushën përkatëse të ligjit në atë shtet;
 - iii. çdo person tjetër që përcaktohet si “zyrtar publik” në ligjet vendore të atij shteti.
- “Zyrtar publik i huaj” nënkupton personin që mban pozitë legjislativë, ekzekutive, administrative apo gjyqësore të një vendi të huaj, qoftë i caktuar apo i zgjedhur;

dhe ndonjë person që ushtron funksion publik për një vend të huaj, përfshirë një agjenci apo ndërmarrje publike (neni 2).

Gjithashtu, Konventa përkufizon të ardhurat nga krimi, pronën, konfiskimin, dërgesën e kontrolluar etj.

Konventa zbatohet, në pajtim me kushtet e saj, për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit dhe për ngrirjen, kapjen, konfiskimin dhe kthimin e fitimeve nga veprat penale të parashikuara sipas kësaj Konvente (neni 3).

Politikat dhe praktikat parandaluese kundër korrupsionit, të përcaktuara në Konventë, obligojnë që secili shtet palë, në përputhje me parimet themelore të sistemit ligjor të tij, zhvillon dhe zbaton ose ruan politika të efektshme dhe të koordinuara kundër korrupsionit, që nxisin pjesëmarrjen e shoqërisë dhe reflektojnë parimet e shtetit ligjor, administrimin e rregullt të punëve publike, të pasurisë publike, integritetit, transparencës dhe përgjegjësisë (neni 5).

Secili shtet palë, në pajtim me parimet themelore të ligjit të tij të brendshëm, merr masa për të parandaluar korrupsionin në sektorin privat, për të forcuar standardet e kontabilitetit dhe të kontrollit në sektorin privat dhe, nëse është e përshtatshme, cakton dënime të efektshme, proporcionale dhe parandaluese, civile administrative dhe penale, nëse këto masa nuk merren (neni 12).

Rëndësi të veçantë i kushton Konventa kërkesës për kriminalizimin e veprave të korrupsionit. Në të kërkohet që: çdo shtet anëtar të miratojë masa ligjore e të tjera të nevojshme që të sanksionojnë si vepra penale, kur kryhen në mënyrë të qëllimshme, këto veprime:

- a) premtimi, ofrimi ose dhënia, direkte apo indirekte, e dobisë së paarsyeshme funksionarit publik ose ndonjë personi apo entiteti tjetër, në mënyrë që ky

funksionar të veprojë ose të përmbahet nga veprimi gjatë kryerjes së detyrës së tij zyrtare,

- b) kërkimi ose pranimi, direkt ose indirekt, e dobisë së paarsyeshme nga funksionari publik ose nga ndonjë person e entitet tjetër, në mënyrë që ky funksionar të veprojë ose të përmbahet nga veprimi gjatë kryerjes së detyrës së tij zyrtare (Neni 15).

Konventa parashikon penalizim për këto vepra penale: Dhënia e ryshfetit nëpunësve publikë të huaj dhe nëpunësve të organizatave publike ndërkombëtare (neni 16); Përfitimi, keqadministrimi ose abuzime të tjera me pasurinë nga një nëpunës publik (neni 17; Ushtrimi i ndikimit (neni 18); Abuzimi me funksionet (neni 19); Pasurimi i paligjshëm (neni 20); Dhënia e ryshfetit në sektorin privat (neni 21); Përfitimi i paligjshëm i pasurisë në sektorin privat (neni 22); Pastrimi i fitimeve nga krimi (neni 23); Fshehja (neni 24); Pengimi i drejtësisë (neni 25); Përgjegjësia e personave juridikë (neni 26); Pjesëmarrja dhe tentativa (neni 27); Dijenia dhe qëllimi si elemente të një vepre penale (neni 28).

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, sipas kësaj Konvente, nëse është e përshtatshme dhe në pajtim me sistemin ligjor të brendshëm, shtetet palë ndihmojnë njëra-tjetrën në hetimin dhe gjykimet e çështjeve civile dhe administrative, që kanë të bëjnë me korrupsionin, si: Ekstradimi (neni 44); Transferimi i personave të dënuar (neni 45); Asistencë ligjore e përbashkët (neni 46); Transferimi i procedimeve penale (neni 47); Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit (neni 48); Investigime të përbashkëta (neni 49); Teknika të veçanta investigative (neni 50).

Konferenca e shteteve palë të kësaj Konvente miraton rregulla procedurale dhe rregulla për funksionimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë nen, përfshirë rregullat

për pranimin dhe pjesëmarrjen e vëzhguesve, si dhe për pagesën e shpenzimeve që rrjedhin nga zhvillimi i këtyre aktiviteteve.

4.1.2 Konventa Civile për Korrupsionin

Kjo konventë obligon që secila palë pjesëmarrëse të parashikojë në ligjin kombëtar rregullime efektive për personat që dëmtohen si rezultat i veprimeve korruptive, t'u japë atyre mundësi të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre, përfshirë edhe mundësinë për t'u kompensuar për dëmin (neni 1).

Konventa përcakton që secila palë në ligjin e vet kombëtar të parashikojë: kompensimin e dëmit për personat që janë dëmtuar si rezultat i korrupsionit; nxerrjen e procedurave të duhura për personat që janë dëmtuar si pasojë e një veprimi korruptiv nga zyrtarët e tij gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre; mbrojtjen e duhur ndaj çdo sanksioni të pajustificuar ndaj punonjësve, që kanë arsye të dyshojnë për korrupsion dhe që këtë dyshim ua paraqesin personave përgjegjës ose autoriteteve.

Neni 13 i saj i obligon palët të vendosin bashkëpunim efektiv për çështjet që kanë të bëjnë me procedurat civile të çështjeve të korrupsionit, sidomos për shërbimin e dokumenteve, me marrjen e provave nga jashtë, juridiksionin, njohjen dhe forcimin e gjykimeve të vendeve të tjera dhe me koston e gjykimit, në përshtatje me dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet civile dhe tregtare, në të cilat ato janë nënshkruese, si dhe në përputhje me ligjin e tyre të brendshëm.

4.1.3 Konventa Penale Kundër Korrupsionit

Konventa Penale për Korrupsion është miratuar nga Këshilli i Europës. Kreu i dytë i saj përmban obligimin që si vepra penale të përkufizohen një sërë formash të korrupsionit, përfshirë korrupsionin aktiv dhe pasiv të zyrtarëve publikë, të zyrtarëve

ndërkombëtarë, të anëtarëve të parlamenteve dhe të këshillave nacionale e ndërkombëtare, të gjyqtarëve të gjykatave shtetërore e ndërkombëtare, ushtrimin e ndikimit, si edhe korrupsionin aktiv dhe pasiv në sektorin privat. Konventa parashikon masat kundër pastrimit të parave, produkte nga veprat e korrupsionit; përgjegjësinë e personave juridikë, sanksione dhe masa, autoritete të specializuara për luftimin e korrupsionit, si dhe mbrojtjen e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe dëshmitarëve.

Në këtë kapitull, gjithashtu, përcaktohet se Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO) monitoron zbatimin e kësaj konvente nga Palët.

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, Konventa obligon palët të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, në përputhje me parashikimet e instrumenteve ndërkombëtare përkatëse të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale ose të marrëveshjeve të arritura mbi bazë legjislacioni uniform ose reciprok dhe në përputhje me ligjin e tyre kombëtar, në kuptimin më të gjerë të mundshëm, për qëllim hetimi dhe procedimi të veprave penale të vendosura në përputhje me këtë Konventë (neni 25). Në veçanti, kërkohet bashkëpunim në fushën e informacionit, asistencës së ndërsjellë dhe ekstradimit.

4.1.4 Konventa e OECD-së Kundër Korrupsionit

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) ka miratuar në vitin 1994 Konventën me disa rekomandime për vendet anëtare të kësaj organizate që të ndërmarrin masa për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit të zyrtarëve të lartë publikë në transaksionet ndërkombëtare afariste. Me *zyrtar i huaj publik*, Konventa nënkupton çdo person që ushtron detyrë legjislative, gjyqësore apo administrative në një vend të huaj, pavarësisht nëse është i emëruar apo i zgjedhur; çdo person që ushtron

detyrë publike për një vend të huaj, përfshirë detyrat në agjenci publike apo ndërmarrje publike; dhe çdo zyrtar apo përfaqësues të organizatave ndërkombëtare.

Sipas Konventës, vendet anëtare të OECD obligohen të ndërmarrin masa efikase për parandalimin e korrupsionit dhe të përcaktojnë elementet e përbashkëta të përkufizimit penalo-juridik të këtyre veprave penale. Me këtë Konventë, korrupsioni kundër zyrtarëve të lartë publikë duhet të kriminalizohet, pavarësisht ligjeve vendore dhe shkallës së korrupsionit. Ajo përcakton se shkalla e dënimit duhet të jetë e ngjashme me dënimin e parashikuar për veprat e kryera nga subjektet vendase, ndërsa përfitimi dhe pasuria e fituar nëpërmjet korrupsionit duhet të konfiskohet. Së fundi, vendet anëtare të Konventës së OECD-së janë të obliguara që dispozitat e Konventës t'i aplikojnë në dispozitat e ligjeve të tyre.

Instrumentet ndërkombëtare identifikojnë si funksione kryesore antikorrupsion: hetimin dhe ndjekjen, parandalimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin, koordinimin, monitorimin dhe hulumtimin. Këto funksione reflektohen në detyrat antikorrupsion në vazhdim: pranimi dhe përgjigjet ndaj ankesave; grumbullimi i informatave, kryerja e monitorimit, kryerja e hetimeve; kryerja e ndjekjes; lëshimi i urdhrave administrativë; zbatimi i hulumtimit paraprak, analiza dhe ndihma teknike; ofrimi i udhëzimeve për politikën etike, për shqyrtimin e përshtatshmërisë, shqyrtimin e deklarimeve të pasurisë; ofrimi i informatave publike, edukimi; sigurimi i bashkëpunimit ndërkombëtar; dhe detyra të tjera (OECD, 2008:21)

4.2 Vështrim krahasimor i legjislacionit të Kosovës me legjislacione të huaja

Aspekti krahasimor i legjislacionit të korrupsionit është i një rëndësie të veçantë, për të pasur një pasqyrë më të qartë mbi ligjet për rregullimin penalo-juridik sipas kodeve apo ligjeve penale të fushës së korrupsionit në vende të ndryshme. Kjo lidhet

edhe me faktin se, në kushtet e globalizmit, shtetet e ndryshme janë të detyruar të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në të gjitha fushat. Pa dyshim që ky bashkëpunim, përveç të tjerash kërkon edhe njohjen reciproke të ligjeve për fusha të caktuara. Edhe në luftën kundër korrupsionit është i domosdoshëm, sidomos kur është fjala për ndërlidhjen e korrupsionit me vepra të tjera kriminale, me konfiskimin e pasurisë së fituar në vende të huaja nga korrupsioni, me pengimin e pastrimit të parave etj.

Vendet që kemi përzgjedhur për krahasimin e këtij legjislacioni janë Sllovenia, Austria dhe Serbia. Mendojmë se legjislacionet e tyre penale janë në interes të studimit tonë, për disa arsye.

Republika e Sllovenisë dhe e Kosovës kanë një të kaluar të përbashkët, si pjesë përbërëse e ish-Federatës Jugosllave deri në shpërbërjen e saj. Gjithashtu, legjislacioni i të dy vendeve ka qenë pjesë e legjislacionit të Jugosllavisë. Republika e Sllovenisë ka dalë nga ish-Federata Jugosllave, është integruar në Bashkimin Europian (BE) dhe vend me nivel të ulët të korrupsionit. Austria, në vazhdimësi ka ruajtur lidhje ekonomike, politike e kulturore me vendet e Ballkanit, është anëtare e BE-së, vend me demokraci të zhvilluar dhe konsiderohet se është ndër vendet me nivel të ulët të korrupsionit. Republika e Serbisë është përzgjedhur për shkak të afërsisë gjeografike, të ndikimit të legjislacionit penal të ish-Federatës Jugosllave, si dhe të aspiratave të saj të njëjta, sikurse Kosova, për integrim në BE.

4.2.1 Legjislacioni i Sllovenisë kundër korrupsionit, në aspektin krahasimor me Kosovën

Arritjet e Sllovenisë në luftimin e korrupsionit dhe legjislacioni i saj në këtë fushë mund t'i shërbejnë përmirësimit të legjislacionit dhe të mekanizmave të Kosovës, në luftimin e korrupsionit. Ato mund të jenë në interes të bashkëpunimit të ndërsjellë,

për faktin se Kosova dhe Sllovenia kanë marrëdhënie shumë të mira në fushën ekonomike, politike dhe të sigurisë.

Sipas OECD, “Sllovenia i ka fuqizuar në shumë aspekte politikat kombëtare, si dhe kornizën institucionale dhe ligjore kundër korrupsionit” (OECD,2014:9).

Kodi Penal i Sllovenisë (KPS) dhe Kodi i Procedurës Penale të Sllovenisë (KPPS) përbëjnë legjislacionin themelor kundër korrupsionit. KPS në kreun e 26-të parashikon dispozitat ndëshkuese për veprat penale kundër detyrave zyrtare dhe kompetencave publike. Vërejmë se KPS jep një përkufizim shumë më të detajuar se KPK. Sipas KPS, neni 99, termi “zyrtar” nënkupton:

- Anëtar i Asamblesë Kombëtare, anëtar i Këshillit Kombëtar, dhe anëtar i organit përfaqësues lokal apo rajonal;
- Gjykatës i Gjykatës Kushtetuese, gjykatës, gjykatës porotë, prokurorë shtetërorë, apo mbrojtës shtetërorë;
- Personi që kryen detyra zyrtare apo ushtron funksion publik me kompetenca dhe përgjegjësi menaxhuese në kuadër të autoritetit shtetëror;
- Ndonjë person tjetër që ushtron detyra zyrtare me autorizim ligjor, urdhëresë apo kontratë arbitrazhi, të lidhur në bazë të ligjit;
- Personi ushtarak i përcaktuar si i tillë me rregullore të veçanta në raste, kur veprimi nuk është i penalizuar si vepër penale kundër detyrës ushtarake;
- Personi në një vend të huaj, që kryen funksione legjislative, ekzekutive apo juridike apo ndonjë detyrë tjetër zyrtare në çfarëdo niveli, me kusht që ai/ajo të përmbushë kriteret substanciale nën pikat 1, 2 apo 3 të këtij paragrafi;
- Personi i njohur si zyrtar brenda organizatave publike ndërkombëtare, me kusht që ai/ajo të përmbushë kriteret substanciale nën pikat 1, 2 apo 3 të këtij paragrafi;

- Personi që kryen funksione apo detyra zyrtare juridike, prokuroriale apo të tjera me gjykatën apo tribunalin ndërkombëtar.

Një dallim tjetër mes KPS dhe KPK është se ligjvënësi slloven në kreun e veprave penale kundër detyrave zyrtare dhe kompetencave publike parashikon edhe disa vepra penale, që mund t'i kryejnë kryesisht zyrtarë të agjencive të sigurisë dhe zbatimit të ligjit, si: Tortura(Neni 265); Shkelja e dinjitetit njerëzor nga keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo të drejtave zyrtare(Neni 266); Deklarata nën shtrëngim (Neni 267).

Mendojmë se kjo është e drejtë, pasi edhe shumë studiues, si Newburn, Maurice, Peak, Gaines, Glensor, brutalitetin e zyrtarëve e cilësojnë si vepër korrupsioni.

Kodi Penal i Kosovës i përmban këto dispozita, por ato janë të shpërndara në kapituj të ndryshëm të tij.

Ndryshe nga KPK, Kodi Penal i Sllovenisë parashikon edhe veprën penale: *Pranimi i ryshfetit për ndërmjetësim ilegal* (Neni 263). Ky nen parashikon veprat penale dhe masat e dënimit për to:

- Kushdo që pranon shpërblim, dhuratë apo ndonjë favor tjetër apo premtim për ndonjë favor të tillë për vete apo ndonjë person të tretë, me qëllim të shfrytëzimit të pozitës së tij, ndikimit real apo të supozuar për të ndërhyrë që një veprim i caktuar zyrtar të kryhet apo të mos kryhet, do të dënohet me burgim jo më shumë se 3 vjet;
- Kushdo që shfrytëzon pozitën apo ndikimin real apo të supozuar për të ndërhyrë për kryerjen e veprimit të zyrtarit të caktuar që nuk duhet të kryhet apo për moskryerjen e ndonjë veprimi zyrtar që do të kryhej apo do të duhej të kryhet, do të dënohet me dënimin e të njëjtës shkallë;
- Nëse autori i veprës, para apo pas ndërhyrjes, pranon ndonjë shpërblim, dhuratë apo ndonjë favor për vete apo për person të tretë, në shkëmbim të ndërhyrjes së tij,

referuar në paragrafin paraardhës, do të dënohet me burgim jo më pak se 1 dhe jo më shumë se 5 vjet;

- Shpërblimi, dhurata apo përfitimet e tjera do të konfiskohen.

Lidhur me dispozitat kundër korrupsionit aktiv dhe pasiv, KPS, ashtu si KPK, parashikon veprat penale *marrje e ryshfetit*(neni 261) dhe *dhënie e ryshfetit*(neni 262). Përmbajtja dhe elementet e veprës nuk ndryshojnë, por KPS parashikon sanksione më të buta, deri në 5 vjet burgim, kurse KPK parashikon deri në 12 dhe 8 vjet burgim.

Kodi Penal i Sllovenisë nuk ka dispozitë të veçantë për veprën penale *dhënie e ryshfetit zyrtarit të huaj publik*, sikurse e ka Kodi Penal i Kosovës, sepse përkufizimi “zyrtar” neni 99 par.7, i KPS, nënkupton *zyrtar i huaj*. Prandaj dispozitat për veprën penale *marrje e ryshfetit* (neni 261) dhe *dhënie e ryshfetit* (neni 262) vlejnë edhe për veprën penale *dhënie e ryshfetit zyrtarit të huaj publik*.

Vepra penale e *ushtrimit të ndikimit* në KPS është e sanksionuar në nenin 263, *Pranimi i ryshfetit për ndërhyrje të kundërligjshme* (korrupsion pasiv) dhe në nenin 264, *Dhënia e dhuratave për ndërhyrje të kundërligjshme* (korrupsion aktiv). Ndërsa Kodi Penal i Kosovës, dispozitat për veprën penale *ushtrimi i ndikimit*, edhe për korrupsionin pasiv, edhe për korrupsionin aktiv, i ka të integruar në një nen të vetëm(431). Përmbajtja e tyre nuk ka dallime esenciale, me përjashtim se KPK parashikon sanksion më të ashpër.

Sikurse në KPK, edhe në KPS *Korrupsioni në sektorin privat* është parashikuar në kapitullin e veprave penale kundër ekonomisë: *Pranimi i paautorizuar i dhuratave*(neni 241) (korrupsion pasiv) dhe *Dhënia e paautorizuar e dhuratave*(neni 242) (korrupsion aktiv). Shohim që ligjvënësi slloven përdor fjalën “i paautorizuar”, kurse në KPK përdoret një përkufizim më i gjerë “i paarsyeshëm”. Dallim tjetër është se

në legjislacionin slloven, te vepra e korrupsionit privat aktiv kemi elementet “jep”, “ofron” dhe “premtan”, ndërsa në KPK (neni 316) mungon elementi “ofron”.

Sipas nenit 99, par.9, të KPS, me *përfitim, dëm apo vlerë materiale* gjatë kryerjes së veprës penale, nënkuptohen:

- 1) shuma që nuk kalon 500 euro ka të bëjë me përfitime, dëme apo vlerë të vogël pasurore;
- 2) shuma që nuk kalon 5000 euro, ka të bëjë me përfitime, dëme apo vlerë substanciale pasurore;
- 3) shuma që nuk kalon 50.000 euro, ka të bëjë me përfitime, dëme apo vlerë të madhe pasurore.

Lidhur me aspektin procedural, ka shumë ngjashmëri mes legjislacionit të Kosovës dhe Sllovenisë. Kjo, sepse siç thotë edhe (Stubs, 2014:61), “Procedura penale në Slloveni ka trashëguar sistemin e procedurës penale nga sistemi jugosllav”.

Roli i Policisë në fazën paraprake të hetimeve përcaktohet me Ligjin për *Detyrat dhe Autorizimet e policisë* dhe me Kodin e Procedurës Penale. Prokurori udhëheq hetimet, kurse gjykatat në çështjet kriminale administrojnë drejtësinë brenda kufijve të juridiksionit të vet real, të paraparë me ligj (neni 24), veprojnë sipas juridiksionit territorial(neni 26).

Për dallim nga legjislacioni i Kosovës, në legjislacionin slloven ekziston gjyqtari hetues. Përparësia definitive e tij qëndron në atë se ai është në rolin e organit gjyqësor dhe jo palë në procedurë. Gjykatësi hetues në Slloveni ka një rol të paqartë: në njërën anë, është i obliguar të hetojë dhe, në anën tjetër, ai mbron liritë dhe të drejtat e të dyshuarit. Këto dy role, në aspektin psikologjik, nuk përputhen: është e pamundur të jesh neutral dhe i paanshëm, në gjykim, kur ke marrë pjesë në mënyrë aktive në hetimet për të dyshuarin. Për këtë arsye, ekziston dyshimi se gjykatësi hetues slloven anon më

shumë kah prokuroria, d.m.th., identifikohet më shumë me rolin e tij parësor hetues. (Stubs, 2014:60).

Struktura më e rëndësishme institucionale në parandalimin e korrupsionit në Slloveni është Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit, i themeluar në vitin 2004, në bazë të ligjit për integritet dhe parandalim të Korrupsionit (*Zakon o integriteti in preprečevanju korupcije*). Komisioni ka ngjashmëri të madhe me Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK) të Kosovës, për sa u përket kompetencave dhe fushëveprimit.

Ky Komision u themelua si një organ i pavarur, me mandat për të reduktuar dhe parandaluar korrupsionin në të dy sektorët, atë privat dhe publik. Ai ka funksione koordinuese, analitike dhe parandaluese. Nuk ka kompetenca tradicionale hetuese apo ndjekëse, por detyruese administrative në fushën e deklarimit të pasurisë dhe parandalimin e konfliktit të interesit. Gjithashtu, ai është organ qendror për bashkëpunim ndërkombëtar dhe bashkëpunim me sektorin joqeveritar në fushën e parandalimit të korrupsionit.(OECD, 2008:125).

Sipas ligjit slloven ‘për integritet dhe parandalim të korrupsionit’, termi “korrupsion” nënkupton çdo shkelje të procedurës së rregullt nga zyrtari dhe personat përgjegjës në sektorin publik apo privat, si dhe sjelljen e personave që nxisin shkeljet apo personat që mund të përfitojnë nga shkelja, me qëllim të përfitimit, direkt apo indirekt, të premtuar apo të dhënë, të kërkuar, të pranuar apo të pritur, për vete apo për ndonjë person tjetër.”(Neni 4, ZIntPK)

Gjithashtu, ky Komision është i autorizuar për parandalimin e konfliktit të interesit, për deklarimin e pasurisë dhe për mbrojtjen e informatorëve. Në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit, sipas ligjit për integritet dhe parandalim të korrupsionit, “zyrtari profesional, i cili mban detyrë publike, nuk mund të angazhohet në asnjë aktivitet profesional apo aktivitet tjetër me qëllim gjenerimin e të ardhurave.

Përfashtim bën angazhimi i zyrtarit publik në aktivitete pedagogjike, shkencore, hulumtimesh, artistike, sportive, kulturore dhe botuese” (neni 26).

Në fushën e deklarimit të pasurisë, Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit ka kompetenca detyruese për zyrtarët, të cilët me ligj janë të obliguar të deklarojnë pasurinë. Sipas ligjit për integritet dhe parandalim të korrupsionit neni 41, personat e obliguar për deklarim të pasurisë janë: zyrtarët profesionalë, kryetarët dhe zëvendëskryetarët, shërbyesit civilë të nivelit të lartë, menaxherët, personat përgjegjës për prokurimin publik, shërbyesit civilë të Komisionit Kombëtar të Shqyrtimit për Shqyrtimin e Procedurave të Dhënies së Prokurimit Publik dhe qytetarët e Republikës së Sllovenisë, të cilët kanë pozita në institucionet e BE, në organet e tjera të BE dhe në institucione të tjera ndërkombëtare, në të cilat janë caktuar apo zgjedhur në bazë të detyrës së përkohshme apo të propozimit nga ana e Qeverisë së Republikës së Sllovenisë apo Asamblesë Kombëtare, për të cilët obligimi i deklarimit të pasurisë nuk është i rregulluar nga ndonjë dokument i institucioneve të BE, organeve të BE apo institucioneve tjera ndërkombëtare për të cilat ata kryejnë detyrat e pozitës.

Me qëllim fuqizimin e luftës kundër korrupsionit, ligji për integritet dhe parandalimin e korrupsionit ka dispozita të veçanta për trajtimin dhe mbrojtjen e informatorëve. Neni 23 i tij thotë: “çdo person mund të raportojë rastet e korrupsionit në institucionet shtetërore, në komunitetin lokal, te bartësit e kompetencave publike apo te persona të tjerë juridikë të qeverisur nga ligjet publike apo private, praktikantët e personave fizikë për të cilat beson se përmbajnë elemente të korrupsionit, në Komision ose në autoritetet kompetente.

Ndërsa në legjislacionin e Kosovës, ndryshe nga Sllovenia, ka një ligj të veçantë për mbrojtjen e informatorëve.

Slllovenia, ndryshe nga Kosova, ka nënshkruar konventat ndërkombëtare kundër korrupsionit, si: Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, nënshkruar më 1.4.2008; Konventa e OECD (The Convention on Combating Bribery of Foreign Public Officials in International Business Transactions), hyri në fuqi më 5.11.2001; Konventa Civile Kundër Korrupsionit, ratifikuar më 17.3.2003; Konventa Penale Kundër Korrupsionit, ratifikuar më 12.05.2000 dhe Konventa e OKB-së Kundër Krimit të Organizuar Transnacional, që hyri në fuqi më 23.4.2004. (<https://www.kpk-rs.si/en/legislation-and-reports>)

Si përfundim, Republika e Slllovenisë ka një legjislacion kundërkorrupsion mjaft të mirë. Ndryshimet e fundit legjislative në vitet 2010 dhe 2011, u përqendruan në integritetin dhe parandalimin e praktikave korruptive, në konfliktin e interesit, transparencën e lobimit, mbrojtjen e informatorëve, prokurimin publik, dispozitat e ligjeve penale dhe procedurës penale. Në veçanti, përmes Aktit të Integritetit dhe Parandalimit të Korrupsionit, miratuar në vitin 2010 dhe plotësuar në vitin 2018, është krijuar një kornizë solide ligjore në mbështetje të parandalimit dhe politikës së integritetit, përcaktimin e detyrave dhe kompetencave të CPC (Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), duke mundësuar mekanizmat verifikues për zbulimin e pasurisë dhe duke përfshirë dispozitat mbi mbrojtjen e informatorëve (European Commission, 2014:2).

4.2.2 Legjislacioni i Austrisë kundër korrupsionit, në aspektin krahasimor me Kosovën

Austria është vend me demokraci parlamentare, i përbërë nga nëntë shtete federale. Është një nga vendet më të pasura dhe ka standarde të larta të cilësisë së jetës. Është anëtare e OKB-së që nga viti 1955, u anëtarësua në BE në vitin 1995 dhe pranoi valutën europiane euro në vitin 1999.

Dispozitat ligjore kundër korrupsionit në Austri janë të sistemuara në kreun XXII të Kodit Penal (*Österreichisches Strafgesetzbuch, StGB*). Kodi Penal i Austrisë (KPA) bën një ndarje të korrupsionit pasiv dhe aktiv, si në sektorin publik, edhe në atë privat. Korrupsioni i zyrtarëve të huaj është i ndaluar me të njëjtat dispozita që penalizojnë ryshfetin e zyrtarëve vendorë.

Korrupsioni pasiv në sektorin publik penalizohet në nenet 304, 305 dhe 306 të KPA. Sipas nenit 304, veprën penale të *korrupsionit pasiv* (“Bestechlichkeit”) e kryen zyrtari publik apo gjyqtari, i cili pranon ryshfet për të kryer një akt zyrtar në kundërshtim me detyrën zyrtare.

Veprën penale nga neni 305 *Pranimi i përfitimit nga zyrtari publik* (“Vorteilsannahme”) e kryen zyrtari publik, i cili kërkon apo pranon benificione, si kusht për të vepruar apo mosvepruar sipas detyrës zyrtare.

Veprën penale të korrupsionit pasiv nga neni 306 *Përgatitja e korrupsionit pasiv* apo e *pranimit të përfitimit nga zyrtarit publik* (“Vorteilsannahme zur Beeinflussung”) e kryen zyrtari publik, i cili kërkon apo pranon përfitim për vete a për tjetrin, më qëllim inicimin e kryerjes apo të moskryerjes së aktit zyrtar në kundërshtim me kompetencat e veta në të ardhmen.

Për dallim nga Kodi Penal i Austrisë, vepra penale *e përgatitjes së korrupsionit* nuk është e inkriminuar në mënyrë specifike në Kodin Penal të Kosovës. Meqenëse sipas dispozitave të KPK-së, kushdo që nuk lajmëron përgatitjen për kryerjen e një apo më shumë veprave penale nga Kreu XXXIV – *Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare* - kryen veprën penale *Moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale* (neni 385 i KPK), konsideroj se është e nevojshme që KPK të plotësohet me një dispozitë për inkriminimin e përgatitjes së veprave penale kundër korrupsionit.

Korrupsioni aktiv në sektorin publik, në KPA penalizohet në nenet 307, 307a, 307b dhe 307c. Veprën penale të korrupsionit aktiv në sektorin publik nga neni 307 *Dhënia e ryshfetit*, e kryen personi, i cili me qëllim që zyrtari publik të veprojë apo të mos veprojë në kundërshtim me detyrën zyrtare, atij apo një personi të tretë i ofron, i jep apo i premtan ndonjë përfitim. Veprën penale nga neni 307a *dhënia e përfitimit* (“Vorteilszuwendung”) e kryen personi, i cili i ofron, i premtan apo i jep zyrtarit publik apo një personi të tretë ndonjë përfitim, me qëllim që zyrtari publik të veprojë apo të mos veprojë sipas detyrë zyrtare. Veprën penale nga neni 307b *dhënia e përfitimit me qëllim ndikimi* (“Vorteilszuwendung zur Beeinflussung”) e kryen personi, i cili i ofron, i premtan apo i jep ndonjë përfitim personit zyrtar apo personit të tretë, me qëllim që të ndikojë në aktivitetin publik të zyrtarit publik.

Për dallim nga KPK, në dispozitat e KPA kundër korrupsionit publik aktiv, inkriminohet edhe ai që ofron, premtan apo jep ndonjë përfitim “personit të tretë”, ndërsa KPK këtë veprim nuk e inkriminon. Konsideroj se *premtimi, ofrimi apo dhënia e përfitimit* personit të tretë është e nevojshme të inkriminohet në KPK.

Në nenin 307c të KPA thuhet se çdokush që është i përfshirë në vepra kriminale të përcaktuara sipas neneve 304 deri 307b, nuk do të ndëshkohet, nëse – para se autoritetet mësojnë për aktin kriminal – shkelësi heq dorë nga sjellja e tij/saj apo – në rast se janë të përfshirë më shumë persona – ai/a jo pengon kryerjen apo shmang në ndonjë rast rezultatin, nëse ai/a jo dorëzon përfitimin e pranuar apo shumën ekuivalente të parave tek autoriteti gjatë vetëdenoncimit të tij/saj. “Me këtë dispozitë synohet të lehtësohet zbulimi i veprave të korrupsionit. Ky lloj mekanizmi vlen vetëm në rast të pendimit për veprat penale të korrupsionit që trajtohen në nenet 304 deri 307b” (GRECO,2011:20).

Ndërsa në KPA, për veprat penale të korrupsionit nga nenet 304 deri 307b, përcaktohet se autori, në rast pendimi, në pajtim me nenin 307c, “nuk do të ndëshkohet”, në Kodin Penal të Kosovës, neni 429.4, përcaktohet se autori i veprës “mund të lirohet nga dënimi” dhe kjo është e kufizuar vetëm në rastet kur autori ka dhënë ryshfet me kërkesë të zyrtarit publik. Nisur nga ky dallim, konsideroj se është e nevojshme që kjo dispozitë e KPK të ndryshohet: shprehja “mund të lirohet nga dënimi” të zëvendësohet me “nuk do të ndëshkohet”, duke specifikuar se në cilat rrethana mund të aplikohet kjo dispozitë.

Për sa i përket korrupsionit në sektorin privat, KPA, në nenin 309, sanksionon edhe korrupsionin pasiv, edhe korrupsionin aktiv. Në nenin 309.1, thuhet se veprën penale të *korruptionit privat pasiv* e kryen i punësuar apo përfaqësuesi i autorizuar i kompanisë, i cili kërkon, pajtohet të pranojë, pranon ndonjë përfitim për të kryer apo për të mos kryer detyrën në kundërshtim me kompetencat. Kurse veprën penale të *korruptionit privat aktiv* e kryen personi, i cili ofron, premtan apo jep ndonjë përfitim të punësuarit apo përfaqësuesit të autorizuar të kompanisë për të kryer apo për të mos kryer detyrën në kundërshtim me kompetencat.

Në Austri përbën vepër të dënueshme *dhënia e përfitimeve të parregullta* dhe *dhënia e përfitimeve të paligjshme* nga austriakët, për të ndikuar zyrtarët publikë joaustriakë jashtë vendit, pavarësisht nëse akti është vepër penale sipas ligjit të shtetit të huaj në fjalë. Nëse dhënia e ryshfetit është bërë jashtë vendit nga një shtetas austriak, në favor të zyrtarit publik austriak (neni 64.2a), ky akt përbën krim sipas ligjit austriak, pavarësisht nëse kjo përbën vepër penale edhe sipas ligjit të shtetit të huaj, ku është kryer vepra (neni 64.1, StGB). “Përfitimi nënkupton pagesat, artikuj më vlerë, çfarëdo lloj shërbimi dhe çfarëdo lloj përfitimi social apo profesional. Përfitimi, sipas KPA mund të jetë material apo përfitim jomaterial” (Wess, Kispert, 2016:34).

Ndërsa Kosova vuan nga fragmentimi i mekanizmave kundër korrupsionit, Austria, e cila ka një praktikë të mirë në këtë aspekt. Ajo ka dy agjenci qendrore të specializuara për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të korrupsionit: Byroja Federale e Anti-Korrupsionit (Bundesamt zur Korruptionsprävention und Korruptionsbekämpfung – BAK) dhe Zyra e Prokurorit Publik për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (Zentrale Wirtschafts - und Korruptionsstaatsanwaltschaft - WKStA).

Byroja Federale e Antikorrupsionit funksionon në kuadër të Ministrisë Federale të Punëve të Brendshme, si pasardhëse e Byrosë Federale të Punëve të Brendshme, të themeluar në vitin 2001. Si institucion i Ministrisë së Brendshme, BAK është krijuar jashtë Drejtorisë së Përgjithshme për Siguri Publike. Ajo ka juridiksion mbi hetimet e policisë lidhur me veprat penale dhe është përgjegjëse për kontaktet ndërkombëtare për rastet që kërkojnë bashkëpunimin ndërkombëtar policor. E pajisur me kompetenca hetimore dhe me juridiksion mbarëkombëtar për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, BAK heton akuzat për korrupsion në sektorin publik, ankesat e bëra ndaj punonjësve të Ministrisë Federale të Punëve të Brendshme dhe të departamenteve në varësi të saj, si dhe kryen hetime lidhur me shpërdorimin e detyrës (Ligji Federal mbi Themelimin dhe Organizimin e Byrosë Federale të Antikorrupsionit (BAK-G), BGBl.I No.72/2009)

Fushëveprimi i Byrosë Federale përfshin:

- Parandalimin – mes të tjerave, analizën e korrupsionit si fenomen dhe marrjen e masave të përshtatshme parandaluese;
- Edukimin - përmes shpërndarjes së informacionit dhe arsimimin për çështjet e ndërgjegjësimit;
- Masa represive - në kuptimin e sigurisë dhe hetimet e krimit

- Bashkëpunimin - me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, që janë të angazhuara në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit dhe shkëmbimin e praktikave të mira. http://www.bak.gv.at/cms/BAK_dt/aufgaben/start.aspx

Ndjekja penale e veprave të korrupsionit, si në sektorin publik, ashtu edhe në sektorin privat, ushtrohet nga prokurori publik, i cili, sipas Kodit të Procedurës Penale të Austrisë, është autoriteti kompetent për hetime. Për plotësimin e nevojave për prokuror të specializuar në fushën e korrupsionit, ligjvënësi austriak krijoi WKStA-në, në Vjenë, e cila është prokurori speciale për hetimin e krimeve ekonomike dhe të korrupsionit. (Wess, Kispert, 2016:35)

Për çështjet penale që hetohen nga WKStA, procedura penale zhvillohet në Gjykatën Penale të Vjenës (Landesgericht für Strafsachen Wien), pranë të cilës janë krijuar disa zyra të veçanta, me gjyqtarë me përvojë dhe njohuri të veçanta për shqyrtimin në mënyrë të përqendruar dhe efikase çështjet penale të këtij lloji.

Ndërsa në Kosovë kemi Prokurorinë Speciale (PSRK), e cila është kompetente për hetimin e çështjeve të korrupsionit. Por kjo dallon nga prokuroria austriake (WKStA) në dy çështje: *e para*, PSRK fokusohet më tepër në hetimin e krimeve të luftës, ndaj prokurorët e caktuar në Departamentin Kundër Korrupsionit ngarkohen me çështje të ndryshme. *E dyta*, Kosova nuk ka gjykatë të veçantë që të gjykojë çështjet e korrupsionit të nivelit të lartë, çështjet penale të PSRK gjykohen nga Departamenti për Krime të Rënda pranë gjykatave themelore.

Mendoj se është e domosdoshme që, në Kosovë, në Gjykatën Themelore të Prishtinës të krijohet një Departament Kundër Korrupsionit, i cili të gjykojë çështjet e hetuara nga PSRK, kurse brenda kësaj të fuqizohen kapacitetet e Departamentit Special Kundër Korrupsionit dhe prokurorët të profilizohen dhe të përqendrohen vetëm në çështjet e korrupsionit.

Për rritjen e efikasitetit në luftimin e korrupsionit, Austria ka synuar të përmirësojë kuadrin ligjor për mbrojtjen e informatorëve, por nismat e saj në këtë drejtim ende nuk kanë çuar në miratimin e një ligji të veçantë. Por ajo ka një dispozitë në Ligjin për Shërbimin Civil, që ndalon kryerjen e veprimeve të dëmshme kundër një shërbyesi publik, i cili në mirëbesim raporton një krim. Është detyrim i përgjithshëm që nëpunësit civilë të raportojnë krimet. (European Commission, 2014:7). Në aspektin praktik, informatorët (*wistlerblower*) kanë mundësi shumë të mira të njoftojnë për veprat penale, duke mbetur plotësisht anonimë.

“WKStA tani menaxhon sistemin e raportimit në *web*, ku mund të paraqiten raporte anonime dhe ku është i mundur komunikimi mes informatorit dhe autoriteteve dhe të dhënat identifikuese të informatorit nuk mund të ndiqen nga autoritetet”(European Commission, 2014:7).

Sugjeroj që një praktikë e tillë të ndiqet edhe në Kosovë.

Austria ka nënshkruar Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, Konventën e OECD, Konventën Civile Kundër Korrupsionit dhe Konventën Penale Kundër Korrupsionit. Sipas Eurobarometrit 2013, ajo konsiderohet ndër vendet më të vlerësuara për efektet parandaluese të ndjekjeve penale të suksesshme në rastet e korrupsionit. Kjo mund të jetë shkak i vëmendjes së mediave në punën e WKStA, si dhe i raporteve të rregullta mbi aktivitetet e BAK (European Commission, 2014:5).

4.2.3 Legjislacioni i Serbisë kundër korrupsionit, në aspektin krahasimor me Kosovën

Legjislacioni i Serbisë, sikurse ai i Sllovenisë dhe i Kosovës, ka qenë pjesë e legjislacionit të ish-Jugosllavisë, kështu që ato kanë tradita të ngjashme ligjore dhe

gjyqësore nga e kaluara. Niveli i korrupsionit në Serbi është relativisht i lartë, sikurse në vendet tjera ballkanike.

“Korrupsioni, si dukuri negative shoqërore, është i pranishëm në çdo sistem dhe nuk ekziston shtet që nuk ballafaqohet me këtë lloj kriminaliteti. Megjithatë, ndryshimi ekziston në shtrirjen e tij dhe në aftësitë e aparatit shtetëror që t’i kundërvihet ndikimit të tij në poret më të thella të shoqërisë” (Antonijevic, 2013:8).

Legjislacioni bazë i Serbisë në luftimin e korrupsionit përfshin: Kodin Penal të Serbisë (KPSrb), Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit, si dhe ligje të tjera në funksion të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, si: Ligji për qasjen e lirë në informatat me rëndësi publike; Ligji për organizimin dhe kompetencat e organeve shtetërore për luftën kundër krimit të organizuar; Ligji për bazën e themelimit të shërbimeve të sigurisë; Ligji për Agjencinë e Sigurisë-Informacionit; Ligji mbi konfiskimin e pasurisë së fituar nga vepra penale dhe Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Në kreun 33, Kodi Penal i Serbisë ka dispozitat ndëshkuese ndaj veprimeve kundër detyrës zyrtare. Kapitulli ka 11 nene, dy më pak se kapitulli përkatës i KP i Kosovës. Ai parashikon si vepra penale që përmbajnë elemente të korrupsionit: *Marrja e mitës*(neni 367); *Dhënia e mitës*(neni 368); *Keqpërdorimi i pozitës zyrtare* (neni 359); *Shkelja e ligjit nga ana e gjyqtarëve, prokurorëve publikë dhe zëvendësve të tyre*(neni 360); *Ushtrimi i ndikimit*(neni 366).

Tek ky grup i veprave penale, KPSrb nuk ka dallime përmbajtësore nga Kodi Penal i Kosovës. Përjashtim paraqet nenin 361 i KPSrb, i cili e sheh *shkeljen e detyrës* si vepër më vete. Neni sanksionon veprimet që shkelin ligjin, rregullat apo aktet e përgjithshme; dështimet në udhëheqjen e detyrës apo neglizhencën në detyrë; gjithashtu, parashikon që personi është i vetëdijshëm apo kërkohet të jetë i vetëdijshëm apo duhet të ketë qenë i vetëdijshëm se ky akt mund të shkaktojë shkelje serioze të të drejtave apo dëm material.

Për veprën penale *dhënie ryshfeti zyrtarit të huaj* KPSrb nuk ka nen të veçantë, por ajo është përfshirë në nenin 368, par.3. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen edhe kur ryshfeti i është dhënë, ofruar apo premtuar *personit të huaj zyrtar*.

Ndryshe nga KPK, në nenin 367, par.5, parashikon se personi i huaj zyrtar që kryen veprën nga paragrafët 1 deri 4 të këtij neni, do të dënohet me dënimin e parashikuar për këtë vepër. Gjithashtu, zyrtari huaj mund të dënohet për veprën penale të *ushtrimit të ndikimit* (neni 366), sipas të cilit, personi i huaj zyrtar që kryen veprën nga paragrafët 1 dhe 4 të këtij neni, do të dënohet me dënimin e parashikuar për këtë vepër.

Konsideroj që në ndryshimet e ardhshme, Kodi Penal i Kosovës duhet të pasurohet me të tilla dispozita

Sipas KPSrb, veprat penale që mund të kryhen lidhur me korrupsionin janë: *Puna e pandërgjegjshme në shërbim*(neni 361); *Pagesat e kundërligjshme*(neni 362); *Shfrytëzimi i papërcaktuar i mjeteve buxhetore*(neni 362a); *Mashtrimi në shërbim* (neni 363); *Shpërdorimi*(neni 364); *Përvetësimi*(neni 365); *Zbulimi i sekretit zyrtar* (neni 369)” (Antonijsi, 2013:12-14).

Për sa u përket organeve të ndjekjes penale, legjislacioni në Serbi është shumë i ngjashëm me atë të Kosovës. Policia ushtron kompetencat në bazë të Ligjit të policisë dhe ligjeve të tjera. Në kuadër të policisë është themeluar SBPOK (*Služba za Borbu Protiv Organizovanog Kriminala*), si strukturë organizative e veçantë kundër krimit të organizuar. Përmes njësive të saj të specializuara, SBPOK merret me luftimin e të gjitha formave të krimit të organizuar të njohura deri tani: kontrabandimi me narkotikë, trafikimi i njerëzve dhe migrimi ilegal, kontrabandimi i armëve dhe eksplozivëve, kontrabandimi ndërkombëtar i mjeteve motorike të vjedhura, rrëmbimet, shtrëngimet, shantazhet me elemente të krimit të organizuar, pastrim parash, korrupsioni, falsifikimi i

kartëmonedhave, mashtrimet me kartat për pagesa, krimi i teknologjisë së lartë (veprat penale që kanë të bëjnë me shpërdorimin e sistemit kompjuterik, shpërdorimi dhe shkelja e të drejtave intelektuale të pronësisë, pornografia me fëmijë).

[http://arhiva.mup.gov.rs/cms lat/UKP.nsf/sbpok. h?OpenPage](http://arhiva.mup.gov.rs/cms%20lat/UKP.nsf/sbpok.h?OpenPage)

Legjislacioni i Serbisë, me ndryshimet e fundit, nuk e trashëgoi institucionin e gjyqtarit hetues sikurse Sllovenia, por ngjashëm me Kosovën, atje figuron gjyqtari i procedurës paraprake.

Prokuroria publike në Serbi është e organizuar dhe ushtron kompetencat në bazë të Ligjit për Prokurorinë Publike (Zakon o Javnom Tuzilaštvu, "Sl.glasnik RS", br.116/2008 i 104/2009). Sipas nenit 13 të këtij ligji, Prokuroria Publike përbëhet nga: Prokuroria Publike e Republikës, Prokuroria Publike e Apelit, Prokuroria e Lartë Publike, Prokuroria Themelore Publike dhe Prokuroritë Publike me kompetenca të veçanta (Prokuroria për Krimin e Organizuar dhe Prokuroria për Krime Luftë).

Prokuroria Publike e Republikës, Prokuroria për Krimin e Organizuar dhe Prokuroria për Krime Luftë i kanë selitë në Beograd. Prokuroria Publike e Apelit formohet për juridiksionin e Gjykatës së Apelit. Prokuroria e Lartë Publike formohet për juridiksionin e Gjykatës së Lartë, ndërsa prokuroritë themelore publike ngrihen për juridiksionin e gjykatës themelore.

Republika e Serbisë, sikurse Sllovenia dhe Kosova, ka themeluar Agjencinë Kundër Korrupsionit, në bazë të Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit (*Zakon o Agenciji za Borbu Protiv Korupcije "Sl.glasnik RS",br.97/2008 i 53/2010*). Me këtë ligj rregullohen: formimi, pozita juridike, kompetencat, organizimi dhe mënyra e punës së Agjencisë për luftën Kundër Korrupsionit, rregullat që kanë të bëjnë me parandalimin e konfliktit të interesit gjatë kryerjes së funksioneve publike dhe deklarimin e pasurisë për personat që kryejnë funksione publike, procedura dhe marrja e vendimit në rast të

shkeljes së këtij ligji, zbatimi i planeve të integritetit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme për punën e agjencisë.

Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit e përkufizon korrupsionin si marrëdhënie e cila bazohet në keqpërdorimin e pozitës, respektivisht, të detyrës zyrtare apo ndikimin në sektorin publik apo privat, me qëllim arritjen e përfitimit personal apo për të tjerët (neni 2).

Agjencia, i raporton për punën e vet Kuvendit. Ajo nuk është në varësi të ndonjë institucioni tjetër. Kështu, ngjashëm me Agjencinë Kundër Korrupsionit në Kosovë, sigurohet një pavarësi më e plotë. Sikurse në Kosovë, edhe kjo Agjenci në Serbi udhëhiqet nga drejtori, detyrat e të cilit janë përcaktuar nga Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Drejtori përfaqëson Agjencinë, udhëheq punën e saj, organizon dhe siguron kryerjen e punëve të agjencisë në përputhje me ligjin dhe në mënyrë efikase; merr vendime në lidhje me shkeljet e këtij ligji dhe shqipton masat; jep mendime dhe udhëzime për zbatimin e këtij ligji; përgatit raportin vjetor për punën e agjencisë; përpilon projektbuxhetin e agjencisë, nxjerr akte të përgjithshme dhe të veçanta; vendos për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të punësuarve në agjenci; zbaton vendimet e bordit të agjencisë dhe kryen punë të tjera të parashikuara me ligj (neni 15).

Drejtori i agjencisë zgjidhet nga Bordi i Agjencisë, ndryshe nga Kosova, ku ai zgjidhet drejtpërdrejt nga parlamenti, me votim të fshehtë. Mendoj se në këtë rast Kosova përfaqëson një praktikë më të mirë në drejtim të mbrojtjes së pavarësisë së Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Strategjia Kombëtare Antikorrupsion në Republikën e Serbisë për periudhën 2013-2018 është dokumenti më i rëndësishëm strategjik për luftën kundër korrupsionit. Plani i Veprimit për Zbatimin e kësaj Strategjie për periudhën 2013–2018 është miratuar në përputhje me synimet e që ka kjo Strategji. Përgjegjësitë e Agjencisë Kundër

Korrupsionit janë: mbikëqyr zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit(neni 62) dhe, sipas Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit, ndjek deklarimet e pasurisë(neni 43), të dhuratave(neni 39) dhe konfliktet e interesit (neni 27).

Republika e Serbisë, ndryshe nga Kosova, ka ratifikuar konventat më të rëndësishme ndërkombëtare kundër korrupsionit, si Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, Konventën Penale Kundër Korrupsionit, Protokollet shtesë të Konventës Penale Kundër Korrupsionit dhe Konventën Civile Kundër Korrupsionit.

KREU V: ANALIZË E TË DHËNAVE RRETH VEPRAVE PENALE TË KORRUPSIONIT TË KRYERA NGA PUNONJËSIT E POLICISË SË KOSOVËS

5.1 Realizimi i kërkimit empirik dhe burimet e informacionit

Në këtë kapitull do të merremi me analizën e të dhënave që mundëm të sigurojmë nga raportet vjetore të Inspektoratit Policor të Kosovës, nga strukturat drejtuese të Policisë së Kosovës, lidhur me hetimet penale ndaj zyrtarëve të PK-së që janë kryer ndaj punonjësve të policisë në periudhën që po shqyrtojmë. Gjithashtu, këtu do të bëjmë edhe analizën e të dhënave sasiore të përfuara nga anketimi i zhvilluar, lidhur me perceptimin e punonjësve të policisë mbi korrupsionin, mbi integritetin policor dhe mbi veprat penale të kryera nga zyrtarë të ndryshëm të policisë. Kemi operuar vetëm me këto burime, pasi, siç e kemi përmendur, pas çlirimit të Kosovës, në fillim këto probleme janë mbuluar nga policia e UNMIK-ut, nga njësitë e tij hetimore, qendrore dhe rajonale, dhe janë gjykuar nga gjyqtarë ndërkombëtarë, që vepronin në kuadër të UNMIK-ut dhe, më pas, të EULEX-it, të cilat nuk përgjigjeshin para institucioneve vendore të pushtetit gjyqësor. Dosjet e hetimeve penale të zhvilluara në atë periudhë nuk kemi mundur t'i sigurojmë, sepse kanë qenë të shpërndara në njësi dhe gjykata të ndryshme dhe mungonte një sistem i integruar i të dhënave. Kjo ishte një ndër vështirësitë në sigurimin e të dhënave statistikore për hetimet e veprave penale në të cilat janë përfshirë zyrtarë të PK-së para vitit 2010.

Për të realizuar kërkimin në terren të të dhënave empirike për problematikën e studimit dhe për analizën e tyre jemi mbështetur në burime të ndryshme teorike, në studime dhe botime të kësaj fushe, si dhe në dokumente të rëndësishme, në raporte të organizmave dhe institucioneve ndërkombëtare dhe të Kosovës. Po ashtu, organizuam

në terren një anketim me punonjës të këtij sektori, lidhur me perceptimin e tyre për korrupsionin dhe veprat penale, që kryhen në radhët e policisë. Kjo ishte e domosdoshme, pasi, pa bërë lidhjen e teorisë me praktikën në terren, nuk mund të arrihet në përfundime të sakta dhe të drejta shkencore. Siç shihet edhe në kapitujt përkatës, ne jemi konsultuar me literaturën e huaj dhe vendase të botuar, me legjislacionin e kësaj fushe, madje, duke e krahasuar edhe me legjislacionin e disa vendeve. Mbi bazën e këtyre burimeve është bërë trajtimi teorik dhe juridiko-penal i dukurisë së korrupsionit dhe të veprave penale, në përgjithësi, si dhe në analizën e të dhënave lidhur me situatën e Kosovës në këtë fushë.

Metodologjia e përdorur për kërkimin empirik dhe metodologjia e analizës së të dhënave të përftuara nga hulumtimi u përzgjedhën mbështetur në burime teorike dhe në përputhje me qëllimin dhe objektivat e studimit. Në bazë të tyre u përzgjedh metoda e anketimit, me pyetësor; u formulua edhe pyetësi, me pyetje, që do të shërbenin për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe për të vërtetuar hipotezat e studimit. Të anketuarit u përzgjedhën nga radhët e policisë me metodën e përdorimit të mostrës së përzgjedhur në mënyrë rastësore. Pyetësi iu shpërnda njëqind zyrtarëve policorë, të moshave të ndryshme, nga të gjitha rajonet e Kosovës, pavarësisht përkatësisë etnike, gjinore apo gradës. Për matjen e variablaveve zgjedhëm shkallëzimin e Likertit, prej 3 pikësh, me këto modalitete përgjigjesh: "Pajtohem", "Nuk pajtohem" dhe "Pjesërisht pajtohem". Mendojmë se këto i përmbahen parimit të shkallëzimit të qëndrimeve.

Por në sigurimin e informacioneve kemi hasur edhe në disa vështirësi. Konkretisht, për këtë periudhë nuk janë gjetur të dhëna për numrin rasteve nga fusha e *korupsionit zyrtar* të referuara në prokurori dhe për numrin e aktakuzave të ngritura nga prokuroritë kompetente. Gjithashtu, nuk janë gjetur të dhëna për numrin e punonjësve të PK-së të shpallur fajtorë me vendim të formës së prerë.

Të dhënat e përftuara nga literatura dhe burimet dokumentare, si dhe ato nga pyetësi u analizuan, u krahasuan dhe u interpretuan nga ana teorike dhe praktike, për të nxjerrë përfundimet përkatëse. Për t'i bërë më të kapshme rezultatet, kemi përdorur tabela dhe grafikë, që mendojmë se e lehtësojnë perceptimin e dinamikës së dukurive të vrojtuar.

5.2 Analiza e rasteve të hetuara nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK)


Me fuqizimin e kapaciteteve të PK-së dhe me pavarësimin e njësive rajonale të hetimeve, gradualisht, njësitë hetimore të PK-së janë ngarkuar me hetimin penal të punonjësve të saj. Ky Inspektorat u krijua në vitin 2006 dhe, kështu, u bë e mundur që edhe në këtë fushë të vepronin strukturat vendore. Fillimisht, Inspektorati ka pasur pak kompetenca dhe mund të hetonte jo veprat penale, por vetëm shkeljet e rënda disiplinore. Ndërsa me hetimin e shkeljeve të lehta disiplinore merrej DSP-ja.

Me ndryshimet e Ligjit për IPK-në ndryshuan edhe kompetencat e Inspektoratit. Me këtë ligj, IPK-ja kryen hetime penale ndaj zyrtarëve të PK-së, kur dyshohet se janë të përfshirë në vepra penale, si edhe hetime disiplinore për zyrtarët me pozita ekzekutive dhe për ata me grada të larta në PK.

5.2.1 Trendi i ankesave të pranuar nga IPK

Bazuar në raportet vjetore të IPK-së, numri i përgjithshëm i ankesave ndaj sjelljes së punonjësve të PK-së, të evidencuara nga IPK-ja në periudhën 2010-2015, është 6503 ankesa për çështje disiplinore dhe penale. Sipas viteve, këto paraqiten në grafikun 1.

Grafiku 1: Trendi i ankesave në vitet 2010-2015



Nga paraqitja grafike vihet re se pas vitit 2010 kemi një dyfishim të ankesave të pranuara dhe se deri në vitin 2015 shifrat e tyre mbeten përafërsisht në këtë nivel. Kjo tregon, si për shtimin e sjelljeve devijante të punonjësve të policisë, ashtu edhe për rritjen e ndërgjegjësimin të qytetarëve të Kosovës për të denoncuar veprimet e policëve, që ata i gjykojnë të padrejta. Njëkohësisht, pranimi i këtyre ankesave dhe shqyrtimi i tyre ndikojnë në rritjen e besimit të qytetarëve te strukturat e PK.


Kuptohet, nga këto ankesa të qytetarëve të pranuar nga IPK-ja, jo të gjitha kanë pasur elemente të veprës penale, ndaj ato i janë referuar DSP-së për hetime disiplinore. Ndërsa ankesat ndaj zyrtarëve të lartë ekzekutivë të policisë i ka shqyrtuar vetë IPK.

5.2.2 Trendi i rasteve penale të evidencuara nga IPK-ja

Duke qenë se sipas ligjit, kompetencat e IPK-së për hetime penale kanë hyrë në fuqi nga qershori i vitit 2011, në këtë vit ka filluar dhe funksionimi i tij. Nga të dhënat rezulton se në periudhën 2011-2015, IPK-ja ka regjistruar gjithsej 1082 çështje për vepra të ndryshme penale. Duke i paraqitur sipas viteve, vëmë re se, ndërsa në vitin 2011 janë evidencuar 143 raste, në vitin 2012 numri i tyre është rritur më shumë se dy herë, duke arritur në 292 raste, shifër kjo që është më e larta në tërë periudhën. Në vitet 2013 dhe 2014 kemi rënie të rasteve të regjistruara, ndërsa në vitin 2015 kjo rënie është

edhe më e madhe. Gjithsesi, shifra prej 173 rastesh penale të evidencuara në këtë vit, përsëri, është më e lartë se ajo e vitit 2011. Këto shifra flasin për një shtim të numrit të punonjësve të policisë të dyshuar për kryerjen e veprave të ndryshme penale.


Grafiku 2: Rastet e veprave penale të evidencuara në IPK në periudhën 2011-2015



5.2.3 Numri i punonjësve të PK-së subjekte të hetimeve penale

Në këtë periudhë, për vepra të ndryshme penale, subjekte të hetimeve penale nga IPK-ja kanë qenë 1379 punonjës të PK-së. Kjo shifër është më e madhe, sesa numri i çështjeve penale të regjistruara (1082), pasi mendohet se ka pasur edhe çështje ku janë të përfshirë më shumë se një person.


Grafiku 3: Numri i punonjësve policorë subjekt i hetimit penal në periudhën 2011-2015



Siç shihet, pas vitit 2011 kemi një rritje prej më shumë se dy herë të numrit të punonjësve të PK-së që kanë qenë subjekte të hetimit penal. Kjo rritje është shqetësuese. Në vitet që pasojnë ka rënie të numrit të punonjësve të PK-së që kanë qenë subjekte të hetimit penal. Ky fakt, sigurisht, është pozitiv, por duhet thënë se problemi përsëri mbetet i mprehtë, pasi shifra e vitit 2015 është më e lartë se ajo e vitit 2011. Kjo dinamikë në rritje e hetimeve penale ndaj punonjësve të policisë, dikton nevojën që ky problem të vlerësohet si duhet dhe në vazhdimësi, me qëllim marrjen e masave efektive për parandalimin e veprimeve të paligjshme nga zyrtarët policorë të të gjitha niveleve.

Për ta perceptuar edhe më mirë dinamikën e numrit të punonjësve policorë që kanë qenë subjekte të hetimit penal në periudhën në fjalë, në grafikun e mëposhtëm po e paraqesim situatën në përqindje.

Grafiku 4: Numri i punonjësve policorë subjekte të hetimit penal, shprehur në përqindje



Kjo paraqitje grafike na e jep në mënyrë më të dukshme rritjen e madhe që patën shifrat në vitin 2012 (5%), si dhe rënien graduale të tyre deri në vitin 2015 (2.45%). Me interes këtu është të shihen shkaqet dhe faktorët e asaj rritjeje të menjëhershme dhe të uljes së numrit të punonjësve të PK-së që janë hetuar penalisht.

Gjithashtu, duhet theksuar se nga rastet e evidencuara, janë dorëzuar në prokuroritë kompetente gjithsej 541 raste dhe janë kryer gjithsej 92 arrestime të punonjësve të PK-së nga hetuesit e IPK-së. Kjo flet për një punë serioze nga strukturat përkatëse dhe ndëshkimet e dhëna tregojnë se ka vullnet për të mos toleruar shkeljet e ligjit nga zyrtarët e policisë. Forca goditëse ndaj këtyre shkeljeve të rënda luan një rol të madh në parandalimin e veprave penale në radhët e policisë, por, gjithashtu, ndihmon edhe në pastrimin e efektivit të policisë nga elementët e padëshiruar dhe në përmirësimin e përbërjes së personelit të saj.

5.2.4 Llojet më të shpeshta të veprave penale të hetuara ndaj punonjësve të PK

Hetimet penale që janë iniciuar ndaj punonjësve të PK-së janë bërë për vepra të paligjshme nga më të ndryshmet, të sanksionuara me KPK. Duke iu referuar punimeve të autorë të huaj, kemi konstatuar një ngjashmëri të këtyre veprave penale në Kosovë me llojet e veprave penale të kryera nga zyrtarë policorë të vendeve të ndryshme.

Nga shikimi i këtyre hetimeve, vihet re se jo të gjitha rastet e inicuar kanë përfunduar me aktakuzë, dhe jo të gjitha rastet për të cilat është ngritur aktakuzë kanë përfunduar me shpallje fajtorë dhe me dhënie dënimesh. Por pavarësisht nga kjo, vetë inicimi i hetimeve për shkelje penale është një tregues që në Policinë e Kosovës ka punonjës që shkelin ligjet, gjë që dëmton imazhin e saj. Kjo bëhet më e dukshme edhe nga fakti se hetimi i zyrtarëve policorë për kryerje veprash penale apo për përfshirje në çfarëdolloj afere korruptive ndiqet dhe pasqyrohet me publicitet të madh nga mediat. Edhe në Kosovë, mediat shpeshherë publikojnë lajme dhe shkrime për përfshirje të zyrtarëve të PK-së në veprime kriminale. Këto njoftime krijojnë në publik një opinion negativ, jo thjesht për persona që përmenden, por edhe për vetë policinë. Komente të tilla, si: “Të përfshirë në keqpërdorim të detyrës zyrtare, marrje ryshfeti, falsifikime të

dokumenteve zyrtare e gjëra të tjera jo të mira, disa zyrtarë policorë të Kosovës duket se po i japin një hije të zezë këtij institucioni” (Kosova Sot, 2014:11), lënë një shije të hidhur në opinionin publik, por edhe në vetë efektivin e policisë, pjesa dërmuese e të cilit përbëhet nga njerëz të ndershëm dhe të përkushtuar ndaj detyrës dhe funksionit të mbrojtjes dhe të zbatimit të ligjit. Edhe raportime si ai gazetës Bota Sot (2013:6), që shkruante se “numri më i madh veprave penale që kanë kryer policët gjatë vitit paraardhës (2012) ishte për lëndime të lehta trupore, rrezikim të trafikut publik, shpërdorim i detyrës zyrtare ose i kompetencave, marrje dhe dhënie ryshfeti e vepra tjera” e dëmtojnë shumë imazhin e policisë, por dhe trondisin besimin e qytetarëve ndaj uniformave blu, që, në fakt, duhet të jenë në luftë të vendosur kundër veprimeve të kundërligjshme.

Nga të dhënat e siguruar nga PK-ja dhe IPK-ja rezulton se llojet më të shpeshta të veprave penale të hetuara në radhët e punonjësve të PK-së janë: veprat penale të korrupsionit, aksidentet, lëndimet e lehta trupore, kanosje, përvetësim i pronës gjatë detyrës, posedim apo përdorim i paautorizuar i armëve, pranim i ryshfetit, kontrabandë me mallra, falsifikim dokumentesh, dhënie e ryshfetit etj. Të dhënat sasiore të veprave penale më të shpeshta në periudhën që studiojmë, po i japim më poshtë, në tabelën nr.1.

Tabela 1: Llojet më të shpeshta të veprave penale të evidencuara në polici

Nr.	Veprat penale	Numri i rasteve të evidencuara
1	Korrupsion zyrtar	325
2	Rrezikim i trafikut publik	197
3	Lëndim i lehtë trupor	167
4	Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare	122
5	Kanosje	89

Burimi: Policia e Kosovës

Të dhënat sasiore më të detajuara sipas llojeve të veprave analizohen më poshtë, duke parë dinamikën e tyre sipas viteve, me qëllim që të dalë më i qartë dhe më i plotë perceptimi për dukurinë e korrupsionit në Policinë e Kosovës.


5.3 Hetimet penale të iniciuara ndaj zyrtarëve të PK për korrupsion zyrtar

Hetimet penale kundër zyrtarëve të PK-së janë inicuar në mënyrë të vazhdueshme dhe me intensitet të ndryshëm nga viti në vit. Nga 1289 raste penale të evidencuara në periudhën 2010-2015, 325 raste apo 25% janë nga fusha e korrupsionit zyrtar.

5.3.1 Dinamika e veprave penale të korrupsionit zyrtar, në vitet 2010-2015

Dinamika e këtyre veprave në vite është e tillë që ato kanë ardhur në rritje. Ndonëse në ndonjë vit ato janë ulur, shohim që në krahasim me vitin 2010, numri i tyre është shumë më i madh. Ndërsa në vitin 2010, ka pasur 31 raste, në vitin 2011 kemi 40 raste, në vitin 2012 kemi 58 raste, në vitin 2013 kemi 51 raste, në vitin 2014 kemi 83 raste dhe në vitin 2015 kemi 62 raste. Siç shihet edhe nga grafiku, në vitin 2014 shënohet numri më i madh, afro trefishi i vitit 2010, kurse në vitin 2015 është dyfishi i veprave të evidencuara në vitin 2010.

Grafiku 5: Dinamika e veprave penale të korrupsionit zyrtar, në vitet 2010-2015



Burimi: Inspektorati Policor i Kosovës

Duhet theksuar se për këtë periudhë nuk janë gjetur të dhëna se sa nga rastet e evidencuara për korrupsion zyrtar janë referuar në prokurori, sa aktakuza janë ngritur nga prokuroritë kompetente dhe sa punonjës të PK-së janë shpallur fajtorë me vendim të formës së prerë.

5.3.2 Llojet më të shpeshta të veprave të korrupsionit zyrtar

Të dhënat e paraqitura (tabela 7) tregojnë se në numrin total të veprave penale në fushën e korrupsionit zyrtar, vendin më të madh e zë “Keqpërdorim i pozitës zyrtare apo autoritetit”, me 63.6%. Kjo shifër e madhe, tregon se në radhët e policisë ka shumë veprime arbitrare gjatë kryerjes së detyrës, të cilat vijnë, ose nga mosnjohja e kompetencave, ose kryhen në mënyrë të vetëdijshme për afëra korruptive. Pas kësaj veprave penale vjen vepra penale “Marrja e ryshfetit”. Edhe numri i rasteve të marrjes së

ryshfetit nga zyrtarët e policisë, është për t'u marrë në konsideratë dhe dikton nevojën për të rritur mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi personelin.

Edhe veprat e tjera penale nga fusha e korrupsionit zyrtar, megjithëse më të pakta në numër, nuk duhen injoruar.

Tabela 2: Veprat penale nga fusha e korrupsionit zyrtar, në vitet 2010-2015

Nr. rendor	Llojet e veprave penale	Numri i rasteve të raportuara
1	Keqpërdorim i pozitës zyrtare apo autoritetit	207
2	Marrja e ryshfetit	66
3	Falsifikimi i dokumentit	26
4	Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	9
5	Mashtrimi në detyrë	6
6	Ushtrimi i ndikimit	6


Burimi: Policia e Kosovës

5.3.3 Vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Siç shihet edhe nga tabela, gjatë periudhës 2010-2015 janë evidencuar 207 raste të veprës penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, të kryera nga punonjësit e PK-së, ose 16% të numrit të përgjithshëm të rasteve penale të evidencuara. Kjo vepër penale shprehet në forma të ndryshme.

Dinamika e saj, sipas viteve, paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 6: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në vitet 2010-2015




Nga grafiku shihet se rastet e kësaj vepre penale pas vitit 2010, kanë ardhur në rritje. Më shumë raste janë regjistruar në vitin 2014 (48 raste) dhe në vitin 2012 (42 raste). Këto shifra, sipas viteve, të kësaj vepre penale, që janë disa herë më shumë se rastet e llojeve të tjera të veprave penale të regjistruara, tregojnë se ka shumë punonjës policie që abuzojnë me kompetencat dhe me autoritetin e tyre zyrtar, i keqpërdorin ato, ose nga formimi i pamjaftueshëm profesional, ose i bëjnë këto veprime me vetëdije, me qëllim, për arsye përfitimi etj.

5.3.4 Dinamika e veprës penale “Marrja e ryshfetit”

Gjatë periudhës 2010-2015 janë evidencuar 66 raste të veprës penale “Marrja e ryshfetit” ose 5.1% e numrit të përgjithshëm të rasteve penale të evidencuara. Pas veprës penale *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*, vepra penale *Marrja e ryshfetit*, zë vend të madh në numrin e përgjithshëm të veprave të raportuara në këtë periudhë. Të para sipas viteve, në grafikun e mëposhtëm, konstatohet se, në krahasim me vitin 2010, rastet e marrjes së ryshfetit nga punonjësit e policisë në vitin 2011, janë rritur tri herë (19 raste). Në vitet pasardhëse ato shënojnë ulje, por, gjithsesi, mbeten në nivel shqetësues. Në vitin 2015 ato janë rreth 2 herë më shumë se në vitin 2010. Kjo situatë tregon se, megjithë punën e bërë për rritjen e integritetit të punonjësve të policisë, mbetet shumë për të bërë në këtë drejtim, pasi kjo lloj vepre penale, përveç pasojave të tjera që sjell, godet dhe cenon personalitetin dhe integritetin e zyrtarëve policorë, si dhe ul besimin e qytetarëve te policia e shtetit.

Më poshtë po sjellim paraqitjen grafike të rasteve të veprave penale “Marrje e ryshfetit”, të raportuara sipas viteve.


Grafiku 7: Dinamika e veprës penale Marrja e ryshfetit, në vitet 2010-2015



5.3.5 Vepra penale “Falsifikimi i dokumentit zyrtar”

Gjatë periudhës 2010-2015 janë evidencuar 26 raste të veprës penale “Falsifikimi i dokumentit zyrtar”. Dinamika e saj në vite shënon vetëm rritje. Në vitin 2014 janë regjistruar 12 raste, 6 herë më shumë se në vitet 2011 dhe 2013. Prania e kësaj vepre të paligjshme, flet për dobësitë në rekrutimin e personelit, në radhët e të cilit kanë mundur të depërtojnë edhe tipa mashtrues, manipulues, që, për qëllime fitimi, guxojnë dhe nuk e kanë për gjë të ndryshojnë e të falsifikojnë dokumente zyrtare, vepër kjo e paligjshme dhe e dënueshme. Ndonëse shifrat e kësaj vepre duken jo shumë të larta, ato duhet të nxisin strukturat përgjegjëse për zbulimin dhe spastrimin nga radhët e policisë të elementëve të tillë, që me vetëdije të plotë shkelin ligjin për përfitime vetjake duke shkelur ligjet.

Grafiku 8: Dinamika e veprës penale “Falsifikimi i dokumentit zyrtar”, 2010-2015



Siç shohim në Tabelën nr.2, gjatë periudhës 2010-2015 janë evidencuar edhe lloje të tjera veprash penale të fushës së korrupsionit zyrtar, të kryera nga punonjës të policisë së Kosovës, si “Zbulimi i fshehtësisë zyrtare”(9 raste); “Mashtrimi në detyrë”(6 raste); dhe “Ushtrimi i ndikimit”(6 raste), “Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit Gjyqësor”(6 raste), si dhe disa vepra të tjera që janë kryer në numër më të vogël, të cilat, gjithashtu, nuk duhet të neglizhohen. Si të tilla, përmendim “Përvetësimi në detyrë”, “Dhënie e ryshfetit”, “Keqpërdorimi i informatës zyrtare”, “Konflikti i interesit”, “Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj”.

Për t’u shënuar është edhe fakti se gjatë periudhës 2010-2015, nuk është evidencuar asnjë rast për këto vepra penale: “Përdorimi i paautorizuar i pasurisë”, “Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme”, “Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”, që parashikohen në Kodin Penal të Kosovës. Ky fakt tregon se në Policinë e Kosovës ekzistojnë mundësitë që të mos kryhen vepra penale dhe korruptive nga punonjësit e saj. Por, sigurisht, për këtë kërkohet një angazhim më i madh i të gjitha strukturave për të punuar nga afër me punonjësit, për t’i udhëzuar dhe ndihmuar ata në

kryerjen sa më rigoroze të detyrës, në përputhje me ligjin, me kërkesat e etikës, si dhe për forcimin e kontrollit dhe të mbikëqyrjes në punën e policisë.

5.4 Analizë e të dhënave sasiore të fituara nga pyetësi lidhur me korrupsionin në PK

Në hulumtimin empirik lidhur me perceptimin e punonjësve të PK-së për korrupsionin në polici, siç e kemi vënë në dukje, përdorëm metodën e anketimit me pyetësor, prej të cilit janë grumbulluar mjaft të dhëna të rëndësishme. Nga analiza e tyre mundëm të mësojmë për qëndrimet, për njohuritë dhe për perceptimin e punonjësve të PK-së lidhur me integritetin policor, etikën, korrupsionin dhe rreth përfshirjes së zyrtarëve policorë në vepra penale.


Pyetjet e pyetësit janë formuluar në mënyrë të tillë që nga përgjigjet që do të merreshin të nxirrnim disa konkluzione për t'iu përgjigjur pyetjeve kërkimore të studimit, në funksion të vërtetimit të hipotezave që kemi ngritur. Gjithsej ishin 19 pyetje, të cilat mendojmë se e mbulojnë problematikën e studimit, për ta vrojtuar problemin në disa aspekte. Po të bëjmë një grupim të tyre, shohim që disa pyetje kanë të bëjnë me *etikën dhe integritetin policor*; disa të tjera, me predispozicionin e të anketuarve *për të raportuar rastet e veprave penale të kryera nga kolegët*. Një grup tjetër pyetjesh ka të bëjë me *masat e marra kundër punonjësve të policisë të përfshirë në vepra penale*; ka pyetje për *nivelin e korrupsionit në Policinë e Kosovës, për hetimin e shkeljeve disiplinore nga punonjësit e policisë* etj.

Mendimet e dhëna nga të intervistuarit na kanë ndihmuar për marrjen e një informacioni sa më real lidhur me domosdoshmërinë dhe mundësitë që ka në Kosovë për të luftuar dhe parandaluar veprimet korruptive dhe të kundërligjshme në radhët e policisë, për efektshmërinë e masave ndëshkimore dhe disiplinore të marra për ata

zyrtarë policie që janë përfshirë në veprime jo të ligjshme. Po ashtu, kemi mundur të krijojmë një ide për predispozicionin apo mungesën e gatishmërisë së punonjësve të policisë për të raportuar shkeljet e kolegëve të tyre; për perceptimin që kanë ata lidhur me etikën dhe integritetin e zyrtarit policor, për nevojën e trajnimit dhe të edukimit të vazhdueshëm të tyre etj.

Më poshtë po analizojmë me radhë përgjigjet e dhëna për secilën pyetje, duke e përpjekur të nxjerrim në pah edhe përfundimet përkatëse.

1. Si punonjës i Policisë së Kosovës, a jeni i kënaqur me vendin tënd të punës?




Për këtë pyetje, 83% e të anketuarve kanë dhënë përgjigje se *janë të kënaqur* me vendin e tyre të punës; 13% janë të kënaqur *pjesërisht* dhe vetëm 4% janë përgjigjur se *nuk janë* të kënaqur. E shtruar këtë pyetje, pasi kemi

parasysh që kënaqësia në punë ndikon pozitivisht në kryerjen e detyrës me korrektësi, me përkushtim, me të gjitha forcat. Nga grafiku shohim se pjesa dërmuese e të pyeturve janë përgjigjur pozitivisht, por, duke pasur parasysh se shifra relative 17% (ata që nuk janë të kënaqur) përfaqëson, në terma absolutë, afërsisht 1400 punonjës policie, del që ky problem në PK nuk duhet neglizhuar, pasi, ka nga ata që, duke mos qenë të kënaqur me vendin e punës, rrezikojnë të bien pre e sjelljeve të pahijshme, e shkeljeve administrative dhe ligjore gjatë kryerjes së detyrës.

Pakënaqësia në punë mund të vijë për shkaqe të ndryshme, që lidhen me pagën, por edhe me kualifikimin profesional e arsimor. Një punonjës policie, që nuk e sheh veten të përshtatur mirë me vendin e punës, ndihet i nënvlerësuar apo i diskriminuar.

Duke mos e pasur qetësinë dhe përqendrimin e duhur në detyrë, ai edhe mund të kalojë në veprime të dënueshme. Për të gjitha këto, mendojmë se pozicionimi i secilit në punë sipas aftësive dhe sipas përgatitjes arsimore e profesionale duhet të konsiderohet si një çështje prioritare e drejtuesve të policisë. Mendojmë që shifra e mësipërme, prej 17%, duhet të merret në konsideratë për të bërë përmirësimet e nevojshme në këtë aspekt të rëndësishëm të punës me burimet njerëzore.


2. A e keni lexuar Kodin e Etikës së Policisë së Kosovës?



Kjo është një pyetje e drejtpërdrejtë, nga e cila kërkonim një informacion të saktë për këtë problem. Rezultatet e nxjerra tregojnë se 96% e të intervistuarve e kanë lexuar Kodin e Etikës së Policisë së Kosovës dhe se vetëm 4% e tyre nuk e kanë lexuar. Fakti që

shumica dërmuese e zyrtarëve policorë janë njohur me Kodin e Etikës, pa dyshim, ndikon në ndërgjegjësimin e tyre për t'u sjellë në mënyrë sa më etike në punë. Por, nuk mund të anashkalohet këtu pyetja përse ajo pjesë e vogël e të anketuarve nuk e kanë lexuar Kodin e Etikës. A është kjo çështje e punës së strukturave drejtuese me personelin apo ka të bëjë me nivelin arsimor të punonjësve, me interesimin e tyre individual etj? Këto shkaqe duhen zbuluar dhe evidencuar, me qëllim që asnjë punonjës i policisë të mos mbetet pa i njohur dhe pa i përvetësuar standardet e etikës, që duhet të jenë në themel të sjelljeve të tyre në detyrë.


3 A keni njohuri për etikën dhe për integritetin policor?



Rezultati i përgjigjeve të kësaj pyetjeje tregon se 64% e punonjësve të anketuar kanë njohuri *të mjaftueshme*; 32% kanë *shumë* njohuri; ndërsa 4% thonë se kanë *pak* njohuri për etikën dhe për integritetin policor. Përgjigjet e

kësaj pyetjeje mbështesin besueshmërinë në përgjigjet e pyetjes nr. 3. Numri prej 4% e zyrtarëve që deklarojnë se kanë pak njohuri për etikën dhe integritetin policor korrespondon me numrin e atyre që nuk e kanë lexuar Kodin e Etikës. Mendojmë se ky problem duhet parë me vëmendje më të madhe nga strukturat drejtuese të policisë, për të bërë një punë më të frytshme për edukimin dhe formimin e personelit.

4. A keni ndjekur ndonjë trajnim specifik për integritetin policor?




Nga përgjigjet e dhëna për këtë pyetje njihemi me një situatë problematike: 64% e të anketuarve deklaruan se nuk kanë ndjekur trajnim specifik për integritetin policor, vetëm 36 % janë përgjigjur pozitivisht. Kjo tregon

se Policia e Kosovës, por edhe AKSP nuk kanë bërë sa duhet në këtë drejtim. Mendojmë se ka nevojë për më shumë përpjekje për të njohur gjendjen reale lidhur me formimin që ka personeli i policisë. Strukturat drejtuese duhet të njohin më mirë nevojat

dhe kërkesat e punonjësve për ngritjen e nivelit të tyre, jo vetëm në aspektin profesional, por edhe lidhur me integritetin dhe me imazhin që duhet të kenë, pasi kjo ndikon shumë në integritetin dhe në imazhin e vetë policisë. Ndaj, në programet e punës së tyre të përfshihen më shumë trajnime me grupe të caktuara punonjësish për integritetin policor etj.

5. A mendoni se keni nevojë për trajnim për etikën dhe integritetin policor?




Kjo pyetje lidhet me pyetjen parardhëse dhe përgjigjet e dhëna për të tregojnë se 60% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë nevojë për trajnime në fushën e integritetit policor, ndërsa 40% thonë se nuk kanë

nevojë për trajnim në këtë fushë. Këtu vëmë re një mospërputhje të vogël në përgjigjet e dhëna për të dyja pyetjet. Konkretisht, megjithëse 64% e të anketuarve nuk kishin ndjekur trajnim specifik për integritetin policor (Pyetja nr.5), këtu na del se jo të gjithë ata, por vetëm 60% kërkojnë trajnime. Po ashtu, ka një mospërputhje edhe të shifrave. Ndërsa pyetjes së mëparshme 36% i janë përgjigjur se kishin bërë trajnime, në përgjigjet e pyetjes nr.5 del se nuk kanë nevojë për trajnime 40% e të intervistuarve. Mendojmë se këto diferenca nuk kanë të bëjnë me besueshmërinë e të anketuarve, por me arsye të tjera që mund të kenë lidhje me vendin e punës, me pozitën zyrtare të të intervistuarve, me formimin shkencor profesional të tyre, me nevojën për më shumë trajnime etj.

Problemi i organizimit të trajnimeve në këtë fushë mbetet në rend të ditës, ndaj PK-ja, duke bërë identifikimin e nevojave të punonjësve, duhet të ketë prioritet në planet e saj afatgjata organizimin e trajnimeve për të gjithë punonjësit e saj.

6. A e dëmtojnë rëndë imazhin e policisë korrupsioni dhe veprat penale të kryera nga punonjësit e saj?




Megjithëse kjo pyetje e ka, si të thuash, në vetvete përgjigjen, ne e shtruam atë për të parë sa të vetëdijshëm janë të anketuarit për pasojat e veprave penale dhe korrupsionit në polici. Siç edhe prisnim, 98% u përgjigjën se

pajtohen me idenë se të tilla veprimet e dëmtojnë imazhin e PK-së, ndërsa 2% shprehin ndonjë rezervë. Ndërtimi i pyetjes nuk kërkonte që ata të shpreheshin për arsyet përse mendonin kështu, por për studimin tonë ka rëndësi fakti që të gjithë të pyeturit, pra, mbarë punonjësit e PK-së kanë vetëdijen e duhur për dëmin që i sjellin policisë korrupsioni dhe veprat penale. Kjo vetëdije duhet mbajtur gjithmonë në nivel të lartë dhe të shfrytëzohet si përparësi për ruajtjen dhe forcimin e vlerave etike brenda radhëve të policisë.

7. Në Policinë e Kosovës, a vlerësohen dhe a çmohen lart nga drejtuesit sjellja etike dhe integriteti i punonjësve?


Për këtë pyetje, 50% e të anketuarve u deklaruan pozitivisht, duke thënë se në Policinë e Kosovës sjellja etike dhe integriteti i punonjësve vlerësohen nga drejtuesit.



Por me interes janë për ne edhe përgjigjet që dha gjysma tjetër e të intervistuarve: 39% e tyre pajtohen *pjesërisht* me mendimin se këto veti të punonjësve vlerësohen,

kurse 11% shprehen prerë se drejtuesit e policisë *nuk i vlerësojnë* sjelljet etike dhe integritetin e vartësve të tyre. Ky qëndrim i 50% të të intervistuarve lidhur me këtë problem, sigurisht, ka një bazë, pasi ata, kur deklarojnë kështu, nisen nga praktika dhe nga eksperiencia e tyre, nga raste konkrete. Edhe pse nuk bëhen të ditura arsyet e këtyre deklarimeve negative, problemi meriton të merret në konsideratë, pasi diçka nuk shkon. Drejtuesit dhe strukturat përkatëse duhet të verifikojnë në praktikë nëse ka qëndrime të tilla mosvlerësuese të kuadrove drejtues ndaj vartësve dhe të identifikojnë format dhe shkaqet e shfaqjes së këtyre qëndrimeve. Punonjësit e policisë kanë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, por ata kanë nevojë edhe të mbështeten, të inkurajohen dhe të stimulohen nga drejtuesit, duke ua vlerësuar meritat, sjelljen, integritetin në forma dhe në raste të ndryshme. Kështu, ata do të motivohen më mirë dhe do të nxiten më shumë që, krahas kryerjes me korrektësi të detyrës, të sillen me etikë dhe me integritet, por edhe të mbajnë lart emrin dhe imazhin e organizatës së policisë.

8. Nëse jeni në dijeni se një koleg është përfshirë në korrupsion apo vepër tjetër penale, a ndiheni mirë nëse e raportoni?




Sipas metodologjisë së përdorur, nga përgjigjet e kësaj pyetjeje kemi këto rezultate: 59% e të anketuarve *nuk pajtohen* me pohimin se ndihen keq nëse e raportojnë kolegun e përfshirë në vepër penale. Kjo do të thotë se

ata jo vetëm nuk e kanë problem të raportojnë rastet në fjalë, por janë të predispozuar ta bëjnë denoncimin. Pjesa tjetër, 21%, *pajtohen pjesërisht* se ndihen keq dhe (20%) të tjerë deklarojnë prerë se ndihen keq, po të raportojnë kolegët për vepra penale. Nga këto rezultate, del se ka edhe punonjës policie, që, po ta themi me fjalë të zbutura, “ndihen

keq” po ta raportojnë kolegün për veprime të paligjshme, por, në fakt, ata mund edhe të ngurrojnë dhe të mos raportojnë. Kjo mund të ndodhë për disa shkaqe: ose ata tërhiqen nga vështirësitë që kanë procedurat e raportimit, ose “mbyllin njërin sy”, ose kanë frikë të raportojnë, ngaqë mendojnë se nesër mund ta pësojnë edhe vetë një gjë të tillë etj. Disa të tjerë, me indiferentizmin e tyre, mënjanojnë dhe ‘shohin punën e tyre’, ndaj nuk angazhohen për të denoncuar dhe raportuar kolegët që shkelin ligjin, megjithëse të dyja palë e kanë detyrë funksionale mbrojtjen dhe zbatimin e ligjit. Këto dukuri duhen ndjekur me kujdes nga strukturat përkatëse, pasi “dobësia” që çon në mosdenoncimin e veprave penale të kryera nga kolegët, jo vetëm nuk ndihmon në parandalimin dhe luftimin e këtyre rasteve, por rrezikon edhe që ata që nuk raportojnë të bëhen subjekte të veprave penale. Puna edukative në këtë drejtim me efektivat e policisë duhet të jetë e vazhdueshme dhe efikase, me qëllim që të krijohen kushtet dhe bindjet e nevojshme për ndryshimin e këtyre qëndrimeve. Fakti që afro gjysma e zyrtarëve ndihen keq për të raportuar shkeljet ligjore, i kontribuon forcimit të kulturës së mosraportimit të shkeljeve të ligjit policisë.

9. A është e thjeshtë dhe e përshtatshme procedura për raportimin e rasteve të veprave penale të kryera nga kolegët tuaj të punës?




E përfshimë këtë pyetje në pyetësor, duke pasur parasysh faktin se nga mënyra si janë ndërtuar, procedurat e raportimit, ose ndihmojnë, ose vështirësojnë dhe pengojnë raportimin për veprat penale që kryhen në radhët e policisë. Këtë

konstatim e mbështesin edhe përgjigjet e dhëna nga të anketuarit. Vetëm 43% pajtohen

me konstatimin se këto procedura janë të thjeshta. Ndërsa më shumë se gjysma e tyre, 57%, kanë mendim ndryshe - 44% e tyre shprehin rezerva, kurse 13% kanë mendim të prerë se këto procedura nuk janë të thjeshta dhe të përshtatshme. Në një situatë të tillë, punonjësit e policisë hasin në vështirësi për shkak të procedurave të denoncimit të kolegëve të tyre për shkelje ligjore. Dëmi këtu është i dyfishtë: edhe veprat penale të zyrtarëve policore nuk raportohen, pra, mbeten pa u zbuluar, por, nga ana tjetër, kjo dëmton edhe ata punonjës korrektë, që kanë predispozicionin për të raportuar, Ata ngurrojnë apo tërhiqen dhe nuk e bëjnë denoncimin për shkak të vështirësive apo rrethanave të sikletshme që mund të krijojnë procedurat e vendosura për raportim. Këto vështirësi mund të jenë të natyrës teknike apo administrative, por mund të jenë edhe për shkak të faktorëve kulturorë, psikologjikë, socialë etj.

Në këto kushte, kur një pjesë e mirë e punonjësve të policisë i sheh metodat e raportimit si të papërshtatshme, mendojmë se ka nevojë të analizohen në mënyrë të detajuar procedurat e komunikimit dhe të raportimit të brendshëm, të rishikohen ato, të zbulohen defektet e tyre, shkaqet e këtyre qëndrimeve dhe, njëkohësisht, të shtohen përpjekjet për përmirësimin e tyre, por edhe të formave dhe metodave të mbikëqyrjes dhe të kontrollit të brendshëm në polici.

10. A ndiheni keq të punoni me një koleg, i cili ka qenë nën hetim për përfshirje në korrupsion apo në vepër tjetër penale?




Kjo pyetje ka të bëjë me faktin që mjaft zyrtarë policorë mund të kenë qenë subjekte të hetimeve disiplinore apo të hetimeve nën dyshimin për vepër penale, por, që nuk janë

gjendur fajtorë dhe, sipas ligjit, kthehen në vendin e punës. Mirëpo kjo mund të krijojë shqetësime tek kolegët, ngaqë këta mund të kenë paragjykime për persona të tillë. Kjo gjë që reflektohet negativisht në marrëdhëniet midis tyre dhe në kryerjen e detyrave të përditshme. Ndaj menduam se kjo pyetje është në interes të këtij hulumtimi, për të njohur sa më mirë situatën që krijohet në polici në raste të tilla. Për pyetjen në fjalë, ne me pikësynim të caktuar formulua tri modalitete përgjigjesh: ”Pajtohem”, “Nuk pajtohem” dhe “Pjesërisht pajtohem” me përgjigjen: “Unë nuk ndihem mirë...”. Pritshmëria jonë u arrit. 70% e të anketuarve pohuan se *pajtohen plotësisht* se nuk ndihen mirë, kurse 23% *pajtohen pjesërisht* se nuk ndihen mirë, të punojnë me një koleg, i cili ka qenë nën hetim penal. Vetëm 7% deklaruan se nuk shohin ndonjë problem në raste të tilla.

Shifra mjaft e madhe e atyre që e shohin si “delen e zezë” një koleg të tyre që ka qenë nën hetim, megjithëse është shpallur i pafajshëm, bart në vetvete disa probleme. Në radhë të parë, këtu ka çështje botëkuptimi dhe formimi. Së dyti, nisur nga fakti se policia është një organizatë që ka si funksion parësor dhe kryesor mbrojtjen dhe zbatimin e ligjit, punonjësit e saj, duhet t’u përmbahen me rigorozitet ligjeve. Në rastin që po diskutojmë, derisa në bazë të ligjit dikush është shpallur i pafajshëm, ai i ka të gjitha të drejtat të vijojë i qetë punën, pa u parë shtrembër nga kolegët, pa u paragjykuar dhe pa u diskriminuar. Pra, shtrohet edhe çështja e njohjes së ligjeve nga punonjësit e policisë. Qëndrimi i atyre që nuk ndihen mirë të punojnë me një koleg që ka qenë i dyshuar për ndonjë vepër penale, ndikon negativisht në marrëdhëniet ndërnjerëzore, por krijon edhe mosbesim në tërë organizatën e policisë. Ndaj, kthimi në punë i këtyre personave duhet shoqëruar me veprimtari sqaruese në kolektivin e policëve, me synimin që në njësitë përkatëse, ku ndeshet ky problem, të ketë marrëdhënie të shëndosha, ngrohtësi dhe respekt midis kolegësh dhe frymë bashkëpunimi në kryerjen e detyrës.


11. E keni më të lehtë të raportoni një vepër penale që ka kryer një qytetar, sesa një vepër të kryer nga një koleg i punës?



Nga përgjigjet e dhëna për këtë pyetje rezulton se 51% prej tyre e kanë më të lehtë të raportojnë për veprat penale që kryejnë qytetarët, sesa veprat penale të kryera nga zyrtarët policorë. Pra, janë më shumë se gjysma, që, sipas koncepteve dhe formimit që kanë,

tregohen të lëkundur dhe nuk janë të gatshëm t'i shohin edhe kolegët e tyre policë të barabartë para ligjit, por i diferencojnë nga qytetarët. Kurse pjesa tjetër, prej 41% kanë mendimin se kolegët e tyre mund t'i denoncojnë njëloj si qytetarët. Pra, këta janë në rregull me ligjin. Shifra 51%, përkthehet në mijëra punonjës policie, që, kush më shumë e kush më pak, nuk janë të predispozuar të denoncojnë kolegët. Kjo vë në pikëpyetje formimin dhe botëkuptimin e personelit, vë në pikëpyetje edukimin juridik të punonjësve policorë, njohjen prej tyre të legjislacionit në fuqi etj., etj. Lind nevoja që strukturat përkatëse të punojnë më shumë me ta në aspektin ligjor dhe etik, për t'u rrënjosur idenë se zyrtarët policorë nuk duhet të bëjnë dallime, të mos tregohen të njëanshëm, të mos tregohen oportunistë, duke fshehur e duke mosdenoncuar veprat penale të kolegëve të tyre. Trajtimi në mënyrë të barabartë i qytetarëve dhe i punonjësve të policisë duhet të jetë moto për policinë, duke theksuar fort se mosraportimi i veprës penale të kolegëve përbën vepër penale në vete.


12. A keni besim te drejtuesit e policisë për të raportuar keqpërdorimet e detyrës zyrtare nga kolegët?



Është me interes të thuhet se rezultati i arritur nga përgjigjet e dhëna për këtë pyetje tregon se shumica dërrmuese e punonjësve policorë kanë besim tek eprorët e tyre që të raportojnë keqpërdorimet e detyrës zyrtare nga ndonjë koleg. Kjo është pozitive, por

ajo duhet parë e lidhur edhe me të dhënat e marra nga pyetjet e tjera të pyetësorit. Që ka probleme në raportet e personelit me stafin udhëheqës, si dhe në besimin reciprok, e tregon edhe fakti që 12% e të intervistuarve deklarojnë se nuk kanë besim te drejtuesit, kur është fjala për raportim të keqpërdorimit të pozitës zyrtare nga kolegët. Gjithashtu, meriton vëmendje edhe ajo pjesë prej 21%, që mbajnë qëndrim indiferent, as ashtu, as kështu. Këto qëndrime flasin se ka gjëra që nuk shkojnë, si në sjelljet e drejtuesve, ashtu edhe në marrëdhëniet e tyre me vartësit. Në këto drejtime puna e hallkave drejtuese të policisë duhet të synojë në forcimin dhe rritjen e besimit të personelit te drejtuesit, në mënyrë që të rritet predispozicioni i punonjësve për raportimin e shkeljeve ligjore dhe të keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga kolegët e tyre.


13. A janë të paanshme dhe efikase masat ndëshkimore ndaj punonjësve të policisë të përfshirë në vepra penale të shpejta?



Shohim se një e treta e të anketuarve, 31%, pohojnë se masat ndëshkimore ndaj punonjësve të policisë të përfshirë në vepra penale merren në kohën e duhur, pa vonesë, se janë të paanshme dhe efikase;

ndërsa 17% mendojnë të kundërtën. Domethënës është edhe fakti që më shumë se gjysma e të anketuarve, 51%, kanë rezerva për këtë konstatim. Nga pozicionimi i tyre, nënkuptohet se lidhur me masat ndëshkimore në polici, ka probleme, si në zvarritjet dhe në vonesat në shqyrtimin dhe marrjen e tyre, po ashtu, edhe në cilësinë e tyre. Ata që janë shprehur kështu, duan të thonë se në praktikë ka edhe raste që në marrjen e masave ndëshkimore ka edhe ndikime, ndërhyrje, për t'i bërë më të lehta ato, çka i bën masat joefikase. Këto janë çështje që kërkojnë vëmendje më të madhe nga strukturat drejtuese të policisë, si dhe një bashkëpunim dhe koordinim më të mirë të tyre me IPK-në, me qëllim që masat disiplinore të jenë në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi, për të mos lejuar asnjë abuzim, ndikim a ndërhyrje të paligjshme në marrjen e tyre dhe që ato t'i shërbejnë qëllimit për të cilin merren.

14. A janë korrekte dhe a ndikojnë pozitivisht në parandalimin e veprave penale dhe të keqpërdorimit të detyrës zyrtare hetimi i shkeljeve disiplinore dhe masat disiplinore të marra ndaj punonjësve të PK-së?




Në këtë pyetje, 60% e të anketuarve, pohojnë se hetimi i punonjësve të policisë për shkelje disiplinore dhe masat e marra kundër tyre kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e disiplinës e brendshme dhe në parandalimin e

keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe të veprave penale ku përfshihen punonjës të policisë. Megjithatë, mendojmë se duhen marrë në konsideratë edhe ata 10% që mendojnë për të kundërtën, pasi presupozohet që ata kanë parasysh raste konkrete, ndaj dhe e japin këtë mendim. Po ashtu, nuk mund të injorohet edhe fakti që 30% e të

anketuarve janë të lëkundur dhe shprehin rezerva ndaj problemit që shtron kjo pyetje. Së bashku, këto dy grupe bëjnë 40%, që është shifër e konsiderueshme. Prandaj lind nevoja që strukturat përkatëse të ndalen në analizimin e hetimeve dhe të masave disiplinore, për të parë rregullsinë dhe efikasitetin e tyre, në funksion të parandalimit të veprave penale dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga punonjësit e policisë.


15. Në ç' nivel është korrupsioni në Policinë e Kosovës?



Ndoshta, kjo pyetje duhet të zinte vendin e parë në pyetësor, sepse fakti se si e perceptojnë vetë punonjësit e policisë korrupsionin në radhët e saj është shumë i rëndësishëm për vetë studimin tonë, por edhe për luftën kundër

korupsionit në praktikë. Për matjen e kësaj dukurie, përdorëm shkallëzimin në tri nivele: nivel i ulët; nivel i lartë; dhe nivel i lartë dhe në rritje. Rezultatet e të dhënave për këtë pyetje i kemi pritur me mjaft interes, pasi ato ndihmojnë drejtpërdrejt për t'iu përgjigjur pyetjeve kërkimore të studimit dhe për vërtetimin ose jo të hipotezave të tij. Siç e shohim edhe në grafikun përkatës, nga analiza e të dhënave, del se pjesa dërrmuese e të anketuarve, 88%, deklarohen se se niveli i korrupsionit në PK është në nivel të ulët. Vetëm 12% janë përgjigjur se korrupsioni në PK është i lartë.


16. A keni qenë ndonjëherë subjekt i hetimeve disiplinore?



Edhe për këtë pyetje ishim shumë të interesuar sesi do të rezultonin përgjigjet. Në fund, doli se 33% prej tyre, pra, një e treta, kanë qenë subjekte të hetimeve disiplinore, kurse 67%, pra, shumica dërrmuese e të anketuarve u përgjigjën se nuk kanë qenë asnjëherë subjekte të hetimeve disiplinore. Ky

është një rezultat i mirë, megjithatë, duhet pranuar se numri i të hetuarve për shkelje disiplinore nuk është i vogël, ndaj nuk ka vend për kënaqësi. Gjithsesi, këto të dhëna nuk mund të vlerësohen saktë, pa i lidhur me rezultatet e përgjigjeve të dhëna për pyetjen e mëposhtme, që ka të bëjë me ndëshkimin ose jo të atyre që i janë nënshtruar hetimit.

17. A keni marrë ndonjë masë disiplinore gjatë punës në PK deri tani?




Siç del nga ajo që theksuam më sipër, kjo pyetje u drejtohet atyre punonjësve të policisë që, për ndonjë arsye apo një tjetër, janë vënë nën hetim disiplinor. Por edhe këtu, për të gjykuar me saktësi duhet pasur parasysh fakti që jo të gjithë ata që hetohen mund të shpallen fajtorë dhe, për rrjedhojë,

nuk ndëshkohen. Kjo pritshmëri u vërtetua edhe në përgjigjet e të intervistuarve, nga të cilët, shumica dërrmuese, prej 80%, deklaruan se nuk kanë pasur masë disiplinore gjatë punës në PK. Pjesa tjetër, prej 20%, pra, një e pesta e të anketuarve, kanë marrë masë disiplinore. Pavarësisht se nuk kemi të dhëna se sa herë janë hetuar dhe sa masa

disiplinore kanë marrë, gjë që nuk u kërkua në pyetësor, konsiderojmë se këto rezultate kërkojnë një analizë të kujdesshme nga strukturat drejtuese dhe mbikëqyrëse të Policisë së Kosovës, për të nxjerrë përfundimet respektive dhe për të përcaktuar masat, aktivitetet për përmirësimin e situatës në këto drejtime.

18. A jeni hetuar ndonjëherë për dyshim për vepër penale?



Ndryshe qëndron problemi i hetimeve të punonjësve të policisë të dyshuar për kryerjen e ndonjë veprë penale. Në këtë aspekt kemi një realitet pozitiv, pasi siç del nga intervista, 97% prej tyre nuk kanë qenë subjekt i hetimeve penale. Por edhe më pozitive paraqitet situata, kur mësojmë se edhe ata punonjës policie, në

masën 3% të të anketuarve, që u janë nënshtruar hetimeve si të dyshuar për kryerje veprash penale, nuk janë gjetur fajtorë. Pra, nuk është vërtetuar të kenë kryer vepra të ndëshkueshme penalisht dhe kjo do të thotë që asnjëri nga të intervistuarit nuk ka kryer vepra penale dhe nuk është ndëshkuar penalisht. Për rrjedhojë, ata vazhdojnë normalisht të jenë në detyrë.

Përfundimet e nxjerra nga analiza e të dhënave të grumbulluara nga anketimi i kemi pasqyruar në kreun VIII, ku jemi përpjekur t'i shqyrtojmë ato në funksion të përgjigjeve që kërkojnë pyetjet kërkimore të studimit dhe të vërtetimit të hipotezave të tij.

KREU VI: HETIMI I VEPRAVE PENALE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT E POLICISË SË KOSOVËS DHE PROBLEMET QË DALIN

6.1 Personeli policor subjekt i hetimeve penale

Veprat penale të kryera nga oficerët policorë janë një çështje shumë komplekse. Fillimisht, nga aspekti i terminologjisë, shkeljet ligjore që përbëjnë vepër penale dhe sjelljet jo etike të zyrtarëve policorë në parim trajtohen si korrupsion. Siç është diskutuar në kreun e dytë, në literaturë dhe në hulumtimet e kryera në këtë fushë, oficerët policorë bëhen subjekte veprash penale të korrupsionit, kur kryejnë shkelje ligjore të tilla, si: keqpëdorimi i detyrës zyrtare, falsifikimi, vjedhja, pranimi i mitës, dhuratat, privilegjet, konflikti i interesit, abuzimi me narkotikë, ngacmimi seksual, brutaliteti, diskriminimi racor apo etnik etj. Po ashtu, në praktikë paraqiten shumë raste, kur ata hetohen edhe për shfaqje të korrupsionit policor, si sjelljet e pahijshme gjatë detyrës, shkelja e rregullave dhe e procedurave administrative, shkelja e kodit të etikës dhe e rregullave të tjera të punës.

“Pjesa më e madhe e administratorëve e përdorin termin *keqpërdorim i policisë*, kur një mbikëqyrës apo një oficer ka shkelur ligjet e shtetit, parimet e departamentit apo rregullat administrative” (Thibault, Lynch, McBride, 2007:268).

Edhe pse sipas raporteve hulumtuese dhe anketimeve të ndryshme të kryera, PK-ja gëzon besueshmëri të lartë të publikut dhe, në përgjithësi, një imazh të mirë, mbetet sfidues numri i madh i raportuar i veprave penale që kanë për subjekte zyrtarë të saj. Siç ka dalë nga hulumtimi, në raportet e institucioneve vendore paraqiten të dhëna të ndryshme për përfshirje të zyrtarëve të Policisë së Kosovës si subjekte të veprave penale. Po të shohim vetëm njërin prej tyre, raportin vjetor të IPK-së për vitin 2011, rezulton se nga muaji qershor deri në dhjetor të këtij viti, pra vetëm në shtatë muaj, IPK-ja ka regjistruar gjithsej 143 çështje të karakterit penal, lidhur me vepra të ndryshme

penale, të cilat supozohet se janë kryer nga zyrtarë policorë, gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare apo edhe jashtë saj.(IPK, 2011:13).

Në praktikë, ndodh që zyrtarët policorë dyshohen si subjekte të veprave penale, ngaqë shpeshherë krijohen dilema lidhur me keqpërdorimim e kompetencave që ata kanë sipas funksionit që kryejnë. Paqartësia këtu është nëse keqpërdorimi i policisë përbën vepër penale apo thjesht shkelje të procedurave administrative. Midis tyre ekziston vetëm një vijë e hollë ndarëse. Kjo kërkon njohje të mirë të legjislacionit, por edhe të personit dhe, sidomos, të rrethanave në të cilat është kryer vepra penale. Është me shumë përgjegjësi, por edhe mjaft e rëndësishme që të qartësohet mirë se kur, në cilat raste, sjellja e pahijshme e zyrtarit të policisë duhet të trajtohet në procedurë të brendshme disiplinore dhe cili është momenti përcaktues që shkelja e rregullave të etikës policore të hetohet dhe të sanksionohet penalisht?

Për ta bërë këtë ndarje, duhet bazuar mirë në ligj dhe rast pas rasti, duke vlerësuar mirë dhe saktë kompetencat dhe liritë që kanë oficerët e policisë gjatë kryerjes së detyrës, sepse ato nga një anë, janë të domosdoshme, nga ana tjetër, kur nuk përdoren ose kur keqpërdoren, krijojnë rreziqe të ndryshme. Ato mund të keqpërdoren dhe të tejkalohen, si edhe mund të mos përdoren, si nga paaftësia profesionale, edhe nga shkak se oficeri tundohet para një afere korruptive.

Zbatimi i ligjit është profesion i veçantë, me zyrtarë që kanë një mori lirish që nuk janë në dispozicion për publikun e gjerë, përfshi edhe aplikimin e forcës vdekjeprurëse, ngarjen e makinës me shpejtësi të lartë dhe konfiskimin e pasurisë personale. Ndërsa këto liri mund të jenë të domosdoshme, ato, gjithashtu, mund të krijojnë mundësi për keqbërje, veçanërisht nëse sjellje të tilla kalojnë pa u zbuluar, për shkak të mbikëqyrjes së dobët. (Fitch,D.B, 2011:24)

Një çështje tepër delikate në këtë aspekt lidhet me autorizimet që kanë me ligj zyrtarët policorë për përdorimin e forcës. Për shembull, si do të trajtohet rasti kur një zyrtar policor hetohet si subjekt i veprës penale që ka ndodhur për shkak të mosveprimit të forcës? Më konkretisht, nëse pasojat janë shkak i mosveprimit të zyrtarit policor, në

cilat raste mund të ky mosveprim konsiderohet vepër penale? Përgjigjja nuk është e thjeshtë. Janë shumë faktorë dhe rrethana që ndikojnë këtu. Lidhur me këtë, Salihu shprehet:

Konsiderohet se mosndërmarrja e veprimit të caktuar apo mosveprimi mund të jetë shkak i pasojës nëse janë përmbushur këto kushte: 1) nëse ka ekzistuar obligimi që të veprohet në mënyrë të caktuar për t'u parandaluar pasoja, 2) nëse personi ka pasur mundësi, ka qenë në gjendje të parandalojë shkaktimin e pasojës dhe 3) nëse konstatohet se me siguri pasoja nuk do të shkaktohej, ose do të shkaktohej pasojë shumë më e vogël, po të ndërmerrej veprimi që është dashur të ndërmerrej. (Salihu, I. 2005:221)

Vendimi rreth çështjes në fjalë mund të merret vetëm me një gjykim të kujdesshëm dhe në bazë të ligjit, mbështetur edhe në rrethanat konkrete që lidhen me veprën penale dhe me subjektin e saj.

Në rast dyshimi për vepër penale, zyrtarët e PK-së, u nënshtrohen dispozitave të procedurës penale njësoj si të gjithë qytetarët tjerë. Kjo shprehet qartë në legjislacion, por përcaktohet edhe në dokumentet e Këshillit të Europës. "Personeli policor do të jetë subjekt i të njëjtit legjislacion sikurse qytetarët e zakonshëm, dhe përjashtimet mund të justifikohen vetëm për shkaqe të performancës adekuate të punës policore në shoqëri demokratike." (Këshilli i Europës, 2001:7).

Një problem tjetër këtu del lidhur me vështirësinë që ndiejnë zyrtarët e PK të ngarkuar me hetimet penale të atyre çështjeve, subjekte të cilave janë kolegët e tyre, punonjës policie. Por, në këto raste, epërsinë mbi ndjenjat dhe faktorët emocionalë e kanë ligji dhe sundimi i tij. Ky dikton hetim të drejtë dhe të paanshëm të punonjësve të Policisë, që janë subjekte të veprave penale, sipas mandatit dhe kompetencave që përcaktojnë legjislacioni dhe rregulloret.

6.2 Ndarja e kompetencave për zhvillimin e hetimeve penale ndaj zyrtarëve të PK-së

Në fazën e hershme të themelimit dhe të zhvillimit të PK-së, në mungesë të njëjësive të specializuara, por edhe në mungesë të kompetencave, hetimi i veprave penale

në të gjitha nivelet, përfshirë edhe veprat penale të kryera nga zyrtarët publikë, ka qenë kompetencë e policisë së UNMIK-ut. Me ngritjen dhe forcimin kapaciteteve operationale dhe strukturimin e PK-së, gradualisht, edhe zyrtarët e PK-së pas trajnimeve të nevojshme për hetimet e krimeve janë sistemuar në njësitë hetimore, fillimisht, në nivel lokal dhe rajonal e, më pas, edhe në nivel qendror. Ky proces dhe roli i PK-së në hetimet penale është zhvilluar krahas procesit të plotësimit të infrastrukturës ligjore për policinë dhe krahas procesit të pavarësimit të PK-së nga Policia e UNMIK-ut.

6.2.1 Roli i PK-së në hetimet penale të zyrtarëve të saj

Me ndryshimet e bëra në kompetencat e IPK-së, duke i dhënë asaj mandatin ligjor edhe për hetimin e veprave penale të kryera nga zyrtarët e PK-së, është përmbushur një standard i rëndësishëm i kontrollit të jashtëm mbi policinë. Megjithatë, kjo nuk e privon në asnjë mënyrë dhe nuk e liron nga përgjegjësia vetë Policinë që të ndër marrë masa për parandalimin, për raportimin dhe hetimin e veprave penale dhe të korrupsionit të kryer nga punonjësit e saj. Zyrtarët e PK-së janë të obliguar nga ligji që të raportojnë shkeljet ligjore në polici dhe të bashkëpunojnë gjatë procedurës hetimore. “Informimi me kohë për ekzistimin ose përgatitjen e veprave penale është njëra ndër detyrat më të rëndësishme organizativo-teknike e organeve të punëve të brendshme.” (Latifi, 2006:49).

Në këtë drejtim, PK-ja ka krijuar mekanizmat e brendshëm të kontrollit, si: Njësia e Inspektimit, Drejtoria për Standarde Profesionale, Komisioni Disiplinor etj. Po ashtu, janë hartuar dhe miratuar edhe procedurat dhe rregulloret e punës, të cilat mundësojnë mbikëqyrje dhe llogaridhënie. Megjithatë, parandalimi dhe luftimi i sjelljeve devijante dhe i shkeljeve të ligjit kërkon edhe plane organizative afatgjata për

ruajtjen dhe forcimin e integritetit policor. Në Planin Zhvillimor Strategjik 2011-2015 të PK-së janë parashikuar aktivitete për parandalimin e korrupsionit në radhët e personelit të policisë. Mirëpo, kjo strategji parasheh vetëm veprime të pjesshme, të vetëm një shtylle, brenda PK-së, dhe jo veprime të përgjithshme, për tërë organizatën. Objektiva Strategjike 3: Kontrolli, mbikëqyrja, parandalimi dhe luftimi i krimit ndërkufitar përmes Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK), në objektivin 3.5 Parandalimi i Korrupsionit Brenda Policisë Kufitare parasheh këto aktivitete:

- a) Trajnimi i zyrtarëve policorë në çështjet antikorrupsion;
- b) Përpilimi dhe shpërndarja e pyetësorëve për qytetarë në pikat kufitare; dhe
- c) Aplikimi i sistemit me rotacion të zyrtarëve policorë.

Përveç veprimeve në fushën e ndjekjes penale, PK-ja duhet të kryejë më tepër veprime administrative dhe menaxheriale, që masat dhe veprimet për parandalimin dhe luftimin e shkeljeve penale të jenë pjesë e planeve zhvillimore dhe të dokumenteve strategjike. Kjo kërkon që udhëheqja e PK-së të hartojë një plan afatgjatë për forcimin e integritetit policor dhe për luftimin e korrupsionit brenda radhëve të saj.

6.3 Roli i Inspektoratit Policor në hetimet penale ndaj punonjësve të PK-së

Hetimet penale ndaj punonjësve të PK-së zhvillohen nga IPK-ja, që është një agjenci e pavarur në kuadër të MPB-së, nëpërmjet zyrtarëve të autorizuar.

Me termin “zyrtari i autorizuar i policisë”, Kodi i Procedurës Penale ka parasysh cilindo punonjës të Policisë së Kosovës apo të ndonjë shërbimi tjetër, që janë të autorizuar të zhvillojnë hetime penale ose të ekzekutojnë vendimin e prokurorit të shtetit apo të gjykatës. Me këtë formulim, Kodi u ka hapur rrugë edhe agjencive të tjera për të kryer hetime apo për të ushtruar detyra të parashikuara në të.

Inspektorati Policor i Kosovës, bazuar në Ligjin nr.03/L-231, është agjenci e autorizuar dhe me kompetencë për të hetuar penalisht zyrtarët policorë të Kosovës. Ai ka edhe disa kompetenca të tjera të kufizuara administrative. Me këtë ligj, hetuesve të IPK-së u janë dhënë kompetencat e zyrtarit të autorizuar policor, që parashikon KPP në procedurën hetimore.


Në nenin 2, të ligjit për IPK, në fushëveprimin e kësaj agjencie përfshihen: parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite, gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj. Në mënyrë më specifike, këto kompetenca të IPK për hetimet penale përcaktohen në nenin 17, *Hetimet penale*. Sipas tij, hetuesit e IPK-së gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre kanë kompetenca policore dhe i ushtrojnë ato në përputhje me Kushtetutën, me KPK-në, KPPK-në, me këtë ligj, si dhe me ligjet dhe akte nënligjore të tjera në fuqi. Ky nen përfshin edhe hetimet mbi incidentet e profilit të lartë disiplinor, si dhe hetimin disiplinor të zyrtarëve policorë me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe të zyrtarëve të lartë të nivelit ekzekutiv.

Kur në bazë të të dhënave që disponohen, dyshohet se një punonjës i Policisë, i cili është subjekt i hetimeve të IPK-së, sipas këtij ligji, sepse ka kryer një vepër penale ose planifikon apo organizon të kryejë një krim dhe kjo veprimtari nuk mund të zbulohet ose të parandalohet në rrugë e mënyra të tjera, hetuesit e IPK-së mund të përdorin masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit, të hetimit dhe të procedurës së parashikuar në Kodin e Procedurës Penale (Ligji për IPK, 2010:9).

Në nenin 2 të ligjit, thuhet se IPK, gjatë hetimit, është i autorizuar të mbledhë informacione dhe dëshmi, për të përcaktuar sjelljen e punonjësit të Policisë, për të cilin është inicuar rasti.

Hetuesit e IPK-së i ushtrojnë kompetencat e tyre në pajtim me Kodin Penal dhe me Kodin e Procedurës Penale.

Figura 1: Struktura Organizative e IPK-së



Burimi: Raporti vjetor 2011 i IPK-së

Siç u përmend më sipër, IPK-ja është e autorizuar edhe për përdorimin e teknikave të fshehta të hetimit. Ligji përcakton qartë se në cilat rrethana është e domosdoshme të aplikohen këto teknika të rëndësishme për efikasitetin e organeve hetuese në hetimin e veprave të rënda penale dhe të krimit të organizuar.

“Teknikat e fshehta përfshijnë infiltrimet afatgjata, mikrofona në trup, vëzhgime (audio dhe video), regjistrime, të gjitha llojet e interceptimeve të telekomunikacionit (p.sh., internet dhe e-mail) dhe situatave të maskuara. Këto mjete shumë të bezdisshme/invazive duhet të vendosen vetëm nëse ka një bazë ligjore të duhur (zakonisht, të përfshira në një akt të procedurës penale). Nëse kjo bazë ligjore mungon (p.sh., një urdhër i lëshuar nga një gjykatës), rezultatet e teknikave të fshehta, të cilat shpesh shkelin të drejtat e njeriut dhe jetën private, nuk mund (dhe nuk duhet) të konsiderohen nga gjykata dhe mund të çojnë në pafajësi ose shkarkim nga ndjekja penale e mëtejshme” (DCAF, 2012:236).

Gjithashtu, del problemi nëse ka rrezik që këto masa dhe operacione të fshehta të kalojnë kompetencat, të cenojnë etikën policore. Sipas DCAF,

“Operacionet e fshehta u referohen hetimeve që përfshijnë një sërë aktiviteteve sekrete të lidhura me njëra-tjetrën për një periudhë kohore të caktuar, të kryera nga agjencitë e zbatimit të ligjit për të penguar dhe zbuluar korrupsionin, si dhe për të mbledhur informacion për arrestimin dhe ndjekjen penale në të ardhmen. Disa aspekte të operacioneve të fshehta mund të ngrenë çështje të etikës, për këtë arsye, ato duhet të

respektojnë këto kushte: proporcionalitetin dhe miratimin nga autoritetet kompetente gjyqësore” (DCAF, 2012:236)

Krahas këtyre kushteve, është e domosdoshme që përdorimi dhe ruajtja e informacioneve të mbledhura nga aplikimi i masave të fshehta të shoqërohen me masa të rrepta sigurie, për të parandaluar rrjedhjen apo zbulimin e paautorizuar të tyre, sepse “në qoftë se ato përdoren në mënyrë jo korrekte ose të gabuar, kjo bart rrezikun e padrejtësive të rënda ndaj individëve” (Born, Leigh, 2005:111).

Rëndësi ka që i tërë procesi të bëhet vetëm me procedurë ligjore, i dokumentuar dhe vetëm për qëllime të ligjshme. Vetëm në këtë mënyrë mund të ruhet besimi i publikut ndaj sistemit të drejtësisë, përndryshe “besimi dhe respekti i publikut, që janë të vlera çmueshme, mund të humbasin shpejt nga sjellja e parregullt e zyrtarëve të drejtësisë kriminale.” (Peak, 2004: 358).

Si përfundim, IPK dhe institucionet e tjera që zbatojnë teknikat e fshehta, për të cilat u fol më lart, kanë për detyrë dhe përgjegjësi të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për respektimin e plotë të dispozitave ligjore, për rekrutimin dhe punësimin e personelit me integritet të lartë, të verifikuar, profesional e moral, që të sigurojnë pajisje dhe teknologji moderne, të miratojnë dhe të zbatojnë procedura standarde veprimi dhe t’u nënshtrohen mbikëqyrjes dhe kontrollit demokratik.

6.4 Inicimi i hetimeve penale ndaj zyrtarëve të PK-së

Në Kodin e Procedurës Penale parashikohen qartë mënyrat se kush ka të drejtë të inicojë një hetim penal ndaj një qytetari, më konkretisht, kush ka të drejtë të bëjë një kallëzim penal. Sipas KPPK-së, kallëzimin penal te prokurori publik ka të drejtë ta bëjë çdo qytetar dhe policia. “Pavarësisht sistemit, roli i prokurorit me ndryshime të parëndësishme, është kudo i njëjtë. Ai përcakton dhe vë në jetë politikat e një vendi dhe përfaqëson mënyrën institucionale, shtetin në procesin penal”(Spiro, 2012).

Në rast dyshimi ndaj zyrtarëve policorë, kallëzimi penal mund të ushtrohet si nga qytetarët, po ashtu edhe nga policia. Por, ekskluzivisht, të drejtën për të ngritur kallëzim penal, sipas detyrës zyrtare, e ka Inspektorati Policor i Kosovës, i cili, sipas ligjit, është përgjegjës për hetimin e veprave penale ndaj zyrtarëve policorë dhe për hetimin e një kategorie të caktuar të veprave administrative – disiplinore, të cilat janë të përcaktuara qartë me ligj.

Për hetimin sa më efikas të veprave penale që kryhen nga punonjës të PK-së është paraparë edhe obligimi ligjor i punonjësve të vetë Policisë për të njoftuar mbikëqyrësit e tyre për çdo rast me elemente të shkeljes penale apo të shkeljes administrative, ku janë përfshirë zyrtarë të policisë.

Të gjithë punonjësit e Policisë janë të detyruar t'ua raportojnë mbikëqyrësve të tyre rastet e shkeljeve të standardeve të disiplinës apo të veprave penale që përfshijnë punonjësit e Policisë. Punonjësit e Policisë duhet të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë dokumentacionin e nevojshëm gjatë hetimeve dhe procedurës disiplinore. (Policia e Kosovës, 2013:5-6)

Kjo ndihmon edhe në krijimin e një kulture të punës brenda organizatës policore, që zyrtarët policorë të mos ngurrojnë, por të kenë përherë predispozicionin për të denoncuar dhe raportuar shkeljet e kolegëve. Sepse në praktikë ka probleme të kësaj natyre. Në hulumtimin e kryer në kuadrin e këtij punimi, 31% e zyrtarëve të PK-së të pyetur janë përgjigjur se “pajtohen” dhe “pjesërisht pajtohen” se ndihen keq nëse e njoftojnë organin kompetent për kolegun e tyre të përfshirë në vepër penale.

IPK, gjatë kryerjes së detyrave të tij në inicimin e procedurës penale, për të cilin është mandatuar, i nënshtrohet në tërësi KPP dhe ushtron të gjitha kompetencat dhe obligimet që dalin prej saj për policinë.

Por ligji parashikon edhe situata që i lejojnë edhe vetë Policisë të ushtrojë të drejtën për kallëzimin penal ndaj punonjësve të vet, sidomos në rastet e hetimeve të krimit të organizuar, kur në to përfshihen edhe zyrtarë policorë. Por, ndërkohë, ligji

parashikon që, kur gjatë hetimit të zyrtarit policor zgjerohen hetimet edhe ndaj qytetarëve, për hetimin e rastit deri në përfundimin e tij përgjegjës do të jetë IPK-ja.

6.4.1 Presumimi i pafajësisë së subjektit që hetohet

Presumimi i pafajësisë është një ndër parimet themelore më të rëndësishme procedurale penale, jo vetëm në Republikën e Kosovës, por në të gjitha shtetet ku sundon demokracia dhe ku të drejtat e njeriut janë të mbrojtura me kushtetutë dhe me ligje. Ligjvënësi, duke përfshirë këtë parim në Kodin Penal ka garantuar që secili person i dyshuar që hetohet do të trajtohet si i pafajshëm deri në vendimin përfundimtar të gjykatës. Prandaj, kushdo që akuzon një person për kryerjen e një krimi duhet të bindë gjyqtarin nëpërmjet provave që personi i akuzuar ka kryer veprën penale. Derisa gjyqi nuk ka provuar fajësinë e të pandehurit nëpërmjet një procesi të rregullt konform procedurës penale, ku respektohen të drejtat e mbrojtjes, si palë e barabartë në procedurë, presumohet se i pandehuri është i pafajshëm. “Presumimi i pafajësisë është prezumim juridik, me të cilin merret se ekziston gjendja faktike, e cila nuk është provuar dhe, si i tillë, liron përkohësisht nga procesi i të provuarit derisa të provohet e kundërta.” (Sahiti, Murati, Elshani, 2014:53).

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 6, përcakton se: çdo person i akuzuar për një vepër penale presumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. Edhe në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, në nenin 3, është parashikon që çdo person i dyshuar ose që akuzohet për vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës dhe se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjyqtari mund të deklarojë të pandehurin fajtor për kryerjen e një vepre penale vetëm kur akuza ka provuar kryerjen e veprës penale tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Nëse akuza nuk arrin të eliminojë dyshimin, i pandehuri duhet të deklarohet i pafajshëm për veprën penale që akuzohet. Si i tillë duhet të trajtohet ai edhe nga të gjithë aktorët shoqërorë, sidomos nga mediat, si një ndër pushtetet kryesore me një ndikim të madh, jo vetëm në publik, por edhe në organet e drejtësisë.

Meqë i pandehuri prezumohet i pafajshëm deri në përfundim të gjykimit, kërkohet ndarja e autoriteteve gjyquese në fazën paraprake dhe në atë të gjykimit. Kjo ndarje është në funksion të parimit të prezumimit të pafajsisë, meqë pamundëson që i njëjti gjyqtar i cili është i angazhuar në dhënien e masës së sigurisë për të dyshuarin, të jetë edhe në procesin e gjykimit të tij. Kështu sigurohet që gjykimi të mos ndikohet. Në të kundërt, në rast se një gjyqtar, që ishte vendimmarrës në dhënien e masës së sigurisë për të pandehurin, do të jetë vendimmarrës edhe në procesin e gjykimit të tij, atëherë trupi gjykues automatikisht do të paragjykohej nga i pandehuri si një gjykatë e njëanshme, pasi është e kuptueshme, që trupi gjykues mund të ndikohet, qoftë edhe minimalisht, se i akuzuari është ai që ka kryer veprën penale. Kjo bie ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe, kështu, do të mungonte paanësia objektive e gjyqtarëve dhe vendimi përfundimtar do të ishte i paragjykuar.

Ky rregull dhe standard i të provuarit në marrjen e vendimit të dënimit, konsiston në aplikimin e parimit të prezumimit të pafajësisë dhe të detyrës që ka gjykata dhe, më pas, edhe prokurori në procesin gjyqësor, i cili ka barrën e provës që të provojë ekzistencën e veprës penale dhe të fajësisë së personit të akuzuar. Prandaj, duke arsyetuar vlerën provuese të provave të paraqitura për të provuar faktin, si dhe vlerën provuese të provave të kundërta, se kjo vepër penale është kryer apo jo nga i pandehuri, gjykata siguron se i pandehuri konsiderohet të jetë i pafajshëm deri në aktgjykim të

plotfuqishëm të saj. Kështu ajo vihet në funksion të plotë të këtij parimi themelor në mbrojtje të të drejtave të njeriut.

Prezumimi i pafajësisë në mënyrë të konsiderueshme është në kundërshtim logjik me faktin që i pandehuri gjatë periudhës së procedurës penale, realisht, u ekspozohet veprimeve dhe masave procedurale penale, të cilat paraqesin ndërhyrje të lloj-llojshme dhe të shumta në të drejtat dhe liritë personale. Është fakt që, para se i pandehuri të shpallet fajtor me aktgjykim të formës së prerë, ndaj tij, si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale, zhvillohet procedura penale, me qëllim zhvillimin e suksesshëm të saj, i pandehuri edhe mund të privohet nga liria. Andaj prezumimi i pafajësisë nuk e përjashton mundësinë e zhvillimit të procedurës penale ndaj të pandehurit, për të cilin ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer vepër penale. (Sahiti, Murati, Elshani, 2013:55).

Ky parim procedural penal ka efektet e veta edhe në procedurat e tjera, sidomos në atë administrative, kur kemi të bëjmë me përfshirjen e zyrtarëve publikë në ndonjë proces penal që ka efekt të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në marrëdhënien e punës së zyrtarit.

Kundër zyrtarit policor, i cili ka kryer krim apo ka keqpërdorur autoritetin zyrtar mund të ndërmerren një sërë veprimesh disiplinore. Nëse zyrtari akuzohet se ka kryer krim, në rrethana normale, atë do ta hetojë zyra e prokurorit të qarkut. Sido që të jetë, ndërsa zhvillohet hetimi, që mund të zgjasë edhe për muaj të tërë, zyrtari mund të mbetet në detyrë (i prezumuar i pafajshëm deri në vendimin e gjykatës) ose mund të pezullohet, me apo pa pagë. Nëse zyrtari nuk dënohet dhe është pezulluar pa pagë, ai normalisht rikthehet në detyrë dhe i jepen edhe pagat e ndaluara. Në disa raste, zyrtarit mund t'i duhet të bëjë padi civile për t'i marrë ato paga. (Thibault, Lynch, McBride, 2007:261)

Në rastet kur zyrtarët policorë, si ndër zyrtarët shtetërorë me më influencë në zbatimin e ligjit, përfshihen në vepra penale, procedura hetimore dhe gjykuese ndikon pothuajse drejtpërdrejt në karrierën e tyre profesionale. Bazuar në kodin e etikës policore dhe në procedurat e brendshme të Policisë, varësisht prej rastit, zyrtari policor mund të pezullohet përkohësisht deri në përfundimin e procedurës penale, kur edhe merret vendimi i gjykatës, por edhe mund të vazhdojë të qëndrojë në detyrë, pavarësisht zhvillimit të procedurës. Këto forma veprimi në Policinë e Kosovës përcaktohen varësisht nga pesha e veprës penale dhe nga fakti se kjo vepër e kryer ndikon në imazhin e policisë.

Veprat penale të zyrtarëve policorë kundër sigurisë në komunikacion janë tipike, ku mund të merren parasysh pasojat, rrezikshmëria, dashja apo qëllimi i autorit.

Aksidentet e trafikut, me dëme të vogla materiale apo lëndime të lehta trupore, parashikohen në Kodin Penal si vepra penale. Por ato mund t'i ndodhin çdo drejtuesi makine, prandaj, në të shumtën e rasteve, zyrtari policor që bën aksident me makinë nuk pezullohet ose kthehet në detyrë deri në vendimin e formës së prerë të gjykatës. Kuptohet, ky vendim mund të jetë përcaktues për të ardhmen e zyrtarit policor, sepse në rast se dënimi i tij shkon mbi gjashtë muaj burg, në bazë të ligjit të punës, atij i ndërpriten marrëdhëniet e punës në polici.

Në rastet kur zyrtari policor kryen ndonjë vepër tjetër penale, që rezulton jo nga pakujdesia dhe që ndikon në dëmtimin e imazhit të policisë, ai pezullohet për një kohë më të gjatë nga detyra, por jo më shumë se gjashtë muaj, pasi, nëse vepra penale përmban edhe shkelje të rëndë administrative, pas kalimit të kësaj periudhe ai duhet të largohet nga detyra edhe pa përfunduar procedura. Po ashtu, atij mund t'i ndërpritet pezullimi dhe t'i jepet e drejta e kthimit në detyrë deri në përfundim të procedurës, por, nëse shpallet fajtor, ai mund të largohet fare nga puna. Megjithatë, shpallja fajtor nuk përcakton domosdoshmërisht largimin nga detyra. Përcaktuese për këtë janë shkalla e shkeljes disiplinore, e cila parashikohet me Udhëzimin Administrativ 06/2012 të Policisë së Kosovës, si dhe kohëzgjatja e dënimit me burg mbi gjashtë muaj.

Së fundi, theksojmë që parimi i prezumimit të pafajësisë ka ndikim të madh dhe ofron siguri edhe në fusha të tjera, pavarësisht masave preventive që ndërmerren nga institucioni për të siguruar se ndikimet e mundshme nga të qenit zyrtarë policorë janë të minimizuara, meqë kompetencat vepruese të tyre pezullohen përkohësisht gjatë hetimit dhe gjykimit.

6.5 Ndjekja penale dhe gjykimi për rastet e korrupsionit

Ndërtimi i bazës ligjore për zhvillimin e procedurës penale në Kosovë ka kaluar nëpër disa faza. Për lëmin e së drejtës penale, ndikim të madh ka pasur Kushtetuta Jugosllavisë e vitit 1974, ngaqë me këtë kushtetutë për herë të parë u aprovua koncepti i decentralizimit të kompetencave ligjdhënëse edhe në lëmin e legjislacionit penal në republika dhe krahina autonome. Mbështetur në dispozitat e kësaj kushtetute (neni 281, par.1. pika 12), të cilat hynë në fuqi më 1 korrik 1977, Kosova, për herë të parë në historinë e saj, nxori ligjin e vet penal, i cili hyri në fuqi po më 1 korrik 1977 (Salihu, 2005:114).

Pas përfundimit të luftës, një nga çështjet e para që preokuponte faktorin politik vendor dhe administratën ndërkombëtare ishte zbatimi i ligjit dhe krijimi i legjislacionit vendor, të harmonizuar me standardet ndërkombëtare. Kjo, sigurisht, kërkonte kohë, por edhe nuk mund të lihej vakuum ligjor. Për këtë, u sollën në Kosovë juristë ndërkombëtarë për të përgatitur një pjesë të legjislacionit brenda një kohe relativisht të shkurtër. Duhet thënë se ata nuk i kushtuan vëmendjen e duhur këtij problemi dhe hartuan disa ligje që nuk përshtateshin mirë me legjislacionin vendor, që ekzistonte në atë kohë. Arsyeja kryesore për këtë ishte mungesa e informimit të tyre mbi legjislacionin vendor, për shkak të vështirësive në qasjen te resurset zyrtare në këtë legjislacion. Gazetat Zyrtare, që përmbanin ligjet kryesore, ose kishin humbur ose qenë shkatërruar gjatë konfliktit të armatosur. Edhe mosnjohja e gjuhëve shqipe dhe serbe ishte një pengesë e madhe për juristët ndërkombëtarë për t'u qasur në legjislacionin vendor (CASIN, 2003:14).

Prandaj, Përfaqësuesi i Përhershëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, me rregulloret e UNMIK-ut nr.1999/1 dhe 1999/24, vendosi të aplikoheshin në Kosovë legjislacioni që ishte në fuqi në Kosovë që nga data 22 mars 1989, si dhe rregulloret e

UNMIK-ut, të aprovuara nga PSSP në pajtim me Rezolutën nr.1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Kështu, lidhur me procedurën penale, zbatohet Ligji i Procedurës Penale i ish-RSFJ, i miratuar në vitin 1977. Këtë ligj, personeli vendas i sistemit të drejtësisë e njihte, edhe në aspektin teorik, edhe në aspektin praktik, gjë që ndihmonte zbatimin e tij pa ndonjë vështirësi dhe brenda kompetencave të tyre, nën mandatin e UNMIK-ut.

Megjithatë, situatat e reja nxorën nevojën të hartohet ligji i ri i procedurës penale, sipas kriterëve dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ekspertët vendas dhe ata ndërkombëtarë të UNMIK-ut dhe të OSBE-së filluan punën për hartimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (KPPP). Ai u miratua nga Kuvendi i Kosovës dhe u nënshkrua nga PSSP më 6 korrik 2003, me rregulloren e UNMIK-ut, nr.2003/26, dhe hyri në fuqi më 6 prill 2004. Me të u bënë mjaft përmirësime në punën e organeve të drejtësisë, pasi Kodi i Procedurës Penale i Jugosllavisë kishte shumë defekte. Ky ishte, në fakt, një sistem inkuizitor i drejtësisë penale, sipas të cilit hetimet bëheshin në bazë të kallëzimit dhe, përgjithësisht, dominoheshin nga gjyqtari hetues. Ndërsa KPPP përmbante zgjidhje dhe risi të harmonizuara me standardet ndërkombëtare, pasi përfshinte edhe përvoja të ndryshimeve të procedurës penale që ishin realizuar në vende të tjera.

Nga viti në vit, sistemi i drejtësisë penale të Kosovës erdhi duke pësuar ndryshime rrënjësore dhe duke u përmirësuar vazhdimisht. Më 6 nëntor 2008, Kuvendi i Kosovës, me ligjin Nr.03/L-003 për Ndryshimin dhe Plotësimin e KPPP të Kosovës, veç tjerash, hoqi nga emërtimi i Kodit fjalën “i Përkohshëm”.

“Kosova ka vazhduar të miratojë legjislacionin kundër korrupsionit, në përputhje me standardet e ndërkombëtare dhe, më e rëndësishmja, të Bashkimit Europian. Megjithatë, disa nga këto ligje të harmonizuara ende kanë nevojë për miratimin e legjislacionit tjetër zbatues, në kuptim të akteve dhe rregulloreve nënligjore, si dhe për të shndërruar kërkesat ligjore në kornizë institucionale.” (Agjencia Kundër Korrupsionit, 2013:23).

Kodi i ri i Procedurës Penale i referohet edhe respektimit të të drejtave të njeriut. Kjo shihet në nenet 192 dhe 441, që përcaktojnë se Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe vendimet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut janë bazë për paraqitjen e mjetit të jashtëzakonshëm juridik nga të pandehurit dhe të akuzuarit. Konkretisht, neni 192 urdhëron gjykatën të mbikëqyrë personat që mbahen në paraburgim. Për ta bërë më efektive këtë të drejtë, ka garanci më të mëdha që i mundësojnë të pandehurit të parashtrojnë kërkesë për lirim, përfshirë kërkesën për rishikimin e ligjshmërisë së paraburgimit nga paragrafi 5. I paraburgosuri duhet të provojë se kushtet e paraburgimit nuk janë në pajtim me Kodin e Procedurës Penale apo me Konventën Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore, siç interpretohet nga vendimet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (Smibert, 2013:16).

Tani Kosova ka një infrastrukturë ligjore më të mirë për zhvillimin e procedurës penale të kompletuar dhe të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. KPP i Kosovës përcakton qartë sesi duhet të fillojë dhe të përfundojë një procedurë penale, duke filluar nga hetimi i veprës penale, deri në gjykimin përfundimtar të të pandehurit, përfshirë edhe mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Lidhur me fazën fillestare të procedurës, konkretisht, atë të hetimit penal, si një ndër fazat më të rëndësishme të luftës kundër kriminalitetit, në nenin 6 të KPP parashikohet fillimi i procedurës penale, duke i dhënë kompetencë Policisë që të fillojë hetimet policore në përputhje me nenet 69–83. Po ashtu, në nenin 7 obligohet edhe Policia, sikurse prokuroria dhe gjykata, që në procedurë të vërtetojë faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit. Ky detyrim i KPP edhe për policinë është shumë i rëndësishëm, pasi policia nuk mund të mbetet pasive, pas prokurorit, por ka përgjegjësitë e saj për të qenë e vëmendshme në ushtrimin e kompetencave të saj, si në

gjetjen e provave fajësuese, ashtu edhe atyre që shkojnë në favor të të pandehurit. Për të arritur këtë,

“duhet të ketë bashkëpunim funksional dhe të përshtatshëm mes policisë dhe prokurorisë publike. Në vendet ku Policia është e vendosur nën autoritetin e prokurorisë publike apo të gjykatësit hetues, ajo duhet të jetë e instruktuar mirë lidhur me prioritetet që drejtojnë politikën e hetimit të krimit dhe progresin e hetimeve penale në raste individuale, me qëllim që ajo të mos vihet nën autoritetin e prokurorisë publike apo të gjykatësit hetues. Përkundrazi, ajo duhet të luajë rolin e saj parësor, lidhur me informimin e organeve të hetimit. Policia duhet të mbajë të informuara autoritetet e larta të hetimit të krimit, lidhur me zbatimin e udhëzimeve të tyre, në veçanti, zhvillimet e rasteve penale duhet të raportohen rregullisht. (Këshilli i Europës, 2002:8).

Kodi i Procedurës Penale përcakton edhe mekanizmat e sistemit të ndjekjes penale në çdo fazë të procedurës hetimore. Në fazën e hetimit paraparak veprojnë policia dhe prokuroria. Këto kanë departamente, drejtori, njësi të specializuara për të hetuar dhe luftuar kriminalitetin, pra, edhe korrupsionin, varësisht nga profili i personave të korruptuar, nga vlera monetare e përfitimeve apo dëmeve të shkaktuara. Ndërsa gjykimi i këtyre rasteve bëhet nga gjykatat themelore, varësisht nga rajoni dhe territori të cilit i përket, gjegjësisht, nga Departamenti i Krimeve të Rënda në Gjykatën Themelore.

Policia ka për hetime Drejtorinë Kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit. Kjo heton të gjitha rastet e korrupsionit, deri edhe zyrtarët e lartë dhe vlera monetare të përcaktuara. Hetimi i rasteve të zyrtarëve të lartë dhe i rasteve për vlera monetare të përcaktuara janë kompetencë e Departamentit Special Antikorrupsion, që funksionon në Prokurorinë Speciale, ku janë caktuar edhe prokurorë të veçantë. Kompetenca e këtij departamenti është përcaktuar me vendimin e qeverisë, nr.02/110, datë 26/02/2010, dhe me marrëveshjen me shkrim ndërmjet Kryeprokurorit të EULEX-it dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë së Republikës së Kosovës. Sipas marrëveshjes, ky departament ngarkohet për të filluar hetimin dhe, më pas, edhe akuzimin e të pandehurve për rastet e korrupsionit të zyrtarëve të lartë, siç janë anëtarët e kabinetit qeveritar, sekretarë

permanentë të ministrive, kryetarët e komunave, kryetarët e bordeve të ndërmarrjeve publike etj.

Ndërsa me rastet e tjera, që nuk janë në kompetencë të Departamentit Special Antikorrupsion, merret Drejtoria Kundër Krimeve Ekonomike, e Prokurorisë Themelore e, më pas, edhe Gjykata Themelore.

Ndër mekanizmat parapenalë radhitet edhe Inspektorati Policor i Kosovës, të cilit, me ligj, i janë dhënë kompetenca policore. IPK ka kompetencë hetimin vetëm të rasteve ku janë të përfshirë punonjës policie; inspektimin e Policisë dhe kryerjen e hetimeve administrative ndaj eprorëve me gradë më të lartë policore. Në raste të veçanta IPK bën edhe hetime administrative ndaj të gjithë punonjësve të policisë, si në: rastet e vdekjeve të personave në mbajtje; incidentet e përdorimit të forcës vdekjeprurëse; aksidentet fatale të trafikut (Ligji për IPK). Këto kompetenca IPK i ushtron në koordinim me Prokurorinë Themelore, e cila ka prokurorë të caktuar që veprojnë në rastet që i heton IPK.

Në këto kushte, për mendimin tonë do të ishte mirë dhe me shumë rëndësi që edhe gjykata të ketë Departamentin Special Antikorrupsion, i cili do t'i përshtatej profilizimit të Prokurorisë dhe Policisë dhe do të bashkëpunonte me to.

Sipas Kodit të Procedurës Penale, prokurorisë i është dhënë kompetencë të ndërmarrë veprime që nga fillimi i një hetimi deri në përfundim të gjykimit, ku prokurori përfaqëson akuzën ndaj të pandehurit. Ky është një ndryshim thelbësor nga ligji i mëparshëm, me të cilin ka funksionuar sistemi i drejtësisë në Kosovë deri në vitin 2004, sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës. Me atë ligj, prokurori ishte vetëm një përfaqësues i akuzës në procedurë penale, ndërsa të gjitha kompetencat hetuese ishin të përqendruara te gjyqtari hetues. Nga viti 2004 prokurorisë iu dhanë kompetenca edhe për hetimin e rasteve, por organizimi i prokurorive dhe i

gjykatave ka qenë i tillë që nuk lejonte profilizimin, sepse nuk kishte ndarje në departamente, siç janë krijuar tani me Ligjin për Prokurorinë e Shtetit dhe Ligjin për Gjykatat, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2013.

Sipas Ligjit për Prokurorinë, tani Prokuroria e Shtetit në Kosovë është e organizuar në prokuroritë e ngritura në shtatë rajone të Kosovës:

- Prokuroria Themelore përbëhet nga Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti për të Mitur dhe Departamenti për Krime të Rënda;
- Prokuroria e Apelit përbëhet nga Departamenti i Përgjithshëm dhe Departamenti për Krime të Rënda;
- Prokuroria Speciale
- Prokuroria e Shtetit

Për të ndjekur rastet e korrupsionit në shkallë të parë kompetente është Prokuroria Themelore, Departamenti për Krime të Rënda, ndërsa për të gjykuar është Gjykata Themelore dhe Departamenti për Krime të Rënda. Ndërsa në shkallë të dytë, kompetenca kalon në Prokurorinë e Apelit dhe në Gjykatën e Apelit.

Është e rëndësishme të theksohet se Gjykatat dhe Prokuroritë në Republikën e Kosovës janë të organizuara në mënyrë të ngjashme, ndaj dhe i përshtaten mirë njëra-tjetrës, gjë që e bën më të lehtë specializimin e prokurorëve dhe të gjyqtarëve sidomos në çështjet e krimeve të rënda dhe të atyre ku personat e përfshirë janë të mitur. Për dallim nga prokuroria, Gjykata Themelore e Prishtinës ka edhe dy departamente, atë për Çështje Ekonomike dhe atë për Çështje Administrative, që mbulojnë tërë territorin Kosovës. Dallim tjetër organizativ i gjykatës është se ajo, ndryshe nga prokuroria, nuk ka ndonjë departament special për gjykimin e rasteve të korrupsionit të zyrtarëve të lartë. Kjo ndikon shumë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, pasi bën shkëputjen nga hallkat tjera të sistemit, ku profilizimi i personave të autorizuar për të

hetuar dhe akuzuar është edhe më specifik, gjë që e vështirëson luftën e shtetit ndaj kësaj dukurie të rrezikshme. Meqë korrupsioni, sikurse format e tjera të krimeve, në shumë raste shkon përtej kufijve kombëtarë, misioni EULEX në raportin e vitit 2014 potencon nevojën për krijimin e mundësive ligjore për bashkëpunim ndërkombëtar në luftimin e korrupsionit.

6.6 Politika penale për personat që janë dënuar për vepra penale të korrupsionit

Politika ndëshkimore është rrjedhojë e reagimit të shtetit në përputhje me politikën kundër kriminalitetit në tërësi. Ajo “është një disiplinë shkencore teorike dhe praktike, e cila merret me studimin e masave, mjeteve dhe metodave më të përshtatshme për luftimin dhe pengimin e kriminalitetit në një shoqëri” (Halili, 2002:65).

Konventa Penale për Korrupsion, në nenin 19 ‘*Sanksione dhe masa*’, duke pasur parasysh natyrën serioze të veprave penale të përcaktuara në përputhje me këtë konventë, obligon që secila palë të sigurojë sanksione dhe masa efektive proporcionale dhe shtrënguese për veprat e korrupsionit. Në përputhje me politikën ndëshkimore shtetërore, kohët e fundit, ligjvënësit kanë bërë disa ndryshime të rëndësishme në KPPK dhe KPK, duke shprehur politikën e re të shtetit për luftën kundër kriminalitetit, në tërësi, dhe korrupsionit, në veçanti dhe duke krijuar një hapësirë më të madhe për punën e organeve të hetuesisë në këto fusha.

Në KPK politika ndëshkimore është shprehur për secilën dukuri kriminale, pra, edhe politika ndëshkimore për veprat e ndryshme penale ku përfshihen persona zyrtarë. Në disa nene të veçanta jepen sanksionet për *veprat penale të korrupsionit zyrtar*. Aty vërejmë se për shumicën e tyre parashikohet minimumi prej gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim; dënim me gjobë deri në tre vjet burgim. Ndërsa *keqpërdorimi i informatës zyrtare*, sipas nenit 423, nëse informata zyrtare ka të bëjë me ndonjë veprim të

prokurimit apo ankand publik, autori dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy deri në tetë vjet; për *përvetësim në detyrë*, sipas nenit 425, kur ai rezulton me dobi pasurore apo humbje në vlerë që tejkalon 50.000 euro, autori dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre deri në dymbëdhjetë vjet. Ndërsa për *mashttrim në detyrë*, sipas nenit 436, nëse veprimi rezulton me dobi pasurore në vlerë që tejkalon 50.000 euro, autori dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në tetë vjet.

Krahasuar me kodet penalë të Sllovenisë, Austrisë dhe Serbisë, shohim se sanksionet që parashikon KP i Kosovës për veprat penale të korrupsionit zyrtar janë më të ashpra. Koncretisht, *marrja e ryshfetit*, në Slloveni ndëshkohet deri në pesë vjet burg, në Austri, deri në dhjetë vjet, në Serbi deri në dymbëdhjetë vjet. Ndërsa në Kosovë dënimi shkon deri në dymbëdhjetë vjet. Po ashtu, edhe *dhënia e ryshfetit*, në Slloveni ndëshkimi shkon deri në pesë vjet, në Austri, deri në pesë, në Serbi deri në pesë vjet. Kurse në Kosovë kjo vepër ndëshkohet deri në tetë vjet burgim. Edhe për veprën penale *zbulimi i sekretit zyrtar*, në Kosovë ndëshkimi është shumë më i ashpër, dhe shkon deri në dhjetë vjet burgim. Ndërsa në Slloveni kjo vepër penale ndëshkohet deri gjashtë vjet burg, në Austri dënimi shkon deri në tre vjet dhe në Serbi deri në pesë vjet.

Por megjithëse sanksionet e parashikuara me KPK shprehin vullnetin e ligjvënësit për sanksione të ashpra kundër korrupsionit, vihet re që zbatimi në praktikë i tyre dhe masat e marra nuk janë efektive në luftimin e këtij fenomeni. Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) në raportin e publikuar “*Korrupsioni në Kosovë: Luftimi apo promovimi i korrupsionit*”, ka paraqitur të arritjet lidhur me efikasitetin e sistemit gjyqësor në trajtimin e këtyre veprave, në vitet 2014-2015. Sipas IKD, gjatë vitit 2014, në 38 çështje gjyqësore për korrupsion gjykatat kanë dhënë *dënime me burg* ndaj 35 personave. Në vitin 2015, ky numër ka rënë në 31 çështje, por është rritur numri i personave të dënuar me burg, që ka shkuar në 41 persona. Gjatë vitit 2014, gjykatat

kanë dhënë *dënime me gjobë* në 37 çështje gjyqësore, ndaj 41 personave; ndërsa në vitin 2015, dënime me gjobë janë dhënë në 31 raste, ndaj 35 personave. Në vitin 2014, gjykatat kanë dhënë *dënime me kusht* në 43 çështje gjyqësore, ndaj 54 personave; kurse në vitin 2015 kanë dhënë *dënime me kusht* në 33 çështje gjyqësore, ndaj 45 personave. Në vitin 2014, gjykatat kanë shpallur *lirimin* e 58 personave, në 41 çështje gjyqësore; kurse në vitin 2015, gjykatat kanë vendosur *lirimin* për 58 persona, në 32 çështje gjyqësore. Në vitin 2014, gjykatat kanë vendosur *aktgjykim refuzues* në 20 çështje gjyqësore, për 40 persona, kurse në vitin 2015 e kanë vendosur atë në 29 çështje gjyqësore, për 63 persona.

Duhet thënë se subjekt i hetimeve dhe i ngritjes së aktakuzave për korrupsion vazhdojnë të mbesin më së shumti persona të profilit ulët dhe të mesëm, dhe persona të zhveshur nga pushteti apo nga përkrahja politike.

Por, në këtë fushë ka edhe probleme, që meritojnë vëmendjen e strukturave. IKD, gjatë monitorimit ka gjetur, në shumë raste, parregullsi, përfshi mosrespektimin e afateve ligjore në trajtimin e rasteve të korrupsionit në të gjitha hallkat e sistemit të drejtësisë, si zvarritjet e çështjeve në polici, në prokurori dhe në gjykata. (IKD, 2016:5-7). Po ashtu, IKD ka konstatuar se prokurorët, në raste shumë të rralla zbatojnë në praktikë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë më kërkesat për sekuestrim apo konfiskim ndaj autorëve të veprave penale të korrupsionit (IKD, 2016:112). Më tepër shih: <http://kli-ks.org/korrupsioni-ne-kosove-luftimi-apo-promovimi-i-korrupsionit-2/>

Në praktikën gjyqësore nuk mungojnë gjykimet penale, ku personat e akuzuar dhe të ndëshkuar janë punonjës policie. Këto raste paraqesin interes për studimin tonë, për të parë llojet e veprave penale të kryera prej tyre, por edhe masat e ndëshkimit që gjykatat kanë dhënë për to.

Gjykata e Qarkut në Gjilan, për veprën penale marrje e mitës, të parashikuar nga neni 343, paragrafi 1, i KPK, punonjësi i PK-së M.F., u dënua me gjashtë muaj burgim me kusht që në afat prej një viti i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale (Gjykata e Qarkut në Gjilan, KZ.br.236/2012). Edhe në Prizren, pasi gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit N.Z., punonjës policie, janë prezent të gjitha elementet e veprës penale të marrjes së ryshfetit, sipas nenit 343, par.1, të KPK, e dënoi atë me burgim me kusht, në kohëzgjatje prej katër muaj, ekzekutimi i të cilit nuk do të bëhet në rast se i akuzuari nuk kryen vepër të re penale në një afat prej një viti (Gjykata Themelore e Prizrenit, P.nr.201/13).

KPK, për veprën penale marrje e ryshfetit nga neni 343 paragraf 1, parashikon dënimin me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Gjykata Komunale e Podujevës, më datë 09.11.2012, me vendimin e saj shpalli fajtor të pandehurin S.M, punonjës policie, për veprën penale marrje ryshfeti, të parashikuar nga neni 343, par. 2 i KPK. Për vendosjen e masës së dënimit, gjykata, pasi vlerësoi provat dhe bazuar në rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, përcaktoi si rrethanë rënduese faktin që të pandehurit i qe besuar detyra zyrtare e policit, të cilën ai nuk duhet ta keqpërdorte dhe të binte në veprime të tilla, sepse Policia e Kosovës është organ në shërbim të qytetarëve dhe sjellja e paligjshme e zyrtarëve policorë ndikon negativisht në autoritetin e Policisë së Kosovës. Në bazë të dispozitave ligjore, gjykata caktoi për të dënimin me pesë muaj, dënim që nuk ekzekutohet në afat prej një viti, nëse i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk kryen vepër tjetër penale.

Në praktikë vihet re se dënimet e shqiptuara për veprat penale *marrje e ryshfetit*, të kryera nga punonjës policor janë tepër të buta, në krahasim me ato që përcakton KPK, për veprën penale *marrje e ryshfetit*, në nenin 343, paragraf 2, ku thuhet se dënimi është: burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet. Ndërsa, Gjykata Themelore

në Mitrovicë, shpalli fajtor punonjës in e policisë A. Sh., për kryerjen e veprës penale *shpërdorim i detyrës zyrtare* apo i kompetencave, në kundërshtim me nenin 339, par.1, të KPK. Ai u dënua me pesë muaj burgim, kurse për veprën penale *marrje ryshfeti* u shpall i pafajshëm. Sipas nenit 43 të KPK dhe nenit 44, par.1 dhe 2, dënimi pezullohet për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vitesh. Gjithashtu, gjykata urdhëron që përfitimi material nga vepra penale të kthehet brenda periudhës prej një viti, në të kundërtën, gjykata urdhëron që dënimi të ekzekutohet. Ndërsa i akuzuari N.P., punonjës policie, shpallet fajtor për kryerjen e veprës penale *shpërdorim i detyrës zyrtare* apo kompetencave, në kundërshtim me nenin 339, par.1, të KPK, dhe për veprën penale *marrje ryshfeti*, në kundërshtim me nenin 343, par.1 të KPK-së, dhe dënohet me pesë muaj burgim për të parën dhe me një vit burgim për veprën e dytë penale. Dënimi përmbledhës për të dyja këto vepra penale, që iu dha të akuzuarit sipas nenit 71 të KPK, i ishte një vit e dy muaj. Sipas nenit 43 të KPK dhe nenin 44, par.1 dhe 2, dënimi pezullohet për periudhën e verifikimit prej dy vjet e gjashtë muaj. Gjkata urdhëron që përfitimi material nga vepra penale të kthehet brenda një viti, në të kundërtën Gjkata urdhëron që dënimi të ekzekutohet. (Gjkata Themelore në Mitrovicë, P.nr.22/12).

Pra, edhe në këtë rast shohim se janë dhënë dënime më të buta, pasi KPK, për veprën penale shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit nga neni 339 par.1 parasheh dënimin deri në një vit burgim.

Me vendim të Gjykatës Komunale të Gjakovës, punonjësi i policisë SH.F. u shpall fajtor për bashkëkryerje të veprës penale shpërdorim i detyrës zyrtare, që parashikon neni 339, par.1, lidhur me veprën penale të falsifikimit të dokumentit zyrtar, të parashikuar nga neni 348, par.1, i KPK dhe iu dha dënimi unik me katër muaj burgim. (Gjkata Komunale Gjakovë, P.nr.540/08).

Për veprën penale të *falsifikimit të dokumentit zyrtar*, sipas nenit 348, par.1, të KPK-së parashikohet dënim prej tre muaj deri në tre vjet. Duke marrë parasysh se i pandehuri në bashkëkryerje kreu dy vepra penale, *falsifikim* dhe *shpërdorim të detyrës zyrtare*, konsideroj se dënimi unik që iu dha është i ulët dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore.

Gjykata Komunale e Gjilanit, për veprën penale zbulim i fshehtësisë zyrtare, të parashikuar nga neni 437, par.1, i dha të pandehurit R.Xh., punonjës policie, dënimin gjashtë muaj burgim me kusht. (Gjykata Komunale Gjilan, P.nr.1115/07). Në KPK, për veprën penale nga neni 437, par. 1, është dënim me burg deri në tre vjet. Pra, duke marrë parasysh llojin e veprës, profesionin e të pandehurit dhe rrezikshmërinë e veprave penale të zbulimit të fshehtësisë zyrtare në kohën e zhvillimit të teknologjisë dhe rëndësisë që ka ruajtja e informacionit, konsideroj se dënimi i dhënë është tepër i butë.

Kur cakton dënimin, gjykata duhet të ketë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për atë vepër penale, qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në këtë kapitull, rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin. (neni 73, KPK). Gjithashtu, gjykata merr parasysh, por nuk kufizohet në: shkallën e përgjegjësisë penale; motivet për kryerjen e veprës; intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur; rrethanat në të cilat është kryer vepra; sjelljen e mëparshme të atij që ka kryer veprën penale; pranimin e fajit prej tij, rrethanat personale të autorit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale.

Edhe pse në arsyetimet e vendimeve gjykatat konstatojnë se kryerja e veprave penale nga punonjës të policisë paraqet rrethanë rënduese, dënimet e dhëna janë të buta dhe joefektive në arritjen e qëllimit të ligjit. Qëllimet e dënimit, të përcaktuara me nenin 41 të KPK janë:

- të parandalojë kryerjen e veprave penale në të ardhmen nga i dënuari dhe të bëjë rehabilitimin e tij;
- të parandalojë kryerjen e veprave penale nga persona të tjerë;
- të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale;
- të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke zbatuar një politikë ndëshkimore të butë në rastet e korrupsionit, gjykatat në Kosovë nuk ndihmojnë për parandalimin poziti he luftimin e korrupsionit, përkundrazi,

Duke dhënë dënime të buta me burg apo dënime me kusht dhe me gjobë, gjykatat përçojnë mesazhe jo të qarta te qytetarët. Këto dënime të buta nuk mund të arrijnë qëllimin e vet, për të cilat janë shqiptuar, qoftë atë të karakterit ndëshkimor ndaj atyre, të cilët janë gjetur fajtorë se kanë kryer vepra penale të korrupsionit, apo të karakterit preventiv, i cili ka për qëllim për të dërguar mesazhin e qartë te personat, të cilët mund të jenë subjekt i kryerjes së veprave penale të korrupsionit (IKD, 2016:109).

6.7 Sfidat në administrimin e hetimeve penale ndaj zyrtarëve policorë

Lidhur me hetimin penal ndaj zyrtarëve policorë strukturat përkatëse përballen me mjaft probleme. E kemi fjalën këtu për vështirësitë që nisin qysh në identifikimin e hershëm të indikacioneve se është duke ndodhur veprimtari kriminale; më pas vijojnë ndërlikimet e ndryshme në vetë procesin hetimor, në dokumentimin dhe argumentimin në procedurën penale, si dhe në vërtetimin e gjendjes faktike në proceset gjyqësore.

“E vërteta materiale nënkupton vërtetimin e plotë të të gjitha fakteve relevante nga të cilat varet zbatimi i së drejtës penale materiale dhe i së drejtës së procedurës penale, duke e përputhur gjendjen faktike, të vërtetuar me vendim gjyqësor, me ngjarjen reale e cila është marrë si vepër penale.” (Sahiti, 2006:16).

Problemi është se kemi të bëjmë me raste kur autorë veprash penale, janë zyrtarë policie, të cilët, në fakt, për nga funksioni që kanë, janë të ngarkuar me luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Si të tillë, nga trajnimet e marra, ata zotërojnë njohuri për provat, për teknikën kriminalistike, për hetimin e vendit të ngjarjes, për metodat hetimore etj. Problemi është se këto njohuri ata mund t'i përdorin për manipulim dhe për fshehje të krimit.

Shqetësues është dhe zbulimi i veprave penale të korrupsionit të kryer nga zyrtarët e policisë. Kjo ndodh, pasi, ndryshe nga shumë krime të tjera, sikurse vrasjet me armë apo vjedhjet, korrupsioni shpesh nuk ka ndonjë viktimë të dukshme, nuk ka viktima që të ankohen. Për më tepër, në të shumtën e rasteve, veprimet korruptive kryhen në fshehtësi, nuk janë shumë të dukshme që të zbulohen dhe të raportohen nga dëshmitarë. Sidomos në rastet e dhënies dhe marrjes së mitës, si një nga format më të shpeshta të korrupsionit, ku, edhe dhënësi, edhe marrësi i mitës bëjnë marrëveshje, e cila, në parim, është e fshehtë dhe pa dëshmitarë në të shumtën e rasteve, vepra penale e vështirë për t'u zbuluar.

Megjithatë, duhet thënë se edhe korrupsioni nuk është krim pa viktima. Në shumë raste, ai që e pëson nga veprat korruptive është interesi i përgjithshëm publik. Në mungesë të vetëdijes për këtë, zyrtarët policorë vështirë se do të dëshirojnë të rrezikojnë të përballen me pasoja personale, si profesionale, ashtu edhe sociale, duke raportuar krimet dhe veprat e korrupsionit të kolegëve të tyre dhe, akoma më pak, të veprave korruptive të mbikëqyrësve të tyre.

Një tjetër aspekt që duhet konsideruar gjatë procedurës së administrimit të veprave penale të kryera nga zyrtarët policorë në cilëndo organizatë policore, jo vetëm në PK, është fakti se raportet ndërmjet vetë zyrtarëve policorë janë të veçanta. Bëhet fjalë për një profesion të veçantë, ku zyrtarët përballen me sfida të shumta, por edhe me

rreziqe e kërcënime gjatë karrierës së tyre, prandaj besimi i ndërsjellë dhe solidariteti janë shumë të pranishëm. Kjo shpie në krijimin në organizatë të një kulture sjelljeje, që mund të ndikojë që një zyrtar policor të “mbyllë syrin” në raste të shkeljeve disiplinore apo penale nga kolegu i tij. Kjo krijon vështirësi në kontrollin dhe zbulimin e korrupsionit brenda organizatës, në parandalimin e veprave penale, por edhe gjatë hetimit të veprave të kryera. Gjatë procedurës hetimore, “si dëshmitarë në krimin e shpërdorimit të detyrës zyrtare thirren punonjësit e institucionit ku punon punonjësi si dhe persona ose punonjës të tjerë, me veprimtarinë e të cilëve ka lidhje veprimtaria e këtij punonjësi” (Begeja,S., 2004:597).

Nëse ka hezitim për të njoftuar me kohë veprën penale, korrupsionin, konfliktin e interesit apo sjellje të tjera të pahijshme, do të jetë më e vështirë edhe për organin hetues zbulimi, ndjekja dhe dokumentimi i ekzistimit të veprës penale. Aq më tepër, nëse organi hetues nuk i merr në konsideratë marrëdhëniet e zyrtarëve policorë dhe ato të mbikëqyrësve të tyre. Autorët Kenney dhe McNamara, në librin “Police and Policing”, duke analizuar korrupsionin brenda departamenteve policore, veçojnë marrëdhëniet mes policëve, por nënvizojnë edhe efektin që ka modeli i udhëheqjes nga zyrtarët komandues.

Është vështirë për të huajt të çmojnë veçantinë e marrëdhënies së zyrtarit policor me zyrtarin policor, të mbikëqyrësve me ata që komandojnë. Sjellja e zyrtarit policor shpesh përcaktohet nga sjelljet e të tjerëve: partnerëve të tyre, mbikëqyrësve të tyre të drejtpërdrejtë, zyrtarëve ekspertë dhe me përvojë në terren brenda njësive të tyre dhe, më e rëndësishmja, zyrtarëve të tyre komandues. Nuk ka profesion tjetër në të cilin vlera e modeleve ndiqet apo ndikon më shumë. (Kenney,McNamara,1999:218).

Identifikimi dhe raportimi i veprave penale të kryera nga zyrtarët policorë mund të jetë problem i madh edhe për qytetarët, të cilët mund të jenë viktimë e shkeljes së të drejtave të tyre drejtpërsëdrejti apo që thjesht mund të jenë në dijeni për ndonjë vepër penale të kryer nga një zyrtar policie. Kjo çështje ka të bëjë me kulturën, me traditën e ndërtuar të bashkëpunimit të publikut me organet shtetërore, me nivelin e besimit që

qytetarët kanë tek institucionet shtetërore, te mekanizmat për mbikëqyrje dhe kontroll dhe me mënyrën e procedimit dhe administrimit të rasteve. Në fakt, nuk duket të jetë e lehtë për një qytetar ta akuzojë një zyrtar publik e sidomos një zyrtar policor për ndonjë vepër penale, nëse nuk është i sigurt se rasti do të trajtohet me tërë fuqinë e ligjit. Në vendet që kanë ndërtuar mekanizma efikasë dhe të besueshëm të luftimit të korrupsionit dhe të hetimit të pavarur të veprave penale, ka një përkrahje shumë më të madhe të qytetarëve në raportimin, identifikimin, zbulimin dhe argumentimin e shkeljeve të ligjit nga zyrtarët. Një rol të madh në këtë drejtim në Kosovë mund të luajë IPK, sidomos në rastet e veprave penale specifike. Kjo agjenci, luan një rol të veçantë me ndihmën për viktimat e dhunës në familje, kur autorë të saj janë punonjës policie. Megjithatë kjo njësi nuk ka kontakt aq të shpeshtë me viktimat, sa kanë aktorët e tjerë, “ajo ka një përgjegjësi të madhe për t’i mbrojtur viktimat nga kryesit e dhunës në familje. Anëtarët e Inspektoratit të Policisë duhet të marrin rolin e policit dhe t’u ofrojnë informata viktimave, t’i udhëzojnë ato gjatë procesit dhe, po ashtu, t’i njoftojnë aktorët e tjerë”(Agjencia për Barazi Gjinore, 2013:22)

Në ato vende ku organizatat policore kanë nivel të lartë të korrupsionit dhe mungesë të kontrollit demokratik është e kuptueshme që qytetarët e kanë të vështirë të bashkëpunojnë me organet e hetuesisë, për shkak të frikës se mund të përballen me pasoja, me dhunë, me keqtrajtime apo kërcënime nga vetë policia.

Këto sfida duhen marrë parasysh nga drejtuesit e organizatës dhe duhen bërë përpjekje për krijimin e mundësive të përshtatshme, të besueshme dhe joburokratike për raportimet e qytetarëve që dëshirojnë të denoncojnë çdo lloj krimi, përfshirë edhe ato të kryera nga punonjësit e policisë. Procedurat për verifikimin e informatave mbi dyshimet e ngritura duhet të kryhen shpejt dhe në mënyrë profesionale, pasi kështu reflektohet

besim te qytetarët dhe forcohet bashkëpunimi me publikun. Kjo kërkon përkushtim dhe angazhim afatgjatë për të fituar dhe ruajtur besimin e qytetarëve.

Nuk janë të mjaftueshme disa veprime me të cilat u mundësohet qytetarëve të shprehin ankesat apo shqetësimet e tyre përmes linjave të veçanta telefonike apo përmes postës elektronike, qoftë edhe në formë anonime, nëse ato nuk shoqërohen me veprime dhe masa konkrete dhe transparente.

Qasja ndaj informacioneve për ekzistimin e krimit apo të një dukurie kriminale dhe fillimi i menjëhershëm i hetimit të tyre bëhen me metodën reaktive dhe metodën proaktive.

Metoda reaktive është metodë tradicionale e hetimit të veprave penale. Ajo nënkupton reagimin e autoriteteve të zbatimit të ligjit, respektivisht, të organit hetues, kur bëhet një ankesë formale apo jepet informacion për ndonjë krim, incident apo aksident. Informacioni apo ankesa mund të vijnë nga qytetarët, nga mediat, nga shoqëria civile, nga vetë agjencitë e zbatimit të ligjit, nga organe të tjera, si ato të inspektimit, të auditimit etj. E përbashkëta e këtyre informacioneve është se nxit reagimin e autoritetit për veprim, pavarësisht se informacioni është i nënshkruar apo anonim. Mirëpo, në aspektin e parandalimit të veprave penale, kjo metodë nuk është shumë efikase, veçanërisht për parandalimin dhe zbulimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit.

Metoda apo qasja proaktive është bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse për luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Për aplikimin e saj, PK ka hartuar Strategjinë e Policimit në Komunitet dhe Strategjinë Policimit të udhëhequr nga Inteligjenca. Përmes këtyre dy strategjive synohet që Policia të jetë sa më afër qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre. Për këtë qëllim janë krijuar edhe mekanizmat e nevojshëm, si: Këshillat Komunalë për Siguri të Bashkësive, Komitetet Lokale për Siguri Publike,

ekipet vepruese për siguri të bashkësive me përfshirje të institucioneve qendrore dhe vendore, drejtuesit e komuniteteve, organizatat joqeveritare, si dhe sektori privat.

Kjo qasje mund të përdoret edhe për parandalimin dhe hetimin e shkeljeve të ligjit brenda radhëve të Policisë dhe për forcimin e kontrollit të brendshëm në të. Kjo nënkupton përdorimin e informacioneve nga burime të ndryshme, të dhëna statistikore, raporte analitike, informatorët, aplikimin e teknikave të fshehta hetimore etj. Mbi bazën e këtij informacioni, agjencia e zbatimit të ligjit planifikon dhe ndërmerr masat për parandalimin dhe luftimin më efikas të krimit dhe të korrupsionit. Pra, nuk kemi thjesht një reagim pas incidentit apo krimit, por veprime aktive për identifikimin e hershëm të personave të përfshirë në krim, të qëllimeve të tyre, të mjeteve dhe mundësive që ata posedojnë, të lidhjeve të tyre dhe viktimat potenciale.

Kjo metodë është shumë e rëndësishme për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe shumë efikase edhe për hetimin e veprave penale të kryera nga zyrtarët policorë.

KREU VII: PERSONELI POLICOR, MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI INSTITUCIONAL I POLICISË SË KOSOVËS

7.1 Vështrim hyrës

Niveli i korrupsionit të zyrtarëve publikë është determinues për nivelin e sigurisë së përgjithshme në vend, të qeverisjes së mirë dhe të stabilitetit ekonomik, social dhe politik. Ai është kthyer në një fenomen problematik për shoqërinë në vende të ndryshme të botës, pasi cenon drejtpërsëdrejti efikasitetin e qeverive në realizimin e detyrave kombëtare dhe ato në shërbim të shtetasve. “Sipas shumë mendimeve, korrupsioni në administratën publike është fenomen i përhapur dhe një kufizim serioz i aftësisë së qeverisë për të përmbushur objektivat e saj.” (Rosenbloom, Kravchuk, 2005:521).

Edhe në Kosovë, siç thuhet në një Progres Raport të KE mbi Kosovën, të vitit 2014: “Korrupsioni mbetet i pranishëm në shumë fusha, përfshirë prokurimin publik; vazhdon të jetë problem serioz dhe duhet të adresohet në mënyrë urgjente. Nevojitet përkushtim i vërtetë politik për të shndërruar përpjekjet në rezultate reale në luftën kundër korrupsionit.” (European Commission, Kosovo Progress Report 2014:16). Po ashtu, në mjaft analiza, studime dhe raporte të organizatave joqeveritare, të mediave, të institucioneve të tjera të Kosovës mbi përfshirjen e zyrtarëve të lartë, gjykatësve, prokurorëve, zyrtarëve policorë etj. në afera korruptive, vihet në dukje se këto raste janë të shumta dhe meritojnë vëmendje dhe një luftë më efikase për evitimin dhe parandalimin e tyre.

Korrupsionin e bëjnë personat që kanë pushtet, një post zyrtar, një përparësi etj., por edhe persona që kanë halle ose që janë mashtrues, biznesmenë, trafikantë dhe persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kjo e bën dukurinë e korrupsionit shumë komplekse dhe të vështirë për t’u zbuluar dhe për t’u luftuar. Në këto kushte, lufta

kundër veprave korruptive të personave zyrtarë, të politikës, të administratës, të gjykatave, prokurorisë, policisë etj., veç të tjerash, lidhet me menaxhimin e personelit, me trajnimin, me mbikëqyrjen e tij, me kontrollin, këshillimin, vlerësimin, disiplinimin dhe me llogaridhënien e punonjësve të të gjitha niveleve. Këtë të fundit, pra, mungesën e llogaridhënies, studiues të ndryshëm e shohin si një nga faktorët kryesorë institucionalë që ndihmojnë korrupsionin. Në një punim me titull “Korrupsioni në polici”, lidhur me këtë faktor lexojmë:

“Korrupsioni në polici reflekton mungesë të llogaridhënies institucionale; menaxherët dhe mbikëqyrësit policorë e përlegjin keqpërdorimin e zyrtarëve të tyre apo i nënshtrohen edhe vetë. Korrupsioni, detyrimisht, shfaqet kur mbikëqyrësit mbyllin njërin sy ndaj sinjaleve të keqpërdorimit të policisë.” (Kos, 2008:54)

Shumë i rëndësishëm është edhe krijimi i një sistemi funksional të forcimit të disiplinës në organizatë. Ky është një problem i mprehtë, edhe për organizatat policore, edhe për ato të zbatimit të ligjit, në përgjithësi. Forcimi i disiplinës së punonjësve policorë dhe kontrolli i saj ndikon jo vetëm në krijimin e një imazhi të mirë në publik për policinë, por, në të njëjtën kohë, ndikon në kryerjen me përgjegjshmëri të detyrave dhe siguron shërbime efikase dhe profesionale ndaj qytetarëve, respektim të të drejtave të tyre.

Një sistem i mirë, me mekanizma efikasë të menaxhimit të disiplinës në polici, të kontrollit dhe të mbikëqyrjes, ndikon fuqishëm në parandalimin e sjelljeve të pahijshme, të shpërdorimit të detyrës, të korrupsionit dhe të kryerjes së veprave penale nga punonjësit e policisë. Përpjekjet e drejtuesve dhe të këtyre mekanizmave duhet të orientohen në mbikëqyrjen e vazhdueshme të ndryshimit të sjelljes dhe të qëndrimeve të personelit, në raport me detyrat dhe me përgjegjësitë e tyre. Identifikimi i hershëm i indikacioneve të sjelljeve devijante të ndonjë zyrtari policor dhe i faktorëve që ndikojnë në këto sjellje është e rëndësishme në identifikimin e zyrtarëve që duhet të mbahen nën mbikëqyrje më intensive, të këshillohen, të ndihmohen në punë. Autorët, Thibault,

Lynch, McBride, por edhe Swanson, Territo, Taylor, kanë trajtuar nevojën për krijimin e një sistemi të paralajmërimit të hershëm për identifikimin e zyrtarëve problematikë:

Është i mundshëm menaxhimi i rrezikut të zyrtarëve policorë që përfshihen në korrupsion apo në sjellje brutale, duke zhvilluar një sistem të paralajmërimit të hershëm për të identifikuar zyrtarët që janë në rrezik. Ky sistem i paralajmërimit të hershëm funksionon më së miri në departamentet që janë të përkushtuar në zbulimin dhe në punën me zyrtarët problematikë. Ndalon problemet e fshehura të rriten dhe të bëhen skandale të mëdha policore dhe e bën të vështirë që departamentet t'i injorojnë dhe t'i mbulojnë sjelljet e zyrtarëve problematikë (Thibault, Lynch, McBride, 2007:267).

Këtë ide e kanë edhe autorë të tjerë, të cilët shtjellojnë edhe se çfarë përfaqëson në vetevete sistemi i paralajmërimit të hershëm. Ata përcaktojnë se:

Sistemi i paralajmërimit të hershëm është një mjet menaxhimi i bazës së të dhënave të policisë, i projektuar për të identifikuar zyrtarët me sjellje problematike dhe për të ndërhyrë për përmirësimin e performancës së tyre. Si përgjigje, departamenti reagon në kohë, para se një zyrtar i tillë të vijë në atë situatë ku rrezikon të kryejë shkelje disiplinore. Sistemi lajmëron departamentin për këta individë dhe i paralajmëron zyrtarët që gjatë këshillimit apo trajnimit t'i ndihmojnë ata të përmirësojnë sjelljet e tyre problematike. (Swanson, Territo, Taylor, 2005:416)

Sistemi i mirëfilltë i administrimit të disiplinës fillon me gatishmërinë dhe me vullnetin e policisë për pranimin dhe shqyrtimin e të gjitha ankesave të publikut ndaj zyrtarëve të saj, pavarësisht nga mënyra e shprehjes së ankesës. Edhe në rastet kur policia ballafaqohet me ankesa edhe nga qytetarë që ankohen për veprimet e policëve në rastet e dhënies së gjobave në qarkullimin rrugor, të sekuestrimit të pasurisë, të ndalimit, arrestimit, përdorimit të forcës etj., ankesat duhet të pranohen si e drejtë legjitime dhe kushtetuese e qytetarëve dhe duhet të shqyrtohen me profesionalizëm, shpejt dhe duke respektuar parimin e ligjshmërisë dhe të etikës. Reagimi i shpejtë dhe i drejtë ndaj ankesave të qytetarëve dhe marrja e masave disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë gabuar, është një detyrë e rëndësishme në funksion të respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, por, njëkohësisht, edhe të ruajtjes dhe forcimit të imazhit të policisë.

Zyrtarët policorë që bëhen subjekt të hetimit disiplinor gëzojnë të drejtat e tyre, ndaj duhet të trajtohen mbi parimin e ligjshmërisë dhe me dinjitet. Provat dhe pretendimet duhet të administrohen mirë dhe kjo kërkon angazhim dhe përkushtim të

zyrtarit mbikëqyrës apo hetues, në mënyrë që procesi hetimor të mos ndikojë në motivimin për punë të zyrtarëve që janë nën hetim, si në rastin kur hetimet përfundojnë me masë disiplinore, ashtu dhe kur përfundojnë se akuzat janë të pabazuara.

“Mbikëqyrësi që heton ankesën kundër vartësit të tij duhet të ndjekë çdo kanal hetimi në dispozicion të tij në kërkimin e së vërtetës. Ai duhet të mbetet objektiv në qasjen e tij dhe të shmanget nga nxjerrja e përfundimeve të pafajësisë apo fajësisë para se të njihen faktet.” (Iannone, Iannone, 2001:247).

Kjo ka të bëjë me faktin se në gjithë këtë proces kurrësi nuk duhen neglizhuar të drejtat legjitime të punonjësve të policisë për t’u mbrojtur nga akuzat e pabaza.

“Qëllimet parësore në administrimin e veprimeve të hetimit efektiv të ankesave ndaj personelit janë mbrojtja e integritetit dhe e reputacionit të forcës policore, mbrojtja e interesit publik dhe mbrojtja e zyrtarit të akuzuar nga akuzimi i padrejtë” (Iannone, Iannone, 2001:215).

Në funksion të kësaj, procesi i hetimit dhe dhënia e masave disiplinore duhet të jenë në pajtueshmëri të plotë me normat ligjore. Gjithashtu, duhet pasur parasysh që ato i shërbejnë ruajtjes së rendit dhe të disiplinës në polici, nxisin llogaridhënien dhe transparencën. Por ajo që ka edhe më shumë rëndësi është se këto masa rrisin besimin e publikut te policia, ndihmojnë krijimin në polici të një mjedisi ku punohet profesionalisht dhe në mënyrë të paanshme. Po ashtu, ato krijojnë një klimë bashkëpunimi të mirë me qytetarët, me mediat, me shoqërinë civile dhe me institucionet dhe organizatat partnere.

Nuk ka asnjë dyshim se në organizatat policore, ku rendi, disiplina dhe vlerat etike janë në nivelin e duhur, gjasat që personeli të përfshihet në vepra penale dhe në korrupsion janë më të vogla. Në të kundërtën, mungesa e etikës në sjellje, shkeljet e shpeshta të disiplinës, ankesat e shumta të qytetarëve, tejkalimi i kompetencave, veprimet e njëanshme apo mosveprimi sipas detyrës dhe menaxhimi joefikas i disiplinës në organizatë, lënë shteg për shkelje të rënda të ligjit, kryerje të veprave penale dhe të korrupsionit.

Në vende të ndryshme janë ndërtuar modele dhe praktika të ndryshme për mbikëqyrjen e organizatave policore, varësisht nga rregullimi shtetëror, nga legjislacioni, por edhe nga nevoja për kontroll dhe mbikëqyrje për shkak të nivelit të korrupsionit, sfidave të ndryshme apo kërkesave të tjera të kohës. Në vendet demokratike organizatat policore u kushtojnë rëndësi administrimit të disiplinës, ndërtimit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe u nënshtrohen mekanizmave të kontrollit të jashtëm dhe mbikëqyrjes nga institucionet legjitime. Në këtë drejtim, edhe në Kosovë është shënuar një progres në krijimin e procedurave administrative dhe ligjore për disiplinën, kontrollin dhe për mbikëqyrjen e PK-së.

7.2 Personeli policor dhe çështjet etike

Sipas Ligjit për Policinë, PK-ja punëson tri kategori punonjësish: *zyrtarë policorë* që bëjnë betimin dhe kanë autoritet t'i ushtrojnë dhe t'i kryejnë kompetencat dhe detyrat policore; *staf civil*, që kryen shërbime mbështetëse dhe administrative, por nuk ka autoritet të ushtrojë kompetenca policore; dhe *kadetë policorë*.

Policia e Kosovës numëron 8705 persona, prej tyre 7606 zyrtarë policorë dhe 1099 personel civil. Në aspektin gjinor, personeli nën uniformë përbëhet nga 88.57% meshkuj dhe 11.43% femra. Ndërsa nga i tërë personeli, me uniformë dhe ai civil, janë 85.79% meshkuj dhe 14.21% femra. Për sa i përket strukturës etnike, PK-ja ka 83.80% shqiptarë dhe 16.20% janë zyrtarë të minoriteteve, prej të cilëve janë: 12% serbë, 2.32% boshnjakë, 0.71% zyrtarë të minoritetit turk e kështu me radhë.

Tabela 3: Personeli i Policisë së Kosovës

POLICIA E KOSOVËS	PERSONELI SIPAS GRADAVE											TOTALI ZYRTAR POLICOR	STAF CIVIL	TOTALI I PERSONELIT
	DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË	ZV.DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË	DREJTORI I DEPARTAMENTIT TË POLICISË	KOLONEL	NËNKOLONEL	MAJOR	KAPITEN	TOGER	RESHTER	ZYRTAR POLICOR	POLIC I RI			
DPP DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË	1			4	4	4	5	11	8	20		57	19	76
ZV.Drejt i Përgjithshëm për OPERATIVË		1		1	1	2	4	12	33	25		79	13	92
Drejtori i Departamentit për OPERACIONE			1			1						2	1	3
Divizioni i Komunikacionit Rrugor				1	1	1	1	2	8	47		61	8	69
Divizioni i Njësive të Specializuara					1	3	10	18	95	925		1052	25	1077
Divizioni i Sigurisë Publike					1		4	3	1	2		11	3	14
DRP - PRISHTINË				0	1	4	15	40	109	817	141	1127	140	1267
DRP - MITROVICË JUG				0	3	2	5	21	50	378		459	75	534
DRP - MITROVICË VERI				0	0	6	4	22	13	453		498	55	553
DRP - PEJË				1	2	1	6	27	67	454		558	80	638
DRP - GJAKOVË				0	2	3	6	16	34	213		274	48	322
DRP - PRIZREN				0	3	3	8	23	72	368		477	77	554
DRP - GJILAN				1	2	2	11	31	64	459		570	82	652
DRP - FERIZAJ				0	1	1	9	18	49	350		428	80	508
Drejtori i Departamentit për KUFIT	0	0	1	0	0	1	1	1	0	0		4	6	10
Divizioni i Kontrollës dhe Mbikëqyrjes së Kufirit	0	0	0	0	3	3	15	41	158	1031		1251	38	1289
Divizioni për Menaxhim të Integruar të Kufirit	0	0	0	2	1	2	1	7	8	28		49	1	50
Drejtori i Departamentit për HETIME			1		1	1	5	1	15	8		32	4	36
Divizioni për Hetimin e Krimeve					3	3	14	35	67	142		264	14	278
Divizioni Kundër Krimit të Organizuar					1	4	3	26	75	143		252	7	259
ZV.Drejt i Përgj. për RESURSE		1			1	1				1		4	4	8
Drejtori i Departamentit për Burime Njerëzore			1	1				1				3	2	5
Divizioni i Personelit dhe Administratës				1	2	2	2	2	3			12	37	49
Divizioni i Trajnimeve				1	3	1	8	6	26	21		66	7	73
Drejtori i Depart. për SHËRBIME MBËSHTETËSE			1					1	1	3		6	231	237
Drejtoria e TIK					1		2	1	2	3		9	42	51
Agjensioni i Laboratorit								1				1		1
TOTALI I PËRGJITHSHËM	1	2	5	13	38	51	139	367	958	5891	141	7606	1099	8705

Burimi: Policia e Kosovës

Tabela 4: Struktura e Personelit të Policisë së Kosovës

Personeli sipas përkatësisë etnike (PK-SC)							Zyrtar Policor		KRAHASIMI GJINOR	
Gjinia	Zyrtar Policor			Staf Civil			Staf Civil			
	Meshkuj	Femra	Totali	Meshkuj	Femra	Totali	Totali	Totali %	M/ Z.Polico	88.57%
Shqiptar	5582	733	6315	680	300	980	7295	83.80%	F/ Z.Polico	11.43%
Serb	867	91	958	36	55	91	1049	12.05%	M/ S.Civil	66.52%
Turk	47	9	56	2	4	6	62	0.71%	F/ S.Civil	33.48%
Boshnjak	158	30	188	9	5	14	202	2.32%	M / Total	85.79%
Rom	11	2	13	0	1	1	14	0.16%	F / Total	14.21%
Ashkali	16	0	16	1	0	1	17	0.20%		
Çerkez	2	0	2	0	0	0	2	0.02%	KRAHASIMI ETNIK	
Egjiptas	6	0	6	0	0	0	6	0.07%		
Goran	37	1	38	3	1	4	42	0.48%	Shqiptar	83.80%
Malazias	2	1	3	0	0	0	3	0.03%	Të tjerë	16.20%
Kroat	2	1	3	0	1	1	4	0.05%		
Maqedonas	1	1	2	0	0	0	2	0.02%		
Slloven	6	0	6	0	1	1	7	0.08%		
Totali	6737	869	7606	731	368	1099	8705	100.00%		

Burimi: Policia e Kosovës

Në përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve të brendshme të kontrollit dhe të

luftimit të korrupsionit, forcimit të etikës policore dhe integritetit profesional Policia e

Kosovës është bazuar në ligjet dhe objektivat nacionale dhe është udhëhequr nga parimet e konventave dhe dokumenteve ndërkombëtare të inkorporuara në legjislacionin e Kosovës. “Normat dhe standardet ndërkombëtare janë shumë të rëndësishme për policinë e çdo shteti, ngase sigurojnë koherencë midis kompetencave ligjore të policisë dhe ndalesave të parapara me normat e etikës dhe të moralit të profesionit të policisë.” (Salihu,I., 2005:86).

Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka luajtur personeli i policisë ndërkombëtare gjatë misionit në Kosovë, përmes projekteve të ndryshme për mbështetjen e PK-së. Çështjet etike dhe parandalimi i korrupsionit kanë qenë prioritet i policisë që nga themelimi. Sipas nenit 7 të Kodit të Kombeve të Bashkuara, të Sjelljes për Zyrtarë të Zbatimit të Ligjit, zyrtarët e zbatimit të ligjit nuk duhet të kryejnë akte korrupsioni, por në mënyrë rigoroze duhet t’i kundërshtojnë dhe t’i luftojnë të ato.

Çdo vepër korrupsioni, ashtu si keqpërdorimet e tjera të autoritetit, nuk përkon me profesionin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit. Ligji duhet të zbatohet tërësisht për çdo zyrtar të zbatimit të ligjit që kryen ndonjë vepër korrupsioni, pasi qeveria nuk mund të zbatojë ligjin ndaj qytetarëve të vet, nëse zyrtarët e zbatimit të ligjit nuk mund apo nuk duan të zbatojnë ligjin ndaj agjentëve të vet dhe brenda agjencive të veta. (UN,1979).

Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, në Kreun II, *Masat parandaluese*, Neni 5, *Politikat dhe praktikat parandaluese kundërkorrupsion* përcakton:

Çdo shtet, në pajtim me parimet themelore të sistemeve të veta ligjore, zhvillon dhe zbaton apo ndjek kundër korrupsionit politika efektive, të koordinuara, që promovojnë pjesëmarrjen e shoqërisë dhe reflektojnë sundimin e ligjit, menaxhimin e duhur të çështjeve publike dhe të pasurisë publike, të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies (UNODC, 2004:5)

Siç është trajtuar edhe në kreun e dytë të këtij studimi, mungesa e një përkufizimi unik të korrupsionit nuk duhet të jetë pengesë për luftimin e tij. Edhe në memorandumun shpjegues të Këshillit të Europës, lidhur me Kodin European të Etikës Policore për korrupsionin policor dhe për masat kundër tij, theksohet mungesa e një

përkufizimi unik ndërkombëtar të termit *korruption*, por, njëkohësisht, në të jepet edhe e përbashkëta që ka në kuptimin e korrupsionit:

Nuk ekziston ndonjë përkufizim i përbashkët ndërkombëtar për korrupsionin. Cilësimi se çka duhet konsideruar korrupsion ndryshon nga një vend në tjetrin. Konventa Penale mbi Korrupsionin, i miratuar nga Këshilli i Europës në vitin 1999, nuk ofron një përkufizim uniform për korrupsionin. Megjithatë, ligji synon zhvillimin e standardeve të përbashkëta lidhur me shkeljet e caktuara korruptive, siç është ryshfeti (aktiv dhe pasiv). Termi “korrupsion policor” përdoret shpesh për të përshkruar një gamë të gjerë veprimesh, si ryshfeti, fabrikimi apo shkatërrimi i provave, favorizimi, nepotizmi etj. Ajo që është e përbashkët në kuptimin për korrupsionin policor është se detyrimisht ai përfshin keqpërdorimin e pozitës dhe keqpërdorimin e të qenit zyrtar policor. (Council of Europe, 2002:44).

Në shumicën e vendeve, tashmë, janë dhënë përkufizime ligjore dhe është vendosur penalizimi i korrupsionit. Duke iu referuar Këshillit të Europës, në çdo vend merren masa efektive në organizatën policore, në të gjitha nivelet, për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin në polici.

Në përputhje me Kodin European të Etikës Policore, në Kosovë është hartuar Ligji për Policinë dhe Kodi i Etikës së PK-së. Kodi i Etikës i PK-së është hartuar mbi bazën e parimeve të cekura më lart, por edhe të dokumenteve të tjera. Ai është nënshkruar nga ministri i Punëve të Brendshme. Në nenin 2 të Ligjit për Policinë jepen parimet udhëzuese, mbi të cilat duhet të udhëhiqet PK-ja, parime që janë të përcaktuara nga Këshilli i Europës:

Parimet udhëzuese sipas ligjit të policisë, aktet e brendshme rregullative, procedurat e punës, planet strategjike, planet e trajnimit dhe edukimit, si dhe vlerësimi i performancës duhet të reflektojnë siguri dhe vullnet për një shërbim policor me dinjitet dhe respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive të njeriut. Organizata policore duhet të marrë masa efikase për të siguruar integritet dhe performancë të mirë të stafit policor, në veçanti, për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore individuale, siç parashihen, posaçërisht, në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. (Council of Europe, 2002:44)

Sipas ligjit, personeli i PK-së, në të gjithë sektorët, operon në bazë të rregulloreve dhe procedurave të shkruara, transparente, të cilat lehtësojnë kryerjen e detyrave dhe ndihmojnë në vlerësimin e drejtë të rezultateve të punës. Të punësuarit në polici kanë kontrata pune, ku fiksohen të drejtat dhe detyrat e tyre sipas legjislacionit në

fuqi. Kjo ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë në organizatë, në ruajtjen e stafit me përvojë, në motivimin dhe përkushtimin e punojësve në punë.

Për ruajtjen dhe forcimin e integritetit policor dhe për parandalimin e shkeljeve të Kodit të Etikës, të shkeljeve ligjore dhe të kryerjes së veprave penale nga zyrtarët e PK-së, përcaktuese dhe shumë të rëndësishme janë funksionet e menaxhimit të personelit në polici. Këtu kemi parasysh planifikimin e burimeve njerëzore, përcaktimin e kriterëve për punësim, procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjes së punonjësve policorë, punësimin dhe caktimin në pozitë të tyre, zhvillimin e karrierës, trajnimin dhe formimin profesional, vlerësimin e performancës, por edhe të shpërblimit. Të gjitha kërkojnë vëmendje të madhe të stafit menaxhues, për të realizuar krijimin e një ambienti pune të udhëhequr nga vlerat etike dhe profesionale.

Në tërë këtë punë, drejtuesit e policisë kanë një rol të rëndësishëm për krijimin e një profili zyrtari policor, që ngre lart të drejtat e individit dhe parimet e mosdiskriminimit brenda organizatës së policisë, por edhe në marrëdhëniet me publikun. Qytetarët në demokraci kanë të drejtë të gëzojnë trajtim të drejtë, të paanshëm dhe të pritshëm nga policia. Sjellja e forcave policore ndaj publikut mund të shihet si një nga treguesit kryesorë të cilësisë së demokracisë në një vend. (IPU&DCAF, 2003:61)

Rëndësia e etikës në administrimin e personelit, trajtohet edhe nga shumë studiues. Në librin “Public Personnel Administration, Problems and Prospects”, autorët Hays dhe Kearney theksojnë:

Gjasat për arritjen dhe ruajtjen e integritetit organizativ rriten kur zyrtarët e lartë janë shembull i lidershit të ndershëm, aplikojnë një kredo organizative që promovon vlera aspiruese, kryejnë auditimin e etikës dhe hartojnë e zbatojnë kodin e etikës. Shikimi i etikës si kriter për punësim dhe promovim, faktorizimi i etikës në vlerësimin e performancës, përfshirja e etikës në programet e menaxhimit dhe trajnimit të punonjësve, rritin më shumë gjasat për institucionalizimin e sjelljes etike. Përveç kësaj, programet orientuese që kanë të bëjnë me çështjet e etikës, politikat e pagave, që shpërblejnë sjelljen etike dhe produktive, dhe paanësia në trajtimin e disiplinës dhe veprimeve negative, gjithashtu, rrisin frymën e etikës. (Hays, Kearney, 2003:313)

Në Policinë e Kosovës i kushtohet kujdes etikës policore. Trajnimet e zyrtarëve të saj në këtë fushë zhvillohen kryesisht në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, e cila, me hyrjen në fuqi më 26 mars të vitit 2008, të Urdhërësës Administrative të

UNMIK-ut nr.2008/3, funksionon si agjenci ekzekutive e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Më poshtë po trajtojmë hollësisht funksionet e menaxhimit të personelit në polici.

7.2.1 Procesi i rekrutimit në Policinë e Kosovës

Procesi i rekrutimit në organizatat policore është hapi i parë i rëndësishëm për të siguruar personel të kualifikuar dhe me integritet të lartë personal. Kjo çështje është vitale për PK-në, e cila, si një organizatë policore shumetnike dhe që vepron në një ambient shumetnik, duhet t'u kushtojë kujdes të përhershëm konceptit të barazisë etnike, diversitetit, vlerave etike dhe integritetit profesional. Lidhur me këtë proces, në PK mbahen mirë parasysh udhëzimet e Këshillit të Europës, si:

Personeli policor, në cilindo nivel që pranohet, duhet të rekrutohet mbi bazën e kualifikimeve dhe përvojës së tyre personale, e cila duhet të jetë e përshtatshme për qëllimet e policisë. Personeli policor duhet të jetë në gjendje të demonstrojë gjykim të shëndoshë, qëndrim të hapur, pjekuri, paanësi, aftësi komunikative dhe, aty ku kërkohet, aftësi drejtuese dhe menaxheriale. Për më tepër, ata duhet të kenë njohuri të mira rreth çështjeve sociale, kulturore dhe të komunitetit. Personat e dënuar për krime të rënda skualifikohen nga puna policore. Procedurat e rekrutimit duhet të kenë bazë objektive dhe jodiskriminuese, të ndiqen nga verifikimet e nevojshme të kandidatëve. Për më tepër, kjo politikë duhet të synojë rekrutimin e meshkujve dhe femrave nga pjesë të ndryshme të shoqërisë, përfshirë grupet e minoriteteve etnike, me një objektiv të përgjithshëm, që personeli policor të reflektojë shoqërinë të cilës i shërbejnë. (Council of Europe, 2002:9)

Sipas Udhëzimit Administrativ nr.07/2012 Mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, neni 5, *Krijimi i marrëdhënies së punës*, të drejtë konkurrimi dhe punësimi në polici kanë të gjithë personat që i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me konkursin publik, i cili bazohet në udhëzimin administrativ dhe në akte të tjera të brendshme. Në të theksohet se punësimi në Polici është i hapur dhe se u ofrohen mundësi të njëjta punësimi të gjithë personave të interesuar, pa dallim përkatësie etnike, gjinie, ngjyre, feje, bindjeje politike apo orientimi seksual, me kusht që ata të përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në konkursin e shpallur.

Ndërsa kriteret themelore për aplikim dhe punësim për personelin policor janë përcaktuar në nenin 9 të udhëzimit. Ato janë: a) të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; b) të jetë i moshës 18-30 vjeç; c) të ketë të përfunduar arsimin e mesëm; d) të jetë në gjendje të mirë fizike, mentale dhe emocionale, e) të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale, f) të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike.

Procesi i punësimit të personelit kryhet përmes disa veprimeve administrative, që janë standarde dhe kanë një renditje të caktuar. Në vende dhe në raste të ndryshme ato mund të kenë ndonjë ndryshim në pjesë të veçanta të procesit, për shkak të legjislacionit apo të specifikave të vendit të punës. Sipas studiuesve Mathis dhe Jackson, rekomandohen këto veprime:

Funksioni i punësimit në çdo organizatë mund të merret me disa apo me të gjitha aktivitetet në vazhdim: (1)pranimi i aplikimeve, (2)intervistimi i aplikantëve, (3)administrimi i testeve të aplikantëve, (4)kryerja e hetimeve të së kaluarës, (5)përgatitja për kontroll fizik, (6)vendosja dhe caktimi i punonjësve të rinj, (7)koordinimi i përcjelljes së këtyre punonjësve, (8)zhvillimi i intervistave të daljes me punonjësit që ikin dhe (9)mbajtja e shënimeve dhe e raporteve (Mathis,Jackson, 2006:226)

Procesi i testimit të kandidatëve për punësim në PK bazohet në praktikat ndërkombëtare dhe në legjislacionin në fuqi. Procesi kalon nëpër disa faza, të cilat parashikohen në nenin 16 të Udhëzimit administrativ. Kandidatët që, sipas konkursit të shpallur, i plotësojnë kriteret e përcaktuara u nënshtrohen procedurave të testimit. Këto procedura kryhen sipas kësaj radhe: a)Testimi me shkrim; b)Testimi i shkathtësive fizike; c)Intervista me gojë; d)Testimi psikologjik; e)Kontrolli mjekësor, f) Verifikimi i së kaluarës së kandidatit.

Edhe procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për punësim në polici, konsiderohet shumë i rëndësishëm nga autorë dhe ekspertë të fushës. Mathis dhe Jackson theksojnë se suksesi i organizatës përcaktohet nga përzgjedhja e aplikantëve të kualifikuar. Ata sugjerojnë dy thënie:

Punëso me vështirësi, menaxho lehtë. Koha dhe përpjekjet e shpenzuara për përzgjedhjen e njerëzve të duhur për punë mund të bëjnë që menaxhimi i tyre të jetë më pak i vështirë, sepse kështu eliminohen shumë probleme.

Trajnimi i mirë nuk e kompenson përzgjedhjen e keqe. Kur nuk përzgjidhen njerëzit e duhur, me aftësitë e duhura për vendin e punës, punëdhënësit më vonë do të kenë vështirësi për trajnimin e individëve të përzgjedhur. (Mathis, Jackson, 2006:226)

Gjatë procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes së personelit, në PK vëmendje e veçantë u kushtohet testit psikologjik dhe hetimit të së kaluarës së kandidatit. Kriteret për testim psikologjik përcaktohen nga Drejtoria e Personelit dhe Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore të PK-së, e cila kontraktin një institucion shëndetësor të licensuar, i cili vepron në mënyrë të pavarur. Kurse procesi i hetimit të së kaluarës së kandidatit administrohet nga Drejtoria e Standardeve Profesionale e PK.

7.2.2 Hetimi i së kaluarës së kandidatit

Hetimi i së kaluarës së kandidatëve për punësim në PK është faza e fundit e testimit para se kandidati të vijojë trajnimin bazë në Akademinë për Siguri Publike. Pas publikimit të rezultatit të meritave dhe rezultateve nga testi psikologjik dhe mjekësor, Sektori i Rekrutimit dhe Seleksionimit në PK, listën e kandidatëve të cilët janë kualifikuar të vijojnë kursin themelor për policinë e përgjithshme (trajnimin bazë) ia dërgon Drejtorisë së Standardeve Profesionale për verifikimin e së kaluarës të secilit prej tyre.

Në bazë të Parimit-3.18, Procesi i Testimit dhe Rekrutimit të Kandidatëve për Polici, hetimet mbi biografinë janë hetime sistematike dhe të plota të shkallës më të lartë. Hetimet bëhen për të gjithë kandidatët, për të përcaktuar përshtatshmërinë e tyre për punësim. Më pas duhet të verifikohen vetitë e mira të karakterit të kandidatit, përvoja e tij e punës, të vërtetohen referencat e kandidatit dhe të vendoset mbi tiparet dhe karakterin e tij. Një vëmendje e madhe i kushtohet kryerjes së hetimeve sistematike të biografisë së kandidatit, për të zbuluar ndonjë dëshmi për aktivitete kriminale, krime

lufte apo krime ndaj të drejtave njerëzore, dëshmi për keqtrajtimin e ndonjë personi apo grupi etnik ose aktivitete tjera të ngjashme, që bien ndesh me standardet aktuale të punësimit që duhet t'i plotësojë kandidati për vendin e punës si polic i PK-së.

Në parimet dhe procedurat e brendshme të procesit të hetimeve të së kaluarës së kandidatit janë përcaktuar edhe standardet për skualifikim, si dhe kriteret për skualifikim të menjëhershëm. Sipas Parimit P-3.18, bazë për skualifikim të menjëhershëm janë: ndonjë dëshmi e dokumentuar për aktivitete kriminale apo për sjellje tjetër kriminale; kur hetimet dëshmojnë se ka ekzistuar arsyeja për ta arrestuar personin, pavarësisht se arrestimi i tij ka rezultuar apo jo në ndjekje penale; hetimi i kandidatit nga autoritetet gjyqësore për ndonjë vepër penale ose për ndonjë kundërvajtje të rëndë (prishja e rendit dhe e qetësisë publike), për të cilën, me vendim të gjykatës, është shpallur fajtor; kur kandidati është dënuar për kundërvajtje të rëndë edhe pse ka qenë i mitur; thirrja në hetuesi sepse ka kryer ndonjë aktivitet të mëhershëm kriminal; posedimi i fakteve të besueshme që kandidati është përzier në mënyrë direkte ose indirekte në ndonjë aktivitet kundërvajtës a kriminal; mosinqeriteti gjatë aplikimit për punësim dhe fshehja e fakteve për krime lufte/krime kundër njerëzimit, gjenocid dhe keqtrajtime.

Edhe mangësitë e karakterit apo të integritetit të kandidatit janë kriter për skualifikim të menjëhershëm. Si të tilla konsiderohen: dëshmitë evidente për një karakter të shthurur, për akte jo të moralshme, që shkelin standardet themelore të pranuar në shoqërinë e civilizuar apo ndonjë shembull i sjelljes amorale apo joetike; mungesa e sinqeritetit apo e besueshmërisë; jondershmëria apo sjelljet jo të ndershme, ndonjë shembull i sjelljes bishtnuese lidhur me persona të tjerë ose me persona me pozita autoritare; sjellja pa përgjegjësi dhe e pamatur, e cila njollos integritetin e

shërbimit dhe çdo karakteristikë e personalitetit që nuk përputhet me standardet e kërkuara nga Policia e Kosovës.

Organizatrat policore duhet të synojnë që përmes trajnimeve, këshillimeve dhe vlerësimeve të punës dhe sjelljes të arrijnë që personeli i tyre të plotësojë dhe të respektojë kriteret dhe standardet etike dhe profesionale. Në parim “punonjësit, duhet të kontrollojnë veten, si në ndërveprime me njëri-tjetrin, ashtu edhe me publikun, në një mënyrë që tregon respekt, sinqeritet, integritet dhe përkushtim ndaj shërbimit publik.” (Swanson, Territo, Taylor, 2005:412).

Një çështje e debatuar gjatë procesit të hetimit të së kaluarës së kandidatëve është edhe rasti kur ndonjëri është shpallur fajtor dhe e ka vuajtur dënimin për vepër penale, por që, sipas ligjit, dënimi është shlyer, në bazë të afateve ligjore, nga evidenca e personit të dënuar. Ç’thotë Kodi Penal për kandidatë të tillë?

Gjykata, me kërkesën e personit të dënuar, mund të vendosë që dënimi t’i shlyhet nga evidenca e personit të dënuar dhe ai person konsiderohet i padënuar, nëse ka kaluar gjysma e afatit përkatës të paraparë me paragrafin 2, të nenit 103, dhe nëse personi i dënuar gjatë kësaj kohe nuk ka kryer vepër të re penale. Me rastin e vendosjes për shlyerjen e dënimit të parashkruar ose të përfunduar me falje ose me ndryshim të Kodit Penal, gjykata merr parasysh sjelljen e personit të dënuar pas vuajtjes së dënimit, natyrën e veprës penale dhe rrethanat e tjera, të cilat mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin e përshtatshmërisë së shlyerjes së dënimit (Neni 104 KPK).

Nga aspekti ligjor, interpretimi i kësaj çështjeje është dhënë nga zyra ligjore e PK-së në memorandumën zyrtar DPPK-01/04/ZL-2395/2014, drejtuar DSP-së në përgjigje në kërkesën e DSP-së për interpretim ligjor në rastet kur kandidatët që kanë aplikuar për punësim në PK më parë janë dënuar për vepër penale sipas Kodit Penal. Kjo çështje është rregulluar në nenin 101, par.3 KPK si vijon: kur dënimi shlyhet, atëherë pushojnë pasojat juridike të dënimit. Sipas interpretimit të Zyrës ligjore, nënkuptohet se edhe dispozitat e aktit nënligjor, Udhëzimit Administrativ 07/2012 “Mbi marrëdhënien e punës” në Polici, raste të tilla nuk mund të kenë pasoja juridike, ngaqë me këto akte është rregulluar që një kandidat i caktuar të mos konsiderohet i dënuar për vepër penale dhe, siç u përmend më lart, nga momenti i shlyerjes së dënimit pushojnë pasojat juridike të dënimit.

Kandidatët që e kalojnë me sukses procesin e hetimit të së kaluarës thirren për nënshkrimin e kontratës së punës dhe dërgohen për trajnimin themelor. Pas përfundimit të pjesës teorike të trajnimit, zyrtarët policorë, në një ceremoni solemne bëjnë betimin, në bazë të Rregullores nr.03/2015 për Betimin Zyrtar. Teksti i betimit është:

Unë (punonjësi e thotë emrin e tij/saj të plotë), betohem se do të zbatoj Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet e Kosovës, do të mbroj sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, do t'u bindem urdhrave të mbikëqyrësve të mi, do t'i kryej detyrat, duke treguar gjithnjë profesionalizëm, përgjegjësi dhe ndershmëri, në interes të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, pa dallim përkatësie etnike, gjinie, religjioni apo ngjyre.(Policia e Kosovës, 2015:2)

7.3 Administrimi i masave disiplinore në Policinë e Kosovës

Në Kosovë, shkeljet disiplinore janë trajtuar në fillim nga policia ndërkombëtare dhe, gradualisht, me pjesëmarrjen e oficerëve të PK. “Që disiplina të zbatohet në mënyrë efektive, duhet të jenë të qarta rregullat. Prandaj, shumica e procedurave specifikojnë llojin e sjelljes që mund të nxisë shkelje disiplinore.” (Bach,Sisson, 2000:323).

Me aprovimin e rregullores nga ana e PSSP-së për Shërbimin Policor të Kosovës, u përcaktuan edhe shkeljet disiplinore, masat disiplinore dhe autoritetet vendimmarrëse në hetimet dhe dhënien e masave disiplinore. Sipas Rregullores nr.2005/54 të UNMIK-ut “Mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës”, shkeljet e rënda disiplinore konsideroheshin; (a)Sjellja e pahijshme e rëndë, (b)Mosbindja e rëndë, (c)Zbulimi i pavend dhe i rëndë i informatave, (d)Korrupsioni, (e)Shkelja e rëndë e kompetencave, (f)Përdorimi i pavend i armës, (g)Përdorimi i tepërt i forcës, (h)Dëmtimi i rëndë i pasurisë së policisë, (i)Përdorimi i alkoolit ose substancave të tjera intoksikuese, (j)Ngacmimi seksual gjatë shërbimit, (k)Keqpërdorimi dhe shfrytëzimi seksual i ndonjë personi dhe (l)Veprimtaria penale. (UNMIK,2005:5).

Nga ky përkufizim vërejmë se korrupsioni dhe veprimtaria penale janë cilësuar shprehimisht si shkelje të rënda. Sipas Rregullores nr.2005/54, parashikohej edhe krijimi i autoritetit vendor për çështje të disiplinës. Sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje: Komisioni për emërime të larta dhe disiplinë në polici (KELDP) themelohet me autorizimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. KELPD përbëhet prej kryesuesit, zëvendëskryesuesit dhe anëtarëve të tjerë. (UNMIK, 2005:4). KELDP ishte i autorizuar për rekomandimin e masave disiplinore për shkelje të rënda, kurse vendimi merrej nga Komisioneri i Policisë së UNMIK-ut.

Masat disiplinore për shkelje të rëndë ishin: a)Shkarkimi, b)Ulje e gradës, c)Largimi nga pozita komanduese, d)Pezullimi, pa pagë, deri në gjashtëdhjetë ditë dhe e)Gjykitje, që nuk është më e madhe se 50% e pagës mujore bruto (UNMIK, 2005:5).

Përveç shkeljeve të rënda disiplinore me këtë rregullore parashikoheshin edhe shkeljet e lehta disiplinore. Polici ose zyrtari i personelit civil, i punësuar nga Shërbimi Policor i Kosovës, kryen shkelje të lehtë disiplinore, kur ai është fajtor për njërin prej veprave të mëposhtme: (a)Sjellje e lehtë diskredituese, (b)Mosbindje e lehtë, (c)Pakujdesi në detyrë, (d)Zbulim i lehtë pa vend të informatave, (e)Keqpërdorim i lehtë i kompetencave, (f)Dëmtim i lehtë i pasurisë së policisë ose (g)Mbajtje e papërshtatshme e uniformës dhe paraqitje e papërshtatshme personale.

Ndryshe nga procedura për shkeljet e rënda, rekomandimi për masën disiplinore për shkelje të lehta jepej nga Njësia e Standardeve Profesionale, kurse vendimi merrej nga Komisioneri. Zyrtari i Policisë së Kosovës ose i personelit civil në Shërbimin Policor të Kosovës, i cili ka kryer shkelje të lehtë disiplinore i nënshtrohet njërit prej këtyre ndëshkimeve: (a)Ulje grade, (b)Caktimi në detyrë tjetër, (c)Pezullimi, pa pagë, deri në tridhjetë ditë, (d)Gjykitje, që nuk është më e madhe se 50% e pagës mujore bruto ose (e)Qortimi.

Karakteristike është se, edhe për shkelje të rënda disiplinore, edhe për shkelje të lehta parashikohej masa e uljes në gradë, kurse vendimmarrja ishte në dorë të autoritetit të Komisionerit të Policisë së UNMIK-ut. Ndonëse kjo rregullore ishte aprovuar për funksionimin e policisë vendore, pra, SHPK-së, karakteristikë ishte se pushteti vendimmarrës ishte PSSP.

Asgjë në këtë nen nuk e cenon a zvogëlon autorizimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, në bazë të Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për të shkarkuar ose kërkuar dorëheqjen e ndonjë polici, përfshirë edhe zëvendëskomisionerin e SHPK-së për ndonjë arsye të fortë, të bazuar në vërtetimin e shkeljes ose keqpërdorimit apo mospërmbylljes së detyrës, në pajtim me ligjin në fuqi. (UNMIK, 2005:6)

Administrimi i disiplinës në PK është zhvilluar krahas zhvillimit organizativ të PK-së, ndryshimeve në legjislacion, krahas procesit të tranzicionit dhe pavarësimit nga policia ndërkombëtare. PK ka arritur të krijojë një sistem të besueshëm hetimi dhe administrimi të masave disiplinore, duke krijuar kapacitetet profesionale për hetimin e rasteve të shkeljeve disiplinore dhe për respektimin e të drejtës për ankesë. “Shkelje disiplinore vlerësohet çdo veprim, mosveprim, sjellje apo qëndrim që bie në kundërshtim me kodin e etikës policore, me ligjet e aplikueshme, si dhe me aktet nënligjore që parashikojnë kryerjen e detyrave nga personeli i PK-së.” (Policia e Kosovës, 2013:16).

Aktualisht, çështja e disiplinës në PK është e rregulluar në bazë të Ligjit për Policinë dhe Udhëzimit Administrativ nr.06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedura Disiplinore në Policinë e Kosovës. Me këtë udhëzim janë përcaktuar llojet e shkeljeve disiplinore, masat disiplinore, roli dhe detyrat e Drejtorisë së Standardeve Profesionale, roli dhe detyrat e Komisionit Disiplinor, roli dhe përgjegjësia e Komisionit për Ankesa dhe çështje të tjera me rëndësi për procedurën disiplinore. Ndër të tjera, ky udhëzim parashikon edhe parimin dyshkallësh në procedurë disiplinore, që nuk ekzistonte gjatë administrimit të disiplinës nga policia e UNMIK-ut.

Për rritjen e efikasitetit dhe trajtimin me kompetencë të të gjitha informacioneve për pretendime të shkeljes disiplinore nga zyrtarët e PK-së, Udhëzimi Administrativ 06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedura Disiplinore përcakton: çdo mbikëqyrës i punonjësit të Policisë, Drejtoria e Standardeve Profesionale, çdoherë kur merr informatë nga individët apo mediat e shkruara dhe elektronike, radiotelevizioni dhe interneti, fillon një hetim paraprak për konstatimin e supozimit të ekzistimit apo mosekzistimit të shkeljeve disiplinore.

7.3.1 Shkeljet e rënda disiplinore

Siç e përmendëm më sipër, shkeljet disiplinore janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedura Disiplinore. Në nenin 12 të tij, theksohet: shkelje e rëndë disiplinore konsiderohet veprimi ose mosveprimi i punonjësit të PK-së, punonjësit që bashkëpunon me të ose atij që nxit kryerjen e shkeljeve të mëposhtme:

- Sjellje e rëndë diskredituese,
- Mosbindje e rëndë,
- Zbulimi i pavend dhe i rëndë i informatave,
- Korrupsioni,
- Shkelje e rëndë e kompetencave,
- Përdorimi i pavend i armës,
- Përdorimi i tepërt i forcës,
- Dëmtimi i rëndë i pasurisë së Policisë,
- Përdorimi i alkoolit dhe substancave intoksikuese,
- Ngacmimet seksuale,

- Veprimet diskriminuese në bazë të moshës, gjinisë, orientimit seksual, përkatësisë etnike apo fetare
- Veprimtaria penale.

Pas kompletimit të procedurës hetimore për shkeljet disiplinore, Drejtoria e Standardeve Profesionale e dërgon materialin me rekomandime në Komisionin e Brendshëm Disiplinor, për caktimin e masës disiplinore. Masat që mund të jepen ndaj punonjësit të PK-së në rastet e shkeljeve të rënda disiplinore parashikohen në nenin 45: a) ndërprerja e marrëdhënies së punës, b) ulje grade - jo më shumë se një gradë, c) largim nga pozita komanduese apo largim në një pozitë tjetër me përgjegjësi më të ulët, por pa e humbur gradën dhe kategorinë funksionale, c) ndalesën në pagë, mbi 20% deri në 30% të pagës mujore bruto prej dy deri në gjashtë muaj.

Krahas masave të përcaktuara me këtë udhëzim, mund të jepen edhe masa plotësuese, të parashikuara në nenin 45, pika 2, të të njëjtit udhëzim: a) transferim administrativ, b) trajnim i detyruar, c) këshillim mjekësor/psikologjik dhe d) ndalesë drejtimi të automjetit të PK-së deri në 1 vit.

Duhet theksuar se, sipas Udhëzimit administrativ për disiplinën, korrupsioni dhe veprimtaria penale parashikohen shprehimisht si shkelje të rënda. Neni 17 i Udhëzimit Administrativ 06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedura Disiplinore përkufizon se:

Punonjësi i Policisë së Kosovës është fajtor për korrupsion nëse:

- Në cilësinë e zyrtarit policor apo të stafit civil të Policisë së Kosovës dhe pa autorizim përkatës, në mënyrë direkte ose indirekte, kërkon ose pranon ndonjë të mirë materiale, dhuratë, çfarëdo shërbimi, nënshkrimi ose rekomandimi;
- E vë veten nën obligime financiare ose obligime të tjera ndaj ndonjë personi tjetër në atë mënyrë që mund të ndikojë në kryerjen si duhet të detyrave si punonjës i Policisë së Kosovës;

- E keqpërdor pozitën e tij apo të saj si punonjës i Policisë së Kosovës, për leverdi personale, për vete ose për të tjerët;
- E vë veten në konflikt interesi, duke ndërmarrë veprime me të cilat kufizon, rrezikon apo pengon përmbushjen e detyrave zyrtare.

Kurse Neni 25, 'Veprimtaria penale', i të njëjtit udhëzim përcakton se: punonjësi i PK-së është fajtor, nëse për veprën penale apo kundërvajtjen e rëndë që ka kryer është shpallur fajtor dhe është dënuar sipas ligjit në fuqi nga cilado gjykatë, që njihet nga ligjet e Kosovës.

7.3.2 Shkeljet e lehta disiplinore

Shkeljet e lehta disiplinore përkufizohen në nenin 13 dhe si të tilla përcaktohen: Sjellja e lehtë diskredituese, Mosbindja e lehtë, Pakujdesia në detyrë, Zbulimi i pavend dhe i lehtë i informatave, Keqpërdorimi i lehtë i kompetencave, Dëmtimi i lehtë i pasurisë së Policisë, Mbajtja e papërshtatshme e uniformës dhe paraqitja e papërshtatshme personale.

Masat për shkelje të lehta disiplinore për punonjësit e PK-së parashikohen në nenin 44 të Udhëzimit Administrativ 06/2012, për Shkeljet, Masat dhe Procedura Disiplinore:

1. Masat që mund të merren ndaj punonjësit të PK-së në rastet e shkeljeve të lehta disiplinore janë: Vërejtje me gojë; Vërejtje me shkrim; Ndalesë në pagë, 5%-20% nga paga bruto, deri në dy muaj;
2. Krahmasave të përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të jepen edhe masa plotësuese: këshillim mjekësor/psikologjik; ndalesë drejtimi të automjetit të PK-së deri 6 muaj dhe transferim administrativ vetëm me masën disiplinore nga paragrafi 1.3 i këtij neni.

3. Autoritetet për trajtimin, shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore janë:

Mbikëqyrësi i punonjësit; Komisioni i Brendshëm Disiplinor; Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime

4. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, të gjitha masat disiplinore sipas kompetencës nga ligji i IPK-së; Ministri i MPB-së, si shkallë e dytë dhe Kryeministri, sipas ligjit të Policisë dhe IPK-së.

Nëse gjatë hetimeve paraprake gjenden elemente të veprës penale, niveli lokal apo DSP, bazuar në Ligjin e IPK-së, ia kalon raportin IPK-së apo Departamentit të Hetimeve, të Policisë së Kosovës.

Nga analizimi i rasteve të inicuar për hetime disiplinore, vëmë re disa dukuri. Sipas raportit vjetor 2014, nga 421 ankesa të qytetarëve, që janë trajtuar, vetëm 70 prej tyre janë gjetur të bazuara, kurse 351 raste (83%) ishin të pabaza. Kurse nga 220 raste të trajtuara si inicime të brendshme, pas procesit hetimor doli që 174 raste ishin të bazuara, kurse 46 raste (20%) nuk qëndronin. Siç shihet, ekziston një diferencë: 57% më shumë raste të pabazuara janë gjetur nga hetimi i rasteve të inicuar nga qytetarët, në krahasim me rastet me inicim të brendshëm. Kjo mund të shpjegohet me faktin se inicimi i hetimeve të brendshme bëhet, kryesisht, nga zyrtarët policorë, të cilët kanë më shumë njohuri për rregullat, procedurat dhe kompetencat ligjore dhe, për rrjedhojë, raportet e inicimeve të brendshme janë më të bazuara dhe të argumentuara. Sidoqoftë, sugjerohet rishikimi i rasteve të gjetura si të pabazuara, me qëllim gjetjen e të vërtetës, pasi kështu rriten besueshmëria dhe transparenca.

Është me vend të theksojmë se, pasi Komisioni i Ankesave merr vendim lidhur me një ankesë, pala e pakënaqur, bazuar në nenin 60 të Udhëzimit për disiplinë, ka të drejtë që brenda tridhjetë ditësh nga dita e marrjes së vendimit, ta apelojë atë në gjykatën kompetente.

Administrimi i masave disiplinore në PK ka kaluar nëpër faza të ndryshme zhvillimi dhe është arritur të krijohet një sistem funksional, i drejtë, i paanshëm, transparent dhe profesional i administrimit të disiplinës.

7.4 Roli i institucioneve të mbikëqyrjes dhe të kontrollit

Mbikëqyrja dhe kontrolli demokratik i organizatave policore është parim bazë për sundimin e ligjit dhe shtetin ligjor. Në bashkësinë ndërkombëtare ekziston konsensusi që legjislacioni dhe masat kundër korrupsionit duhet të zbatohen dhe të monitorohen nga organe të specializuara dhe/apo personel me kompetenca, burime dhe me trajnimin e duhur.

“Për këtë duhet të ketë mekanizma që sigurojnë nivel të lartë të autonomisë strukturore, operative dhe financiare të institucioneve dhe të personave përgjegjës për luftimin e korrupsionit, për t’i mbrojtur ata nga ndikimet e padrejta politike. (OECD, 2008:17)

Institucionet e mbikëqyrjes së policisë kanë detyra të shumta dhe komplekse. Roli i tyre qëndron në kërkesat për zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore nga zyrtarët policorë, për ruajtjen dhe forcimin e vlerave etike, ngritjen e profesionalizmit, të performancës dhe të efikasitetit të tyre në punë. Gjithashtu, ato luajnë një rol të madh në menaxhimin e burimeve njerëzore, në proceset e rekrutimit, përzgjedhjes dhe trajnimit të personelit, në vlerësimin dhe shpërblimin e secilit, në ruajtjen e barazisë dhe të diversitetit të punonjësve të policisë. Ato mbikëqyrin edhe menaxhimin e pronës dhe të financave, procedurat e prokurimit, marrëdhëniet me publikun, administrimin e ankesave të qytetarëve, administrimin e disiplinës, hetimet penale, mbrojtjen e të dhënave dhe realizimin e objektivave të përgjithshme dhe specifike, të përcaktuara në dokumentet strategjike të policisë dhe të qeverisë.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i mbikëqyrjes dhe i kontrollit të policisë është shqyrtimi apo vlerësimi i përputhjes së akteve nënligjore me ligjet në fuqi dhe zbatimin e tyre në praktikë. Ato udhëhiqen nga parimi, sipas të cilit “Policia gjithmonë duhet të veprojë në bazë të ligjeve. Policët u nënshtrohen të njëjtave ligje, të cilat duhet t’i zbatojnë dhe t’i mbrojnë.” (IPU&DCAF, 2003:61)

Ekzistojnë dy lloje të mekanizmave të mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi policinë: Kontrolli *i brendshëm* dhe kontrolli *i jashtëm*. Ndonëse qëllimi i tyre është i njëjtë, ato dallojnë në mënyrën dhe në shkallën e ndërhyrjes në punën e pavarur të policisë.

Mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë të strukturuar brenda policisë, janë pjesë integrale e saj dhe kanë kompetenca dhe autorizime për të ushtruar mandatin e tyre. Për sa u përket mekanizmave të kontrollit të jashtëm, shtrohet rreziku i mundësisë së ndikimit të politikës mbi ta, nga institucione që janë plotësisht të pavarura nga policia. Këtu merr rëndësi kërkimi i llogaridhënies nga institucionet që mund të kenë ngjyrimë politike.

“Ka disa pyetje rreth mënyrës faktike përmes së cilës shfaqet kjo llogaridhënie dhe shkallën në të cilën është. Është sugjeruar se shkalla e kontrollit mbi policinë nga autoriteti politik ndryshon me nivelin e udhëheqjes, në të cilin ndodhin funksionet policore.” (Swanson, Territo, Taylor, 2005:90).

Policia e Kosovës ka, tashmë, një sistem të kompletuar të kontrollit të brendshëm: të inspektimit, të auditimit, të disiplinës, të mbrojtjes së të drejtave të personelit, të shqyrtimit të përdorimit të forcës etj. Lidhur me kontrollin e jashtëm, Ligji për Policinë përcakton se:

Policia funksionon nën autoritetin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e drejtorit të përgjithshëm të policisë. Autoriteti i ministrit nuk përfshin menaxhimin operacional të policisë. Drejtori i përgjithshëm i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt ministrit për administrimin dhe menaxhimin e policisë. Drejtori i përgjithshëm bashkëpunon me ministrin dhe i ofron informata dhe raporte atij sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. (Ligji për Policinë, 2012:4).

Niveli dhe forma e kontrollit të autoritetit politik mbi policinë përcaktohen edhe nga kultura politike që ekziston në vend. Praktikën e ushtrimit të kontrollit mbi policinë parashikohen me dispozita ligjore.

7.5 Mekanizmat e kontrollit të brendshëm të Policisë së Kosovës

Kontrolli i brendshëm i policisë është një nga funksionet më të rëndësishme të udhëheqjes së organizatës policore. Qëllimi i këtij kontrolli është që kryerja e detyrave dhe përmbushja e misionit të policisë të bazohen në standardet më të larta të policimit demokratik, që policia të respektojë me rigorozitet parimet, procedurat dhe normat ligjore në të gjithë veprimtarinë e saj. Kontrolli nis që nga mbikëqyrja e mënyrës si zhvillohet procesi i rekrutimit të personelit policor, a ka trajtim të barabartë të aplikantëve, a respektohen të drejtat e punonjësve, si ushtrohen kompetencat nga policët, a bëhen të gjitha këto në pajtim me ligjet e në fuqi dhe me konventat ndërkombëtare etj. Por rol edhe më të madh, mbikëqyrja dhe kontrolli i brendshëm luajnë për parandalimin e shpërdorimit të ligjit, të shkeljeve të procedurave të veprimeve policore, si dhe të vendimeve dhe veprimeve arbitrare të zyrtarëve policorë. Në funksionet e kontrollit të brendshëm vend të rëndësishëm zë edhe ndërmarrja e hapave për hetimin dhe sanksionimin e çdo shkeljeje nga ana e të punësuarve dhe, njëkohësisht, sigurimi i hetimeve të paanshme të zyrtarëve policorë të dyshuar.

Kontrolli i brendshëm i policisë duhet të jetë i vazhdueshëm dhe cilësor. Për këtë, nga mekanizmat mbikëqyrës kërkohet jo vetëm angazhim dhe përkushtim, por edhe të kenë vizion dhe njohuritë e nevojshme për të ushtruar një kontroll sa më efikas dhe rezultativ. Secili nga organizmat e mbikëqyrjes, së pari, duhet t'u kushtojë kujdes burimeve të veta njerëzore, që ata të jenë të aftë, të përkushtuar, me moral të lartë kërkues në zbatimin e ligjit.

Secili zyrtar i agjencisë duhet të luajë rol për të siguruar që kontrolli i brendshëm funksionon në mënyrë të rregullt, sidoqoftë, menaxherët janë ata që kanë përgjegjësinë kryesore për të realizuar kontrollet e brendshme dhe për të monitoruar efikasitetin e tyre.(Crime and Misconduct Commission, 2005:25)

Rolin kyç në kontrollin e brendshëm në PK e luajnë njësitë e strukturuar për këtë qëllim, të cilat kanë të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë. Të tilla janë: Drejtoria e

Standardeve Profesionale, Komisioni Disiplinor, Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime, Komisioni për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës, Drejtoria e Personelit, Njësia e Inspektimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe njësi të tjera. Këto kanë përgjegjësi në mbikëqyrjen e zbatimit e praktikave dhe standardeve të policimit demokratik.

Por synimi është që mbikëqyrja dhe kontrolli në Polici të mos mbeten vetëm në duart e organizmave të ngarkuara me këtë detyrë, por të realizohet nga të gjithë të punësuarit, të cilët duhet të jenë aktivë në këtë drejtim, duke ndihmuar me konstatimet dhe informatat e tyre për çdo shkelje të ligjit dhe të normave nga cilido punonjës policie. Vetëm kështu koncepti i mbikëqyrjes dhe kontrollit të brendshëm të policisë do të jetë efektiv dhe në funksion të ndërtimit të një organizate policore me integritet të lartë, me standarde etike dhe profesionale, të aftë për të përmbushur objektivat në luftimin e krimit, të gëzojë një respekt dhe besim nga publiku.

Besimi dhe përkrahja e publikut mbetet qëllim permanent i organizatave bashkëkohore policore. “Shërbimi ndaj komunitetit me profesionalizëm dhe integritet duhet të jetë qëllim i çdo agjencie dhe i të punësuarve të saj në atë mënyrë që të sigurohet se besimi dhe respekti janë ruajtur” (Peek, 2004: 358).

Sidoqoftë, duhet theksuar se PK-ja është ndër institucionet e pakta në Kosovë që ka ndërtuar mekanizma funksionalë për administrimin e disiplinës. “Edhe pse, kishim një sistem të brishtë të disiplinës të trashëguar nga ndërkombëtarët, prapë, ai ishte i dobishëm për të ndërtuar një sistem vendor të qëndrueshëm dhe që u përgjigjet kushteve dhe rrethanave të vendit” (Azizi I., Intervistë, 2015).

7.5.1 Drejtoria e Standardeve Profesionale

Drejtoria e Standardeve Profesionale (DSP), në kuadër të Policisë, merret me hetimin e shkeljeve disiplinore të kryera nga punonjësit e PK-së dhe me verifikimin e së

kaluarës së aplikantëve për punësim në PK dhe për punonjësit e PK-së gjatë procesit të promovimit dhe gradimit.

Kjo drejtori është ndër njësitë e para të themeluara të PK-së dhe ka kaluar një periudhë ndryshimesh organizative dhe legislative. Procesi i tranzicionit ka krijuar për të vështirësi dhe probleme, për arsye subjektive dhe objektive. Një pjesë e policëve ndërkombëtarë nuk janë treguar të gatshëm që kjo të kalonte nën menaxhimin e vendorëve, me arsyetimin se nuk janë të përgatitur për këtë kalim. Vështirësi objektive kanë ardhur nga fakti se ky njësit nuk ka pasur strukturë të qëndrueshme dhe as të aprovuar, si dhe kanë munguar procedurat e standardet e operimit. Pas përfundimit të tranzicionit, njësia u shndërrua në Drejtori dhe, në kuadër të saj, veprojnë edhe njësitet e standardeve profesionale në secilën drejtori rajonale policore (Azizi I., Intervistë, 2015).

DSP merret kryesisht me administrimin e disiplinës në PK. Ndaj funksionimi i saj duhet të jetë i organizuar mirë dhe të këtë qasje në tërë strukturën e policisë. Në intervistën e zhvilluar, zyrtari i lartë i PK-së shprehet se janë duke u bërë përpjekje që të fitohet sa më shumë përvojë në menaxhimin e disiplinës nga niveli lokal, çka nënkupton mbikëqyrësit e vijës së parë dhe të dytë, sipas strukturës policore. Ky sistem jep garanci që disiplina të menaxhohet nga baza, që këshillohet, trajnohet dhe monitorohet nga qendra.

Gjatë procedurës disiplinore duhet të merren në konsideratë qëllimi i masave disiplinore, si dhe obligimet ligjore për të drejtat e punonjësve, për mosdiskriminimin, ankesat dhe paditë pranë gjykatave, që mund të vijnë si pasojë e procedurës dhe e masave disiplinore.

Për shkak të çështjeve ligjore, menaxherët duhet të njohin disiplinën dhe të dinë si ta administrojnë siç duhet atë. Disiplina efektive duhet të drejtohet te sjelljet problematike, jo te punonjësi personalisht, sepse arsyeja për disiplinë është të përmirësojë performancën. (Mathis, Jackson, 2006:516)

Një hetim disiplinor kalon nëpër disa filtra, për të arritur në një konstatim dhe vendim disiplinor. Kjo jep garanci se askush nuk do të ndëshkohet, nëse nuk ka dëshmi për shkelje disiplinore, dhe se askush nuk do të lirohet nga përgjegjësia, nëse ka dëshmi. Ky sistem jep mesazhe të forta tek të gjithë zyrtarët e policisë se askush nuk është i privilegjuar të shkelë rregullat dhe kodin policor.

Përveç njësive që merren me hetime, janë edhe dy komisione, Komisioni Disiplinor dhe Komisioni i Ankesave. Këta janë mekanizma të përhershëm për shqyrtimin e raporteve hetuese, për vendimmarrje dhe për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve disiplinore. Komisioni Disiplinor vepron si organ i shkallës së parë në shqyrtim dhe në vendimmarrje disiplinore, ndërsa Komisioni i Ankesave vepron si organ i shkallës së dytë në shqyrtimin e ankesave dhe të marrjes së vendimeve disiplinore. (Azizi I., Intervistë, 2015).

Meqenëse ekziston një korelacion ndërmjet disiplinës dhe korrupsionit, është i domosdoshëm një bashkëpunim i ngushtë i DSP-së me mekanizmat e tjera, në veçanti, me IPK-në. Secili mekanizëm ka kompetencat e veta, por bashkëpunimi midis tyre i shërben përmirësimit të procedurave të punës dhe rritjes së efikasitetit të menaxhimit të disiplinës. Fakt është që në praktikë ka koordinim të punëve midis këtyre organizmave. Siç theksohet edhe në një Progresraport të BE për Kosovën, “bashkëpunimi mes inspektoratit të pavarur policor (IPK) dhe njësisë së PK-së për disiplinë vazhdon të jetë i mirë.” (EU Kosovo Progress Report, 2014:51).

Çështja është që ky bashkëpunim të vihet në baza më të shëndosha dhe të mos cenohet për shkak të kompetencave që kanë këto mekanizma.

“Kjo ndarje e kompetencave,- thotë zyrtari i lartë Azizi,- është bërë nën ndikimin e rrethanave të kohës, ndaj mendoj se ka nevojë për ndryshime dhe ripërcaktim të tyre. Për shembull, do të ishte mirë që IPK-ja të merret me hetime penale për veprat penale të rënda dhe shumë serioze dhe jo me shkelje disiplinore dhe veprat e lehta penale. Këto të fundit, mendoj, t’i kalojnë DSP-së. (Azizi I., intervistë, 2015).

7.5.2 Komisioni i Brendshëm Disiplinor

Ky Komision u themelua në pajtim me Ligjin e PK-së dhe Udhëzimin Administrativ nr.06/2012, respektivisht, neni 48. KBD funksionon në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës dhe është kompetent për shqyrtimin e rasteve të shkeljeve disiplinore dhe për dhënien e masave disiplinore ndaj punonjësve të Policisë, siç parashikohet në këtë udhëzim administrativ. Shqyrtimi i çështjeve disiplinore bëhet në një panel prej tre anëtarësh, për masat disiplinore, përveç masës së uljes së gradës dhe masës së ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Këto të fundit KBD-ja i shqyrton në një panel tjetër prej pesë anëtarësh. Seanca disiplinore udhëhiqet nga kryesuesi i panelit, i cili kujdeset për mbajtjen e rendit në seancë, për shqyrtimin objektiv, gjithëpërfshirës dhe të drejtë të rastit dhe, në fund, merr vendimin e duhur, lidhur me çështjen e shqyrtuar.

Sipas nenit 50 të Udhëzimit 06/2012, i dyshuari ka të drejtë ta kundërshtojë përbërjen e panelit gjatë shqyrtimit kryesor dhe të kërkojë përjashtimin e ndonjërit prej anëtarëve të panelit, madje, edhe të kryesuesit të tij. Për një shqyrtim sa më objektiv, paneli disiplinor analizon të gjitha provat dhe rrethanat e shkeljes disiplinore të paraqitura nga DSP-ja dhe merr vendim. Ndaj vendimit të panelit për shqyrtim të kërkesës për përjashtim të një anëtari të tij, nuk lejohet ankesë. Nëse nuk ka konsensus mes anëtarëve gjatë procedurës së shqyrtimit, paneli vendos me shumicë votash, me votim të fshehtë. Ai mund të japë këto vendime:

- Vendim me të cilin punonjësi shpallet fajtor dhe përcakton njëren nga masat disiplinore,
- Vendime me të cilin punonjësi i akuzuar shpallet i pafajshëm/lirohet nga akuza,
- Vendimin me të cilin kërkohet plotësimi i hetimeve,

- Pala e pakënaqur nga vendimi i Komisionit Disiplinor ka të drejtën e ushtrimit të ankesës sipas procedurave ligjore.

7.5.3 Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime

Zyrtarët e PK-së i gëzojnë të gjitha të drejtat e garantuara me ligj dhe me kushtetutë. E drejta për ankesë për vendimet administrative garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës. “Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij, në mënyrën e përcaktuar me ligj.” (Kushtetuta e RK, 2008/10).

Nisur nga kjo, bazuar në ligjin për policinë, Udhëzimi Administrativ 06/2012, në nenin 59, parashikon të drejtën për ankesë të zyrtarëve të PK-së kundër vendimeve administrative, pra, edhe kundër vendimeve disiplinore. Këtë të drejtë e ka çdo palë në procedurën disiplinore. Ankesa parashtrohet me shkrim, në afat prej 15 ditëve për Komisionin për Ankesa dhe Shpërblime (KASH), përmes Komisionit të Brendshëm Disiplinor apo autoritetit tjetër vendimmarrës, që e ka nxjerrë vendimin, në rastet kur vendimin për masë disiplinore e ka marrë Drejtori i Përgjithshëm, në bazë të rekomandimeve nga IPK-ja.

Neni 59 i Udhëzimit Administrativ 06/2012 përcakton se ankesa ndaj vendimit disiplinor mund të ushtrohet për shkak të:

- Shkeljes së Ligjit apo akteve nënligjore të zbatueshme.
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
- Shkeljes së procedurës disiplinore.
- Vendimit mbi masën disiplinore.

Pas pranimit të ankesës, në një afat prej 30 ditësh, në bazë të nenit 65, *Vendimi i panelit të ankesave*, Paneli për Ankesa e merr vendimin me votim të fshehtë, nëse paraprakisht nuk ka konsensus. Kryesuesi i panelit numëron votat, komunikon rezultatin e votimit dhe shpall vendimin e komisionit për ankesa. Rezultati i votimit dhe shpallja e vendimit evidencohen në formular të veçantë. Pas shqyrtimit të ankesës ndaj vendimeve disiplinore, paneli nxjerr njërin nga këto vendime:

- Ankesa është e bazuar – vendimi anulohet.

- Ankesa është e pabazuar - vendimi i atakuar mbetet në fuqi.
- Ankesa është pjesërisht e bazuar - vendimi pjesërisht ndryshohet.
- Hetimi disiplinor është i pakompletuar - çështja kthehet për plotësim të hetimeve.

7.5.4 Komisioni për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës

Detyrat dhe funksionimi i Komisionit për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës (KSHPF) janë të përcaktuar me nenin 23 të Udhëzimit Administrativ të PK-së, nr. 02/2012. Sipas këtij udhëzimi, KSHPF merret me shqyrtimin e rasteve të raportuara të përdorimit të forcës policore dhe, bazuar në gjetjet, konstaton se përdorimi i forcës nga ana e zyrtarëve policorë ndaj personave është apo nuk është në përputhje me kompetencat që jep ligji i PK-së.

Ligji për policinë, në nenet 26 dhe 27, përcakton kompetencat e policisë për përdorimin e forcës dhe të armëve të zjarrit. Konkretisht, neni 26, *Përdorimi i forcës*, parashikon:

- Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë forcën, vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në atë nivel që kërkohet për t'i arritur objektivat legjitime të policisë.
- Zyrtari policor mund ta përdorë forcën për ta mbrojtur jetën e personit, për ta parandaluar sulmin, kryerjen e veprës penale, arratisjen e kryesit të veprës apo atëherë kur masat e tjera nuk janë të suksesshme për arritjen e një objekti tjetër legjitim të policisë.
- Zyrtari policor vepron me maturinë e tij/saj për ta përcaktuar llojin e forcës më të përshtatshme dhe kufizimet në përdorimin e forcës. Zyrtari policor merr parasysh rrethanat specifike, natyrën e veprës penale, shkallën e rrezikut ndaj personave të

tjerë që janë të pranishëm dhe gjendjen fizike, mentale dhe emocionale të personit ndaj të cilit përdoret forca.

- Në rastet e përdorimit të forcës, zyrtari policor duhet të përpiqet ta minimizojë ndërhyrjen në të drejtat dhe liritë e personit dhe të minimizojë çfarëdo pasoje të dëmshme.
- Përdorimi i forcës, si term që përdoret në këtë ligj, përfshin, por nuk kufizohet vetëm në përdorimin e forcës fizike, shufrës zyrtare, sprajtit, mjeteve pranguese, mjeteve për ndalimin e automjeteve, të qenit të policisë, të mjeteve kimike për paaftësim të përkohshëm, të kalit të policisë, të armëve të zjarrit, hedhseve të ujit, automjeteve dhe llojeve të veçanta të armëve dhe mjeteve shpërthyes.

Kurse Neni 27, *Përdorimi i armëve të zjarrit*, parashikon:

1. Zyrtari policor është i autorizuar të posedojë dhe ta bartë armën zyrtare të zjarrit të lejuar nga policia. Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit vetëm atëherë kur është absolutisht e domosdoshme dhe vetëm deri në atë nivel që kërkohet për ta arritur objektivin ligjor të policisë, kur përdorimi i saj është në proporcion me shkallën e rrezikut dhe seriozitetin e veprës penale në atë situatë, dhe vetëm nëse konsiderohet se, me përdorimin e mjeteve më të vogla të forcës, nuk do të arrihen objektivat legjitime të policisë.
2. Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit kundër personit tjetër vetëm kur mjetet më pak ekstreme janë të pamjaftueshme që të:
 - mbrojnë jetën e vet ose jetën e të tjerëve nga sulmet e pashmangshme;
 - parandalojnë kryerjen e pashmangshme apo vazhdimësinë e veprës penale që shkakton rrezik të lartë për jetën;
 - arrestojë personin i cili paraqet rrezik për jetën e të tjerëve dhe që u reziston urdhrave ligjorë të dhënë nga zyrtari policor;

- parandalojë arratisjen e personit i cili paraqet rrezik të pashmangshëm për jetën e personave të tjerë dhe që u reziston urdhrave ligjorë të dhënë nga zyrtari policor.
- 3. Para se ta përdorë armën e zjarrit, zyrtari policor jep vërejtje gojore, prezanton veten si zyrtar policor, duke urdhëruar personin që të ndalet, por edhe duke e paralajmëruar se do të shtierë nëse ai/ajo nuk ndalet.
- 4. Si masë e veçantë në rrethana urgjente, zyrtari policor mund të mos e bëjë paralajmërimin, në rast se një veprim i tillë e rrezikon zyrtarin policor ose personat e tjerë nga një rrezik serioz i pashmangshëm.
- 5. Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit kundër kafshëve, kur ato paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë e cilitdo person ose për shkak të rrezikut nga sulmi.

Nëse gjatë shqyrtimit të rasteve të përdorimit të forcës KSHPF arrin në përfundimin se ka tejkalim të kompetencave policore, ai inicon procedurën disiplinore, kurse për rastet e tejkalimit të kompetencave në përdorimin e forcës, me dyshime për vepër penale, çështja i dërgohet IPK-së për zhvillimin e hetimeve penale.

7.6 Mekanizmat e kontrollit të jashtëm të Policisë së Kosovës dhe roli i tyre në luftën kundër korrupsionit

Për përmbushjen e misionit të tyre në mënyrë sa më profesionale dhe sidomos për zbatimin sa më drejt të kompetencave ligjore dhe respektimin e standardeve të policimit demokratik, organizatat policore, përveç mekanizmave të kontrollit të brendshëm, u nënshtrohen edhe mbikëqyrjes dhe kontrollit të jashtëm. Këto, në fakt, janë vazhdimësi e mbikëqyrjes së brendshme, por me funksionin për të siguruar një pavarësi më të plotë dhe për të shmangur konfliktin e interesit në hetimet e shkeljeve

serioze të ligjit dhe kodit të sjelljes nga zyrtarët policorë. Mbikëqyrja e jashtme mbi policinë nuk kufizohet vetëm me hetimin apo mbikëqyrjen e hetimit të rasteve të caktuara, por kryen edhe funksione të tjera me interes për qytetarët dhe për shtetin.

Mbikëqyrja dhe kontrolli i jashtëm kanë katër role kryesore:

Për të siguruar zhvillimin e kontrolleve të brendshme.
Për të monitoruar nëse kontrollet e brendshme funksionojnë në mënyrë efektive brenda policisë.
Për t'i siguruar publikut një mekanizëm të pavarur ankesash mbi korrupsionin në polici.
Për t'u marrë me rastet e korrupsionit të policisë, të cilat nuk mund të zgjidhen nga vetë shërbimet policore, për shkak të vështirësisë së rastit ose për shkak të konfliktit të interesit.
(DCAF, 2012:202)

Organizatat policore janë në shërbim të zbatimit të ligjit. Ato kanë përgjegjësi ligjore sidomos për parandalimin dhe hetimin e rasteve të rënda të shkeljes së kodit të etikës, të rasteve të korrupsionit dhe të veprave tjera penale. Megjithatë, zyrtarët e saj, për motive të ndryshme, mund të përfshihen në raste të shkeljeve të ligjit. Ja ç' thotë për këtë Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura:

“Mund të rezultojë sfida për policinë zbulimi dhe parandalimi i shkeljeve që ndodhin në vetë shërbimin policor. Për këtë arsye, ka organe mbikëqyrjeje dhe kontrolli të jashtëm që monitorojnë policinë për të garantuar që ajo vepron në përputhje me ligjin.” (DCAF, 2012:197).

Prandaj, me të drejtë, shtrohet pyetja se sa efikas dhe i paanshëm mund të jetë procesi kur zyrtari policor heton një koleg të tij. Në mjaft botime dhe studime të ndryshme theksohet ideja shumë e rëndësishme se në këto raste është mirë që zyrtari hetues të mos jetë vendimmarrës, por të ndihmojë në mbledhjen e fakteve. Ja përse:

Hetimi i pretendimeve për shpërdorim, kundër kolegëve, mund të jetë detyrë e vështirë për zyrtarin e ngarkuar me të. Madje, është edhe më e vështirë të kërkohej kjo gjë nga zyrtarët e nivelit të parë. Zakonisht, ata janë në të njëjtën njësi me të akuzuarit dhe mund t'u duhet të punojnë drejtpërsëdrejti me ta në të ardhmen. Prandaj, zyrtarët hetues nuk duhet të jenë përgjegjës për konkluzione, konstatime apo rekomandime; përgjegjësia e tyre duhet të kufizohet në gjetjen e fakteve (Swanson, Territo, Taylor, 2005:420)

Në rastet e shkeljeve administrative, që, në fakt, përbëjnë shkelje të disiplinës, hetimet e brendshme mund të rezultojnë të suksesshme, nëse ekzistojnë kapacitetet profesionale dhe nëse ekziston vullneti i drejtuesit që njësia policore që ai drejton të jetë

e disiplinuar dhe me vlera të larta etike. Lidhur me këtë, Kodi European i Etikës Policore, në kreun *Llogaridhënia dhe kontrolli i policisë* përcakton kriteret e llogaridhënies dhe të kontrollit të policisë. Policia duhet t'u japë llogari shtetit, qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre. Pikërisht edhe për këtë arsye, policia u nënshtrohet mbikëqyrjes dhe kontrollit të jashtëm, pra, kontrollit shtetëror.

Kontrolli shtetëror mbi policinë ndahet mes pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Këto autoritete duhet të sigurojnë procedura efikase dhe të paanshme lidhur me shqyrtimin e ankesave kundër policisë. Po ashtu, bazuar në komunikimin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë mes publikut dhe policisë, duhet të promovohen edhe mekanizmat e llogaridhënies, të gjejë zbatim Kodi i Etikës së policisë. Këshilli i Europës, në memorandumun shpjegues të Kodit të Etikës në lidhje me mbikëqyrjen dhe kontrollin e jashtëm komenton:

Ankesat kundër policisë duhet të hetohen në mënyrë të paanshme. "Policia që heton policinë" është një çështje që, përgjithësisht, ngre dyshime për paanshmërinë. Prandaj shtetet duhet të ofrojnë sisteme që janë, jo vetëm të paanshme, por edhe që shihen si të paanshme, që të fitojnë besimin e publikut. Përfundimisht, duhet të jetë e mundshme referimi i këtyre ankesave tek gjykata. (Council of Europe, 2002:69)

Për një koordinim sa më të mirë midis institucioneve përgjegjëse për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, në Kosovë është hartuar dhe miratuar Strategjia Kundër Korrupsionit, e cila përcakton edhe përgjegjësitë e secilit institucion të mbikëqyrjes dhe kontrollit të PK-së. Në të thuhet:

"Qëllimi kryesor i Strategjisë së re Kundër Korrupsion është të kontribuojë në zvogëlimin progresiv dhe të qëndrueshëm të korrupsionit, në rritjen e integritetit dhe të besimit të qytetarëve ndaj institucioneve të qeverisjes publike, si dhe në promovimin e parimit 'zero tolerancë' ndaj korrupsionit; të zbatojë standardet ndërkombëtare kundër korrupsionit, që ndihmojnë në zbatimin efikas dhe funksional të ligjit në Kosovë." (Agjencia Kundër Korrupsionit, 2013:5)

Edhe pse relativisht e re, Policia e Kosovës ka arritur, që në bazë të legjislacionit, të krijojë nga ana organizative të gjitha hapësirat për mbikëqyrjen dhe kontrollin e jashtëm të saj. Madje, me përmirësimet e bëra në legjislacion lidhur me

këtë, Kosova ka një sistem kontrolli të jashtëm të policisë, që dallon nga shumë shtete, për faktin se hetimet penale kundër zyrtarëve të PK-së zhvillohen nga një agjenci krejtësisht e pavarur nga policia, por që ka kompetenca ligjore për zhvillimin e hetimeve penale në mënyrë të pavarur, sipas Kodit të Procedurës Penale dhe nën mbikëqyrjen e prokurorit publik. Kjo paraqet një praktikë të re, e cila nuk gjendet në shumë vende të tjera.

7.6.1 Roli i Inspektoratit Policor të Kosovës në kontrollin e jashtëm të PK-së

Një nga mekanizmat më të rëndësishëm për mbikëqyrje dhe kontroll të jashtëm të policisë është IPK. Themelimi i kësaj agjencie është autorizuar nga PPSP, me rregulloren e UNMIK-ut nr.2005/54 *Mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës* dhe, fillimisht, u quajt Inspektorati i Policisë. Funkcionet e tij ishin: të bënte kontrole dhe inspektime në Shërbimin Policor të Kosovës; të raportonte për përmbushjen dhe efektshmërinë e këtij shërbimi në arritjen e objektivave; si dhe të hetonte denoncimet për kryerjen e shkeljeve të rënda disiplinore nga policët ose personeli civil i Shërbimit Policor të Kosovës. Nëse ai dilte me rekomandime për ndonjë masë ndëshkimore, ia paraqiste ato KELDP-së.

Inspektorati i Policisë është i pavarur nga Shërbimi Policor i Kosovës; personeli dhe mjetet materiale të tij nuk duhet të konsiderohen si personel dhe mjete materiale të Shërbimit Policor të Kosovës; ai duhet të punojë në mënyrë profesionale dhe të paanshme, duke i respektuar plotësisht standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, pa ndikime politike dhe në interesin e të gjitha bashkësive në Kosovë. Inspektorati i Policisë themelohet si një agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, por me përbërje dhe me detyra që pasqyrojnë parimet e përcaktuara më lart. (UNMIK, 2005:11-12)

Roli dhe kompetencat e IPK-së u ndryshuan dhe u zgjeruan me aprovimin e ligjit për IPK-në, në të cilin thuhet: “Misioni i Inspektoratit Policor të Kosovës është që, përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e

kërkuara.” (Ligji për IPK,2011:2). Kurse në nenin 2 të këtij ligji përcaktohet fushëveprimi i IPK-së:

- inspektimi i strukturave dhe i funksioneve të Policisë së Kosovës, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, të akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi;
- hetimi dhe/ose inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës, siç është përcaktuar në nenin 4, paragrafin 1, nënparagrafin 1.11 të këtij ligji.
- hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policorë me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policorë të nivelit të lartë ekzekutiv;
- kur ekziston dyshimi i bazuar se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka kryer shkelje disiplinore, Kryeministri mund të autorizojë IPK-në për zhvillim të hetimeve disiplinore. IPK-ja, pas përfundimit të hetimeve disiplinore, i raporton Kryeministrit për gjetjet;
- pranimi i të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimi dhe përcaktimi se cilat nga ankesat hetohen nga IPK dhe cilat do t’i referohen Policisë së Kosovës apo institucioneve përgjegjëse.

7.6.2 Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI)

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është një tjetër institucion i rëndësishëm në rolin e mekanizmit të kontrollit të jashtëm të PK-së, e themeluar në bazë të Ligjit Nr.03/L-063 *Për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë*. Në këtë ligj theksohet se:

“AKI mbledh informacion në lidhje me kërcënimet ndaj sigurisë së Kosovës. Në çdo rast, kërcënim ndaj sigurisë së Kosovës konsiderohet kërcënimi ndaj integritetit territorial, integritetit të institucioneve, rendit kushtetues, stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik, si dhe kërcënimet ndaj sigurisë globale në dëm të Kosovës.”(Ligji për AKI, 2008:2)

AKI, duke pasur mandatin për grumbullimin dhe analizimin e informacioneve për sigurinë, krimin e organizuar, integritetin e institucioneve etj., është shumë e dobishme që ajo të bëjë paralajmërimin e hershëm për indikacionet e krimit dhe të korrupsionit në polici. Kjo ndihmon në parandalimin dhe zbulimin e veprave penale dhe korrupsionit në radhët e PK-së. Por kjo nxjerr problemin që zyrtarët e PK-së që kanë qasje në informacionet e klasifikuara duhet të kalojnë procesin e verifikimit dhe të pajisen me lejen e sigurisë. Për këtë, sipas ligjit, kompetente është AKI. Procesi i verifikimit të zyrtarëve policorë është i gjithanshëm dhe duhet kryer me kujdes, pasi ka të bëjë me përshtatshmërinë ose jo të zyrtarit të verifikuar për të pasur qasje në informatat e klasifikuara, në bazë të pozitës që ka. Duke ushtruar këtë kompetencë, AKI, në fakt, realizon kontroll dhe mbikëqyrje institucionale mbi PK-në.

Mosmarrja e lejes së sigurisë rezulton me transferimin e personit zyrtarit në një pozitë tjetër të barasvlefshme, për të cilën nuk nevojitet verifikimi i sigurisë. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë mosmarrja e lejes së sigurisë rezulton me largim nga puna apo me përfundim të kontratës mbi vepër ose shërbime në raport me autoritetin publik, nëse posedimi i lejes së vlefshme të sigurisë është kërkesë e domosdoshme për punësimin apo shërbimin përkatës. (Ligji nr.03/L-178, 2010:17)

Sipas Ligjit nr.03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë, AKI është autoriteti verifikues. Neni 25 '*Leja e Sigurisë*', i këtij ligji përcakton: Autoriteti Verifikues ia lëshon lejen mbi sigurinë vetëm atij personi, i cili, pas kryerjes të një procedure të verifikimit të sigurisë në pajtim me këtë ligj, është përcaktuar si rrezik i pranueshëm për sigurinë. Leja e sigurisë tregon qartë nivelin e informacionit të klasifikuar, në të cilën personi që e ka kaluar procedurën e verifikimit të sigurisë mund të ketë qasje. Leja e sigurisë për një nivel të caktuar të klasifikimit i jep bartësit qasje edhe në informacionet me nivel më të ulët të klasifikimit.

7.6.3 Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsion (KKKK)

Është themeluar më 14 shkurt 2012. Misioni i tij është koordinimi i punës dhe i aktiviteteve të institucioneve dhe agjencive anëtare, brenda kompetencave dhe

fushëveprimit të tyre, në funksion të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.

Funksionet kryesore të Këshillit janë:

- Të koordinojë aktivitetet në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.
- Të identifikojë dhe të koordinojë aktivitetet në mbështetje të zbatimit të strategjisë kombëtare në luftimin e korrupsionit.
- Të përcaktojë prioritetet dhe politikat për zbatimin e axhendës ligjore në ngritjen e efikasitetit në luftën kundër korrupsionit.
- Të koordinojë punën dhe aktivitetet e institucioneve përgjegjëse në fuqizimin e mekanizmave ekzistuese për luftimin e korrupsionit.
- Të rrisë vetëdijësimin e shoqërisë për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Anëtarë të KKKK janë; Agjencia Kundër Korrupsion, Audituesi Gjeneral i Kosovës, Komisioni Parlamentar për Legjislacionin, Komisioni Parlamentar për Buxhetin dhe Financat, Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrje të Financave Publike, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës, Këshilli Konsultativ i Komuniteteve, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Integriteteve Europiane, Ministria e Qeverisjes dhe Administrimit Lokal, Policia e Kosovës dhe Njësia e Qendrës së Inteligjencës Financiare.

7.6.4 Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK)

Mbikëqyrja dhe kontrolli i PK-së ushtrohet edhe nga kjo Agjenci, që është një nga mekanizmat më të rëndësishëm për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Krijimi i saj parashikohet në nenin 142, të Kushtetutës së Kosovës, që ka të bëjë me themelimin dhe funksionimin e Agjencive të Pavarura. Ligji për AKK-në e përkufizon korrupsionin si çdo keqpërdorim të pushtetit apo çdo sjellje tjetër të personit zyrtar,

personit përgjegjës apo personit tjetër, me qëllim arritjen e një përparësie apo përfitimi të kundërligjshëm për veten apo për tjetrin.” (neni 2, Ligji për AKK).

Ligji nr.03/l-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit parashikon kompetenca dhe autorizime për kontroll lidhur me korrupsionin në institucionet publike, përfshirë edhe Policinë. Edhe pse AKK nuk ka kompetenca ekzekutive, kontrolli i saj mbi Policinë ushtrohet përmes zbatimit të kompetencave ligjore në fushën e parandalimit të korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit, deklarimit të pasurisë dhe monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit.

7.6.5 Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit

Këshilli Prokurorial i Kosovës, bazuar në Ligjin për Këshillin Prokurorial dhe në Ligjin për Prokurorinë e Shtetit, më datë 1 nëntor 2013 aprovoi Planin e Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit (Këshilli Prokurorial, Nr.1285/2013). Qëllimi i këtij plani është të ndihmojë në kryerjen e veprimeve dhe aktiviteteve konkrete të përcaktuara nga Prokuroria Speciale e Kosovës dhe Prokuroritë Themelore për luftimin e korrupsionit.

Kryeprokurori i Shtetit, bazuar në planin e veprimit, emëron një prokuror nga Zyra e tij, si koordinator nacional për koordinimin e aktiviteteve dhe për mbikëqyrjen e këtij plani veprimi. Koordinator bashkëpunon ngushtë dhe koordinon aktivitetet me kryeprokurorët e prokurorive themelore dhe Prokurorisë Speciale.

Si një hallkë e veçantë, Koordinatorin nacional, ka rol të kufizuar në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, pasi ai, kryesisht, vepron për raportimin dhe koordinimin ndërmjet Prokurorive themelore, Prokurorisë Speciale, Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Policisë së Kosovës.

7.6.6 Zyra e Kordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike

Kjo është themeluar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, bazuar në Memorandumin e bashkëpunimit mes Këshillit Prokurorial të Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Bankës Qendrore të Kosovës, Agjencisë Kundër Korrupsion si dhe Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. Synimi i kësaj Zyre është rritja e efikasitetit në ndjekjen autorëve të veprave penale, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së fituar përmes veprave penale.

7.6.7 Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë

Një nga praktikat e zakonshme të mbikëqyrjes dhe kontrollit demokratik mbi Policinë janë komisionet parlamentare. Në Kosovë këtë detyrë e kryen Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, i cili funksionon në bazë të rregullores së punës të Kuvendit. Puna e këtij Komisioni është e një rëndësie të veçantë, pasi reflekton drejtpërsëdrejti vullnetin politik për ushtrimin e kontrollit demokratik mbi Policinë.

Mungesa e vullnetit politik për të mbikëqyrur shërbimet e Sigurisë mund të shkaktohet nga faktorë të ndryshëm, si:

Disiplina e partisë. Është në interes të parlamentarëve të partisë qeverisëse të mbajnë vendimmarrësit në pushtet, ata kanë tendencë të përmbahen prej kritikizmit publik të vendim marrësve.

Interesi elektoratit/mungesë e interesit. Në shumë shtete publiku, përgjithësisht, nuk është i interesuar për çështje të sigurisë. Kështu që shumë parlamentarë, në aspektin e rizgjedhjes së tyre, mendojnë se nuk ia vlen të shpenzojnë shumë kohë për çështjet e sigurisë.

Konsiderata ndaj çështjeve të sigurisë që shtyjnë parlamentarët, që janë, p.sh., anëtarë të Komisionit të Inteligjencës, të mos i zbulojnë gjetjet e tyre. (IPU&DCAF, 2003:76).

Fakti që Komisioni kryesohet nga deputetë të partive opozitare, i jep vlerë shtesë punës së tij, pasi prodhon vlerësime kritike për Policinë, vërejtje për menaxhimin që ajo u bën incidenteve që zgjojnë reagim në publik, apo legjislacionit dhe procedurave administrative, menaxhimin e financave etj.

Ky Komision Parlamentar është përgjegjës për mbikëqyrje të organeve të punëve të brendshme dhe të Forcës së Sigurisë.

Mendoj se duhet të rishikohet dhe të shqyrtohet mundësia për krijimin e një komisioni parlamentar të veçantë për punët e brendshme.

7.6.8 Avokati i Popullit

Roli dhe kompetencat e Avokatit të Popullit përcaktohen në nenin 132, Kapitulli XII, Institucionet e Pavarura të Kushtetutës së Republikës së Kosovës:

1. Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.
2. Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës.
3. Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.

Bazuar në nenin 135 të Kushtetutës, Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga organet e administratës publike dhe organe të tjera shtetërore, deri në referim të çështjes në Gjykatën Kushtetuese.

Në Ligjin Nr.05/L-019 përcaktohen qëllimi, kompetencat dhe fushëveprimi i Avokatit të Popullit. Sipas nenit 1, ky ligj ka për qëllim krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave

fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera, që ushtrojnë kompetenca publike në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: autoritetet publike), si dhe krijimin e mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.

Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë, pa diskriminim, në bazat e mbrojtura nga Ligji për *barazi gjinore* dhe nga Ligji për *mbrojtje nga diskriminimi*.

Në nenin 16 të ligjit për *Avokatin e Popullit* përcaktohen kompetencat e tij, që janë të hetojë ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik, lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parashikuara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.

Në pikën 4 të këtij neni, thuhet se Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime, qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me nismativën e vet (*ex officio*), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të konkludojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, me ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Kurse në pikën 5, neni 16, parashikon: nëse Avokati i Popullit, gjatë kryerjes së hetimeve, vëren se ka elemente të veprës penale, informon organin kompetent për fillimin e hetimeve.

Ligji për Avokatin e Popullit obligon institucionet për bashkëpunim në çështjet për të cilat zhvillohen hetime. Sipas nenit 25, *Detyrimi i bashkëpunimit dhe pasojat e*

refuzimit, të gjitha autoritetet kanë për detyrë t'i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t'i ofrojnë ndihmën e duhur, sipas kërkesës së tij. Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyt në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore, për pengim të kryerjes së detyrës zyrtare.

Vëllimi i punëve të Avokatit të Popullit dhe numri i çështjeve të trajtuara prej tij janë rritur vazhdimisht. Puna e këtij institucioni pasqyrohet në raportet vjetore që ia drejton Kuvendit të Kosovës. Në raportin e Avokatit të Popullit, të vitit 2010, policia përmendet vetëm një herë. Kurse në raportin për vitin 2012, PK-ja përmendet 25 herë dhe paraqitet si palë përgjegjëse në 103 raste.

Duke shfletuar disa nga këto raporte, kemi mundur të nxjerrim disa problematika të punës së PK-së në zbatimin e ligjit, të raportuara nga Avokati i Popullit

Në vitin 2007, Institucioni i Ombudsmanit pranoi një ankesë që kishte të bënte me një rast të dhunës familjare, që përfshinte një polic të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK). Gruaja e policit ishte keqtrajtuar fizikisht dhe psikologjikisht dhe shpesh ishte kërcënuar me thikë dhe me revole nga polici. Rasti u raportua, por policia nuk ndërmori asnjë veprim dhe, prandaj, ushtruesi i detyrës së Ombudsmanit kërkoi nga SHPK-ja t'i siguronin informata për masat e ndërmarra në rastin e lartpërmendur. Përgjigja e SHPK-së zbuloi se kjo e fundit kishte hapur vetëm hetime administrative lidhur me rastin e lartpërmendur, me argumentim se po vepronte sipas mendimit të Zyrës së Prokurorit Komunal (Avokati i Popullit, 2007:82)

Roli dhe rëndësia e Avokatit të Popullit qëndron edhe në aspektin e monitorimit të ndikimeve politike në organizatën policore, por edhe në nevojën për ruajtjen e integritetit të policisë dhe respektimit të parimit të paanshmërisë. “Avokati i Popullit konsideron se, në kryerjen e rolit të saj, policia është e obliguar dhe duhet të ketë synim parësor mbrojtjen të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.. (Avokati i Popullit, 2012:60)

Avokati i Popullit tërheq vërejtjen se, sado të ashpra qofshin kontradiktat dhe qëndrimet politike mes subjekteve politike, policia nuk guxon të keqpërdoret për qëllime politike. Instrumentalizimi i policisë për qëllime politike është i papranueshëm dhe tepër i rrezikshëm për demokracinë, stabilitetin dhe shpie pashmangshmërisht në rrënimin e parimit të ndarjes së pushteteve dhe, rrjedhimisht, edhe drejt shkeljes së të drejtave të njeriut (Avokati i Popullit, 2012:63)

Këta shembuj nga raportet vjetore të Avokatit të Popullit tregojnë për rolin dhe rëndësinë që ka ky institucion në mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi Policinë.

7.6.9 Auditori i Përgjithshëm

Ky është një institucion i rëndësishëm që ka mandat për mbikëqyrje dhe kontroll institucional. Ai është institucion i pavarur dhe kompetent për auditimin e buxhetit. Mbështetur në Kushtetutën e Kosovës, Neni 136, Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Kurse me Ligjin nr.03/l-075 për themelimin e zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës, në nenin 3 përcaktohen kompetencat dhe fushëveprimi i Auditorit i Përgjithshëm.

1. Auditori i përgjithshëm i raporton Kuvendit.
2. Auditori i përgjithshëm, në bazë vjetore, kryen auditim të Rregullsisë të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, të organizatave buxhetore, duke përfshirë, por pa u kufizuar, Kuvendin e Republikës së Kosovës, Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës, çdo ministri dhe agjenci ekzekutive, komunat, organet e pavarura, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) dhe subjektet e tjera, që janë më shumë se 50% në pronësi publike ose marrin mjete financiare nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës, sigurojnë dividendët apo të ardhura të tjera të pataksueshme për të, duke përfshirë, por pa u kufizuar, Shërbimin Doganor të Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ombudsmanin.

Sikurse këto institucione, edhe Policia, si organizatë e pavarur buxhetore, u nënshtrohet procedurave të auditimit për rregullsinë buxhetore.

Siç e pamë më sipër, në Kosovë ekzistojnë disa institucione që kanë mandat kontrolli në funksion të luftimit të korrupsionit. Por çështja shtrohet sa efektive janë ato, ç’rezultate japin në praktikë. Përgjithësisht, konstatohet se ato nuk kanë arritur rezultatet që priten dhe se nuk është krijuar një praktikë e mirëfilltë e bashkëpunimit institucional. Kjo, për shkak të mungesës së një sistemi, i cili do të siguronte koordinim domethënës të agjencive, shkëmbim informacioni, si dhe adresim të duhur të përgjegjëseve.

Shumë vërejtje bëhen në këtë drejtim nga një Progresraport i Komisionit European për Kosovën:

“Ngritja e institucioneve që merren me korrupsionin mbetet komplekse. Sistemi është i fragmentuar, me role dhe përgjegjësi të paqarta. Nuk ka sistem të përbashkët të statistikave. Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsion është krijuar me synimin që të sigurojë përgjegjësi dhe llogaridhënie të institucioneve të përfshira në luftimin e korrupsionit. Sido që të jetë, këshilli nuk takohet rregullisht. Për më shumë, takimet e tij mbahen në publik dhe numri i pjesëmarrësve është rritur. Kjo ngre shqetësime lidhur me efektivitetin dhe autoritetin.” (European Commission, Kosovo Progress Report 2013:13).

7.6.10 Misioni i Bashkimit European për Sundimin e Ligjit - EULEX

Misioni më i madh i BE-së për Sundimin e Ligjit – EULEX, është i mandatuar që nga viti 2008 për të monitoruar, udhëzuar dhe këshilluar autoritetet vendore për çështjet e sundimit të ligjit me zbatim të mandatit ekzekutiv, lidhur me rastet e ndjeshme të tilla, si korrupsioni i nivelit të lartë nga zyrtarët e shtetit (KIPRED, 2014:11).

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1,4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në qershor 2016, miratoi ligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit European, mbi Misionin e Bashkimit European për sundimin e ligjit në Kosovë (“EULEX KOSOVA”). Kjo marrëveshje u arrit nëpërmjet shkëmbimit të instrumenteve mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit European. Ndër të tjera, ligji parasheh edhe zgjatjen e mandatit të EULEX-it në fushat e parashikuara në marrëveshje, deri më 15 qershor 2018.

Edhe pse prokurorët vendorë të PSRK-së kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të luftuar korrupsionin, shpesh EULEX-i përdoret si një justifikim për mungesën e nisativës së tyre, që është në kundërshtim me arsyet e krijimit të një PSRK-je të udhëhequr nga ndërkombëtarët. Prokurorët e EULEX-it janë bërë një mburojë për joefikasitetin e homologëve të tyre vendorë. Ata vazhdojnë të shprehin dyshimet e tyre në kapacitetet e prokurorëve vendorë, duke justifikuar, kështu, nevojën për qenien e tyre (KIPRED, 2014:12).

KREU VIII: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

8.1 Përfundime të përgjithshme rreth studimit

Në zgjedhjen e kësaj teme doktorature u nxitëm kryesisht nga fakti se, megjithëse në dekadën e fundit, në Kosovë janë bërë shumë ndryshime dhe përmirësime në plotësimin e infrastrukturës ligjore, në hartimin e dokumenteve strategjike dhe procedurave të veprimit, si dhe me krijimin e mekanizmave institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, niveli i korrupsionit në vend është ende i lartë.

Është mendim i përgjithshëm se shoqëria bashkëkohore sot ballafaqohet përditë me dukurinë e korrupsionit zyrtar dhe me pasojat e tij. Në vendet me nivel të ulët të sundimit të ligjit dhe me mungesë të transparencës, ku institucioni i llogaridhënies nuk funksionon, korrupsioni është prezent në të gjitha institucionet. Por abuzimet me detyrën, rastet e shpërdorimit të pozitës zyrtare dhe skandale të tjera korruptive ndeshen edhe në vende me nivel të lartë të zhvillimit demokratik dhe të sundimit të ligjit. Edhe në Kosovë korrupsioni dhe abuzimi me detyrën dhe me kompetencat paraqesin një plagë për shoqërinë në përgjithësi, për shkak se shtrirja e kësaj dukurie në organet e administratës shtetërore konsiderohet të jetë e lartë. Policia, si pjesë e sistemit, nuk mund të mos ndikohet nga ambienti që e rrethon. Faktet tregojnë se ka zyrtarë policorë që kyejnë vepra të ndryshme penale të korrupsionit. Megjithë përpjekjet e bëra për të vendosur standarde të sjelljes në detyrë të personelit, policia përballlet me veprime të paligjshme dhe afera korruptive të zyrtarëve policorë, që kanë marrë përmasa që nuk mund të injorohen. Krahas forcimit të punës për luftimin e tyre, ato duhen studiuar dhe analizuar, me qëllim që të ndërmerren masat e nevojshme për parandalimin e tyre.

Për këtë arsye u ndërmor ky studim, që të adresojë sfidat konkrete dhe të perspektivës në luftën kundër korrupsionit në radhët e Policisë së Kosovës dhe domosdoshmërinë e forcimit të pandërprerë të kësaj lufte, përmes përmirësimit të legjislacionit dhe penalizimit të veprave penale në këtë fushë, por edhe nëpërmjet menaxhimit më të mirë të personelit, të forcimit të integritetit profesional dhe etik të zyrtarëve policorë dhe rritjes së efikasitetit të mekanizmave të kontrollit dhe të mbikëqyrjes institucionale të Policisë.

Në këtë punim doktoral bëhet analizimi i veprave penale në fushën e korrupsionit të kryera nga zyrtarët e Policisë së Kosovës në periudhën 2010-2015, evidencohen probleme të administrimit të disiplinës, ndërtimi i kapaciteteve profesionale, identifikimi i mangësive ligjore, administrative apo menaxheriale që vështirësojnë përpjekjet në parandalimin dhe luftimin e sjelljeve devijante brenda personelit në Policinë e Kosovës. Përfundimet e nxjerra lidhur me problematikën e studiuar, diktojnë edhe formulimin e disa rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes në këtë fushë.

Studimi synon të ofrojë ide dhe mundësi, që do të shërbejnë në aspektin praktik për ta ndihmuar Policinë e Kosovës në përmbushjen e misionit të vet, por edhe në influencimin në vendimmarrjet strategjike, në planifikimin e veprimeve për forcimin e integritetit policor, në përmirësimin e procedurave të rekrutimit, përzgjedhjes së personelit, si dhe në edukimin dhe trajnimin e tij.

Si studimi i parë i kësaj problematike në Kosovë, ai do të ndihmojë në pasurimin e fondit të kërkimeve shkencore në këtë fushë, por dhe të mendimit juridik e kriminologjik lidhur me këto vepra penale. Mbështetur në një vëllim të mjaftueshëm literature dhe dokumentesh, ku u njohëm me kontributet shkencore të studiuesve të ndryshëm, në idetë dhe teoritë e ndryshme për korrupsionin, hodhëm bazat konceptuale

teorike të strukturimit dhe të zhvillimit të punimit doktorat dhe projektua vërtetimin empirik në terren. Po ashtu, mbi baza teorike shkencore formulua qëllimin dhe objektivat e hulumtimit, zgjedhëm metodologjinë, metodat dhe teknikat e përshtatshme të vërtetimit, si anketimin dhe intervistën. Vëmendje e veçantë iu kushtua formulimit të Hipotezave të punimit, vlefshmëria e të cilave do t'i nënshtrohej vërtetimit empirik. Në funksion të kësaj, hartuam edhe pyetjet kërkimore, përgjigjet e të cilave do të shërbenin për të vërtetuar hipotezat.

Për realizimin e studimit u gjetën dhe u përdorën burime parësore dhe dytësore informacioni, literaturë e huaj dhe dokumente të institucioneve të ndryshme të Kosovës dhe të organizmave ndërkombëtare, që na dhanë teoritë dhe konceptet bazë lidhur me korrupsionin dhe me luftën kundër tij.

Në punimin doktorat vihet në dukje se menjëherë pas krijimit të shtetit të ri të Kosovës u bë një punë e mirë për hartimin e legjislacionit dhe të strukturave të ndryshme të zbatimit të ligjit. Hapa të rëndësishëm kanë qenë miratimi i mjaft ligjeve, si dhe ngritja e një sërë agjencive dhe institucionesh, me synim fuqizimin e luftës kundër dukurisë së korrupsionit. Legjislacioni i Kosovës kundër korrupsionit në vite është përafruar me standardet ndërkombëtare. Në këtë studim, ai është parë lidhur ngushtë me legjislacionin dhe instrumentet ndërkombëtare, që identifikojnë funksionet dhe detyrat kryesore antikorrupsion. Për të pasur një pasqyrë më të qartë të ligjeve dhe standardeve ndërkombëtare kemi bërë edhe një vështrim krahasimor të legjislacionit të korrupsionit të Kosovës me atë të disa vendeve të tjera. Përmes këtij krahasimi janë identifikuar dallimet, por edhe mangësitë në dispozitat e Kodit Penal të Kosovës, në raport me legjislacionin e vendeve të tjera, me Konventën Penale Kundër Korrupsionit etj.

Përmes punës hulumtuese u siguruan të dhëna sasiore dhe cilësore nga raportet statistikore të PK-së dhe IPK-së, përmes të cilave u studiuan numri dhe trendi i veprave

penale në vite, llojet e veprave të raportuara, numri i zyrtarëve të PK-së të përfshirë në to etj. Gjithashtu, u hulumtuan dhe u shfrytëzuan një numër vendimesh gjyqësore të marra ndaj zyrtarëve të PK-së të gjykuar, me qëllim që të shohim llojin e veprave penale të kryera, por edhe politikën ndëshkimore të ndjekur nga gjykatat e vendit. Për të njohur perceptimin e vetë zyrtarëve të PK-së për korrupsionin dhe për veprat penale të kryera nga personeli policor, për çështjet etike, dhe integritetin policor etj., organizuam kërkimin empirik në terren, përmes metodës së anketimit me pyetësor. Trajtimin dhe interpretimin e informacionit të larmishëm që u mblodh, e kemi paraqitur edhe përmes tabelave dhe grafikëve.

Studimi ka dhe disa kufizime, që kanë ardhur nga vështirësitë në sigurimin e të dhënave statistikore për rastet e hetimeve ndaj zyrtarëve të PK-së; nga mungesa e literaturës së kësaj fushe në gjuhën shqipe dhe ngaqë nuk u gjetën të dhëna statistikore për karakteristikat personale të autorëve të këtyre veprave në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës.

Në njohjen e kësaj problematike në literaturën e shfrytëzuar, e pamë me interes të ndaleshim edhe te vetë termi “korrupsion policor”. Për të nuk ka një përkufizim gjithëpërfshirës dhe të pranuar në mënyrë universale, por janë në qarkullim shumë përkufizime të ndryshme. E përbashkëta e tyre është se në to ky term përdoret për të njëjtat veprime, si: abuzimi me detyrën, ryshfeti; dhuna dhe brutaliteti; falsifikimi dhe shkatërrimi i dëshmive; racizmi; favorizimi apo nepotizmi etj., të gjitha këto për përfitime private. Çështja e termit ngrihet në studim jo thjesht për kulturë gjuhësore apo juridike, por për faktin se mungesa e një përkufizimi për korrupsionin mund të jetë pengesë, në shumë aspekte, për luftimin e kësaj dukurie, si në aspektin nacional, ashtu edhe në aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në aspektin ligjor, mund të jetë

sfidues përcaktimi i saktë i kufirit të ndarjes mes shkeljeve administrative që paraqesin shkelje disiplinore apo shkelje të kodit të etikës dhe shkeljeve që përbëjnë vepër penale.

Studimi vë në dukje se korrupsionin e bëjnë personat që kanë pushtet, një post zyrtar, një përparësi etj., por edhe persona që kanë halle ose që janë mashtrues, biznesmenë, trafikantë, si dhe persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kjo e bën dukurinë e korrupsionit shumë komplekse dhe të vështirë për t'u zbuluar dhe për t'u luftuar. Korrupsioni, përveç dimensionit politik dhe ekonomik, ka edhe dimension historik, psikologjik dhe kulturor.

Në përputhje me qëllimin e tij, punimi doktoral bën identifikimin e faktorëve dhe të shkaqeve që ndikojnë në praninë e korrupsionit policor. Ky identifikim konsiderohet hapi i parë në trajtimin dhe në punën për parandalimin dhe luftimin efikas të kësaj dukurie. Faktorët janë shumë kompleksë, të përgjithshëm dhe të veçantë. Si faktorë të përgjithshëm njihen ata që veprojnë edhe në vendet e tjera, ndërsa me faktorë të veçantë kemi parasysh rrethanat specifike të Kosovës, si një shtet i ri i dalë nga lufta. Policia e Kosovës, si një ndër institucionet kryesore të zbatimit të ligjit dhe të sigurisë publike, u krijua në rrethana mjaft komplekse, kur në vend, pas lufte zotëronte gjendja e rëndë ekonomike, sociale e politike. Shtojmë këtu varësinë e saj nga policia e UNMIK-ut; mangësitë në punën e personelit policor ndërkombëtar, që do të krijonte dhe do të trajnonte policinë e re të Kosovës; procesin e pavarësimit të PK-së etj. Këta faktorë kanë bërë që lufta kundër korrupsionit të mos ishte në shkallën e duhur. Po ashtu, kanë ndikuar edhe sistemet jo të shëndosha të llogaridhënies në prokurori dhe në gjykata; legjislacioni jo i plotë; traditat kulturore; korrupsioni në institucione të tjera të shtetit; aspekti demografik dhe gjeografik, që ka të bëjë me faktin se sa shpesh janë në kontakt qytetarët me zyrtarë policorë etj.

Por në studim i mëshohet idesë se shumë faktorë duhen kërkuar brenda vetë policisë, te përzgjedhja e personelit, te departamentet e PK që nuk bëjnë punë të mirë për trajnimin dhe disiplinimin e personelit, te defektet e kontrollit dhe të mbikëqyrjes mbi vartësit etj.

Mbështetur në studime të ndryshme, në literaturën e botuar, si edhe në vërtetimin empirik janë identifikuar edhe format dhe llojet e ndryshme të veprave korruptive. Në punim evidencohen këto lloje: *korupsioni spontan*, që përkufizohet si një sjellje e individit, që nuk ndikohet nga jashtë; *korupsioni i planifikuar*, i cili nënkupton ekzistencën e kontaktit mes atij që jep mitë dhe atij që e pranon atë; *korupsioni situativ*, që ndodh më tepër si rastësi, që kryhet vetëm një herë dhe nuk përsëritet; dhe *korupsioni sistematik*, i cili paraqitet si një veprim korruptiv gjithmonë i planifikuar dhe që nënkupton bashkëpunim sistematik dhe marrëdhënie të vazhdueshme mes atyre që japin mitë dhe atyre që e marrin atë.

Një nga format më të përfolura të kryerjes së korupsionit në polici është pranimi i mitës. Kjo ndodh, ngaqë zyrtarët policorë janë në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët, qoftë në veprimet për zbatimin e ligjit, qoftë në kryerjen e shërbimeve të ndryshme. Forma të tjera janë: përpilimi i raporteve të falsifikuara, vjedhja e drogës në detyrë, vjedhja e pasurisë së konfiskuar, shitja e informacioneve lidhur me operacionet policore, falsifikimi i deklaratave të dëshmitarëve, manipulimi i provave, brutaliteti etj.

Si një kërkesë logjike, në studim evidencohen edhe pasojat që sjell korupsioni policor në shoqëri. Ai mund të rrezikojë deri edhe kapacitetin dhe legjitimitetin e shtetit, mund të dobësojë shërbimet e sigurisë, por edhe sundimin e ligjit në vend. Ndonjëherë, korupsioni, sidomos ai që zhvillohet nga zyrtarët e rangjeve të larta, konsiderohet si “kapje e shtetit”. Korupsioni konsiderohet i rrezikshëm edhe sepse ai përdoret si praktikë maskuese e fuqishme për aktivitetet e krimit të organizuar, që e shfrytëzojnë

atë për të depërtuar deri në strukturat e larta shtetërore, në ekonominë e ligjshme, në organet e zbatimit të ligjit e në të gjitha poret e shoqërisë.

Një fakt i rëndësishëm që evidencon studimi është se në Kosovë veprat penale të korrupsionit janë njohur që në fillim në të drejtën penale si vepra kriminale, duke përcaktuar, njëkohësisht, edhe politikat penale ndaj zyrtarëve që kryejnë të tilla vepra. Në legjislacionin e Kosovës jepen qartë karakteristikat dhe figurat juridiko-penale të këtyre veprave penale. Ato analizohen lidhur ngushtë me politikën penale dhe hetimore, duke nxjerrë problemet që ekzistojnë dhe përmirësimet që duhen bërë. Në përputhje me politikën ndëshkimore shtetërore, janë bërë ndryshime të rëndësishme në KPPK dhe KPK, duke shprehur politikën e re të shtetit për luftën kundër kriminalitetit, në tërësi, dhe të korrupsionit, në veçanti, dhe duke krijuar një hapësirë më të madhe për punën e organeve të hetuesisë në këto fusha.

Me interes është konstatimi se, krahasuar me kodet penale të Sllovenisë, Austrisë dhe Serbisë, sanksionet që parashikon KPK për veprat penale të korrupsionit zyrtar janë më të ashpra, por në Kosovë vihet re se zbatimi në praktikë i tyre dhe masat e marra nuk janë efikase në luftimin e fenomenit. Po ashtu, ka edhe parregullsi, mosrespektim të afateve ligjore në trajtimin e rasteve të korrupsionit në hallkat e ndryshme të sistemit të drejtësisë, si zvarritjet në prokurori, gjykata dhe në polici, ka prirje për të dhënë dënime më të buta, sesa parashikon ligji etj.

Një trajtim i veçantë u bëhet në studim problemeve që lidhen drejtpërdrejt me nevojën e reformimit dhe me përmirësimet që duhen bërë në hetimin e veprave penale të korrupsionit policor. Në këtë proces, strukturat përkatëse të PK përballen me mjaft probleme, me vështirësi, me shkelje, që nisin qysh në identifikimin e hershëm të indikacioneve për veprimtari kriminale; me ndërlikimet e ndryshme gjatë procesit

hetimor, në dokumentimin dhe argumentimin në procedurën penale, si dhe në vërtetimin e gjendjes faktike në proceset gjyqësore.

Nga hulumtimi i kryer rezulton se problematikë janë edhe zbulimi dhe denoncimi i veprave penale të korrupsionit, të kryera nga zyrtarët e policisë. Shpesh, marrëdhëniet ndërmjet vetë zyrtarëve policorë shpien në krijimin në polici të një kulture sjelljeje, që ndikon te zyrtarët policorë të “mbyllin syrin” ndaj shkeljeve disiplinore apo penale nga kolegët. Këto raste, jo vetëm që nuk ndihmojnë në parandalimin dhe luftimin e veprave penale, por rrezikojnë që, duke mos raportuar, edhe vetë zyrtarët të bëhen subjekte të veprave penale. Por zbulimi i veprave penale të korrupsionit është i vështirë edhe për faktin se korrupsioni shpesh nuk ka ndonjë viktimë të dukshme, që të ankohet. Veprimet korruptive kryhen në fshehtësi dhe nuk kanë dëshmitarë.

Një tjetër problem që del nga hulumtimi është ai i qëndrimit që mbajnë në punë punonjësit e policisë ndaj një kolegu që ka qenë hetuar për ndonjë vepër penale. 70% e të anketuarve pohuan se nuk ndihen mirë kur punojnë me një koleg të tillë, 23% ndihen pjesërisht keq, dhe vetëm 7% e të pyeturve deklaruan se nuk shohin ndonjë problem në raste të tilla. Nga analiza e këtyre shifrave kuptohet qartë se ka mungesa në formimin dhe në nivelin kulturor të pjesës dërmuese të efektivëve të policisë, gjë që ndikon negativisht në marrëdhëniet ndërnjerëzore midis tyre, por edhe krijon mosbesim në organizatën e policisë.

Edhe raportimi nga qytetarët i veprave penale të kryera nga zyrtarët policorë, për shkak të frikës se mund të përballen me pasoja, me dhunë, me keqtrajtime apo kërcënime nga policia, është një çështje që kërkon vëmendje dhe që duhet marrë në konsideratë nga drejtuesit e PK. Lind nevoja që të krijohen mënyra, procedura dhe mundësi më të përshtatshme, të thjeshta dhe joburokratike për raportimet e qytetarëve

që dëshirojnë të denoncojnë çdo lloj krimi, përfshirë edhe ato të kryera nga punonjës policie.

Shpeshherë fenomeni i korrupsionit në polici trajtohet më tepër në aspektin deklarativ, sesa në aspektin ligjor, llogaridhënës dhe me transparencë. Kjo nxjerr nevojën e ndërtimit dhe të fuqizimit të pandërprerë të kapaciteteve për mbikëqyrje demokratike dhe të pavarur të organizatave policore, si dhe domosdoshmërinë e veprimit të ligjit me ‘zero tolerancë’ mbi këdo që përfshihet në vepra korruptive, qoftë punonjës i thjeshtë, qoftë zyrtar i lartë i policisë. Edhe në funksionimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të PK, nevojitet një sistem më i mirë kontrolli dhe mbikëqyrjeje, si dhe forma dhe mekanizma më efikasë të menaxhimit të disiplinës në polici.

Është fakt pozitiv që Policia e Kosovës ka, tashmë, një sistem të kompletuar të kontrollit të brendshëm: të inspektimit, të auditimit, të disiplinës, të mbrojtjes së të drejtave të personelit, të shqyrtimit të përdorimit të forcës etj. Theksojmë se PK-ja është ndër institucionet e pakta në Kosovë që ka ndërtuar mekanizma funksionalë për administrimin e disiplinës. Por e rëndësishme është që ky kontroll, ashtu si dhe përmbushja e misionit të policisë, të bazohen në standardet më të larta të policimit demokratik, në respektimin me rigorozitet të parimeve, procedurave dhe normave ligjore në të gjithë procesin.

Edhe mbikëqyrja e jashtme e policisë ushtrohet nga struktura të ngritura me ligj, veprimtaria e të cilave nuk kufizohet vetëm me hetimin apo mbikëqyrjen e hetimit të rasteve të caktuara, por përfshin edhe funksione të tjera me interes për qytetarët dhe për shtetin. Me përmirësimet e bëra në legjislacion, Kosova ka një sistem kontrolli të jashtëm të policisë, që dallon nga shumë shtete, për faktin se hetimet penale kundër zyrtarëve të PK-së zhvillohen nga një agjenci krejtësisht e pavarur nga policia dhe që ka

kompetenca ligjore për zhvillimin e hetimeve penale në mënyrë të pavarur, sipas Kodit të Procedurës Penale dhe nën mbikëqyrjen e prokurorit publik. Kjo paraqet një praktikë të re, e cila nuk gjendet në shumë vende të tjera.

Sfidues mbetet bashkëpunimi më efikas i strukturave të zbatimit të ligjit dhe sidomos forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet organeve dhe institucioneve kompetente për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Një përfundim i rëndësishëm është fakti që edhe vetë zyrtarët e PK-së janë të vetëdijshëm se korrupsioni dhe veprat penale të kryera në radhët e tyre për qëllime përfitimi janë të pranishme në Polici dhe se dëmtojnë rëndë imazhin e organizatës. Nga përgjigjet e intervistës del se, megjithë arritjet në punën e saj, PK, si një organizatë e re, është përballur dhe përballët çdo ditë me korrupsionin dhe me një numër të madh veprash penale, ku janë përfshirë punonjës të saj. 12% e të anketuarve kanë perceptimin se niveli i korrupsionit në PK është i lartë dhe në rritje.

Pra, mund të thuhet se veprat e korrupsionit në polici, jo vetëm janë të pranishme, por edhe përbëjnë një sfidë, një dukuri në PK, ashtu siç parathuhet edhe në Hipotezën kryesore të këtij punimi doktoral.

8.2 Shqyrtime mbi vërtetimin e hipotezave të studimit

Siç e kemi theksuar, për të vërtetuar hipotezat e ngritura lidhur me nivelin e korrupsionit në Kosovë dhe me sfidat në luftimin e tij jemi mbështetur në përgjigjet që kemi mundur t'u japim secilës nga pyetjet kërkimore të studimit. Këto përgjigje janë rezultat i përpunimit dhe i analizës së të dhënave sasiore dhe cilësore të grumbulluara për shtetin e Kosovës pas luftës, sidomos për vitet 2010-2015.

Përpunimi i të dhënave u bë duke përdorur qasje analitike, tematike, statistikore dhe krahasuese. Nga rezultatet u përftua një tablo e qartë rreth problematikës së

korupsionit në PK dhe rreth luftës që bëhet kundër kësaj dukurie. Prej tyre u nxorën mangësitë, shqetësimet, problemet që ka zhvillimi i kësaj lufte dhe që kërkojnë zgjidhje. Së fundi, ato ndihmuan për arritjen e konkluzioneve të vlefshme për t'u dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të studimit.

Po ndalemi tani në shqyrtimin e problematikës në funksion të testimit të hipotezave të këtij disertacioni.

Hipoteza kryesore: Megjithë plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, korupsioni në Policinë e Kosovës po merr formë fenomeni, ngaqë mungojnë masat efikase për parandalimin dhe luftimin e tij, ndaj del domosdoshmëria e forcimit të vazhdueshëm të luftës kundër këtij fenomeni.

Për të arritur vërtetimin e saj, testojmë më parë dy nënhipotezat.

Për Nënhipotezën 1: Politika penale për veprat penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës në fushën e korupsionit zyrtar nuk është efektive, po u referohemi përgjigjeve të pyetjes së 4-t kërkimore: *A është efikase politika penale për personat që janë dënuar për kryerjen e veprave penale të korupsionit?*

Nga përpunimi i të dhënave, del se në KPK politika ndëshkimore është shprehur për secilën nga veprat e ndryshme penale, ku përfshihen persona zyrtarë. Në disa nene të veçanta të tij jepen sanksionet për *veprat penale të korupsionit zyrtar*. Krahësuar me kodet penale të Sllovenisë, Austrisë dhe Serbisë, shohim se sanksionet që parashikon KP i Kosovës për veprat penale të korupsionit zyrtar janë më të ashpra, dënimi shkon deri në dymbëdhjetë vjet. Edhe *dhënia e ryshfetit*, në Kosovë ndëshkohet deri në tetë vjet burgim. Ndëshkim shumë më i ashpër, në Kosovë jepet edhe për veprën penale *zbulimi i sekretit zyrtar*, që shkon deri në dhjetë vjet burgim.

Por megjithëse sanksionet e parashikuara me KPK shprehin vullnetin e ligjvënësit për sanksione të ashpra kundër korrupsionit, vihet re që zbatimi në praktikë i këtyre dispozitave dhe masat e marra nuk janë efektive për luftimin e këtij fenomeni.

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) në raportin e publikuar “*Korrupsioni në Kosovë: Luftimi apo promovimi i korrupsionit*”, ka paraqitur arritjet lidhur me efikasitetin e sistemit gjyqësor në trajtimin e këtyre veprave, në vitet 2014-2015. Sipas tij, gjatë vitit 2014, në 38 çështje gjyqësore për korrupsion, gjykatat kanë dhënë *dënime me burg* ndaj 35 personave. Në vitin 2015, ky numër ka rënë në 31 çështje, por është rritur numri i personave të dënuar me burg, që ka shkuar në 41.

Gjatë vitit 2014, gjykatat kanë dhënë *dënime me gjobë* në 37 çështje gjyqësore, ndaj 41 personave; ndërsa në vitin 2015, dënime me gjobë janë dhënë në 31 raste, ndaj 35 personave.

Në vitin 2014, gjykatat kanë dhënë *dënime me kusht* në 43 çështje gjyqësore, ndaj 54 personave; kurse në vitin 2015 kanë dhënë *dënime me kusht* në 33 çështje gjyqësore, ndaj 45 personave.

Në vitin 2014, gjykatat kanë shpallur *lirimin* e 58 personave, në 41 çështje gjyqësore; kurse në vitin 2015, gjykatat kanë vendosur *lirimin* për 58 persona, në 32 çështje gjyqësore.

Në vitin 2014, gjykatat kanë vendosur *aktgjykim refuzues* në 20 çështje gjyqësore, për 40 persona, kurse në vitin 2015 e kanë vendosur atë në 29 çështje gjyqësore, për 63 persona.

Nga këto shifra, por edhe nga çështjet gjyqësore, që kemi cituar në studim, shohim që në shumë raste janë dhënë dënime më të buta, sesa parashikon KPK. Shpesh gjykatat, kur caktojnë dënimin, nuk mbajnë sa duhet parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për atë vepër penale, qëllimin e dënimit, parimet e

përcaktuara në kodin penal; rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin; shkallën e përgjegjësisë penale; motivet për kryerjen e veprës; intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur etj.

Lidhur me masat ndëshkimore, në përgjigjet e marra nga intervista e kryer u shfaqën mendime të ndryshme. Për *masat ndëshkimore që merren ndaj punonjësve të policisë të përfshirë në vepra penale*, 31% e të anketuarve pohojnë se ato janë të paanshme dhe efikase, se merren në kohën e duhur dhe pa vonesë. Me interes këtu është fakti që gjysma tjetër e të anketuarve, 52%, kanë rezerva për efikasitetin e këtyre masave, ndërsa 17% mendojnë se këto masa nuk janë të paanshme dhe efikase. Ata që janë shprehur kështu, duan të thonë se në praktikë ka raste që në marrjen e masave ndëshkimore ka edhe ndikime, ndërhyrje, për t'i bërë më të lehta ato. Kështu, masat ndëshkuese nuk kanë efikasitet dhe nuk arrijnë qëllimin që kanë. Duke zbatuar një politikë ndëshkimore të butë në rastet e korrupsionit, edhe gjykatat në Kosovë nuk përcjellin mesazhe pozitive, qoftë të karakterit ndëshkimor për ata që gjenden fajtorë për vepra penale të korrupsionit, qoftë të karakterit parandalues për personat që mund të jenë në të ardhmen subjekt i veprave penale të korrupsionit.

Pra, mund të thuhet se, megjithëse Kosova ka një infrastrukturë ligjore të mirë për zhvillimin e procedurës penale dhe politika penale me standarde të larta, në praktikë ka probleme në zbatimin korrekt të tyre. Edhe përgjigjet e dhëna për pyetjen e 4-t kërkimore flasin për masa ndëshkimore joefektive, se në politikën ndëshkimore që ndiqet në praktikë nga gjykatat e niveleve të ndryshme ka mangësi dhe jo efikasitet, si në vetë dënimin e fajtorëve, ashtu edhe në parandalimin e veprave të tilla penale.

Me këtë përfundim vërtetohet plotësisht ***nënhipoteza 1*** se politika penale për veprat penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës në fushën e korrupsionit

zyrtar nuk është efektive. Kjo ndikon negativisht dhe nuk e ndihmon luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Shumë i rëndësishëm për vërtetimin e Hipotezës kryesore ishte edhe testimi i ***Nënhipotezës 2: Legjislacioni i Kosovës kundër korrupsionit, i harmonizuar me legjislacionin ndërkombëtar, ndikon në parandalimin dhe luftimin me sukses të dukurisë së korrupsionit dhe të veprave penale në radhët e Policisë së Kosovës.***

Nga studimi doli se legjislacioni i Kosovës kundër korrupsionit është i harmonizuar mirë me standardet ndërkombëtare, është i mbështetur në konventat dhe në dokumente të tjera të organizatave ndërkombëtare, që rregullojnë luftën kundër korrupsionit, në tërësi, dhe atij policor, në veçanti.

Më qartë e shohim këtë, edhe në përgjigjet e dhëna për pyetjet kërkimore, 5 dhe 6, që lidhen me fushën e legjislacionit.

Pyetja e 5-të kërkonte: *A është i plotë legjislacioni i Kosovës për korrupsionin dhe në përputhje me aktet dhe standardet ndërkombëtare?*

Për këtë mund të thuhet se menjëherë pas krijimit të shtetit të pavarur të Kosovës u bë një punë e mirë për hartimin e legjislacionit dhe të strukturave të ndryshme të zbatimit të ligjit. E gjithë kjo punë u krye nga specialistët tanë, me ndihmën e ekspertëve të huaj. Në këtë process u siguruan përkrahja dhe bashkëpunimi i Këshillit të Europës, Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), Misionit të Sundimit të Ligjit të Bashkimit European në Kosovë (EULEX) dhe i Zyrës së Bashkimit European në Kosovë.

Bazë për hartimin dhe përmirësimin e legjislacionit të Kosovës kundër korrupsionit janë një sërë konventash ndërkombëtare, si: *Konventa e OKB-së Kundër Korrupsionit*, e cila mbulon një gamë shumë të gjerë çështjesh, përfshirë parandalimin e korrupsionit, penalizimin e tij, bashkëpunimin ndërkombëtar, konfiskimin e aseteve të

rigjeneruara nga korrupsioni etj; *Konventa Civile për Korrupsionin*, që obligon shtetet të parashikojnë në ligjet e tyre mundësi që të mbrojnë të drejtat dhe interesat e personave që dëmtohen nga veprimet korruptive, përfshirë edhe mundësinë për t'i kompensuar për dëmin; *Konventa Penale për Korrupsionin*, e miratuar nga Këshilli i Europës, që përkufizon si vepra penale një sërë formash të korrupsionit, si korrupsionin aktiv dhe pasiv të zyrtarëve publikë, të zyrtarëve ndërkombëtarë, të gjyqtarëve të gjykatave shtetërore e ndërkombëtare, ushtrimin e ndikimit, si edhe korrupsionin aktiv dhe pasiv në sektorin privat; *Konventa e OECD-së Kundër Korrupsionit*, e cila ka rekomandime për vendet anëtare të kësaj organizate që të ndërmarrin masa për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit të zyrtarëve të lartë publikë në transaksionet ndërkombëtare afariste.

Duke përmbushur standardet e parapara në këto konventa ndërkombëtare, krahas KPK dhe KPPK, në Kosovë aplikohen edhe këto ligje për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit:

Ligji për *Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë*, sipas të cilit, deklarimi i pasurisë është obligim i të gjithë zyrtarëve publikë që nga momenti kur ata marrin detyrën publike.

Ligji për *Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë*, i cili obligon të gjitha institucionet publike të garantojnë sigurinë fizike dhe sigurinë e informacioneve të klasifikuara, në pajtim me standardet dhe procedurat e përcaktuara. Edhe ky ligj është në pajtim me kërkesat dhe standardet e përcaktuara nga Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe me rregulloret për sigurinë të Bashkimit Europian (neni 19). Neni 50 i ligjit parashikon sanksionet penale për zyrtarët që nuk i trajtojnë sipas

rregullave, në mënyrë konfidenciale dhe nuk i mbrojnë nga keqpërdorimi informacionet e klasifikuara që posedojnë dhe i përdorin gjatë detyrës.

Ligji për *Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik*, i cili detyron çdo zyrtar të lartë, që gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik të evitojë çdo shkak dhe prirje për lindjen e një konflikti ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të tij.

Ligji për *Mbrojtjen e informatorëve* është nxjerrë në frymën e Konventës së OKB-së Kundër Korrupsionit dhe të Konventës Penale Kundër Korrupsionit, miratuar nga Këshilli i Europës. Në to përcaktohet që secili shtet palë shqyrton përfshirjen në sistemin e tij ligjor të masave të përshtatshme për të garantuar mbrojtjen kundër çdo trajtimi të pajustificuar për çdo person që raporton në mirëbesim dhe për shkaqe të arsyeshme në organet kompetente çdo fakt lidhur me veprat penale që parashikohen në këtë Konventë.

Megjithatë, duhet thënë se nga një shikim i kujdesshëm i këtij ligji, të miratuar në Kosovë, konstatohet se ai është në përputhje me standardet ndërkombëtare vetëm nga forma, kurse në përmbajtje, mendojmë se nuk përputhet si duhet.

Në funksion të luftës kundër korrupsionit është dhe miratimi i ligjit *kundër diskriminimit* të personit. Ky ligj është në përputhje me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Dispozitat dhe përkufizimet e tij janë shumë të rëndësishme dhe krijojnë obligime për punën e policisë dhe të organeve të tjera.

Edhe ligji për *Agjencinë Kundër Korrupsionit*, është në pajtim me kërkesat e konventave ndërkombëtare. Sipas standardeve të tyre, neni 21 i tij përcakton se “Zyrtarët e Agjencisë gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare gëzojnë pavarësi të plotë dhe nuk mund t’u imponohet asnjë presion nga jashtë për shkak të detyrës së tyre apo kur

ndërmarrin veprime të caktuara konkrete në pajtim me këtë ligj apo me ligjet e tjera në fuqi”.

Që ligjet antikorruption në Kosovë janë sipas ligjeve dhe dokumenteve ndërkombëtare, e ka afirmuar edhe vetë Këshilli i Europës, kur shprehet se: “Legjislacioni i Kosovës në masë të madhe i plotëson kërkesat e standardeve ndërkombëtare në fushën kundër korrupsionit”.

Megjithatë, konstatojmë se në disa ligje kundër korrupsionit, si edhe në disa dispozita të Kodit Penal të Kosovës janë identifikuar mangësi, në raport me Konventën Penale Kundër Korrupsionit dhe mospërputhje me standardet ndërkombëtare.

Konkretisht: neni 428 i KPK nuk përmban dispozitë të veçantë që të sanksionojë marrjen e ryshfetit nga zyrtari i huaj publik apo personi i huaj zyrtar.

Korrupsioni i zyrtarëve publikë kombëtarë, që parashikohet në Konventën Penale, në KPK ndëshkohet me dy dispozita kryesore, nenin 428 (*ryshfet pasiv*) dhe nenin 429 (*ryshfet aktiv*), por, ndryshe nga Konventa, këto nene të KPK nuk shprehen për marrje e dhënie ryshfeti nga *zyrtarë të huaj publikë*; as nuk mbulojnë drejtpërdrejt situatat kur janë të përfshirë përfituesit *palë të treta* – për shembull, kur ryshfeti nuk i jepet vetë personit zyrtar, por gruas së tij ose personit tjetër. Kjo bie në kundërshtim me Konventën, ku thuhet: “për veten e tij/saj apo për këdo tjetër”;

Po ashtu, dispozitat e KPK për veprat e ryshfetit aktiv dhe pasiv në sektorin publik mbulojnë veprimet apo mosveprimet në ushtrimin e funksioneve të zyrtarit në kuadër të fushëveprimit të detyrave, por jo edhe veprimet apo mosveprimet në ushtrimin e funksioneve të tij/saj jashtë fushëveprimit të detyrave.

Ndërkohë që neni 3 i Konventës Penale thekson se lloji i veprimeve të paligjshme që kryhen duhet të jetë “në ushtrim të funksioneve të tij ose të saj zyrtare”, edhe në dispozitat e KPK (nenet 428, 429 dhe 430), lloji i veprimeve që duhet të kryhen

apo të mos kryhen nga ana e zyrtarit publik në kontekstin e veprës penale të rryshfetit, duhet të jenë në “kuadër të detyrës së tij ose të saj zyrtare”, “në pajtim me detyrën e tij ose të saj zyrtare”.

KPK ka mospërputhje me Konventën Penale kundër Korrupsionit edhe lidhur me veprimet që përcaktohen si vepër penale *Korrupsion pasiv në sektorin privat* dhe *Korrupsion aktiv në sektorin privat*. Figura e veprës nga neni 315 i KPK përmban elementet “*kërkimi dhe pranimi*”, por aty mungon elementi “*pranimi i një oferte apo premtimi*”, që parashikohet në Konventën Penale, neni 7, *Korrupsioni aktiv në sektorin privat*. Edhe figura e veprës nga neni 316 i KPK përmban elementet “*dhënia dhe premtimi*”, por mungon elementi “*ofrimi*”, që e parashikon Konventa Penale kundër Korrupsionit, neni 7, *Korrupsioni aktiv në sektorin privat*.

Po ashtu, në nenet 315 dhe 316 të KPK mungon elementi “*për veten e tij/saj apo këdo tjetër*”, i cili paraqitet në paragrafin 2 të nenit 315 KP (“*për vete ose për personin tjetër*”), si dhe mungon edhe shprehja “*drejtpërdrejt apo tërthorazi*”.

Konventa Penale, në nenet 7 dhe 8 të saj, e përcakton se personi që kryen veprën është në çfarëdo cilësie, ndërsa në nenet 315 dhe 316 të KPK, ndonëse përcaktohet se kush e kryen veprën, nuk thuhet saktë nëse personi që kryen veprimtari ekonomike është personi me cilësi të caktuara.

Lidhur me inkriminimin e veprës penale *Zbulimi i fshehtësisë zyrtare*, kemi një mospërputhje midis KPK dhe ligjit përkatës. Sipas KPK-së (neni 433, par.2), për këtë vepër penale parashikohet dënimi maksimal deri në dhjetë (10) vite burgim, ndërsa *Ligji për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë* shohim se parashikon dënim me burg deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

Ndërsa vepra penale e *Përgatitjes së korrupsionit* nuk është e inkriminuar në mënyrë specifike në Kodin Penal të Kosovës. Ndoshta, është gjykuar që kjo vepër

përfshihet në nenin 385, “*Moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale*”, ku thuhet se kushdo që nuk lajmëron përgatitjen për kryerjen e një apo më shumë veprave penale nga Kapitulli XXXIV – *Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare*, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

Mangësi të tilla dhe dallimet e identifikuar në dispozitat penale kundër korrupsionit, diktojnë ndryshime dhe përmirësime të tjera të KPK. Po ashtu, nga hulumtimi del se, përgjithësisht, në fushën e legjislacionit kundërkorrupsion ka nevojë edhe për disa rregullore dhe akte nënligjore të tjera, që ndihmojnë në zbatimin e ligjeve ekzistuese, si dhe për të shndërruar kërkesat ligjore në korniza institucionale.

Si përfundim, duke njohur se legjislacioni i Kosovës kundër korrupsionit është i harmonizuar me legjislacionin dhe konventat ndërkombëtare të kësaj fushe, por edhe që ka mangësi dhe mospërputhje me to, themi se ky fakt ushtron ndikimin e vet në luftën për parandalimin dhe reduktimin e këtij fenomeni në Kosovë. Ky përfundim shkon në të mirë të vërtetimit të **nënhipotezës 2**. Megjithatë, për vërtetimin plotësisht të saj do të ndihmojnë edhe përgjigjet e dhëna për pyetjen e 6 kërkimore: *Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet mes legjislacionit të Kosovës, Sllovenisë, Serbisë dhe Austrisë?*

Meqë në kushtet e globalizmit, shtetet e ndryshme janë të detyruara të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në të gjitha fushat, pra, edhe në luftën kundër korrupsionit, për shkak të ndërlidhjes së korrupsionit me vepra të tjera kriminale që shtrihen edhe jashtë shtetit; të rasteve të konfiskimit të pasurisë së fituar në vende të huaja nga korrupsioni; të veprave korruptive që pengojnë zbulimin e pastrimit të parave etj., në kreun IV kemi bërë krahasimin e legjislacionit të Kosovës me ato të disa vende të përzgjedhura, si Sllovenia, Austria dhe Serbia.

Nga ky vështrim krahasimor kemi konstatuar të përbashkëtat dhe dallimet që ekzistojnë midis tyre.

Një dallim mes Kodit Penal të **Sllovenisë** (KPS) dhe KPK është se ligjvënësi slloven veprat penale, që mund t'i kryejnë kryesisht zyrtarë të agjencive të sigurisë dhe zbatimit të ligjit, si: tortura, shkelja e dinjitetit njerëzor nga keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo të drejtave zyrtare, deklarata nën shtrëngim, i ka përqendruar në një kapitull të vetëm. Ndërsa Kodi Penal i Kosovës këto dispozita i ka të shpërndara në kapituj të ndryshëm të tij.

Ndryshe nga KPK, Kodi Penal i Sllovenisë parashikon edhe veprën penale: *Pranimi i ryshfetit për ndërmjetësim ilegal* (Neni 263). Ndërsa e përbashkët është se edhe në KPK, edhe në KPS, *Korrupsioni në sektorin privat* parashikohet në kapitullin e veprave penale kundër ekonomisë.

Lidhur me dispozitat kundër korrupsionit aktiv dhe pasiv, KPS dallon nga KPK në dënimet që parashikon. KPS përcakton sanksione më të buta, deri në 5 vjet burgim, kurse KPK parashikon deri në 12 dhe 8 vjet burgim. Ndryshim ka midis dy kodeve penale edhe në veprën penale *ushtrimi i ndikimit*. Ndërsa Kodi Penal i Kosovës, dispozitat për këtë vepër penale, edhe për *korruptionin pasiv*, edhe për *korruptionin aktiv*, i ka të integruara në një nen të vetëm, KPS i sanksionon në dy nene të veçanta.

Dallim tjetër është se në legjislacionin slloven, te vepra e *korruptionit privat aktiv* kemi elementet “jep”, “ofron” dhe “premt”, ndërsa në KPK (neni 316) mungon elementi “ofron”.

Për dallim nga legjislacioni i Kosovës, në atë slloven ekziston gjyqtari hetues. Ndërsa në legjislacionin e Kosovës, ndryshe nga Sllovenia, ka një ligj të veçantë për mbrojtjen e informatorëve.

Dallime ka KPK edhe me Kodin Penal të **Austriës** (KPA). Vepra penale e *Përgatitjes së korrupsionit* nuk është e inkriminuar në mënyrë specifike në Kodin Penal

të Kosovës, kurse KPA e ka. Konsideroj se është e nevojshme që KPK të plotësohet me një dispozitë për inkrimimin e përgatitjes së veprave penale kundër korrupsionit.

Ndryshe nga KPA, në dispozitat kundër korrupsionit publik aktiv, inkriminohet edhe ai që ofron, premtan apo jep ndonjë përfitim “personit të tretë”, ndërsa KPK këtë veprim nuk e inkriminon. Mendoj që *premtimi, ofrimi apo dhënia e përfitimit* personit të tretë është e nevojshme të inkriminohet në KPK.

Në KPA, për veprat penale të korrupsionit nga nenet 304 deri 307b, përcaktohet se autori, në rast pendimi, në pajtim me nenin 307c, “nuk do të ndëshkohet”. Ndërsa në Kodin Penal të Kosovës, neni 429.4, përcaktohet se autori i veprës “mund të lirohet nga dënimi”. Nisur nga ky dallim, konsideroj se është e nevojshme që kjo dispozitë e KPK të ndryshohet: shprehja “mund të lirohet nga dënimi” të zëvendësohet me “nuk do të ndëshkohet”, duke specifikuar se në cilat rrethana mund të aplikohet kjo dispozitë.

Ndërsa Kosova vuan nga fragmentimi i mekanizmave kundër korrupsionit, Austria, ka një praktikë më të mirë në këtë aspekt. Ajo ka dy agjenci qendrore të specializuara për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të korrupsionit: Byroja Federale e Anti-Korrupsionit dhe Zyra e Prokurorit Publik për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit.

Zgjedhëm për krahasim edhe legjislacionin e **Serbisë**, meqë, edhe ky, sikurse ai i Sllovenisë dhe i Kosovës, ka qenë pjesë e legjislacionit të ish-Jugosllavisë dhe ngaqë kemi tradita të ngjashme ligjore dhe gjyqësore nga e kaluara.

KPSrb, te grupi i veprave penale që përmbajnë elemente të korrupsionit nuk ka dallime përmbajtësore nga Kodi Penal i Kosovës. Përjashtim paraqet neni 361 i KPSrb, i cili e sheh *shkeljen e detyrës* si vepër më vete. Po ashtu, për veprën penale *dhënie ryshfeti zyrtarit të huaj* KPSrb nuk ka nen të veçantë, por e ka të përfshirë në nenin e një vepre tjetër.

Dallim tjetër është se Kodi Penal i Kosovës nuk ka disa dispozita ku jepen ndëshkime për zyrtarët e huaj për veprat penale *marrje e ryshfetit*, të *ushtrimit të ndikimit*, ndërsa në KPSrb ato janë.

Për sa u përket organeve të ndjekjes, legjislacioni në Serbi është shumë i ngjashëm me atë të Kosovës.

Duke i parë me vëmendje këto dallime ndërmjet legjislacionit të Kosovës dhe atyre të vendeve të tjera, del e nevojshme që nga strukturat ligjvënëse të ndërhyhet në KPK për të bërë plotësimet dhe përmirësimet e domosdoshme.

Nga shqyrtimi me hollësi i përgjigjeve që u dhamë këtyre pyetjeve kërkimore, shohim se ato vërtetojnë dy nënhipotezat e studimit, të cilat, nga ana e tyre, rezultojnë të vlefshme për vërtetimin e hipotezës kryesore të punimit doktoral. Megjithatë, për një gjykim më të plotë dhe përfundimtar rreth kësaj, po analizojmë edhe përgjigjet që jepen për pyetjet kërkimore që lidhen drejtpërdrejt me kërkesat e Hipotezës kryesore:

Megjithë plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, korrupsioni në Policinë e Kosovës po merr formë fenomeni, ngaqë mungojnë masat efikase për parandalimin dhe luftimin e tij, ndaj del domosdoshmëria e forcimit të vazhdueshëm të luftës kundër këtij fenomeni.

Pyetjet kërkimore që lidhen drejtpërdrejt me këtë hipotezë janë:

1. Cilat janë sfidat në hetimin e veprave penale të kryera nga zyrtarët e PK-së?
2. Cilët janë faktorët që ndikojnë në veprat korruptive dhe në kryerjen e veprave penale nga ana e punonjësve të PK-së?
3. A janë efektive masat parandaluese dhe mekanizmat e pavarur institucionalë të mbikëqyrjes dhe kontrollit institucional të PK-së?

Lidhur me pyetjen e parë, *Cilat janë sfidat në hetimin e veprave penale të kryera nga zyrtarët e PK-së*, nga analizimi i rezultateve të hulumtimit, së pari, mund të themi se numri i hetimeve për vepra penale të korrupsionit në PK është shqetësues dhe përbën një sfidë për strukturat drejtuese të policisë. Mbështetur në literaturën e shfrytëzuar, veprat penale të korrupsionit në PK jemi përpjekur t'i analizojmë në aspektin sasior, në aspektin e *intensitetit* dhe prirjes së tyre, por edhe për në aspektin cilësor, pra, për nga *llojet e veprave penale*.

Sipas raporteve të IPK-së rezulton se në periudhën 2010-2015 kanë qenë subjekt i hetimeve penale nga IPK-ja 1379 punonjës të policisë dhe janë evidencuar 1082 çështje penale etj. Kuptohet, jo të gjitha rastet e inicuar përfundojnë me aktakuzë dhe jo të gjitha rastet për të cilat janë ngritur aktakuza përfundojnë me shpallje fajtorë të të akuzuarve dhe me dhënie dënimesh. Por, sidoqoftë, edhe nga shifrat e mësipërme krijohet ideja për përmasat e problemit të shkeljeve penale dhe disiplinore nga punonjësit e policisë.

Gjithashtu, nga IPK-ja të evidencuar në këtë periudhë 6503 ankesa për çështje disiplinore dhe penale. Numri i të hetuarve për shkelje disiplinore në radhët e policisë (33%), pra, një e treta, nuk është i vogël, ndaj nuk ka vend për kënaqësi. Fakti që 20% e të intervistuarve, pra, një e pesta, kanë marrë masa disiplinore tregon se problemi i shkeljeve disiplinore nga punonjësit e policisë të Kosovës është i pranishëm dhe kërkon vëmendjen e strukturave përkatëse. Ndonëse nuk kemi të dhëna se sa herë janë hetuar dhe sa masa disiplinore kanë marrë, gjë që nuk u kërkua në pyetësor, konsiderojmë se këto rezultate kërkojnë një analizë të kujdesshme nga strukturat drejtuese dhe mbikëqyrëse të Policisë së Kosovës, për të nxjerrë konkluzione dhe për të përcaktuar masat dhe aktivitetet për përmirësimin e situatës në këtë drejtim.

Edhe nga rezultatet e hulumtimit në terren konfirmohet se Policia e Kosovës përballlet me raste të shumta të përfshirjes së zyrtarëve të saj në korrupsion dhe në vepra të ndryshme penale. Në fushën e korrupsionit zyrtar për periudhën 2010-2015, janë evidencuar 325 raste penale. Kjo përbën 25% të rasteve nga numri i përgjithshëm i veprave penale të evidencuara ndaj zyrtarëve të PK-së. Nga shikimi i të dhënave të ofruara nga Policia e Kosovës, rezulton se trendi i veprave penale të korrupsionit zyrtar në radhët e punonjësve të Policisë, në vitet 2010-2015, ka ardhur në rritje. Numri më i madh, 83 vepra penale, është shënuar në vitin 2014, kur ai gati është trefishuar, në krahasim me vitin 2010. Në vitin 2015, shënohet rënie, por përsëri, numri i veprave penale shkon në 62, që është dy herë më shumë se në vitin 2010.

Llojet më të shpeshta të veprave penale në fushën e korrupsionit zyrtar të evidencuara ndaj zyrtarëve të PK-së janë: Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit (207 raste), Marrje e ryshfetit (66 raste), Falsifikim i dokumentit (26 raste), Zbulim i fshehtësisë zyrtare (9 raste), Mashtrimi në detyrë (6 raste), Ushtrimi i ndikimit (6 raste) etj. Siç shihet, lloji që ka numrin më të madh është *Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit*, me 63.6%, dhe *Marrja e ryshfetit*, me 23%. Këto të dhëna flasin se në radhët e policisë ka shumë veprime arbitrare gjatë kryerjes së detyrës, që vijnë, ose nga mosnjohja e kompetencave, ose kryhen në mënyrë të vetëdijshme për afera korruptive, me qëllim përfitimi. Këtë e tregon edhe numri i rasteve të marrjes së ryshfetit nga zyrtarët e policisë, shifra e të cilave duhet të merret në konsideratë, për të rritur mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi personelin. Por edhe veprat e tjera nga fusha e korrupsionit zyrtar, megjithëse më të pakta në numër, nuk duhen injoruar.

Duhet thënë se sfida nuk përbën vetëm ana sasiore e hetimeve të veprave të korrupsionit, por edhe zbulimi dhe parandalimi i tyre. Për këto hasen shumë vështirësi dhe pengesa. Një vështirësi, p.sh., paraqet fakti që, edhe pse procedurat e brendshme të

procedimit dhe të administrimit të rasteve penale janë të harmonizuara me ligjet në fuqi, hetimet penale në Polici, janë problematike, pasi këtu autorë janë zyrtarë policorë, të cilët, në fakt, janë të punësuar pikërisht për ta luftuar dhe parandaluar kriminalitetin. Për këtë gjë ata janë përgatitur dhe trajnuar, ndaj dhe zotërojnë njohuri të shumta, si për provat, për teknikën kriminalistike, për hetimin e vendit të ngjarjes, për metodat hetimore etj. Kështu që, kur ndodh që bëhen subjekt veprash penale, ata mund t'i përdorin këto njohuri për manipulim dhe fshehje të krimit. Kjo e vështirëson dhe e ndërlikon shumë procesin e zbulimit dhe të hetimit të zyrtarëve policorë.

Sfidë tjetër është dhe predispozicioni i zyrtarëve policorë për të denoncuar një koleg të tyre. Në rezultatet e anketimit, del se 59% e të intervistuarve *nuk ndihen keq* nëse e raportojnë kolegun e përfshirë në vepër penale, pra, janë të predispozuar ta bëjnë denoncimin. Por fakti që 20 % u përgjigjën se *ndihen keq*, po ta raportojnë kolegun, do të thotë se ka shumë nga ata që ngurrojnë, madje, në raste të caktuara, edhe mund të mos e njoftojnë krimin.

Nga hulumtimi në terren, u konstatua se ngurrimi i zyrtarëve policorë për të raportuar kolegët vjen edhe sepse, siç deklarojnë 57% e të anketuarve, hasin në vështirësi për shkak të procedurave të denoncimit, të cilat, sipas tyre, nuk janë të thjeshta dhe të përshtatshme.

Këtu evidencuam edhe një problem tjetër: 51% e të intervistuarve pohuan se e kanë më të lehtë të raportojnë për veprat penale që kryejnë qytetarët, sesa për veprat penale të kryera nga zyrtarët policorë. Kjo është një sjellje që duhet parë me vëmendje, pasi ka të bëjë me qëndrimin e zyrtarëve policorë ndaj ligjit, me formimin, me botëkuptimin dhe me edukimin juridik të tyre, me njohjen që ata kanë për legjislacionin në fuqi, si dhe me predispozicionin e tyre për të zbatuar ligjin.

Nga përgjigjet lidhur me këtë problem, shohim se shumica dërrmuese (61%) e punonjësve policorë të intervistuar *kanë besim* tek eprorët e tyre që të raportojnë keqpërdorimet e detyrës zyrtare nga ndonjë koleg, ndërsa 12% e të intervistuarve kanë deklaruar se *nuk kanë besim* te drejtuesit. Ballafaqimi, analiza dhe shqyrtimi i këtyre shifrave do të ndihmonte strukturat drejtuese të policisë të nxjerrin problematikat përkatëse dhe të planifikojnë masat për përmirësimin e gjendjes.

Me rëndësi për vërtetimin e hipotezës kryesore kanë rëndësi edhe përgjigjet e dhëna për pyetja e dytë kërkimore: *Cilët janë faktorët që ndikojnë në veprat korruptive dhe në kryerjen e veprave penale nga ana e punonjësve të PK-së?*

Nga hulumtimi teorik dhe në terren del se për kryerjen e veprave korruptive dhe të veprave penale nga punonjësit e PK-së ndikojnë disa faktorë, njohja dhe zbulimi i të cilave është një domosdoshmëri për parandalimin dhe zbulimin me sukses të veprave të korrupsionit në PK.

Një ndër faktorët e përgjithshëm ka qenë tranzicioni nga regjimi komunist në ekonomi të tregut, i cili krijon mundësi të shumta për përfitime ilegale dhe për lulëzimin e korrupsionit, sepse, zakonisht, shoqërohet nga një grumbullim të dyshimtë pasurie në disa duar dhe, sidomos, nga një pabarazi ekonomike në rritje. Këtu përfshihen edhe faktorë të jashtëm politikë, që mund të përcaktojnë nivelin e përhapjes së korrupsionit në sektorin publik. I theksojmë këto, pasi shkalla e korrupsionit, e shpërdorimeve dhe e sjelljeve devijante të zyrtarëve të policisë varet dhe ndikohet nga niveli i korrupsionit dhe krimit në nivel të përgjithshëm në vend, i cili është, gjithashtu, një faktor për praninë e korrupsionit në PK.

Një faktor vendimtar janë edhe mangësitë dhe boshllëqet në vlerat etike dhe në integritetin e zyrtarëve policorë. Hulumtimi tregoi se në PK mungojnë trajnimet e punonjësve për çështje të etikës dhe të integritetit. 60 % e të anketuarve deklaruan se

kanë nevojë për trajnime nga fusha e integritetit policor, ndërsa 64 % prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë ndjekur ndonjë trajnim specifik për integritetin policor. Ky fakt është tepër shqetësues dhe kërkon të ndiqet me përparësi nga strukturat drejtuese.

Pa dyshim që në shfaqjen e korrupsionit në polici ndikojnë edhe shumë faktorë të tjerë, të natyrës institucionale. Si faktorë primarë janë ata që burojnë nga mangësitë në rekrutimin, trajnimin dhe promovimin e personelit; nga sistemet e llogaridhënies brenda departamenteve të PK, në gjykata; nga legjislacioni; nga traditat kulturore, që pengojnë zhvillimin profesional të standardeve të policisë, si dhe nga defektet në kontrollin dhe mbikëqyrjen sistematike të personelit. Nga intervista na del se lidhur me qëndrimin e drejtuesve të policisë ndaj sjelljeve etike dhe integritetit të vartësve të tyre ka mendime të ndryshme. Gjysma e tyre shprehen se drejtuesit i vlerësojnë këto sjellje, ndërsa 11% shprehen në mënyrë të prerë se drejtuesit nuk i vlerësojnë dhe 39% pajtohen *pjesërisht* me mendimin se këto veti të punonjësve vlerësohen. Këto qëndrime mosvlerësuese të eprorëve ndaj vartësve, ndikojnë negativisht dhe cenojnë besimin e punonjësve te drejtuesit e tyre. Këta duhet të kenë të qartë se te korrupsioni kanë ndikim edhe mjaft faktorë të natyrës individuale dhe kulturore, ndaj dhe duhet të njohin nga afër dhe më mire punonjësit, psikologjinë dhe sjelljet e tyre, nivelin arsimor dhe kulturor e me radhë.

Por një rol të rëndësishëm lidhur me gjendjen e korrupsionit në polici luajnë organizmat dhe strukturat e ngritura për kontrollin dhe mbikëqyrjen e PK. Për këtë arsye, gjatë hulumtimit u kërkua se sa efektive janë këto struktura dhe masat që marrin ato për parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit policor. Kjo lidhet me përgjigjet e dhëna pyetjes së 3-të kërkimore, *A janë efektive masat parandaluese dhe mekanizmat e pavarur institucionalë të mbikëqyrjes dhe kontrollit institucional të PK-së.*

Siç është vënë në dukje, Policia e Kosovës ka ndërtuar një sistem të kompletuar të kontrollit të brendshëm të inspektimit, auditimit, disiplinës, për të drejtat e personelit, për shqyrtimin e përdorimit të forcës dhe administrimin e ankesave. Qëllimi i këtij kontrolli është jo vetëm ndjekja e kryerjes së detyrave dhe përmbushjes së misionit të policisë sipas standardeve më të larta të policimit demokratik, por edhe ndërmarrja e hapave për hetimin dhe sanksionimin e çdo shkeljeje nga ana e të punonjësve policorë e, njëkohësisht, sigurimi i hetimeve të paanshme të zyrtarëve policorë të dyshuar. Për të realizuar këtë detyrim ligjor, Policia ka disa mekanizma të kontrollit të brendshëm, si Drejtoria e Standardeve Profesionale, Komisioni Disiplinor, Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime, Komisioni për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës, Drejtoria e Personelit, Njësia e Inspektimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm, Drejtorinë Kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit etj.

Nga hulumtimi i kryer rezulton se mbetet problem që këto hallka të ushtrojnë një kontroll me përkushtim dhe me vizion, që kontrolli të jetë sa më efikas dhe rezultativ, pasi disa prej strukturave nuk e kanë përvojën e duhur, sidomos në menaxhimin e disiplinës në nivelin lokal, pra, te mbikëqyrësit e vijës së parë dhe të dytë të strukturës policore. Ky proces kontrolli kërkon kapacitete profesionale dhe sidomos paanësi. Sfidë përbën këtu problemi se sa efikas dhe i paanshëm është ky proces kur zyrtari policor mbikëqyr dhe heton një koleg të tij. Ky fakt e bën hetimin vërtet një detyrë të vështirë për zyrtarët e ngarkuar me të. Por këta duhet ta kapërcejnë këtë moment dhe t'i kushtohen zbatimit me korrektësi të ligjit. Gjithashtu, që kontrolli dhe mbikëqyrja e punonjësve të jenë të suksesshme, kërkohet që bashkëpunimi midis këtyre organizmave e sidomos mes policisë dhe prokurorisë publike, të vihet në baza më të shëndosha dhe të mos cenohet për shkak të kompetencave që ka secili.

Që në Policinë e Kosovës të zhvillohen kontrole dhe mbikëqyrje profesionale dhe të paanshme, janë themeluar disa institucione për mbikëqyrjen dhe kontrollit të jashtëm të PK. Inspektorati Policor i Kosovës, është një agjenci e pavarur nga PK-ja, me kompetenca për hetimin penal të zyrtarëve policorë dhe marrjen e masave ndëshkimore ndaj atyre që deklarohen fajtorë. Për kontroll dhe mbikëqyrje të PK shërbejnë edhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit, Agjencia Kundër Korrupsionit, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Avokati i Popullit, Auditori i Përgjithshëm dhe EULEX-i. Mandati dhe funksionimi i këtyre organizmave është rregulluar me ligj dhe në pajtim me kushtetutën e vendit.

Por çështja shtrohet sa efektive janë ato, ç'rezultate japin në praktikë, sa efekt japin masat që ato marrin. Nga hulumtimi rreth efikasitetit të masave të ndërmarra ndaj zyrtarëve të PK-së të përfshirë në vepra penale, rezulton: 31% e zyrtarëve policorë të anketuar deklarojnë se masat e ndërmarra ndaj atyre që shkelin ligjet në polici janë të shpejta, të paanshme dhe efikase. Por pjesa më e madhe e të pyeturve (52%) shprehen të lëkundur dhe 17% e tyre shprehen qartë se masat e ndërmarra nuk janë të shpejta, nuk janë të paanshme dhe efikase.

Përgjithësisht, konstatohet se nuk janë arritur rezultatet që priteshin dhe se nuk është krijuar një praktikë e mirëfilltë e bashkëpunimit institucional midis këtyre strukturave. Kjo, për shkak të mungesës së një sistemi, i cili do të siguronte koordinim domethënës të agjencive, shkëmbim informacioni, si dhe adresim të duhur të përgjegjësi. Shumë vërejtje bëhen në këtë drejtim edhe nga një Progresraport i Komisionit European për Kosovën, ku nënvizohet se tërë këto institucione krijojnë një sistem të fragmentuar, me role dhe përgjegjësi të paqarta. Kjo ngre shqetësime lidhur me

efektivitetin dhe autoritetin e tyre. Gjithashtu, ka pasur edhe ndonjë prej tyre, si Drejtoria e Standardeve Profesionale, që, për shkaqe objektive, në fillim nuk ka pasur strukturë të qëndrueshme dhe as të aprovuar, si dhe i kanë munguar procedurat e standardet e funksionimit. Po ashtu, kemi hasur në konstatimin se ka probleme edhe në ndarjen më të qartë të kompetencave. Për shembull, ka mendime se do të ishte mirë që IPK-ja të merret me hetime për veprat penale të rënda dhe shumë serioze dhe jo me shkeljet disiplinore dhe veprat e lehta penale, të cilat mund t'i kalojnë DSP-së.

Në mbyllje të këtij shqyrtimi, mund të themi se përgjigjet për të trija pyetjet e mësipërme na çojnë në vërtetimin plotësisht të Hipotezës kryesore se korrupsioni në PK nuk është një shfaqje e izoluar, por ai është rritur, si nga ana sasiore, ashtu edhe për nga lloji dhe format e tij. Prandaj konkludojmë se në PK korrupsioni tashmë është një fenomen, që kërkon një angazhim të të gjitha strukturave për ta parandaluar dhe luftuar në shkallën e duhur me veprime më efikase. Bazuar edhe në vërtetimin e dy nënhipotezave, na rezulton se qëllimi i punimit doktoral për vërtetimin e Hipotezës kryesore është arritur. Përfundimet e studimit shoqërohen edhe me rekomandimet përkatëse.

8.3 Rekomandime

Bazuar në literaturën dhe hulumtimet e kryera në fushën korrupsionit dhe të shkeljeve penale nga zyrtarët policorë, në analizën e legjislacionit vendor dhe të huaj, në konventat ndërkombëtare dhe në dokumente strategjike të Kosovës, në interpretimin e të dhënave empirike dhe të disa vendimeve gjyqësore ndaj zyrtarëve të PK-së, si dhe në vrojtime personale, japim këto rekomandime:

- Në dispozitat e KPK, neni 428, të shtohet një dispozitë e veçantë për marrjen e ryshfetit nga zyrtari i huaj publik apo personi i huaj zyrtar.

- Të ndërmerren masa juridike për t'i mbuluar drejtpërdrejt përfituesit e tretë në lidhje me ryshfetin aktiv nenet 429 dhe 430 të KPK.
- Të ndërmerren masa legislative që veprat e ryshfetit aktiv dhe pasiv në sektorin publik t'i mbulojnë të gjitha veprimet/mosveprimet në ushtrimin e funksioneve të zyrtarit publik, qofshin apo jo në kuadër të fushëveprimit të detyrave të zyrtarit.
- Të riformulohet nenit 316 i KPK - *Dhënia e paarsyeshme e dhuratave* dhe neni 315- *Pranimi i paarsyeshëm i dhuratave*, të përshtaten me formulimin e dhënë në Konventën Penale, duke u bërë: Neni 316 - *Korrupsioni aktiv në sektorin privat* dhe neni 315 - *Korrupsioni pasiv në sektorin privat*.
- Në dispozitat e nenit 315 dhe 316 të KPK, në pajtim me neni 7 dhe neni 8 të Konventës Penale Kundër Korrupsionit, të përcaktohet saktë se personi që kryen veprën është person që kryen veprimtari ekonomike në çfarëdo cilësie.
- Në nenin 315 të KPK, figurës së veprës t'i shtohet edhe elementi “pranimi i një oferte apo premtimi”, ashtu siç parashikohet në nenin 8, *Korrupsioni pasiv në sektorin privat*, të Konventës Penale Kundër Korrupsionit.
- Në nenin 316 të KPK, figurës së veprës penale t'i shtohet edhe elementi “ofrimi”, ashtu siç parashikon neni 7, *Korrupsioni aktiv në sektorin privat* i Konventës Penale Kundër Korrupsionit.
- Të harmonizohen sanksionet e parashikuara me Ligjin për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë dhe me Kodin Penal të Kosovës, ku për të njëjtën vepër penale, *Zbulimi i fshehtësisë zyrtare*, jepen masa të ndryshme dënimi.
- Të rivlerësohet dhe të ndryshohet *Ligji për mbrojtjen e informatorëve*, në atë mënyrë që të mundësojë ruajtjen e anonimitetit të personave që lajmërojnë

veprën penale. Termi “informatore” të zëvendësohet me një term tjetër më të përafërt me termin “whistleblower”.

- Të inkriminohet në KPK vepra penale *Përgatitje e korrupsionit* me një dispozitë të posaçme.
- Të ndryshohet dispozita e nenit 429.4 e KPK. Në vend të, kryesi i veprës “mund të lirohet nga dënimi”, të vihet: kryesi i veprës “nuk do të ndëshkohet”, duke përcaktuar saktë se në cilat rrethana mund të aplikohet kjo dispozitë.
- Të themelohet një Gjykatë e veçantë në nivel vendi për gjykimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, të cilat hetohen nga PSRK-ja.
- Të fuqizohen kapacitetet e Departamentit Special Kundër Korrupsionit në kuadër të PSRK-së. Prokurorët të profilizohen dhe specializohen për hetimin e korrupsionit.
- PK-ja, krahas dokumenteve të tjera strategjike, të hartojë edhe një plan strategjik për ruajtjen dhe forcimin e integritetit policor, që të evitojë fragmentarizimin që ekziston në veprimet e deritanishme në çështjet etike dhe të integritetit të policies.
- Të hartohet një plan konkret për organizimin në vazhdimësi të trajnimeve të zyrtarëve të PK-së për çështjet etike dhe të integritetit policor.
- Të krijohet në PK një sistem i brendshëm paralajmërimi dhe raportimi nga vetë zyrtarët policorë të shkeljeve administrative dhe ligjore nga kolegët, për identifikimin e shkaqeve të kryerjes së veprave penale dhe korrupsionit në PK dhe për luftimin e tyre. për konflikt interesi, korrupsion apo vepra penale. Gjithashtu, të ndërtohen procedura që mbrojnë ata që raportojnë korrupsionin në PK.

- Në punën e drejtuesve të programohen veprime afirmative për respektimin e vlerave dhe parimeve të Kodit të Etikës, për njohjen dhe vlerësimin e zyrtarëve policore që janë shembull në punë dhe me integritet në kryerjen e detyrave.
- Të praktikohet në procesin e rekrutimit, gjatë kontrollimeve mjekësore, edhe ekzaminimi i kandidatëve për përdorim të substancave narkotike.
- IPK-ja të forcojë më tej kapaciteteve vepruese njerëzore, në pajisje dhe teknologji, në hetimet e krimit të korrupsionit në polici.
- Nga IPK të aplikohen metodat proaktive në hetimin e veprave penale të kryera nga zyrtarët policorë.
- Të planifikohet organizimi i hetimeve të përbashkëta të IPK-së dhe PK-së, sidomos për rastet kur zyrtarët policorë të përfshirë në krim bashkëveprojnë me individë që nuk janë pjesë e PK-së.
- Të bëhen analiza dhe rishikime të hetimeve penale të parashkuara, të hetimeve penale të mbyllura dhe të hetimeve të dërguara në prokurori me raport të veçantë, ku janë të akuzuar zyrtarët e PK-së, me qëllim që të shihet efikasitetit i hetimeve.
- Të rishikohet ndarja e kompetencave ligjore ndërmjet IPK dhe DSP. Kundërvajtjet dhe veprat penale të trafikut mund të hetohen nga vetë zyrtarët e PK-së, respektivisht, nga DSP-së, kurse IPK të fokusohet në rastet më të ndjeshme të shkeljeve disiplinore të profilit të lartë dhe në veprat penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit.
- Kuvendi i Kosovës të themelojë Komisionin e Pavarur Mbikëqyrës, i cili do të mbikëqyrë hetimin e shkeljeve disiplinore serioze dhe hetimet penale, do të ndikonte pozitivisht në cilësinë e administrimit të çështjeve dhe do të

parandalonte ndikimet e jashtme të mundshme në proceset hetimore. Komisioni të jetë i përhershëm, i paanshëm dhe apolitik.

- Strukturat drejtuese të rishikojnë kushtet e punës, të zyrtarëve të PK-së, sidomos sigurimin shëndetësor, sigurimin i jetës, pagesa për ushqimin ditor të punonjësve policorë (shujta) etj. dhe përmirësime të tjera qërrisin motivimin në punë, avancimin në karrierë të punonjësve etj.
- Të organizohen herë pas here hulumtime në fushën e sjelljes organizative të personelit të PK-së. Motivimi i punonjësve, lojaliteti, kënaqësia me vendin e punës, perceptimi për barazi etj., duhet të jenë temë e këtyre hulumtimeve.
- Të organizohen hulumtime rreth perceptimit të opinionit të publikut për punën e policisë, për të marrë informacione të dobishme për PK dhe për të zbuluar pakënaqësitë ndaj saj, sidomos në çështjet e integritetit dhe korrupsionit policor.
- Të bëhet një studim mbi ndikimin e ambientit të jashtëm në nivelin e korrupsionit policor, në aspektin krahasimor me shtete me demokraci të zhvilluar dhe me nivel të ulët të korrupsionit dhe me vende me nivel lartë të korrupsionit.
- Të rishikohet struktura e organizimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku janë përqendruar nën autoritetin e ministrit tri agjenci: Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës dhe Agjencia për Forenzikë. Ky rishikim të synojë për të bërë ndonjë përmirësim organizativ që të sigurojë një sistem më efikas të kontrollit dhe të mbikëqyrjes së PK-së dhe të rrisë llogaridhënien dhe transparencën e këtyre tri agjencive.
- Të krijohet një Komision i veçantë Parlamentar për Mbikëqyrje të Organeve të Punëve të Brendshme, për një mbikëqyrje dhe kontroll më intensiv.

- Të krijohet një sistem i integruar për regjistrimin dhe menaxhimin e çështjeve të hetimeve penale dhe korrupsionit, si dhe një bazë e integruar e të dhënave për inicimin e hetimeve, përmes aplikimit të teknologjisë informative.

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

BURIMET PARËSORE

Legjislacioni kombëtar

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
2. Kodi Penal i Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082 (2013), Prishtinë.
3. Kodi Penal i Përkohshëm i Kosovës (2004), Prishtinë
4. Kodi Procedurës Penale i Kosovës, (2013), Prishtinë.
5. Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, (2003), Prishtinë
6. Ligji Nr.2004/3 Kundër Diskriminimit, (2004), Prishtinë.
7. Ligji nr. 03/L-035 për Policinë, (2008), Prishtinë.
8. Ligji për gjykatat (Nr. 03/L-199, 2010), Prishtinë
9. Ligji për prokurorinë e shtetit (Nr. 03/L-225, 2010), Prishtinë
10. Ligji Nr. 03/L-052 Për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës,(2008), Prishtinë.
11. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë, (2012), Prishtinë.
12. Ligji nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, (2011), Prishtinë.
13. Ligji nr.03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, (2009), Prishtinë.
14. Ligji nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, (2010), Prishtinë.
15. Ligji nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë, (2010), Prishtinë.
16. Ligji Nr. 03/L-063 Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.
17. Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit
18. Ligji Nr. 03/L-075 për themelimin e zyrës së auditorit të përgjithshëm dhe zyrës së auditimit të Kosovës
19. Ligji Nr. 04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve (2011), Prishtinë.
20. Ligji nr. 04/L-31, (2011) për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, Prishtinë.
21. Ligji Nr. 05/L-102 për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit European mbi Misionin e Bashkimit European për sundim të ligjit në Kosovë.

22. Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë (2013), Agjencia për Barazi Gjinore, Qeveria e Kosovës, Prishtinë.
23. Rregullore (2015), Rregullore nr. 03/2015 për Betimin Zyrtar, Policia e Kosovës Prishtinë.
24. Udhëzim Administrativ (2013), Udhëzimi Administrativ nr. 06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedura Disiplinore në Policinë e Kosovës, Prishtinë.
25. Udhëzimit Administrativ nr. 02/2012 Komisioni për Shqyrtim të Përdorimit të Forcës.
26. Udhëzimit Administrativ nr. 07/2012 Mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.
27. UNMIK, (2001), Rregullore 2001/7 Mbi Autorizimi për Posedim të Armëve në Kosovë, Prishtinë.
28. UNMIK, (2005), Rregullore nr. 2005/54 Mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës, Prishtinë.
29. Urdhëresë Administrative/UNMIK-ut nr .2008/3, Akademia për Siguri Publike.

Konventat ndërkombëtare

30. Council of Europe,(1999), Criminal Law Convention on Corruption, Strasbourg.
31. Council of Europe (2001),THE EUROPEAN CODE OF POLICE ETHICS, Recommendation Rec(2001)10 adopted by the Committee of Ministers of the Council of Europe on 19 September 2001 and explanatory memorandum, Council of Europe, Communication and Research Directorate, Strasbourg.
32. Council of Europe,(1999), Civil Law Convention on Corruption, Strasbourg.
33. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
34. Konventa e OECD-së kundër Korrupsionit
35. Konventa ndër-amerikane kundër korrupsionit (1996)
36. Resolution AG-2002-RES-01, 2002, Adopting the global standards to combat corruption in police forces/services, INTERPOL.
37. United Nations (1979), Code of Conduct for the Law Enforcement officials.
38. United Nations Convention Against Corruption

Legjislacioni i huaj

39. Bundesgesetz über die Einrichtung und Organisation des Bundesamts zur Korruptionsprävention und Korruptionsbekämpfung –BAK, Wien
40. Kodi Penal i Sllovenisë, (2008) Lublanë.
41. Kodi Procedurës Penale i Sllovenisë (2007) Lublanë
42. Kodi Penal i Serbisë, Beograd
43. Kodi i Procedurës Penale i Srbisë, Beograd
44. Kodi Penal i Austrisë (Strafgesetzbuch, StGB), Vjenë
45. Kodi i Procedurës Penale i Austrisë (Strafprozessordnung, StPO), Vjenë.
46. National Anti-Corruption Strategy in the Republic of Serbia for the period 2013-2018, (2013), "Official Gazette of RS" No. 57/13.
47. Police Act of the Republic of Slovenia (2007)
48. Zakon o integriteti in preprečevanju korupcije (Uradni list RS, št. 45/10, 26/11 in 43/11) (ZIntPK), Slovenija.
49. Zakon o Agenciji za borbu protiv Korupcije, ("Sl. glasnik RS", br. 97/2008 i 53/2010), Beograd.
50. Zakon o Javnom Tuzilaštvu ("Sl. glasnik RS", br. 116/2008 i 104/2009), Beograd

BURIMET DYTËSORE

1. Bach, Stephen. Sisson, Keith. (2000). Personel Management: A Comprehensive Guide to Theory adn Practice, 3rded . Blackwell Publishers, Oxford, UK.
2. Begeja, S.(2004), Kriminalistika. SHBLU, Tiranë.
3. Berisha, V. (17 korrik 2014). Kur mbrojtësit e ligjit e thyejnë ligjin: Hetohen 51 zyrtarë policorë për vepra penale. Gazeta Kosova Sot, fq.11
4. Born, Hans. & Leigh, Ian. (2005), Standardet ligjore dhe praktika më e mirë për mbikëqyrjen e agjencive të fshehta të informacionit, TOENA, Tiranë.
5. Curtis, Clarke. Ed (2011) INTERNATIONAL POLICE TRAINING JOURNAL, Issue 2. Police Training and Development Directorate, INTERPOL, Lyon, France.
6. DCAF, (2012), Pakoja e instrumenteve mbi integritetin e policisë, Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura, Geneva.
7. Fitch, D.B., (2011), Understanding the Psychology of Police Misconduct, The Police Chief International Association of Chiefs of Police, Washington
8. Halili, Ragip.(2002) Kriminologjia, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.

9. Hays, W. S., Kearney, C.R. editors, (2003), Public Personnel Administration, Problems and Prospects, fourth ed., Prentice Hall, New Jersey.
10. Herring, J. (2013), E drejta penale: teori, kazuse dhe materiale, UET Press, Tiranë
11. Hetzer, W. (2008), Review IACSS 2008, Federal Ministry of the Interior, Austria
12. Iannone, F. N., Iannone, D.M, (2001), Supervision of Police Personnel, 6thed, Prentice Hall, New Jersey.
13. Kenney J. D., McNamara, P.R. Editors (1999). Police and Policing; Contemporary Issues, 2nd ed, Praeger, Westport, USA.
14. Kolenc, Tadeja.(2003), The Slovene Police, Ministry of the Interior of the Republic Slovenia, Police, General Police Directorate, Ljubljana.
15. Korajlic, N. (2002). Istrazivanje krivicnih djela, Jordan studio, Sarajevo
16. Latifi, Vesel,(2006). Kriminalistika, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
17. Mathis, L.R., John H. Jackson, H.J., (2006), Human Resource Management, eleventh edition, Thomson South –Western, Mason, Ohio.
18. More,W.M.,Wegener, W.R.,(1992), Behavioral Police Management, Macmillan Publishing Company, New York
19. Punch, Maurice.(2009). Police Corruption: Deviance, accountability and reform in Policing, Willian Publishing, Devon, UK.
20. Peak, J.K., Gaines, K.L., Glensor, W.R., (2004). Police Supervision and Management; In an Era of Community Policing, 2nd ed. Pearson Prentice Hall, New Jersey.
21. Peak, Kenneth J. (2004), Justice Administration : Police, Courts and Corrections Management 4thed, Pearson Prentice Hall , New Jersey, 2004.
22. Petrovic, B. (2006), E drejta penale, Universiteti AAB, Sarajevë/Prishtinë.
23. Riccucci, M. Norma. Ed,(2006). Public Personel Management; current concerns, future challenges, 4th ed. Pearson Lomgman, New York.
24. Robert B. Denhardt dhe Joseph W. Grubbs, Administrimi Publik, Ufo Press, Tiranë, 2007.
25. Rosenbloom, H.D., Kravchuk, S.R., (2005), public administration, Understanding Management, Politics, and Law in the Public Sector, McGraw-Hill, New York.
26. JOVASEVIC, D. (2011), Revija za kriminologiju i krivicno pravo. Institut za Kriminoloska i Socioloska Istrazivanja, Beograd.

27. Kesic, Z. (2012), Revija za kriminologiju i krivicno pravo. Institut za Kriminoloska i Socioloska Istrazivanja, Beograd.
28. Leskoviku, Migena. (2012)., Akti Diskrecial, Ligjërätë e autorizuar, Universiteti European i Tiranës, Tiranë.
29. Mischkowitz, Robert., Heike Bruhn, Roland Desch, Gerd-Ekkehard Hübner, Dieter Beese (2000), "Einschätzungen zur Korruption in Polizei, Justiz und Zoll", Bundeskriminalamt-BKA, Wisbaden.
30. PK (2011), Plan i Zhvillimor Strategjik 2011-2015, Policia e Kosovës, Prishtinë.
31. Policia e Kosovës ,(2014), Strategjia e Trajnimeve 2014-2018, PK, Prishtinë.
32. Policia e Kosovës, (2014), Zyra Ligjore e Policisë së Kosovës; Përgjigje në Kërkesën për Interpretim Ligjor, DPPK-01/04/ZL-2395/2014, Prishtinë.
33. Sahiti, Ejup.,Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, (2014), Komentar, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), Prishtinë.
34. Salihu, Zhitia, Hasani, (2014), Komentar, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), Prishtinë.
35. Sahiti, Ejup., (2006), Argumentimi në Procedurën Penale, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
36. Salihu, Ismet. (2005), E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
37. Salihu, Ismet. (2005), E drejta Penale Ndërkombëtare, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
38. Salihu, Ismet. (2006), E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
39. Schmalleger, F. (2006), Criminal Law Today, Pearson Prentice Hall, New Jersey.
40. Smibert, Jon. (2013), Udhëzues për Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (2013), Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë.
41. Spiro, Spiro.(2012), Vështrim i shkurtër krahasues i disa aspekteve të gjyqësorit në demokracitë bashkëkohore, Ligjërätë e autorizuar, Universiteti European i Tiranës, Tiranë.
42. Strategjia Kombëtare Kundër Korrupsionit dhe Plan i Veprimit 2013-2017, Agjencioni Kundër Korrupsionit (2013), Prishtinë

43. Swanson, R.C. Leonard Territo, Robert W. Taylor. (2005), Police Administration, Structures, Processes and Behavior, Prentice Hall, New Jersey.
44. Tänzler, D.(2008), Review IACSS 2008, Federal Ministry of the Interior, Austria
45. Thibault, A.E., Lawrence M.L., R.B., McBride, (2007), Proactive Police Management, 7th ed, Pearson Prentice Hall, New Jersey.
46. Tomic, Z. (2007), Krivicno pravo II, posebni deo, Pravni Fakultet, Sarajevo.
47. Toska,B., (12 Mars 2013), Edhe “uniformat blu” e shkelin ligjin. Bota Sot, fq.6
48. Vendim, Nr. 1285/2013, Plani i Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e korrupsionit, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Prishtinë.
49. Yzeiri, Bajram.(2002), Ligji dhe Policia, Ilar, Tiranë.
50. Zeneli,Valbona (2012), The Cost of Corruption, per Concordiam, Journal of European Security and Defense Issues, vol.3, Issue 1, Georg C. Marshall European Center for Security Studies, Garmisch-Partenkirchen.

Raporte ndërkombëtare dhe kombëtare

51. EULEX Kosovo,(2014), Compact Progress Report , Prishtinë.
52. European Commission, (2014), EU Anti-Corruption Report, Slovenia.
53. European Commission, (2014), EU Anti-Corruption Report, Austria
54. Institucioni i Ombudspersonit (2008), Raporti i Tetë Vjetor 2007-2008, Prishtinë.
55. Institucioni i Avokatit të Popullit (2011), Raporti i Dhjetë Vjetor 2010, Prishtinë.
56. Institucioni i Avokatit të Popullit (2012), Raport Vjetor 2011, Prishtinë
57. IPK, (2011), Raporti Vjetor 2011, Inspektorati Policor i Kosovës, Prishtinë.
58. IPK, (2012), Raporti Vjetor 2012, Inspektorati Policor i Kosovës, Prishtinë.
59. IPK, (2013), Raporti Vjetor 2013, Inspektorati Policor i Kosovës, Prishtinë.
60. IPK, (2014), Raporti Vjetor 2014, Inspektorati Policor i Kosovës, Prishtinë.
61. IPK, (2015), Raporti Vjetor 2015, Inspektorati Policor i Kosovës, Prishtinë.
62. Komisioni European, (2009) Kosovo 2009 Progress Report, Brussels.
63. Komisioni European, (2013), Kosovo 2013 Progress Report, Brussels.
64. Komisioni European, (2014), Kosovo 2014 Progress Report, Brussels.
65. Policia e Kosovës, (2015), Raporti Vjetor 2014, Prishtinë 2015.
66. Report (2011), On Police Directorate, Work and Security state of play in 2010, Police Directorate, Podgorica, Montenegro.

67. Transparency International Deutschland e.V. (2014), Corruption as a Threat to Stability and Peace, Berlin.

Praktikë Gjyqësore

68. Vendimi, PAKR 158/15, (2016) Gjykata e Apelit Prishtinë
69. Vendimi, PAKR 413/2013, (2016), Gjykata e Apelit Prishtinë
70. Vendim, P.nr. 201/13(2013), Gjykata Themelore Prizren
71. Vendim, P.nr. 1699/12(2014), Gjykata Themelore Ferizaj
72. Vendim, P.nr. 72/2010 (2012), Gjykata Komunale në Podujevë
73. Vendim, KZ.br.236/2012(2012), Gjykata e Qarkut Gjiilan
74. Vendim, P. Nr. 22/12, (2012), Gjykata Themelore në Mitrovicë
75. Vendim, P.nr.272/2007, (2007), Gjykata Themelore Vushtrri
76. Vendim, P.nr. 540/08, (2012), Gjykata Komunale Gjakovë
77. Vendim, P.nr.1115/07, (2012), Gjykata Komunale Gjiilan
78. Vendimi, P.nr.729/2008 (2008), Gjykatës së Qarkut Prishtinë
79. Vendimi, PKR.nr.506/15, (2016), Gjykata Themelore në Prishtinë,
80. Vendimi, P.nr.1222/09, (2010), Gjykata Komunale Gjiilan
81. Vendimi, P.nr.113/07, (2007), Gjykata Komunale Skënderaj
82. Vendimi, PAKR 412/15 (2016), Gjykata e Apelit Prishtinë

Burime nga interneti

1. Antonijević, et al. (2015), Strengthening the Judiciary in Combating Corruption, Komitet pravnika za ljudska prava, YUCOM, Beograd.
<http://antikorupcija.yucom.org.rs/wp-content/uploads/2015/09/Strengthening-the-Judiciary-in-Combating-Corruption-WEB-2.pdf> (08.10.2016)
2. Antonijević, M (2013), Za efikasne pravosuđe protiv korupcije, Komitet pravnika za ljudska prava, YUCOM, Beograd. http://www.yucom.org.rs/wp-content/uploads/2015/04/1363187517_GS0_antikorupcija_web.pdf (5.11.2016)
3. Bayley, David., Perito, Robert. (2011), Special Report, Police Corruption, United States Institute of Peace, Washington.
<http://www.usip.org/sites/default/files/SR%20294.pdf> (10.04.2015)

4. CASIN, (2003), Administration and governance in Kosovo: lessons learned and lessons to be learned, Centre for Applied Studies in International Negotiations (CASIN), Prishtina/Geneva. <https://www.files.ethz.ch/isn/20287/01.2003.pdf>
5. Crime and Misconduct Commission, (2005), Fraud and Corruption Control, Guidelines for Best Practice, Brisbane, Queensland, Australia. <http://www.ccc.qld.gov.au/research-and-publications/publications/prevention/fraud-and-corruption/fraud-and-corruption-control-guidelines-for-best-practice-1.pdf/download> (06.06.2015)
6. Dzhekova, Rositsa., Philip Gouner, Tihomur Bezlov, (2013), Countering Police Corruption: European Perspectives, Center for the Study of Democracy, Sofia. https://www.files.ethz.ch/isn/173386/Report_European_police_corruption_EN.pdf (12.05.2015)
7. IDM (2014), Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Tiranë http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/12/Integriteti_dhe_korrupsioni_web_ENG.pdf
8. IPU & DCAF (2003), Handbook for Parliamentarians: Parliamentary Oversight of the Security Sector; Principles, Mechanisms and Practices, Published by; Inter-Parliamentary Union, Geneva Center for the Democratic Control of Armed Forces. <http://www.ipu.org/PDF/publications/decaf-e.pdf>
9. IPCC, (2012), Corruption in the police service in England and Wales: Second report – a report based on the IPCC’s experience from 2008 to 2011, IPPC, London. https://www.ipcc.gov.uk/sites/default/files/Documents/research_stats/Corruption_in_the_Police_Service_in_England_Wales_Report_2_May_2012.pdf (10.04.2015)
10. Këshilli i Europës, (2006). Projekti CARPO (Zhvillimi i sistemeve policore të besueshme dhe funksionale); Raporti mbi Gjendjen e Krimit të Organizuar dhe Krimit Ekonomik në Europën Juglindore, Strasbourg. https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/organisedcrime/projects/CARPO/Pctc_2006_20alb.pdf
11. Këshilli i Europës, (2015). Raporti i vlerësimit mbi përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit; Projekti Kundër

Kriminologjik në Kosovë; Strasbourg.

https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/assessment_report_sq.pdf (14.10.2016)

12. KIPRED (2014), Lufta kundër Korrupsionit: Analizë krahasuese mes Kosovës dhe Kroacisë, Prishtinë.

http://www.kipred.org/repository/docs/Lufta_Kundër_Korrupsionit-Analizë_Krahasuese_Mes_Kosovës_Dhe_Kroacisë_164083.pdf (10.09.2016)

13. Kos, Drago (2008). Police Corruption. An organisation based problem?, SIAK-Journal – Zeitschrift für Polizeiwissenschaft und polizeiliche Praxis (2), 51-58, Online: http://dx.doi.org/10.7396/2008_2_E.

14. Kubiciel, M. (2009). Core Criminal Law Provisions in the United Nations Convention Against Corruption. International Criminal Law Review, 9(1), 139-155. doi:10.1163/157181209X398853

15. Newburn, Tim. (1999), Understanding and preventing police corruption: lessons from the literature. No. 110. Home Office, Policing and Reducing Crime Unit, Research, Development and Statistics Directorate, London.
<http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/20110218135832/http://rds.homeoffice.gov.uk/rds/prgpdfs/fprs110.pdf> (05.01.2015).

16. OECD (2008), Corruption, A Glossary of International Standards in Criminal Law

<http://www.oecd.org/daf/antibribery/corruptionglossaryofinternationalcriminalstandards.htm> (24.09.2016)

17. OECD (2008), Specialised Anti-Corruption Institutions,
<https://www.oecd.org/corruption/acn/39971975.pdf> (10.11.2016)

18. Yildiz, Muamer. (2001). Culture and Subculture in the Turkish Police Force.(Doctoral Dissertation, University of Leicester), ProQuest LLC, Ann Arbor, Michigan. <https://lra.le.ac.uk/bitstream/2381/30121/1/U144983.pdf> (18.06.2015)

19. United Nations Office on Drugs and Crime (UNDOC),(2011) Corruption in Kosovo: Bribery as experienced by the population, Vienna.

https://www.unodc.org/documents/data-analysis/statistics/corruption/CORRUPTION_KOSOVO_Population.pdf
(02.08.2015)

20. United Nations Office on Drugs and Crime (UNDOC), (2004), United Nations Handbook On Practical Anti-Corruption Measures For Prosecutors And

- Investigators, Vienna. <https://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/Handbook.pdf> (05.08.2015)
21. United Nations Office on Drugs and Crime (UNDOC),(2011) Corruption in Albania: Bribery as experienced by the population, Vienna.
https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/Albania_corruption_report_2011_web_small.pdf (02.08.2015)
 22. U.S. Department of State (2015), Trafficking in Persons Report, Country Reports <http://www.state.gov/documents/organization/245365.pdf> (2015)
 23. Weisburd, David., Rosann Greenspan, Edwin E. Hamilton, Hubert Williams, Kellie A. Bryant, (2000), Police Attitudes Toward Abuse of Authority: Findings From a National Study, National Institute of Justice.
<https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/181312.pdf> (13.03.2015)
 24. Williams, Hubert.,(2002), Core Factors of Police Corruption Across the World, Forum on Crime and Society, Vol2, No1,United Nations, Center for International Crime Prevention, New York.
http://www.unodc.org/pdf/crime/publications/core_factors.pdf (28.02.2013)
 25. Wess, N., Kispert, B.,(2016) Bribery & Corruption, Published by Global Legal Group Ltd, London.
http://www.wkklaw.at/fileadmin/inhalte/Publikationen/Norbert_Bernhard_GLI-B_C2-Austria.pdf (03.11.2016)
 26. <http://www.transparency.org/what-is-corruption>
 27. <http://www1.worldbank.org/publicsector/anticorrupt/corruptn/cor02.htm>
 28. <https://www.kpk-rs.si/en/legislation-and-reports>
 29. <http://www.austria.org/overview>